

# ENVER HOXHA

VEPRA

32



**PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT  
QËNDROR TË PARTISË SË PUNËS TË  
SHQIPËRISË



**ENVER HOXHA**



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

VËLLIMI

32

PRILL 1966 — QERSHOR 1966

SITËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1981



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 32-TË

Në këtë vëllim të Veprave të scrisë të shokut Enver Hoxha përfshihen materiale të periudhës prill-qershor 1966. Këto janë fjalime, diskutime, biseda dhe artikuj, që flasin për probleme të kohës e të perspektivës, për detyra që shtroheshin në atë periudhë para Partisë dhe popullit. Një pjesë e këtyre dokumenteve botohet për herë të parë.

Thelbi i dokumenteve të këtij vëllimi është vazhdimi i vrullshëm i luftës që kishte filluar për revolucionarizimin e jetës së Partisë e të vendit, mobilizimi energjik i komunistëve dhe i punonjësve për të zbatuar idetë e Letrës së Hapur të Komitetit Qendror të PPSH, për të plotësuar detyrat e vitit të parë të planit të katërt pesëvjeçar, që ishte viti kur do të zhvillohej Kongresi i 5-të i Partisë.

Një çështje me rëndësi që spikat në materialet e këtij vëllimi është puna e Partisë me njerëzit, kujdesi i saj për të rritur nivelin ideoteorik dhe ndërgjegjen klasore revolucionare të tyre. Shoku Enver Hoxha theksonte se çdo gjë bëhet me sukses po të mobilizohet populli, po të jetë ai me nerva të tendosur dhe kurdoherë me një frymë të lartë revolucionare. Kjo do të arrihej po të forcoheshin më tej organizatat-bazë të Partisë, për

të cilat, ndër të tjera, ai porosiste: «Organizatat e Partisë ne duhet t'i kthejmë në qendra revolucionare, ku të ziejë mendimi krijues marksist-leninist, të zhduken sektarizmi dhe rutina e një pune të vogël e të fjetur, ku të mësohen njerëzit të mendojnë vetë me kokën e tyre dhe nëpërmjet diskutimeve të zjarra, konstruktive e frytdhënëse të shfaqin mendimet lirisht».

Në dokumentet që përmban ky vëllim duket qartë militantizmi i Partisë, arti i udhëheqjes së saj, metoda shkencore që ndjek ajo në analizën e problemeve, puna plot dinamizëm e klasës punëtore dhe e masave punonjëse. Duke i lexuar ato, çdo komunist e kuadër, çdo punonjës, edhe ai më i thjeshti, gjen shembullin se si duhet vepruar për ta kryer detyrën si revolucionar në punë, në jetë e në shoqëri, gjen argumentet pse janë domosdoshmëri ruajtja dhe forcimi i tipareve të revolucionarit, pse kërkohet që secili të jetë në ballë të luftës për ndërtimin e socializmit.

Në këtë luftë Partia ka vënë kurdoherë në lëvizje masat. Kjo pasqyrohet edhe në disa materiale të rëndësishme të këtij vëllimi, si «Partia dhe organizatat e masave», «Organizata profesionale të përgatitë aktivistë të zjarrtë e me autoritet», «Ai vend që e rrit rininë të shëndoshë politikisht dhe ideologjikisht, ai bën e do të bëjë medoemos përpara». Në këto dokumente spikat vlerësimi i lartë që u bën Partia organizatave të masave, kujdesi i veçantë që tregon ajo për t'i revolucionarizuar gjithnjë e më shumë këto leva të saj. Biseda e ngrohtë dhe shumë e përzemërt e udhëheqësit të Partisë me kuadro e aktivistë të këtyre organizatave është një mësim

me vlerë për të gjithë Partinë dhe kuadrot që punojnë me këto organizata.

Krahas materialeve që trajtojnë probleme të edukimit komunist të punonjësve dhe mobilizimit të tyre për realizimin e planeve në industri, në bujqësi e në të gjithë sektorët e tjerë, në këtë vëllim botohen edhe materiale të rëndësishme me temë ushtarake, për mbrojtjen e atdheut. Në materialet «Forca e ushtrisë sonë qëndron te populli dhe tek udhëheqja e Partisë», «Ta bëjmë të gjithë atdheun mburojë të pakapërcyeshme për armiqtë» etj. argumentohet në mënyrë shkencore marksiste-leniniste domosdoshmëria e kalitjes ideologjike e politike të mbarë popullit e të ushtrisë së tij për të forcuar gjithnjë e më shumë fuqinë mbrojtëse të atdheut. Duke folur për punën e madhe që bën e duhet të bëjë Partia për edukimin e ushtrisë dhe të kuadrove të saj, për forcimin e marrëdhënieve kuadër-ushtar, për forcimin e lidhjeve të ushtrisë me popullin, për kuptimin e lartë të detyrave etj., shoku Enver Hoxha thekson se «Një ushtri është e pathyeshme, kur ajo është një ushtri e punëtorëve dhe e fshatarëve të çliruar, kur ajo është ushtri e diktaturës së proletariatit dhe kur udhëhiqet nga një parti e vërtetë marksiste-leniniste». Ai demaskon përpjekjet e revizionistëve për t'i çarmatosur ideologjikisht, politikisht dhe teknikisht ushtritë e vendeve socialiste, për t'i larguar ato nga rruga marksiste-leniniste.

Në këtë vëllim një vend me rëndësi zë edhe analiza që i bën Partia jonë dhe shoku Enver Hoxha gjendjes ndërkombëtare. Në artikujt «Kongresi i 23-të i PK të BS sanksionoi vijën e përgjithshme të revizio-

nizmit hrushovian, politikën e tradhtisë dhe të kapitullimit», «Grushti fashist në Indonezi dhe mësimet që nxjerrin prej tij komunistët», në bisedat me delegacione të huaja dhe në takime me popullin, me kuadro drejtues të Partisë, të pushtetit e të ushtrisë trajtohen gjerësisht probleme të zhvillimit botëror e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Edhe në këtë periudhë, si në të gjithë jetën dhe veprimtarinë e saj, Partia zhvillonte një luftë të ashpër klasore, pa iu trembur syri, si në planin e brendshëm, ashtu dhe kundër revizionizmit modern me atë sovjetik në krye e kundër imperializmit me atë amerikan në krye. Duke folur për Kongresin e 23-të të PK të BS, shoku Enver Hoxha thekson se «... ai ishte kongresi i «ngrirjes» së të gjitha problemeve që preokupojnë sot popullin sovjetik», ishte kongresi i hrushovizmit pa Hrushovin, i vazhdimit me vendosmëri të politikës proimperialiste. Ky vlerësim real ishte një goditje edhe për ata që ushqenin iluzione se me rrëzimin e Hrushovit diçka do të ndryshonte.

Në këtë luftë klasore brenda dhe jashtë vendit, Partia jonë ka vepruar kurdoherë në mënyrë parimore dhe me konsekuencë. Shoku Enver Hoxha theksonte: «Në qoftë se ndokush nuk e kupton mirë rëndësinë e kësaj lufte klasore, ai nuk do të jetë në gjendje t'i mbrojë interesat e socializmit e të revolucionit». Për këtë çështje Partisë sonë i është dashur të ndeshet edhe me udhëheqësit revizionistë kinezë, t'u kundërvihet tezave të tyre antimarksiste. Kjo pasqyrohet edhe në diskutimin që titullohet «Me këto teza të kinezëve nuk mund të jemi dakord».

*Studimi i materialeve të këtij vëllimi, të cilat kanë një vlerë të madhe aktuale, do t'i ndihmojë komunistët, kuadrot dhe masat punonjëse për t'i gjykuar problemet më thellë e për t'i parë ato kurdoherë me sy klasor e revolucionar; do t'i frymëzojë ata për të zgjidhur drejt detyrat që u dalin në jetën e përditshme, për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut.*



## PARTIA DHE ORGANIZATAT E MASAVE

*Fjala në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

8 prill 1966

Problemet që shtruat këtu dhe mendimet tuaja lidhur me to janë të rëndësishme e me interes. Eksperiencën që sjellim nga baza ta studiojmë, të përcaktojmë se ku janë të mirat dhe ku janë dobësitë, ta përgjithësojmë atë dhe t'ia kthejmë bazës të përpunuar me detyra të reja. Kjo duhet të jetë metoda e punës që duhet të praktikojmë.

Mirë bëtë që, problemet e nxjerra nga puna ku ishit në bazë, ua keni rekomanduar shokëve të rretheve për t'i zgjidhur, por rëndësi ka që vetë ata të mësohen të punojnë me një metodë e stil të ri, revolucionar, të jenë më të thelluar në këto çështje. Një shok ngriti këtu shumë probleme. Kur po diskutonte për futjen e gruas në punë, problem ky që është ngritur vazhdimisht, unë pritja që ai të thoshte edhe rrugën e zgjidhjes. Ajo punë individuale që bëhet me një grua,

---

1 Në këtë mbledhje u raportua nga përgjegjësit e ekipeve që ishin në disa rrethe gjatë muajit mars.

duke i thënë «të vejë punëtore në bujqësi», është me vlerë, por jo e gjitha. Do të ishte mirë që, për të shpjeguar përse duhet zëvendësuar puna e burrit me gruan në disa procese pune, ky shpjegim të bëhej jo në mënyrë të përciptë, vetëm nga ana praktike, por ideologjikisht dhe politikisht, ashtu siç bëri Hysniu tani që ishte në Vlorë. Atje ai u mbajti grave një fjalim të argumentuar mirë për rëndësinë shoqërore të punës, duke vënë në dukje karakteristikat mikroborgjeze të disave prej tyre dhe qëndrimin heroik të grave që punojnë; u tha ç'gjë është e mirë dhe cila është e keqe; kritikoi ato që zgjedhin punën më të lehtë; foli për dëmin që ka njeriu kur rri pa punë dhe përfitimet që ka kur punon. Më në fund u tha se kush dëshiron të punojë atje ku ka punë, le të vejë që të nesërmen në komitetin ekzekutiv ku do t'i thuhet vendi i punës dhe të fillojë. Me një punë të tillë bindëse u hapet njerëzve perspektiva, u hidhen poshtë pikëpamjet mikroborgjeze mbi punën.

Çështjen e kam se tani që u kthyet nga rrethet<sup>1</sup>, këto probleme, ashtu siç i ngritët këtu, i klasifikoni mirë dhe i përpunoni. Me këto konkluzione të ndihmojmë edhe komitetet e Partisë, të cilat kanë nevojë për ndihmën tonë. Këtë ndihmë, para se t'ua japim, ne duhet ta mendojmë më mirë se ç'vlera ka.

Të marrim punimin e Letrës së Hapur të Komitetit Qendror, për të cilën folën shokët. Ne nuk mund të shkarkohemi nga përgjegjësia duke menduar se tani i kemi dhënë kompetenca bazës, prandaj ajo le të ve-

---

1 U drejtohet përgjegjësve të ekipeve.



projë dhe të punojë vetë. Është e vërtetë që kompetenca i kemi dhënë bazës, po ndihmën e nevojshme për punimin e Letrës së Komitetit Qendror nuk ia kemi dhënë si duhet. Ne duhet të nxjerrim disa udhëzime të qarta politike dhe ideologjike, qoftë si duhet të punohet Letra, ashtu edhe për një varg problemesh të tjera, për të cilat, siç e thatë edhe ju, baza ka nevojë. Këto konkluzione dhe udhëzime duhet t'i bëjmë ne, që nga aparati, për të gjitha rrethet. Mirëpo në qoftë se ju, siç kërkoni, do të qëndroni në rrethe më shumë, atëherë kush do t'i përgatitë këto materiale, ne, sekretarët e Komitetit Qendror? Duhet të jeni ju që t'i përpunoni dhe t'i hartoni ato për çdo sektor, natyrisht, duke ju dhënë edhe ne mendimet tona.

Mendimet që ju dhatë këtë radhë dhe ato të mbledhjes së mëparshme janë plotësisht të drejta, vetëm se duhet të punohen, të zhvillohen dhe të konkretizohen më mirë, gjë të cilën duhet ta bëni ju vetë. Do të ketë raste që mund të qëndroni edhe 20, edhe 25 ditë në bazë, por qëndrimi juaj nuk duhet të jetë qëndrim prej inspektori, po prej instruktori, jo për t'i thënë, ta zëme, shefit të tregtisë çfarë duhet të bëjë, po për ta bërë së bashku me të atë që duhet, domethënë të dalësh edhe vetë para sekretarëve të organizatave-bazë ose përpara një grupi grash dhe, për një problem që i preokupon ata, t'u flasësh në një nivel të lartë politik e teorik. Me këtë mënyrë ti, si instruktor i Komitetit Qendror, ke bërë dy punë: së pari ke sqaruar masat për një problem që i preokupon ato dhe, së dyti, u ke dhënë shembullin punonjësve përkatës se si duhet të punojnë edhe ata për të sqaruar masat.

Pastaj ju e dini se për ç'probleme veni në bazë. Për to mund të merrni edhe të dhëna me vete dhe kështu ditën punoni e natën reflektoni, përgjithësoni çështjet. Në këtë mënyrë ju jepni shembullin tuaj të mirë, se si duhen trajtuar problemet. Kështu atje njerëzit mësojnë dhe aftësohen më tepër, kurse qendra lehtësohet nga barra e përgjithësimi të këtyre çështjeve që duhet t'i zgjidhë baza dhe i jepet mundësia të merret me disa përgjithësime të tjera, të cilat do të ndihmojnë në forcimin e punës së Partisë në shkallë më të gjerë, për të gjithë vendin.

Problemet që ju sollët nga baza e që i diskutuam këtu në mënyrë të organizuar t'i përpunojë secili sipas sektorit të vet. Këtu u ngrit, për shembull, problemi i ndërtimit të Partisë. Duhet organizata të përgjithshme në kooperativat bujqësore apo jo, kjo është një diçka tjetër, por nuk do të lejojmë që të kemi njëqind lloje ndërtimesh në Parti. Ato që u thanë për këtë çështje dhe i morët në shënim, shokët e sektorit të Statutit të Partisë t'i diskutojnë me ju dhe brenda dy-tri ditëve t'i studiojnë në detaje; mbasi të kenë shkuar edhe në dy-tri vende t'i përpunojnë dhe të vijë këtu në Sekretariat me propozime konkrete për të dhënë udhëzime, se si duhet të kuptohen e të interpretohen orientimet e Byrosë Politike mbi ndërtimin e organizatave të Partisë. Kështu duhet vepruar edhe për probleme të tjera.

Doja të thosha diçka edhe për emulacionin socialist. Ta kemi si parim, që kur vendosim të studiojmë një problem, si ata që ngarkohen ta studiojnë, ashtu edhe ata që bëhen objekt pyetjesh, nuk duhet ta ma-

rrin këtë si një gjë të vendosur. Prandaj për sa u përket marrjes së zotimeve, garave dhe emulacionit, udhëzimet e dhëna qëndrojnë në fuqi, sepse nuk kemi marrë ndonjë vendim të kundërt. Në qoftë se paska raste që udhëzimet keqinterpretohen, sikur nuk qenka i nevojshëm emulacioni, meqë planin e hartojnë punëtorët dhe ata ç'kishin për të thënë e thanë, të qëndrohet dhe të bëhet sqarimi. Po pse, me këtë plan që bëmë ne, i kemi shfrytëzuar të gjitha mundësitë dhe rezervat tona dhe s'ka përse të vrasim mendjen më tej? Këto mendime janë të gabuara dhe duhen kritikuar. Mendime të tilla përhapen aty ku puna politike e Partisë nuk është e gjallë dhe kur nuk është e tillë, kjo do të thotë që bindja e njerëzve nuk është akoma e kalitur në atë nivel saqë edhe një njeri i thjeshtë në fabrikë, po ta dëgjojë nga ndonjë që ta thotë se këtë e tutje nuk ka nevojë më për emulacion, të ngrihet e ta kritikojë. Ndryshime në formën e marrjes së zotimeve për garat e emulacionit mendoj se mund të bëjmë dhe, meqenëse duhet bërë ky studim, ai të synojë për një organizim më të mirë të garave dhe të emulacionit socialist. Por orientimet për një studim nuk duhen marrë si vendim, kjo nuk është e lejueshme. Kur të paraqitet studimi për shqyrtim, ai mund të aprovohet edhe tërësisht, por mund të ndodhë që gjysma ose një e treta e propozimeve të mos aprovohen, prandaj, pa u vendosur, nuk duhen marrë si direktiva. Ta kuptojmë drejt këtë çështje. Ju shokët e Bashkimeve Profesionale e përgatitni studimin që jeni duke bërë, shikojeni edhe me shokët e sektorëve përkatës në aparatin e Komitetit Qendror dhe na e paraqitni për ta shqyrtuar në Sekretariat.

Ju, pra, jeni përçuesit dhe marrësit e eksperiencës së bazës, përgjithësuesit e kësaj. Këtë eksperiencë ne duhet ta konkretizojmë më gjerë e me një përgatitje të plotë morale, politike, ideologjike, organizative, ekonomike dhe t'ia dërgojmë bazës si shembull dhe orientim.

Diskutimi im sot do të jetë mbi Partinë dhe organizatat e masave pse në përgjithësi edhe diskutimet tuaja u përqendruan në këto probleme. Këto që do të shtrij janë çështje të mëdha ideologjike, politike, organizative etj., po mund të mos jenë të plota. Ne duhet të reflektojmë më thellë mbi to dhe t'i plotësojmë.

Partia udhëheq popullin shqiptar, udhëheq dhe edukon masat e gjera të popullit, udhëheq dhe frymëzon organizatat e masave: Frontin Demokratik, bashkimet profesionale, organizatën e rinisë dhe atë të gruas.

Këtu s'ka asgjë të re, por në drejtimin e punës së Partisë, në organizimin dhe në dhënien nga ana e saj të ndihmës për këto organizata, që janë leva të rëndësishme të Partisë, ka shumë gjëra të vjetra, shumë pikëpamje sektare, simpliste, mosinteresim, nënvleftësim, forma pune arkaike që nuk u përgjigjen momenteve.

Dhe e keqja është se forumet e Partisë në rrethe, në ndërmarrje ose në fshat, nuk bëjnë përpjekje, nuk preokupohen fare në disa vende të sjellin një freski në punë, të thellohen mbi problemet që i preokupojnë këto organizata dhe të mendojnë për të gjetur forma e metoda të reja pune për cilëndo prej tyre.

Në përgjithësi forumet e Partisë, kur studiojnë dhe vendosin për ndonjë problem, ndjekin këtë rrugë: për-

caktojnë detyra të përgjithshme e të veçanta, detyra ekonomike në radhë të parë, kurse detyra politike shumë rrallë, me përjashtim të rasteve kur vetë problemi ka karakter politik.

Politika e problemit kurdoherë presupozohet dhe këtu qëndron një nga gabimet e forumeve të Partisë, sikur ajo të ishte e njohur nga masat, gjë që nuk është reale. Forumet presupozojnë se kjo është një punë «e lehtë» që vetë komunistët do ta bëjnë me masat në praktikë, por kjo ose s'bëhet si duhet ose nuk bëhet fare, kurse vetë nuk i vënë rëndësinë e duhur kësaj ane kaq të rëndësishme të problemit.

Në detajimin e detyrave thuhet se organizatat e masave do të përcaktojnë edhe anët politike të problemit. Kjo bëhet shumë keq ose nuk bëhet fare, sepse forumi udhëheqës ka ngjallur një frymë simpliste në punë, e cila është transmetuar edhe poshtë. Forumi kënaqet më të shumtat e rasteve me marrjen në shqyrtim të problemit dhe, duke përdorur format e vjetra në punë, e shtron atë në mbledhje të ndryshme të organizatave të Partisë. Por këtu, natyrisht, problemi shtrohet me mjaft të meta nga fryma dhe nga përmbajtja, në formë simpliste, jo i shoqëruar me konsiderata të veçanta moralo-politike dhe organizative, sepse udhëheqja vazhdon të presupozojë duke u mbështetur në mendimin e drejtë se organizata-bazë duhet të vetëveprojë, të vetëmendojë dhe të krijojë forma të reja pune, sipas vendit, rrethanave dhe gjendjes moralo-politike e kulturore të kolektivit.

Veçse në më të shumtat e rasteve jo vetëm organizatat-bazë, por as anëtarët e plenumëve të komiteteve

të Partisë të rretheve nuk reagojnë në këto drejtime, nuk e ndiejnë veten sa duhet përgjegjës, nuk mobilizohen dhe nuk e vrasin mendjen sa duhet, qoftë si forum drejtues, qoftë si pjesëtarë të tij, për zbatimin në jetë të problemit në mënyrë revolucionare, për të bërë shpjegime plotësuese, për të aplikuar forma të reja krijuese. Ata e pranojnë vendimin dhe personalisht e zbatojnë atë sa të jetë e mundur më mirë, por, për sa i përket punës së gjerë e të organizuar me masat, asnjë nuk ndien përgjegjësi me përjashtim të atij që merret posaçërisht me rininë, me gruan, me bashkimet profesionale, lëre pastaj organizatës së Frontit që nuk i vënë rëndësi fare. Forumi udhëheqës, pasi diskuton problemin dhe merr vendimin, ashtu si e merr, mirë ose me të meta, e quan punën të mbaruar dhe, kur ka si pjesëtarë të tij përfaqësues të organizatave të masave, mendon se i lehtëson telashet, se vetë udhëheqësit e këtyre organizatave e kanë problemin të qartë, prandaj pa u dhënë ndonjë ndihmë të veçantë thotë: «Le të venë ta shtrojnë problemin në organizatat e tyre, me metoda dhe me forma, natyrisht, që ata i dinë, ndërsa forumi s'ka pse të preokupohet» dhe e fle mendjen.

Sekretarët e forumit as përpara as më vonë nuk i preokupon fare çështja nëse organizatat e masave, që janë levat e Partisë, kanë nevojë për ndonjë ndihmë më të gjerë politike, ideologjike ose organizative për shtruarjen si duhet të problemit. Kjo ndihmë u jepet shumë rrallë, atëherë kur u kërkohet dhe u kërkohet gjithashtu rrallë. Por, edhe në këto raste organizatat e masave përcillen me formula stereotipe, të përgjith-

shme, sepse sekretarët as që kanë menduar për një gjë të tillë, bile këtë e quajnë kohë të humbur; sipas tyre për këtë çështje duhet të mendojnë vetë forumet e organizatave të masave, pasi ata kanë punë të tjera. Po të analizohen në hollësi punët që kryejnë shokët e forumit gjatë ditës dhe përdorimi i gjithë kësaj kohe të vlefshme, do të rezultojë se pjesa më e mirë e saj përdoret për çështje shumë më pak rentable nga detyra në fjalë që na preokupon. Kjo është bërë një vijë dhe këndej rrjedh se forumet dhe veçanërisht sekretarët e tyre njohin përcipërisht gjendjen e organizatave të masave, punën e tyre, problemet dhe hallet e tyre, që janë probleme të masave, të popullit.

Atëherë del pyetja: I njeh apo nuk i njeh forumi i Partisë problemet e masave? Ai i njeh, po në mënyrë të çalë, jo nëpërmjet organizatave të masave, por më shumë nëpërmjet organizatave të Partisë dhe kryesisht në kontaktet me sekretarët e organizatave-bazë. A ka gjë të keqe këtu? Jo, të keqe s'ka, po ka të meta dhe e meta kryesore qëndron në atë që kur themi se organizatat e masave janë levat e Partisë, në praktikë s'janë plotësisht të tilla. Ne themi se Partia drejton masat në mënyrë të organizuar, i frymëzon, i mobilizon ato, por në praktikë nuk bëhet plotësisht kështu.

Ka organizata partie që udhëzojnë e drejtojnë, duke lënë pas dore organizatat e masave, duke e reduktuar punën e Partisë në një udhëzim shumë herë formal që u jep forumeve të këtyre organizatave dhe vetë komunistët qëndrojnë krejt në pasivitet si anëtarë të këtyre organizatave. Komunistët nuk kanë kuptuar si duhet se organizata-bazë e Partisë i edukon e i arma-

tos ata që të shkojnë në masë, domethënë në organizatat e masave ku bëjnë pjesë dhe atje të organizojnë, të drejtojnë, të mobilizojnë, të gjallërojnë organizatën e masave, të përdorin gjallërisht format e punës së saj, të krijojnë forma të reja, të ndihmojnë forumin e organizatës, të jenë të bindur dhe të zbatojnë udhëzimet e forumeve të organizatave të masave ku bëjnë pjesë, sepse këto forume punojnë në bazë të direktivave të Partisë, sipas specifikave të veçanta të çdo organizate. Jo, kjo nuk kuptohet kështu, nuk kuptohet drejt as nga forumet as nga sekretarët e organizatave-bazë të Partisë as nga komunistët. Si rrjedhim, Fronti e ka humbur gati krejt aktivitetin, pas tij vjen organizata e gruas, pastaj bashkimet profesionale dhe më në fund disi më kompakte është organizata e rinisë.

A është drejt kjo punë? A është e shëndoshë kjo situatë? A do të vazhdojmë ne kështu? Në asnjë mënyrë, jo!

Isha në Fabrikën e Gomës në Durrës, ku pashë përparime të mëdha, pashë një kolektiv kompakt, dinamik, burra, gra dhe të rinj, plot iniciativë e gjallëri. Duket që atje Partia nuk punon keq dhe ka rezultate. Por kur u futa në hollësi, në punën e Partisë gjeta formalizëm, shabllonizëm, rutinë. Pashë të reja dhe të rinj dinamikë e të zgjuar, asnjë prej tyre nuk ishte me shkollë fillore, të gjithë ishin me 7-vjeçare e me gjimnaz. Pyeta kush ishte sekretari i rinisë dhe më treguan një inxhinier që mund të ishte rreth 30 vjeç. Midis tyre i thashë një vajze të re shpuzë, nëse mund ta bënte ajo punën e sekretares së rinisë dhe m'u përgjigj serbes: «Patjetër mund ta bëj, shoku Enver, po të më zgjedhin,



unë jam rritur në organizatë dhe e njoh mirë rininë në fabrikë». Shihni, pra, çfarë sektarizmi!

U interesova për organizatën e gruas në këtë fabrikë ku punojnë shumë gra dhe bisedova me kryetaren. Ajo ishte shumë e re. Unë apostafat e pyeta: «Sa fëmijë ke?». M'u përgjigj: «Jam vajzë e re dhe e pamartuar». Pavarësisht se ajo është shoqe e mirë, ashtu si dhe inxhinieri që është sekretar i rinisë, por shihni, sekretar të rinisë vënë një burrë 30-vjeçar, ndërsa kryetare të organizatës së gruas një të re 20-vjeçare! Ky është mosthellim në problemet, nënvleftësim i organizatave të masave, i problemeve dhe i jetës së tyre.

Por, mosinteresimin për organizatat e masave e vuara re edhe në një punë kryesore. Pyeta sekretarin e organizatës së Partisë se si u punua atje Letra e Hapur e Komitetit Qendror. Dhe ai më tregoi se u punua dobët. Unë nuk do të trajtoj këtë anë të çështjes, por dua të them se mezi ia nxora, si «me darë» e përmendi ai emrin e Frontit. Ai e kishte harruar krejt, jo vetëm Frontin, po kur e pyeta si e keni punuar Letrën në organizatat e masave, m'u përgjigj: «E punuam vetëm në organizatën e rinisë». Ata as e kishin marrë mundimin dhe as e kishin vënë ujët në zjarr ta punonin Letrën në bashkimet profesionale dhe në organizatën e gruas. Kur e qortova sekretarin për këtë, ai u skuq si paparunë, ishte një mësim për të, po fakti është i hidhur dhe kjo e shumë të dhëna të tjera vërtetojnë konkluzionin për të cilin fola më sipër.

Shembuj ka plot, sa të duash, por nga këta duhet të nxjerrim konkluzione dhe të udhëzojmë Partinë deri në bazë ta korrigojë sa më parë këtë gjendje jo të mirë.

Ku qëndrojnë arsyet e këtyre dobësive në punë? Unë do të përpiqem të vë në dukje disa prej tyre, sepse, sipas mendimit tim, ka edhe shumë të tjera.

E keqja kryesore qëndron në atë që njerëzit e udhëheqjes në radhë të parë, nuk e vrasin sa duhet mendjen që me kulturën dhe me eksperiencën që kanë fituar të jenë novatorë dhe studiues të fakteve, të ndodhive, të eksperiencës dhe të nxjerrin konkluzione e mësimë të mëtejshme për të forcuar punën. Metoda e punës së vetedukimit të tyre, qoftë me anë të shkollës, qoftë si autodidaktë, është shumë e dobët dhe shumë e vjetër. Më të shumtat e herës ata as që e vënë fare ujët në zjarr. Prandaj të mos çuditemi nga ai shembulli që thatë ju që në Korçë të thonë: «Ç'na duhet tani shkolla». Organizimi i punës për të mësuar marksizëm-leninizmin si teori udhëheqëse në punën e tyre, për të studiuar me kujdesin më të madh eksperiencën marksiste-leniniste të Partisë sonë, shkrimet, rezolutat dhe vendimet e ndryshme të saj, si duket bëhet me shumë dobësi. Drejtuesit duhet ta kenë të qartë se nuk mund të ecet pa mësuar, pa mësuar seriozisht dhe jo vetëm marksizëm-leninizmin, por pa u pajisur edhe me kulturë të përgjithshme. Por, a ecet vetëm me njohuri praktike, të gjëmtuara andej-këtej? Kjo shkakton që të mos arrihet të bëhen përgjithësime, të mos nxirren konkluzione, të mos shpiken forma e metoda të reja pune partie, ashtu sikurse bën novatorizma në uzinë punëtari, i cili e di mirë zanatin e tij.

Shumë drejtues flenë mbi këtë rutinë, bredhin lart e poshtë, bëjnë «mizën» e kalit të arabasë nën titullin e drejtuesit të Partisë. Natyrisht, ata kështu

frenojnë ecjen e punës përpara. Këta drejtues, që e duan Partinë dhe janë gati të bëjnë fli edhe jetën e tyre për të, duhet ta kuptojnë qartë se kanë mbetur mjaft prapa nga shumë njerëz që jo vetëm s'janë në udhëheqje, por nuk janë as anëtarë partie dhe që Partia u ka besuar atyre detyra me rëndësi, të cilat i kryejnë me një frymë të lartë partie.

Vallë, ç'përshtypje do t'u bëjë këtyre njerëzve pa parti, po me partishmëri të madhe në punë, një drejtues partie me nivel të ulët, që merret me cikërrima, kur ata vetë t'i kërkojnë mendimin dhe ndihmën e Partisë? Natyrisht, përshtypje të keqe. T'i pyesim këta drejtues të mefshtë e pa vullnet për të ecur përpara, për të mësuar, për t'u ngritur në nivelin e vërtetë të udhëheqësit: e dëmtojnë apo jo punën e Partisë? Pra, në interesin e Partisë ata duhet t'i vënë gishtin kokës dhe të lëvizin sa më parë.

Po të shkojmë në organizatën-bazë në këtë drejtim kemi dobësi akoma më të mëdha, të cilat janë refleksi i punës së dobët të udhëheqjes dhe të karakteristikave të metodës së punës së saj.

Në përgjithësi organizatat-bazë të Partisë në fshat, si organizata udhëheqëse që duhet të jenë, janë të dobëta. Atje dominon puna praktike, puna në ara, në bujqësi. Komunistët kooperativistë në bujqësi punojnë mirë, bëjnë përpjekje për të renë, dallohen, por rrallë ngrihen ata mbi fshatarët e tjerë me tërë kuptimin e fjalës si komunistë, si udhëheqës për të kryer me kompetencë detyrat e mëdha të Partisë. Ndodh që sekretari i organizatës së Partisë në fshat ka nivel më të ulët nga kryetari i kooperativës, prandaj në raste të tilla proble-

met e organizatës së Partisë atje janë reduktuar në një skematizëm skeletik.

Po të marrim pranimet në Parti për disa vjet me radhë sidomos në fshatra, por edhe në qytete, do të gjejmë me mijëra komunistë që kanë nga 10 e më shumë vjet që janë pranuar në Parti, por që kanë mbetur në vend, s'kanë bërë asnjë hap përpara, s'janë ngritur mbi masën. Kur janë pranuar në Parti, nga ana e karakteristikave ata kanë qenë të mirë. Edhe tani janë të mirë e besnikë të Partisë, por kanë ngelur prapa, s'janë në pararojë, por në praparojë, ata mburren vetëm me vjetërsinë në Parti, kjo është e gjithë pasuria e tyre. Mirëpo kjo pasuri për ta, bëhet e dëmshme për Partinë, sepse, duke ruajtur dhe duke zbatuar kriteret e rritjes së Partisë dhe të pranimeve, ky kontingjent anëtarësh partie pa aktivitet bëhet një pengesë serioze për futjen e gjakut të ri revolucionar në Parti. Organizata e Partisë me një numër të tillë anëtarësh të mefshtë, humbet kombativitetin, zvarritet në bisht të situatës, s'mund të gjendet si duhet në krye të punëve, s'ka si i ndihmon gjithë këta njerëz të rinj revolucionarë të mësuar nga Partia, që kanë sulmuar fshatin dhe do ta sulmojnë çdo ditë e më shumë; kështu krijohet brenda në organizatën-bazë një gjendje e sëmurë, ku mbretërojnë praktikizmi i vogël pa horizont, mentaliteti i vogël fshatar, tarafet, grindjet, thashethemet.

Në këtë gjendje, si mund të mendohet seriozisht që shumë anëtarë partie në fshat, që janë analfabetë ose vetëm me një shkollë fillore dhe nuk bëjnë përpjekje të ngrihen nga praktikizmi i tyre, të këshillojnë ose të

drejtojnë armatën e mësuesve, të agronomëve, të mjekëve, të veterinerëve që kanë mbuluar fshatin?

Ky është një problem serioz, shokë, që duhet të na preokupojë jashtëzakonisht. Këtu hyn edhe çështja e drejtimit dhe e aktivizimit nga Partia të organizatave të masave sidomos në fshatra, por edhe në qytete.

A mund t'i drejtojë organizata-bazë e Partisë në fshat këto organizata, t'u hapë atyre horizonte pune për problemet e ndryshme, për disa nga të cilat do të flas pak më poshtë, kur vetë udhëheqja e rrethit mendon shumë pak për këto organizata masash, kur ajo i ndihmon aq pak, sepse nuk e studion problemin seriozisht për gjithsecilën, kur vetë udhëheqja e Partisë në rreth rron me një punë ku dominon një stil e metodë pune praktike e vogël, që, kur arrin deri në fshat, bëhet krejt e paqenë? Ky frymëzim ose udhëzim krejt i paqenë, duke gjetur në fshat një organizatë partie të fjetur, varroset përfundimisht, saqë atje organizatat e masave shpesh rrojnë vetëm në emër.

E keqja e dytë qëndron në atë që udhëheqësit e Partisë dhe komunistët në përgjithësi, nuk kanë kuptuar si duhet nevojën e ngutshme të edukimit të thellë, me rrënjë, me vazhdimësi, me këmbëngulje, të ngritjes së përgjithshme arsimore, kulturore, teknike, morale të njerëzve, të punonjësve. Megjithëse mundësitë janë krijuar, forma e mjete ekzistojnë, edhe kuadro të kualifikuar ka dhe po shtohen çdo vit, spontaneiteti në këtë drejtim është i theksuar.

Interesimi për ekonominë është i kënaqshëm, por nuk mendohet sa duhet dhe si duhet se prodhimi varet nga njerëzit. Për ngritjen e njeriut nga çdo pikëpamje

çalojmë, pikërisht nga pakujdesia jonë. Të kuptohemi, njerëzit në vendin tonë kanë bërë përparime, qoftë në njohuritë teknike, qoftë në ngritjen politike dhe në atë ideologjike, por ne nuk duhet të kënaqemi me këto rezultate të arritura; kur i krahasojmë me të kaluarën ose edhe nga një vit në tjetrin, ne duhet të vërejmë boshllëqet e mëdha që kemi, ta matim përparimin e bërë me mundësitë e mëdha që kemi dhe që nuk i shfrytëzojmë; rezultatet e arritura t'i krahasojmë me kërkesat e shumta të kohës që ecën dhe me nevojat e ekonomisë, të kulturës, të jetës së re në përgjithësi që zhvillohen.

Në qoftë se udhëheqësit e forumeve të Partisë e të pushtetit do të largohen nga praktikizmi, të cilin ka kush e bën dhe e bën mirë, dhe të studiojnë më thellë e më mirë problemet kyçe, të procedojnë me konsultime serioze me njerëzit, njëkohësisht të kuptojnë edhe më mirë gjendjen, të mësojnë më shumë nga kuadrot kompetentë dhe pastaj të bëjnë konkluzione serioze për mbarëvajtjen e punës dhe këto konkluzione, më parë se t'i zbatojnë, t'ia nënshtrojnë një kontrolli teorik, politiko-shkencor, duke studiuar veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit jo të tëra në bllok, por posaçërisht për çdo problem, nëse do t'i bëjnë këto, atëherë do të kemi me të vërtetë një punë shumë serioze, shumë të kualifikuar, me të cilën do të edukojmë si duhet Partinë të udhëheqë dhe të drejtojmë me të vërtetë si pararojë.

Një udhëheqës partie ose shtetëror që punon me një frymë e metodë të tillë, kur shkon në mbledhje, në aktiv e në organizatën-bazë flet jo me formula, jo me fraza

stereotipe, por me kompetencë të madhe. Kjo punë serioze i edukon njerëzit të ecin po në këtë rrugë.

Këtu nuk është çështja të japim vetëm recetën dhe njëri t'ia transmetojë këtë tjetrit sikundër ngjet, kryesorja është të gjejmë ilaçin, të bëhemi vetë farmacistë, por ilaçi që rekomandon receta nuk duket gjekundi. Të japësh recetën është njëra anë, kurse përgatitja e ilaçit është ana tjetër, kryesorja, vendimtarja që ne duhet ta përmirësojmë me metoda të reja pune.

Pra, këto që themi, po nuk u zbërthyen nga çdo forum partie, nga çdo udhëheqës, nga çdo komunist në punën që i është ngarkuar, në punën kolektive, në ndërgjegjen e tij dhe në ngritjen e personit të tij, të tëra këto do të mbeten slogane, parulla pa brendi ose me një brendi të zbehtë.

Ne theksojmë me të drejtë se shembulli i komunistëve duhet të udhëheqë dhe të edukojë të tjerët. Komunistët duhet të jenë shembull në jetë, në prodhim, në udhëheqje.

Të marrim shembullin e komunistit në prodhim dhe në udhëheqje.

Nga ana e komunistit, bëhen përpjekje më të dukshme për ngritjen në punë, në prodhim, kurse si udhëheqës, për ngritjen e tij politike, ideologjike dhe nga ana e kulturës së përgjithshme, ecet shumë ngadalë, në mënyrë jo të organizuar e të sistemuar dhe pa shumë perspektivë.

Nga ana profesionale komunisti e ndien nevojën e ngritjes, bën përpjekje i shtyrë nga fakti se duhet të punojë, të prodhojë dhe të hajë.

Komunisti interesohet, pra, më shumë për prodhi-

min dhe këtu luan rol ana subjektive, personale, rrjedhimisht interesohet të ngrihet teknikisht, kurse për ngritjen ideologjike dhe politike nuk interesohet si duhet, sepse imediatisht nuk sheh rrjedhime ekonomike për veten e tij, nuk sheh si duhet lidhjen e tyre me çështjet ekonomike, qoftë në kuadrin e përgjithshëm, qoftë në kuadrin e ngushtë personal.

Kurse kategoria e komunistëve që nuk punojnë në prodhim i jep rëndësi më shumë ngritjes politike, ideologjike, sepse natyra e punës këtyre ua lehtëson disi këtë nxitje. Por edhe kësaj kategorie komunistësh lënda imediate i intereson më shumë. Këta komunistë bëjnë përpjekje më shumë të zhvillohen në zanatin e tyre, por nuk e shohin drejt thyerjen e këtyre kornizave dhe ca më pak përgjegjësinë e tyre të madhe që si komunistë, pra, si udhëheqës, kanë detyra më të mëdha, më të gjera, më të koklavitura.

Kemi pastaj kategorinë tjetër të komunistëve që janë punëtorë partie. Kësaj kategorie, natyrisht, i kërkohet të kryejë detyra të rënda, me përgjegjësi, të shumanshme, të koklavitura. Këta, pra, janë udhëheqës të zgjedhur, se udhëheqës konsiderohen të gjithë anëtarët e Partisë. Punonjësit e kësaj kategorie duhet të mësojnë, të organizojnë, të përgjithësojnë, të edukojnë të gjithë komunistët. Supozohet, pra, që këta punonjës partie, udhëheqës, të zgjedhur ose të emëruar, të jenë më të ngritur nga masa e Partisë. Derisa detyrat e këtyre punonjësve partie janë të shumanshme, edhe ngritja e tyre duhet të jetë e shumanshme, në radhë të parë e mjaftueshme për drejtimin e punës së caktuar. Porsa ngrihet në instanca të ndryshme të Partisë një



komunist i kësaj kategorie, ai duhet jo vetëm të bëjë përpjekje që të zgjerohen dijenitë e tij në drejtimin e punës speciale, por edhe në të gjitha drejtimet e tjera, natyrisht, pa i kërkuar këtij gjënë e pamundur për të qenë një enciklopedist i përsosur. Këtë anë e kompenson i gjithë kolektivi i Partisë dhe i njerëzve pa parti, të cilët Partia i ka bërë të aftë për çdo drejtim. Rëndësi ka çështja që udhëheqja të dijë t'i shfrytëzojë me mend këto pasuri e në mënyrë rentable dhe që ta bëjë këtë, vetë punëtori ose udhëheqësi i Partisë duhet të jetë i ngritur, të mos provojë ndjenjën e inferioritetit dhe kjo dobësi të mos e shtyjë atë të fshehë paditurinë e tij për të keqpërdorur këtë thesar diturish që kanë punonjësit e tjerë, ose të mos e përdorë fare nga frika se mos i dalë boja paditurisë së tij.

Këtu ekziston një rrezik i parë që punën nuk e lë të zhvillohet me atë hov revolucionar që kërkohet. Ne nuk mund të themi se kuadrot tanë në përgjithësi nuk janë ngritur dhe në veçanti komunistët si udhëheqës, si dhe punonjësit e Partisë dhe udhëheqësit e saj. Por, po të vërejmë dhe duhet të vërejmë më me kujdes, se duhet ta përmirësojmë këtë punë, do të shohim se kjo ngritje nuk është zhvilluar në mënyrë të rregullt e progresive, nuk janë pasur kurdoherë parasysh karakteristikat e nevojshme që përbëjnë këtë ngritje dhe kur çdo kuadër nuk i ka dhe nuk mund t'i ketë përnjëherësh të gjitha këto karakteristika, ne nuk kemi punuar sistematikisht, me këmbëngulje dhe në mënyrë të organizuar, për t'ia zhvilluar më tej ato që i ka dhe për të hedhur bazat e shëndosha të atyre të tjerave që nuk i ka. Kështu që kuadri ose ka vazhdimisht boshllëqe në dijenitë e tij,

ose ka një zhvillim të njëanshëm. Më e keqja është kur zhvillimi i njëanshëm i një komunisti ose i një udhëheqësi ka ngelur në vend ose është reduktuar në një zhvillim të njëanshëm praktik, pa e forcuar këtë praktikë me një ushqim politik, ideologjik dhe kulturor të vazhdueshëm.

Këtu qëndron një dobësi tjetër dhe këtej e kanë burimin semplicizmi, stereotipizmi, formulat dhe një punë e vogël pa perspektivë që i komunikohet edhe bazës dhe që, po të mos korrigohet, do të ketë pasoja. Ky kompleks krijon komplekse të tjera të rrezikshme për revolucionarizimin e punës së Partisë.

Këta kuadro udhëheqës, që nuk bëjnë përpjekje për edukimin e vet, e ndiejnë inferioritetin përpara shumë kuadrove me parti e pa parti dhe me dashje ose pa dashje bëhen barrikadë. Me dashje sepse nuk duan të njohin gjendjen që ata janë kapërcyer nga të tjerë, dhe s'mund të dalin nga kjo situatë, veçse me një punë të vullnetshme studimi nga ana e tyre. Pa dashje sepse nuk analizojnë si marksistë gjendjen e vet dhe vazhdojnë një punë rutinë, të thjeshtë, praktike, të vogël dhe e mbulojnë këtë situatë të tyre me zhvillimin e përgjithshëm, me lodhjen fizike të tyre që shumë herë është reale, por jo aq e frytshme sa do të ishte sikur ata të bënin përpjekje për ngritjen politike, ideologjike dhe kulturore.

Këta udhëheqës harrojnë se me një punë të tillë e ulin rolin e Partisë, sepse këto dobësi të tyre s'mund të mos ua njohin kuadrot që vijnë e u kërkojnë ndihmë dhe këshilla ose që një herë apo dhjetë herë kanë propozuar masa, kanë bërë sugjerime etj., por që këto

masa e propozime as janë marrë dhe as që janë studiuar me seriozitet.

Këtëj rrjedh edhe një tjetër kompleks, ai i mosmarrjes pjesë në diskutime në organizatën-bazë, i mospërgatitjes, i mungesës së kritikës dhe të autokritikës.

Të gjitha këto komplekse, mendoj unë, krijojnë një gjendje stagnante në organizatën-bazë, një punë të fjetur, ku numërohen vazhdimisht disa shifra dhe njerëzit vijnë rrotull ndonjë kritike personale ose marrin disa masa gjysmake.

Është e rrezikshme për Partinë kur organizata-bazë nuk kthehet në një shkollë të madhe, në një vatër të vërtetë revolucionare, ku të farkëtohen punonjës revolucionarë me virtyte të larta moralo-politike e me perspektiva të gjera dhe jo nëpunës burokratë që vetëm presin t'i urdhërosh dhe të zbatojnë urdhrin si automatë. Organizatat e Partisë ne duhet t'i kthejmë në qendra revolucionare, ku të ziejë mendimi krijues marksist-leninist, të zhduken sektarizmi dhe rutina e një pune të vogël e të fjetur, ku të mësohen njerëzit të mendojnë vetë me kokën e tyre dhe nëpërmjet diskutimeve të zjarra, konstruktive e frytdhënëse të shfaqin mendimet lirisht.

Vetëm një punë e tillë do t'i zhdukë këto dobësi që ekzistojnë në një sërë kuadrosh dhe organizatash partie. Partia jonë është një parti me një hov të madh revolucionar që ka bërë dhe po bën mrekulli, ajo ka fituar një eksperiencë kolosale, ka përgatitur kuadro të shumtë, të pajisur me ideologjinë marksiste-leniniste dhe me kulturë të përgjithshme e speciale, prandaj ajo

i ka të gjitha mundësitë që me një punë këmbëngulëse t'i spastrojë këto të meta e boshllëqe që vërtetohen në punën e saj në një sërë kuadrosh, në disa forume dhe organizata-bazë. Shokët dhe forumet, duke i analizuar me kujdes problemet, duhet të marrin masa rrënjësore në drejtim të përmirësimit të punës.

Natyrisht mobilizimi i njerëzve për të ndërtuar socializmin nuk mund të bëhet pa i sqaruar, pa i edukuar. Dhe Partia pikërisht për t'i sqaruar dhe për t'i edukuar masat ka krijuar veçanërisht organizatat e tyre, si organizata politike, për të cilat do të flas tani.

## **Probleme të organizatës së madhe të Frontit Demokratik**

Përse nuk i jepet kësaj organizate ajo rëndësi e madhe që i duhet dhënë? Organizatat e Partisë përse nuk i vënë rëndësinë e duhur punës së gjallë politike në organizatën e Frontit? A mos vallë Partia e krijoj kot dhe rastësisht këtë organizatë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare? Mos vallë tani kjo u bë e panevojshme?

Të gjitha këto pyetje që lindin nga gjendja aktuale na detyrojnë të mendohemi dhe të dalim me konkluzionin se ne nuk e kemi drejt që e nënvleftësojmë organizatën e Frontit.

Unë nuk dëshiroj të ndalem këtu në origjinën e krijimit të kësaj organizate të madhe, as të përmend rolin e madh që ka luajtur Fronti, i udhëhequr nga Partia, gjatë gjithë kohës së luftës dhe pas Çlirimit, por të kuptohet ky rol dhe të mos harrohen, qoftë edhe

vetëm në këtë periudhë, ato shërbime të mëdha që ai i ka sjellë çështjes së popullit. Edhe sikur Fronti me punën e vet të tanishme t'ua rikujtojë, t'ua freskojë masave këtë rol dhe këto shërbime, ky do të ishte një shërbim kolosal që mund t'i bëhej ngritjes politike dhe ideologjike të masave. Ne nuk duhet të harrojmë e të nënvleftësojmë që Fronti edhe tani e ruan atë forcë dhe atë qëllim për të cilin u krijua gjatë Luftës Nacionalçlirimtare e që duhet të shërbejë edhe tani në luftën për ndërtimin e socializmit.

Fronti u krijua si një organizatë politike që udhëhiqej nga Partia. Komunistët militonin në të në mënyrë të organizuar, çonin atje frymën dhe edukonin masat për realizime të mëdha. Këto masa e konsideronin Frontin organizatën e tyre, e donin atë, luftonin për forcimin e saj.

Mendoni vetëm periudhën e luftës së Frontit Nacionalçlirimtar kundër «Ballit Kombëtar». Parullat e mëdha që e frymëzonin këtë organizatë: «luftë pa kompromis kundër okupatorit dhe tradhtarëve për çlirimin e atdheut», «të gjithë në Front, pa dallim pikëpamjesh e krahinash dhe me armë në dorë për të çliruar Shqipërinë», të gjitha këto formuan traditën e madhe luftarake të kësaj organizate që krijoi dhe udhëhoqi Partia.

Kur u çlirua Shqipëria, Partia nuk e prishi dhe as e nënvleftësoi rolin e madh të kësaj organizate. Përkundrazi e forcoi atë dhe, duke ndjekur traditën e luftës, i vuri detyra të reja po aq të lavdishme, detyra për ngritjen politike dhe ideologjike të masave, për ri-ndërtimin e atdheut. Në këtë periudhë kishte edhe or-

ganizata të tjera masash, si ajo e rinisë dhe e gruas, u krijuan edhe bashkimet profesionale, por të gjitha këto nuk e penguan veprimtarinë e Frontit që u dallua e dha rezultate të mëdha, që fuqizoi vijën e Partisë. Anëtarët e Frontit e kishin për nder të mbanin kartën, dëshminë e tij, për aksionet, për gjestet patriotike.

Dhe roli i madh i organizatës së Frontit vazhdon edhe në këtë etapë të ndërtimit të plotë të socializmit. Vetëm se në këto vitet e fundit, pa arsye dhe në mënyrë të gabuar, kjo organizatë dhe roli i saj po lihen pas dore; harrohet që ka një masë të madhe pa parti që e do Frontin, që dëshiron të jetë anëtar i tij, që do të militojë në të në mënyrë të organizuar, sipas traditës dhjetërvjeçare. Me mosinteresimin tonë ne u themi këtyre masave: «largohuni nga Fronti», «Fronti s'ka më vlerë», «kaloi në histori».

Shkohet me mendimin e gabuar se «derisa kemi organizata të tjera ç'na duhet Fronti?». Sa për organizatën e gruas, pak e peshojnë e po të vazhdohet të mendohet kështu, kjo të çon drejt likuidimit të tyre.

Këto janë mendime të gabuara e të dënueshme, jo vetëm po t'i themi, por edhe pa i thënë hapur. Prandaj, këto mendime kur shfaqen në jetë në format e neglizhimit e të nënvleftësimit të organizatave në fjalë, duhet të dënohen. Por nuk mjafton vetëm të dënohen, ato sidomos duhet të riparohen, sepse mendoj që arsyeja e nënvleftësimit të organizatave të masave dhe veçanërisht e Frontit, burimin e ka te njerëzit e udhëheqjes së Partisë në rrethe, të cilët, duke mos dashur të vrasin mendjen për të gjetur forma të reja pune

për Frontin, kanë shkuar në rrugën më të lehtë, t'i vënë kryq veprimtarisë së kësaj organizate.

Natyrisht, ne duhet të kuptojmë mirë se niveli i organizatës së Frontit ngrihet tok me atë të anëtarëve që e përbëjnë. Në rast se ne, sikurse po bëhet, shkojmë në mbledhje të Frontit dhe u flasim anëtarëve të kësaj organizate me mendimin se niveli i tyre politik është si ai i 25 vjetëve më parë, ky përmban vetvetiu idenë e nënvleftësimit, të kotësisë së mbledhjes në fjalë. Është fakt se ka komunistë që e quajnë angari të venë të flasin dhe të edukojnë të tjerët në Front. Kjo është skandaloze. Këta njerëz nuk meritojnë të mbajnë teshen e Partisë, sepse ata nënvleftësojnë masat, i ofendojnë ato, ata nuk kuptojnë as vijën e Partisë, as vijën e masave që propagandon Partia.

Frontit i jepet njëfarë rëndësie kur bëhen zgjedhjet, ndërsa si mbarohen këto, atëherë ai vihet në qetësi si shpata në këllëf. Por zgjedhja e deputetëve, e gjyqtarëve, e këshilltarëve, është një nga veprimet bazë të pushtetit tonë popullor, është shprehja më e qartë e demokracisë sonë socialiste, është një nga armët më të mprehta të Partisë, një veprim i shquar ku shprehet vija e masave, demokracia e vërtetë. Këto veprime të mëdha Partia i ndërmerr, duke mobilizuar totalisht organizatën e Frontit.

Vallë, a nuk mjafton ky shembull i madh mbi të cilin baza duhet të reflektojë sa rëndësi i vë Partia dhe Komiteti Qendror organizatës së Frontit, apo Partia e bën këtë sa për formë, ose për të gënjyer njerëzit? Jo, shokë, duhet të jemi të bindur se Fronti jo vetëm ka

shërbyer, por duhet dhe do të shërbejë edhe në të ardhmen.

Partia duhet ta organizojë punën në një mënyrë të tillë që asnjë organizatë të mos i hajë bukën tjetrës dhe ca më pak Frontit, po të dimë ta organizojmë punën në të. Të aktivizosh Frontin nuk do të thotë të mbledhësh kuotizacionet apo të fillosh të bësh mbledhje për mbledhje, për të mërzitur njerëzit.

Partia duhet të organizojë aktivistë të veçantë e të specializuar të Frontit, t'i udhëzojë ata se për ç'gjëra duhet të mblidhet organizata e Frontit (dhe Fronti nuk mund të mblidhet vetëm për të grumbulluar hi dhe plehra, aksion i madh ky e i nderuar që njerëzit e bëjnë me një kuptim të lartë politik, por ata që kanë nevojë për këto plehra, as që çajnë kokën t'i marrin e t'i çojnë në ara). Këta aktivistë, jo vetëm duhet të jenë aktivë, por edhe të pasionuar për këtë punë, sepse fjalët që i thuhën masës duhet të jenë të peshuara, edukuese, mobilizuese, të shoqëruara me parulla, me shifra, me dokumentarë, me filma e të tjera forma të shumta që i lyp koha, momenti, ngritja arsimore e kulturore e masës. Njerëzit e Frontit shkojnë në aksione, por fletëlavdërime jepen pak ose aspak. Aktivistët e Frontit as që udhëzohen për bisedën që do të bëjnë, që të mos ndodhë që këta të venë t'i flasin masës për të njëjtin problem, për të cilin nesër do t'i vejë edhe ai i bashkimeve profesionale dhe do t'i këndojë të njëjtën këngë.

Partia trastën e ka plot me fishekë, po ajo duhet ta organizojë mirë hedhjen e tyre kur, ku dhe prej kujt, në mënyrë që çdo fishek të bëjë efektin e vet.



Shumë herë gjërat bëhen lëmsh. Unë nuk kam ndër mend të zgjatem këtu në hollësi mbi mënyrën si duhet punuar në të gjitha organizatat e masave, sepse atëherë s'do të dilnim dot kurrë, por megjithëse edhe në raste të tjera kam folur për disa nga organizatat tona, tani do të ndalem përsëri në disa çështje të veçanta, që në fund të fundit na preokupojnë. Disa gjëra në to i sjell edhe si shembuj që mund të shërbejnë për të studiuar e për të zgjidhur me dhjetëra e dhjetëra probleme akoma më të rëndësishme aktuale, të zjarra, të cilat na preokupojnë si Parti dhe si organizata të veçanta.

Në ndonjë mbledhje tjetër unë do të flas për disa mendime të miat se si të forcojmë organizimin e punës në bashkimet profesionale dhe në organizatën e rinisë (për këtë të rinisë sot do të sjell vetëm disa mendime mbi një problem të veçantë).

Tani dua të them disa mendime për organizatën e gruas dhe për rolin e mësuesit në fshat e për analogji edhe në qytet.

## Mbi punën me organizatën e gruas

Për problemin e gruas fshatare në veçanti fola edhe në mbledhjen e kaluar të Sekretariatit, por problemi i madh i punës me gratë në fshatra dhe në qyte te mbetet një çështje që duhet thelluar dhe organizuar më mirë.

Organizata e gruas, si dhe organizatat e tjera të masave që drejtohen nga Partia, jo vetëm duhet të

koordinojnë punën, por bashkërisht duhet të rishikojnë më parë të tërë problemin, të ndajnë dhe të përcaktojnë orientime të reja pune, të vendosin forma të reja pune të përshtatshme me kohën dhe me gjendjen që ka krijuar vetë zhvillimi revolucionar i vendit tonë.

Organizatat e masave janë leva ndihmëse të Partisë dhe si të tilla, të bazuara në direktivat e Partisë, në çdo lëmë të aktivitetit, ato duhet të përcaktojnë vijën e punës sipas specifikave të veçanta të tyre, ta zhvillojnë më tej këtë vijë, pa krijuar as konfuzion në detyrat e tyre as shumë përsëritje, por as edhe shkëputje nga qëllimi i përbashkët.

Që kjo punë të bëhet e pastër dhe e mirë, duhet një koordinim i vazhdueshëm i veprimtarisë nga Partia dhe nga organizatat e masave për çdo problem që ngrihet, një përcaktim më i studiuar i problemit të përgjithshëm dhe i çështjeve të veçanta që përbëjnë problem për çdo organizatë. Kjo ka rëndësi, pasi shtresat e ndryshme, gratë, punëtorët ose rinia nuk janë të ndara me mure, veç e veç, të gjitha jetojnë së bashku dhe janë të interesuara për të gjitha punët. Gruaja, e reja, i riu punojnë edhe në fabrikë, edhe në shkollë, edhe në lagje, edhe në shtëpi. Të gjithë pra, janë nën ndikimin e punës që zhvillojnë Partia, organizata e bashkimeve profesionale, e gruas dhe ajo e rinisë.

Pra, në qoftë se nuk i koordinojmë punët, në qoftë se nuk përpunojmë detyrat specifike dhe nuk gjejmë forma të ndryshme në metodën dhe stilin e punës që t'i përshtaten çdo organizate, atëherë do të na ndodhë kjo që na ndodh, paralelizëm në punë, mërzi për njerëzit, konfuzion, derisa të arrihet pastaj në mendi-

me absurde që thashë më parë, sa të thuhet «të prishet kjo ose ajo organizatë, meqenëse punën e bën Partia».

Në këtë çështje ne duhet të ndalemi dhe të reflektojmë thellë. Por, që ta bëjmë këtë, udhëheqjet e organizatave të masave duhet të shqyrtojnë rrënjësisht veprimtarinë e tyre në drejtimet që përmenda më lart.

Si për të gjitha shtresat, edhe problemin e gruas, në qytet ose në fshat, nuk duhet ta marrim kuturu, duke u nisur nga mendimi se ky problem është një bllok monolit. Jo. Po të mendohet kështu, do të ishte gabim dhe puna që do të vendosim të bëjmë nuk do të na japë frytet që dëshirojmë.

Problemet e gruas në fshat ndryshojnë nga ato të gruas në qytet. Problemet e gruas në një rreth ndryshojnë, gjithashtu, në specifikën e tyre, nga ato të një rrethi tjetër, ashtu sikurse ndryshojnë problemet e një qyteti nga ato të një qyteti tjetër. Flas natyrisht, për specifikën e problemit të përgjithshëm të gruas, pasi kjo specifikë është e kushtëzuar nga shumë faktorë, nga ngritja ekonomike, arsimore e kulturore e çdo kooperative, e çdo rrethi ose qyteti, është e kushtëzuar nga feja dhe nga mbeturinat e saj në ndërgjegjen e burrave, të grave, është e kushtëzuar edhe nga vetë problemi.

Qëllimi dhe detyra jonë është që, duke i pasur të qarta këto specifika, të dimë të mobilizojmë gjithë masën e grave, t'i organizojmë këto në një punë të zgjuar e të frytshme për ngritjen e tyre të gjithanshme.

Problemi i gruas është nga problemet më të rëndësishme për ndërtimin e socializmit, prandaj unë ngul këmbë kaq shumë për këtë.

Kategori të tëra grash në qytete, e kam fjalën për

një mori grash me arsim e kulturë, as nuk merren dhe as bëhen merak fare për ngritjen e gruas. Kjo situatë duhet të na preokupojë pa masë. Ne kemi aktivitete, kemi këshilla grash në fabrika, në shkolla, në spitale, në lagje e gjetkë, por po të bëjmë, dhe duhet medoemos të bëjmë, një analizë të punës së tyre, do të dalim me konkluzionin se punohet dobët dhe kjo forcë e madhe nuk është rentable.

Këshillat e grave, mendoj unë, duhet t'i zgjedhim në bazë të një kriteri të ri, më të shëndoshë, kriter që të pasqyrojë nevojën e zhvillimit të shumanshëm të grave në përgjithësi dhe të specifikave të tyre në veçanti, pasi në atë rajon ku vepron këshilli, ka gra të shtresave të ndryshme, me zhvillim të ndryshëm arsimor e kulturor, me profesione të ndryshme, me probleme të ndryshme. Këshilli i gruas, pra, duhet të jetë një ndihmës i fuqishëm i Partisë që të rrezatojë drejtime pune në gra të kategorive të ndryshme, të cilat, të grumbulluara dhe në forma të veçanta, mund të rrahin ato probleme specifike të gruas që do t'i ndihmojnë ato vetë të ngrihen dhe të bëhen më luftëtare në zbatimin e vijës së Partisë.

Të marrim, për shembull, disa kategori grash: mësueset, pedagoget, mjeket, punëtoret e të tjera. Të gjitha kanë probleme të përgjithshme, po çdo grup ka edhe problemet e veta, specifike. T'i grumbullosh e t'i udhëzosh të gjitha së toku është një çështje, por jo e tëra. Këtu, mendoj unë, haset vështirësia, pasi të gjitha udhëzohen me disa direktiva tip, standard. Më kot përpiqemi t'i aktivizojmë të gjitha kategoritë e grave për disa direktiva standard. Ato i shmangen një pune të dobi-

shme shoqërore, të përgjithshme, por besoj se nuk do t'u shmangen detyrave shoqërore të specifikës së tyre, vetëm se këto duhet t'i organizojmë më mirë, t'i udhëzojmë më mirë, t'u hapim perspektiva të reja.

Të mos nisemi nga mendimi se këto detyra ato kategori grash i kryejnë dhe i studiojnë në rrugën shtetërore, ose përzihen me detyrat e Partisë dhe të organizatave të tjera të masave dhe, pra, konsumohet vetvetiu puna specifike e gruas me kategoritë e ndryshme. Në pamje mund të duket kështu, por mendoj se nuk është plotësisht kështu, në rast se organizata e gruas i përvishet një studimi të këtyre problemeve në specifikën e tyre dhe del me konkluzione shkencore për vetë punën e saj. Në qoftë se çdo gjë e veçantë e çdo kategorie të veçantë grash do të zhvillohet në rrugë të drejtë shkencore dhe do të ndikojë në grupet e ndryshme të grave që rrojnë dhe luftojnë së bashku, mendoni sa ndihmë e madhe do t'i jepej Partisë, jo vetëm me rezultatet e punës që do të bëhet, por edhe me bashkërendimin e të gjitha këtyre specifikave, të cilat do ta ngrenë gruan në mënyrë të gjithanshme!

Mbi të gjitha, do të krijojë te gratë besimin në forcat e tyre krijuese, do të forcojë besimin në rolin e tyre në jetë dhe në shoqëri, do të forcojë tek ato mendimin politik mbi punën dhe profesionin e tyre në jetë. Kjo ka shumë rëndësi.

Unë kam besim të madh tek organizata e gruas. Ajo ka forca të shumta ta studiojë këtë problem, për ta vënë në rrugë të drejtë; në rrugën e një aktiviteti masiv revolucionar, nën drejtimin e Partisë.

Nga ana ligjore, dhe jo vetëm nga kjo anë, Partia

e ka çliruar gruan dhe e ka bërë të barabartë me burrin. Ajo tani merr pjesë pa asnjë pengesë në sektorët e ndryshëm të prodhimit, në industri, në bujqësi, në punët e shtetit dhe në çdo veprimtari shoqërore, kjo është një fitore e madhe. Por me gjithë këto suksese, Partia nuk duhet të kënaqet dhe të flejë në dafina, duke kujtuar se çdo gjë në drejtim të çlirimit të plotë të gruas u arrit, ose të mendohet se gruas i janë hapur të gjitha portat, pra, është e lirë nga çdo pengesë, mund të hyjë kudo dhe Partia të mos e zhvillojë kështu më tej luftën për zhdukjen e barrikadave që ekzistojnë ende dhe e pengojnë të marrë zhvillimin e plotë të saj në jetën socialiste.

Ka akoma shumë pengesa që rrjedhin nga paragjykimet, nga zakonet dhe nga rutina e sundimit të burrit mbi gruan, të cilat e kanë burimin në pikëpamjen e vjetër të pronës private që e bën burrin ta konsiderojë gruan si një plaçkë shtëpie, si një mjet shfrytëzimi. Prandaj duhet të zhvillojmë një luftë të ashpër kundër koncepteve të vjetra skllavëruese ndaj gruas dhe familjes.

Duhet të çrrënjosisim pikëpamjet e vjetra te njerëzit e fshatit, se gruaja është «një kafshë për punë», si dhe idetë borgjeze, të cilat ishin futur në rrethet e borgjezisë tregtare të vendit tonë, që sapo ngrihej para revolucionit, se gruaja është një «kafshë luksi».

Të dyja këto koncepte që tani janë në rënie, nuk mund të themi se janë zhdukur plotësisht, sidomos në fshat, për rastin e parë, dhe në disa elementë të borgjezisë së vjetër në qytet për rastin e dytë, të cilët i ruajnë të gjalla dhe i përhapin këto mendime.

Gjendja e mëparshme e gruas në fshat ndaj burrit ishte, si të thuash, si pozita e proletarit ndaj kapitalistit. Ajo shfrytëzohej në punët e arave dhe në punët shtëpiake, ashtu siç e shfrytëzon punëtorin kapitalisti. Pra, gruaja mund të konsiderohej si proletare e burrit. Tani kjo gjendje ka ndryshuar, por jo tërësisht. Vetë pjesëmarrja masive e gruas në prodhimin shoqëror, do ta zhdukë plotësisht këtë dhe një punë më e madhe e më e thellë politiko-ideologjike, me konferenca masive me burrat e me gratë dhe jo me pëshpëritje, do të bëjë që të zhduken edhe mbeturinat e këtyre mentaliteteve reaksionare.

Duhet të kemi parasysh dy periudhat e jetës së femrës: periudhën e rinisë dhe periudhën kur ajo martohet, prandaj të luftojmë edhe idetë borgjeze se gjoja periudha e parë është ajo kur e reja është e dhënë pas ndryshimeve, karakterizohet nga kurioziteti rinor dhe periudha e dytë, ajo e gruas që martohet e që karakterizohet nga ideja e një stabilizimi të jetës me martesën, e arritjes së «qëllimit të madh e definitiv të jetës» e vendosjes së unitetit në familje dhe të qetësisë sentimentale.

Shumë burra dhe shumë gra nuk e kuptojnë akoma sa duhet barazinë në mes tyre dhe nuk luftojnë sa duhet e si duhet për zhdukjen e paragjyqimeve prapanike. Në shoqëri ata sillen ndryshe, në familje ndryshe. Çështjen e familjes ata e quajnë një problem privat në të cilën mund të ekzistojnë dhe të zhvillohen si më parë mentalitetet e vjetra të pabarazisë. Prandaj është e domosdoshme të kuptohet si duhet se vetëm futja e gruas në prodhimin shoqëror dhe zhdukja e pabarazi-

së në familje janë dy kushtet bazë për çlirimin e plotë të saj. Edhe në kohën kur i jep qumësht foshnjës, gruaja duhet të ndiejë dhe të jetë në gjendje të gëzojë shoqërisht nga prodhimet e punës ekonomike, të realizuara me pjesëmarrjen e saj në prodhimin shoqëror.

Vetëm çlirimi ekonomik mund ta bëjë gruan me të vërtetë të lirë në dashuri dhe në miqësi, vetëm në këtë mënyrë ajo mund t'u qëndrojë me sukses paragjykimeve të vjetra patriarkale dhe reaksionare të sundimit të burrit dhe të mbajtjes gjallë të frymës reaksionare që lidhte dhe drejtonte familjen e vjetër.

Të mos harrojmë për asnjë çast se këto mentalitete të vjetra që rëndojnë mbi gruan ushqehen dhe zhvillohen në radhë të parë brenda në jetën familjare, ku gruaja punon ekskluzivisht vetëm. Ajo kryen pothuajse të gjitha punët e shtëpisë pa përjashtim. Në këtë drejtim ekziston gati i plotë mendimi i vjetër se punët në shtëpi do t'i bëjë vetëm gruaja. Pra, këtu nuk ekziston një ndarje pune shoqërore në mes burrit dhe gruas, siç ndodh në prodhimin shoqëror, ku të dy janë të barabartë dhe shpërblehen njëllëj, duke pasur të gjitha të drejtat, si njëri ashtu edhe tjetri. Brenda në shtëpi, në familje, burri merr epërsinë dhe, në këtë aspekt të jetës, gruaja vazhdon të jetë një proletare e burrit, e detyruar të punojë, si të thuash, për burrin, pasi gjoja punët brenda shtëpisë janë për gratë dhe jo për burrat, burri ka punë të tjera jashtë, të cilat në fakt janë të njëllëjta me ato që bën edhe gruaja, së cilës i duhet të bëjë edhe ato të shtëpisë, që janë jashtëzakonisht të lodhshme e të mërzitshme.

Në këtë drejtim ne duhet të bëjmë një kthesë të



plotë, pasi kjo duhet të konsiderohet një pengesë e dyfishtë, ideologjike dhe morale, për zhvillimin e gruas, një pengesë që nuk e lejon atë të marrë pjesë si duhet gjerësisht, ashtu si edhe burri, në prodhimin shoqëror.

Kjo kthesë duhet të bëhet në radhë të parë në mentalitetin e burrit, ajo të duket në jetë, domethënë në ndarjen e punëve midis burrit e gruas në shtëpi dhe në shoqëri, duke mbështetur krijimin e çerdheve e të kopshteve në qytete dhe në kooperativa, si edhe të institucioneve të tjera që ta çlirojnë e ta lehtësojnë gruan nga punët e shtëpisë.

Nga ana tjetër duhet që vetë gratë të bëjnë një kthesë të madhe, sepse uniteti i familjes, dashuria për burrin, nuk konsiston dhe nuk forcohet duke iu nënshtruar paragjykimëve dhe zakoneve prapanike të përluljes, të shërbëtores ndaj burrit, por duke i luftuar ato në rrugë të drejtë. Aktualisht nuk ka më vend frika e gruas ndaj burrit, frikë që e kishte burimin në skllavërimin ekonomik, se mos mbetej pa bukë ose në skllavërimin moral, se mos e ndante dhe e linte të turpëruar para shoqërisë.

Uniteti tani duhet të zhvillohet në barazinë shoqërore, në respektin për personalitetin e secilit, në të drejtat e njëlljota dhe jo në mendimet e mykura dhe reaksionare të familjes patriarkale, feudale e borgjeze.

Forcimi i personalitetit të gruas duhet të na preokupojë. Këtë personalitet duhet t'ia krijojmë dhe t'ia forcojmë me një punë të shumanshme, ekonomike, politike, ideologjike.

Shpesh vritet mendja për problemet specifike të gruas dhe arrihet në përfundim se këto probleme ja-

në ato të pastërtisë e të higjienës, të mirëmbajtjes së shtëpisë dhe disa gjëra të tjera të kësaj natyre. Këto janë probleme për gruan, siç është për të edhe mirërritja e fëmijëve, si fizikisht ashtu edhe nga ana politiko-morale, por nuk janë vetëm këto detyrat politike të gruas. Shumë të drejta politiko-shoqërore, të fituara nga gruaja me revolucionin e madh që bëri Partia, kalojnë në fondin e përgjithshëm të fitoreve dhe mendohet se këto nuk janë më probleme specifike të gruas, por të gjithë popullit, dhe si të tilla ato trajtohen në mënyrë të përgjithshme e shkurt.

Pjesëmarrja e gruas në prodhimin shoqëror është një problem i veçantë, bile shumë i rëndësishëm për gruan. Organizata e gruas, duke aktivizuar shumë gra të mësuara dhe të vullnetshme, mund të bëjë një punë aq të vlefshme sa edhe të ndryshme, mund ta trajtojë këtë problem gjerësisht dhe t'ua rrënjosë thellë në mendje e në zemër grave këtë fitore të madhe ekonomike dhe njëkohësisht moralopolitike, me një vlerë të pалlogaritshme për ngritjen e rolit të tyre në shoqërinë tonë socialiste.

Të marrim çështjen e arsimit, që është një problem i përgjithshëm: Ky është një nga problemet më të rëndësishme për gruan, problem i një rëndësie speciale. Por a trajtohet ky si i tillë? Jo.

A u kujtohen shoqeve që punojnë me gratë, kohët heroike të luftës kundër analfabetizmit? A u kujtohen atyre përpjekjet që bënte organizata e gruas për të çuar në banka, përpara hartës, kalemit dhe dërrasës së zezë, plakën dhe të renë fshatare e qytetare të mësonin abëcënë, të mësonin të shkruanin e të lexonin? Po, u

kujtohen, por tanimë ato kanë hyrë në «historinë e lashtë». Ai entuziazëm tani sikur ka rënë, por nevoja është akoma gjallë, pasi shumë nga ato që mësuan shkrim e këndim i harruan. Organizata e gruas mendon «shyqyr», tani na mësojnë gjithë të rejat, por nuk interesohet më për gratë 40-vjeçare që kanë mësuar shkrim e këndim, por, që, po të mos e përdorin, mund të kthehen në analfabete.

Fushata e arsimit për gruan, në mënyrë të veçantë, nuk qëndron vetëm në çështjen se ato që mësuan dhe tani i kanë harruar, t'u përtërihen, po që të vazhdojë edhe më tej ngritja e tyre arsimore. Po për të rejat që kanë mbaruar 7-vjeçaren, nuk duhet interesuar? Për këto organizata e gruas jo vetëm duhet të interesohet që të mos harrojnë ato që kanë mësuar, por t'i nxitë për të vazhduar shkollën edhe më tej ose të zhvillohen si autodidakte. A nuk është vallë kjo një detyrë specifike për organizatën e gruas?

Të marrim problemin e divorcit. A nuk është kjo një fitore e madhe për gruan? Për këtë fitore të madhe nuk flitet fare, sikur të ishte një gjë e turpshme, se nuk kuptohet. Divorci për gruan, veçanërisht, është një fitore nga më të rëndësishmet. Organizata e gruas këtë duhet t'ia shpjegojë masës së grave, ajo duhet t'ia shpjegojë edhe historikisht, edhe si duhet ta përdorë gruaja drejt këtë armë lirie kundër skllavërisë së vet. Kur gruaja ta kuptojë drejt këtë fitore, do të dijë edhe ta përdorë atë drejt, pasi i kuptuar kështu divorci edhe ndan, por edhe bashkon, pra, shërben edhe për forcimin e unitetit në mes burrit dhe gruas, për forcimin e unitetit të familjes, për rritjen e mirë të fëmijëve.

E drejta demokratike e votimit është një fitore e madhe për të gjithë, por në specifikën e vet, ajo është një fitore tjetër e madhe për gruan shqiptare. Me të drejtën demokratike të votimit, gruaja fitoi të drejtën e fjalës në shtet dhe në shoqëri ashtu si edhe burri. Me dhjetëra mijëra gra janë vrarë në botë për ta fituar këtë të drejtë. Ka vende shumë të përparuara, siç quhen, ku akoma edhe sot gratë nuk e kanë fituar këtë të drejtë të madhe që kanë fituar gratë e vendit tonë.

Prandaj ne duhet ta quajmë edhe këtë një nga problemet specifike të organizatës së gruas. Ajo duhet, me mënyra të ndryshme, t'i shpjegojë gruas shqiptare se ç'fitore e madhe është kjo, ku qëndron rëndësia e saj, ç'përmbledh ajo në vetvete, si lidhet me veprimet ekonomike, me lirinë demokratike, me moralin, me problemet politike dhe me afirmimin e personalitetit të madh të gruas në shoqëri.

Ne kemi folur shpesh për afirmimin e personalitetit të gruas, për ndihmën që duhet t'i japë asaj Partia, por nga takimet që po bëj, nga leximet dhe nga puna konkrete, shoh se çështja e ngritjes së personalitetit të saj përdoret vetëm si parullë, sepse nuk po shpjegohen si duhet gjithë këto fitore, që dihen, si edhe origjina e tyre. Kështu gruaja, duke i zbatuar të gjitha të drejtat e fituara, do ta ngrejë edhe më lart dhe do ta afirmojë personalitetin e saj të madh në shoqërinë tonë.

Si këto probleme të posaçme të gruas ka shumë, të cilat Partia dhe organizata e gruas duhet t'i vënë mirë në dukje, t'i shpjegojnë, t'i zbatojnë. Vetëm në këtë mënyrë organizata e gruas do të bëhet me të vërtetë një levë e fuqishme e Partisë, në mënyrë që gruaja të

mos mendojë vetëm për familjen e saj, por të jetë në radhë të parë një faktor i madh politik dhe ekonomik i shoqërisë sonë.

## Roli i madh i mësuesit në fshat

Roli i mësuesit në fshat është kolosal dhe po të dimë ta ndihmojmë dhe ta vëmë atë si duhet në lëvizje, do ta ndryshojë gjendjen arsimore-kulturore të fshatit. Përveç detyrës së tij, të mësojë e t'i edukojë fëmijët nga çdo anë dhe me të gjitha virtytet e mira, mësuesi mundet dhe duhet të zhvillojë një punë të madhe jashtë shkollës në drejtim të ngritjes kulturore të të gjithë fshatit. Natyrisht, që ta bëjë këtë, ai duhet të ndihmohet nga Partia, të jetë në lidhje të ngushtë me të, me organizatën e rinisë dhe me atë të gruas në fshat. Gati në çdo fshat ne kemi 5-15 mësues dhe mësuese në përgjithësi nga fshati, djem e vajza të reja plot zell, plot dëshirë e hov revolucionar.

Ky numër mësuesish duhet të jetë kontingjenti pararojë i Partisë për përhapjen e kulturës në fshat. Por ky kontingjent nuk përdoret si duhet dhe sa duhet. Organizata e Partisë në fshat, duke u dhënë kryesisht pas drejtimit të ekonomisë, në mënyrë shumë të pamjaftueshme, interesohet edhe për vetë punën e mësuesit brenda në shkollë, pa lëre jashtë saj.

Mësuesi ka pastaj nevojë të ndihmohet edhe për zanatin e tij. Këtë e ndihmon arsimiti, thuhet, me njerëzit e vet, me format e tij të punës që ka vendosur, e ndihmon seksioni i arsimit i rrethit me seminare. Këto janë të vërteta, por nuk janë e tëra, pasi ndihma

e arsimit nga qendra e nga rrethi nuk mund të jetë e përditshme, kurse ajo e Partisë dhe e organizatave të tjera të masave në fshat është e përditshme.

Në gjendjen aktuale të nivelit kulturor që kanë komunistët e fshatit është e zorshme që ndihma e organizatës së Partisë atje të jetë e kualifikuar për sa i përket anës së kontrollit të dhënies së lëndës ose të formave didaktike, por mësuesi mund të kalitet nga organizata e Partisë në drejtim të metodës në punë, të durimit, të këmbënguljes, të sjelljeve e të orientimeve të veçanta për të theksuar te nxënësit disa lëndë ose botëkuptime që do t'u duhen atyre në luftë me jetën, në nxitjen e dëshirës te nxënësit për bujqësinë, për blegtorinë etj.

Vetë mësuesi ka shumë nevojë të jetë i lidhur ngushtë shpirtërisht dhe ekonomikisht me jetën në kooperativë. Prandaj nuk mjafton të thuhet se është i lidhur meqenëse rron dhe punon në kooperativë. Partia, në mënyrë të veçantë e të organizuar, duhet ta mbajë në korent dhe t'i sqarojë mësuesin e mësuesen për çdo gjë.

Nga një punë e tillë e organizuar del edhe detyra e madhe e Partisë që t'i bëjë mësuesin dhe mësuesen të interesohen dhe t'i drejtojnë të punojnë edhe jashtë shkollës për përhapjen e kulturës.

Mësueset dhe mësuesit duhet të drejtojnë vetë shtëpinë ose vatrën e kulturës në fshat, leximin e librave dhe të gazetave, muzikën, këngët, vallet e shfaqjet. Ata duhet të jenë kryesorët që të formulojnë planet e konferencave dhe kryesisht t'i zhvillojnë ato; të drejtojnë ekskursionet dhe tok me organizatën e rinisë e të gruas, me një punë të organizuar, të harmonizuar e të drej-

tuar nga Partia në fshat, të marrin përsipër ngritjen masive arsimore e kulturore të të gjithë fshatit.

Mësuesit dhe mësueset duhet të përdoren dhe të aktivizohen zgjuarsisht e totalisht nga Partia për zgjidhjen drejt të problemeve shoqërore të fshatit, për forcimin socialist të fshatit, për luftën kundër bestytive, mbeturinave feudale, patriarkale, mikroborgjeze etj.

Ç'frymëzim të madh duhet t'u ngjallin Partia, organizata e rinisë dhe ajo e gruas mësuesve dhe mësueseve në të katër anët e Shqipërisë! Në çdo rreth, por le të marrim rrethin e Mirditës, ku kemi shembullin e shkëlqyer të Gjokës, mësuesit hero dhe dëshmor për çështjen e arsimit dhe të kulturës, sa gjëra të mëdha mund të kryejnë mësuesit dhe mësueset! Por ata, shpeshherë nuk i frymëzon, nuk i udhëzon, nuk i drejton kush.

Malësia e Mirditës është vend luftërash që në kohët e lashta të Skënderbeut, vend kryengritjesh të rrepta të fshatarëve kundër Turqisë, kundër taksave e xhelepeve. Historia e saj është e pasur me luftërat e fiseve dhe të bajraqeve, me zhvillimin e zhdukjen e tyre, me vuajtjet dhe rezistencën e fshatarëve të frymëzuar për të hequr qafe zgjedhën, për të fituar tokën, për të mbrojtur nderin, me historinë e hidhur të gjaqeve dhe të vrasjeve, të këtyre plagëve të rënda shoqërore, që u mbajtën gjallë nga bajraktarët dhe nga feja katolike; atje ka shumë për të folur për jetën e rinisë, luftën e saj, luftën e grave heroike të Mirditës tri herë të skllavëruara tërë jetën: nga fiset, nga kisha, nga burrat.

Ç'histori frymëzuese për mësuesit dhe mësueset, ç'pasuri e madhe historike dhe kulturore për atdheun tonë! Mësuesi dhe mësuesja në Mirditë, po t'i hapin këto

horizonte, jo vetëm nuk do të mërziten në ato malësi aq të dashura për ne, jo vetëm nuk do të duan të ndahen kurrë prej tyre, por nuk do të kenë kohë të hanë as bukë. Ata duhet të kthehen në kërkues, shkrues dhe përhapës të një kulture të madhe, të jenë mësues, por njëkohësisht edhe arkeologë, etnologë, mbledhës e studiues të folklorit të pasur, të lashtë e të ri, të përrallave të popullit të atyre krahinave, të zakoneve në dasma, në gosti, në zi, në luftëra, në mjerime, në shpresa e në fitore. Në çdo drejtim mësuesi dhe mësuesja, njerëz me kulturë dhe që zgjerojnë vazhdimisht horizontin e tyre duke punuar, do të interesohen dhe do të interpretojnë historikisht çdo gur, çdo rrënim, do të interesohen për rëndësinë e çdo fjale, të çdo shprehjeje, të çdo fraze, nga ana morfologjike, nga ana sintaktike, do të kërkojnë edhe origjinën, edhe shpjegimet, deri në qëndisimat e xhybeve të grave të Mirditës, se edhe ato kanë historinë e tyre.

Dhe të gjitha këto thesare mësuesit do t'i përpunojnë, do t'i këndojnë, do t'i shpjegojnë në fëmijët, në popull, vatër më vatër, do t'u mësojnë kështu historinë dialektiko-materialiste të popullit tonë dhe do të nxjerrin akoma më mirë në dukje historinë e lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare, udhëheqjen e lavdishme të Partisë, konsekuencën shekullore të historisë liridashëse dhe përparimtare të popullit tonë.

Sa zakone prapanike do të zhdukim ne në fshat po të vëmë në lëvizje mësuesin! Sa zakone të mira do të forcojmë e do të rrënjosisim, sa besim do të ngjallim te njerëzit në forcat e tyre, sa dashuri do të ngjallim në popull, për vendin, për përparimin, për kulturën!



A na lejohet, pra, shokë, që këtë forcë të madhe mësuesish ta lëmë të flejë? A i lejohet Partisë që të merret me disa gjëra të vogla dhe të harrojë të mëdhatë? Në asnjë mënyrë! Jo! Absolutisht jo! Pa humbur kohë ne duhet ta vëmë në lëvizje të madhe tërë këtë forcë, të bëjmë përmbysje, të bëjmë revolucion në këtë drejtim. Bindja ime është si shkëmb, se mendja e ndritur e Partisë do të bëjë që mësuesit dhe mësueset tona të fshatit dhe të qytetit, të bëhen jo vetëm pionierët e lavdishëm, lëvruarit dhe përhapësit e arsimit, por edhe të kulturës së përgjithshme dhe të pasur të vendit tonë.

Mësuesit formojnë një armatë të madhe në fshat. Këtyre njerëzve të mësuar, po t'u shtojmë edhe kuadrot e lartë e të mesëm të profileve të ndryshme që punojnë atje, do të dalim me një bilanc të pasur kuadrosh të mësuar, të cilët po të organizohen e të drejtohen mirë në punët shoqërore dhe kulturore, ne do të kemi përparime kualitative të habitshme në fshat.

Organizatat e Partisë duhet t'i udhëzojmë më mirë që ta kthejnë më fort fytyrën në këtë drejtim dhe t'i bëjmë të ndërgjegjshme se, duke u marrë me këtë problem nuk është kohë e humbur, kjo punë aspak nuk u heq atyre kujdesin nga ekonomia, përkundrazi zhvillimi i ekonomisë do të na ecë edhe më përpara, me hapa më të mëdhenj.

## Mbi një çështje për rininë

Kam përshtypjen se rinia jonë nuk e njeh ose e njeh shumë dobët të kaluarën rinore të brezit të vjetër

dhe se bën shumë pak përpjekje për ta studiuar e për ta njohur atë, për të analizuar gjendjen shoqërore, aspiratat e preokupimet e tij dhe si zgjidheshin këto probleme në kohën e regjimit të Zogut e në periudhën e pushtimit fashist, për të mos u futur pastaj më thellë dhe për të mos përsëritur atë që u tha se si punëtorët e naftës i merrnin tubat në krahë dhe i çonin në vend në periudhën fill pas Çlirimit.

Është për të ardhur keq se studiues të rinisë sonë të re nuk kanë dalë dhe nuk orientohen të studiojnë si duhet këtë periudhë të rëndësishme dhe imediate para Çlirimit dhe kur them imediate, mendoj se është më e lehtë për ta studiuar, sepse ekziston material i shkruar dhe materiali i gjallë njerëzor që sot është i moshave 40-50-vjeçare.

Sigurisht, disa shkrimtarë e kanë prekur në shkrimet e tyre këtë periudhë të rëndësishme, kanë trajtuar disa aspekte të jetës së rinisë para luftës, por kjo, me gjithë vlerën e saj të çmueshme, prapëseprapë është një gjë e vogël, jo e sistemuar, jo me kritere shkencore e shoqërore të theksuara. Këto të dhëna, duke mos pasur atë kujdes të veçantë që nevojitet për një saktësi faktike të periudhës që përshkruan (saktësi kjo që nuk i duhet sakrifikuar fantazisë ose deformacionit për të qenë brenda një orientimi të përcaktuar), humbasin vlerën e vërtetë në tërësinë e romanit, në personazhin, në kujdesin e autorit për ta zbukuruar ose për ta nxirë sipas nevojës së konceptit të temës.

Por krahas romaneve, literaturës, duhet medoemos që studiuesit tanë të rinj (dhe kjo i përket organizatës së rinisë t'i orientojë këta), t'i përvishen një pune të

sistemuar shkencore dhe shoqërore, t'i përvishen këtij problemi në të gjitha aspektet e tij, sikurse bëhet dhe për praktikatat e tjera.

Nuk mund të kënaqemi me disa slogane propagandistike që karakterizojnë studimin e këtij problemi gjoja imediatisht të kaluar. Këto slogane nuk na thonë shumë gjëra dhe ato pak që na thonë, bëjnë pjesë ose janë një pjesë e vogël e gjendjes së përgjithshme të popullit tonë, në periudhën para Çlirimit.

Rinia nuk mund të zhvillohej, të rritej, të mendonte, të aspironte jashtë zhvillimit shoqëror e mendor të pjesës tjetër të popullit. Por ajo, në çdo kohë, si sot në socializëm, ashtu edhe dje në regjimet shtypëse feudale borgjeze, kishte veçoritë e saj të zhvillimit, të mendimit, në pararojë të brezave me një moshë më të kaluar. Si paraqiteshin këto veçori, në ç'forma shfaqeshin e zhvilloheshin, cilat ishin kontradiktat që i çonin përpara, si zhvilloheshin dhe si zgjidheshin këto kontradikta antagoniste dhe joantagoniste?

Vendi ynë, ishte me klasa shoqërore antagoniste ku zhvillohej luftë klasash, ishte me zhvillim shoqëror të prapambetur, me zhvillim arsimor e kulturor akoma më të ulët, të disniveluar në kulm, të ndikuar nga shumë rryma kulturore të jashtme ose «të vjedhura» si të thuash, të aplikuara keq e të kondicionuara nga qejfi ose nga intrigat e feudo-borgjezisë së korruptuar, injorante, antipërparimtare dhe të shitur; vendi ynë, pra, në këto kushte të vështira, rriste një rini, e cila punonte, mendonte, kërkonte rrugëdalje, rrugë të reja, çante në mes të kësaj mjegulle të dendur dhe me zor, me dhimbje, po fitonte disa kala, disa pozita, të cilat

udhëheqja reaksionare shtetërore nuk është e vërtetë se ia jepte nga qejfi, por rinia ia rrëmbente me luftë për të renë, për ekzistencën. Kjo ka rëndësi të njihet, të studiohet, të shkruhet dhe të shërbejë për edukimin e brezit të ri që po rritet, që rron dhe lufton në socializëm, po ku zhvillohet përsëri e përsëri lufta e klasave.

Rinia e moshave tona ka luajtur një rol vendimtar në çlirimin e atdheut. Ajo mori pjesë në masë në Luftën Nacionalçlirimtare, duke u çuar peshë kur Partia i bëri thirrjen të rrokte pushkën dhe shkroi faqe të lavdishme heroizmi, sakrifice, pjekurie. Nga buruan gjithë ai heroizëm dhe ajo pjekuri e saj, gjithë ato sakrifica? Ne deri tani kemi vënë në dukje si duhet heroizmat e rinisë, të heronjve të saj të lavdishëm dhe të panumërt (megjithëse kemi akoma shumë për të bërë në këtë drejtim), por nuk jemi thelluar se si u mbryjtën ata të rinj para se të dilnin në mal, si rronin ata, si mendonin, çfarë ndienin, çfarë aspironin, si luftonin, para se t'i përgjigjeshin thirrjes së Partisë për revolucion.

Janë bërë disa orvatje të zbehta në këtë drejtim, janë shkruar disa episode më shumë me karakter letrar, propagandistik, por këto janë krejt të pamjaftueshme. Duhet shkruar episodi, por ky është përfundimi, rezultati, konkluzioni i një gjendjeje shoqërore, i një situatë ekonomike, i një situatë shpirtërore revolucionare që shpërtheu. Si ishte kjo gjendje, cilat kanë qenë rrethanat specifike dhe të përgjithshme, ç'rol ka luajtur rinia e asaj kohe për përgatitjen dhe shpërthimin revolucionar, kësaj ne nuk i futemi ta studiojmë thellë dhe e mbulojmë atë me ekzaltimin propagandistik të episodit.

Kjo mënyrë nuk i përgjigjet më nivelit e kërkesave

të sotme të rinisë. Rininë e sotme në socializëm duhet ta frymëzojmë medoemos, po jo në mënyrë «bombastike», vetëm me fraza, por duke i shpjeguar rrënjët e heroizmit, të sakrificës, të pjekurisë. Duhet të kemi gjithashtu parasysh se niveli kulturor i rinisë së paraçlirimit, me atë të sotmen, ndryshon shumë. Një shpjegim i thatë mund të ishte i mjaftueshëm për rininë në të kaluarën, por nuk mund të jetë më i mjaftueshëm për rininë e sotme. Kjo jo për arsye se rinia në të kaluarën i kuptonte më mirë dhe e sotmja i kupton më me zor, por sepse horizonti i rinisë së djeshme ishte i ngushtë, kurse kërkesat e rinisë së sotme janë më të mëdha, se horizonti dhe kultura e saj janë më të gjera. Rinia e sotme rron në socializëm, kurse në të kaluarën rronte në gjysmëfeudalizëm.

Si për çdo praktikë, edhe lufta e rinisë nuk duhet të ketë shkëputje, ajo duhet të studiohet në bazë të materializmit historik. Për këtë studim ne duhet të interesohemi dhe ta frymëzojmë organizatën e rinisë që ta bëjë dhe jam absolutisht i bindur se ajo do ta bëjë mirë këtë, sepse është një pjesë e historisë së saj, pjesë e historisë së përgjithshme të popullit tonë heroik.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha «Raporte e fjalime 1965-1966», f. 326-367. Tiranë, 1971*

*Botohet e plotë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **IDETË E MARKSIZËM-LENINIZMIT DO TË FITOJNË NË TË GJITHË BOTËN**

*Nga biseda me ambasadorin e RP të Kinës*

**11 prill 1966**

*Më 4 prill 1966, shoku Enver Hoxha thirri në selinë e Komitetit Qendror të PPSH ambasadorin kinez në Tiranë për t'i komunikuar vendimin e Byrosë Politike të KQ të PPSH për të dërguar në RP të Kinës një delegacion të PPSH e të Qeverisë së RP të Shqipërisë. Më 11 prill 1966, shoku Enver Hoxha e priti përsëri ambasadorin kinez që kërkoi të kthente përgjigjen e partisë dhe të qeverisë së tij lidhur me vajtjen në Kinë të delegacionit shqiptar.*

*Më poshtë po botojmë bisedën e shokut Enver Hoxha në të dyja këto takime me ambasadorin kinez.*

Shoku ambasador, ne edhe më përpara kemi pasur dëshirë për të dërguar një delegacion partie dhe qeverie në Republikën Popullore të Kinës. Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë sonë arriti në përfundim për të dërguar këtë delegacion në vendin tuaj pikërisht tani. Në krye të këtij delegacioni do të jetë shoku Mehmet Shehu. Me keqardhje ju them se unë vetë personalisht nuk

do të jem në delegacion. Për mua do të ishte një ngjarje e gëzuar të bëja një vizitë në Kinë e të takohej me popullin, me komunistët dhe me udhëheqësit tuaj, të shkëmbeja mendimet dhe eksperiencën me ta. Por shokët udhëheqës kinezë do ta kuptojnë se në këto momente është e vështirë të largohemi në të njëjtën kohë edhe unë edhe shoku Mehmet Shehu. Është e nevojshme që njëri nga ne të qëndrojë këtu për vazhdimin e përgatitjeve për Kongresin e ardhshëm të Partisë.

Mirëpritja nga udhëheqja e partisë dhe e qeverisë kineze e propozimit të bërë nga ana jonë për vajtjen e këtij delegacioni në Kinë në këto momente të përshtatshme për ne na kënaq së tepërmi.

Ju siguroj, shoku ambasador, se populli shqiptar do të jetë jashtëzakonisht i entuziazmuar kur të marrë vesh nisjen e delegacionit të Partisë dhe të Qeverisë sonë për në Republikën Popullore të Kinës.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë sonë mendon se pikërisht tani është momenti i favorshëm për të shkuar delegacioni ynë në Kinë. Ku e mbështetim ne këtë?

Siç e dini revizionistët hrushovianë, këta tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe armiq të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të të gjithë popujve të botës, bënë Kongresin e tyre të 23-të, kongresin e tradhtisë. Ky kongres i mbaroi punimet e tij, siç thotë një shprehje e popullit tonë, «si bisht peshku», domethënë «Ku ishe? — Hiç gjëkundi».

Shumë karakteristika e dallojnë këtë kongres të revizionistëve të Moskës. Ato tregojnë për dobësinë e madhe dhe ekzistencën e kontradiktave të padiskutue-

shme në radhët e tyre. Fakti është që, jashtë çdo tradite të domosdoshme të kongreseve të partive komuniste dhe punëtore të botës, asnjëri nga anëtarët e Presidiumit të KQ të PK të BS nuk e mori fjalën në këtë kongres. Përse ka ndodhur një gjë e tillë? Sepse, sipas mendimit tonë, në radhët e tyre duhet të ketë pasur kontradikta të mëdha, të cilat kanë dashur t'i mbulojnë dhe kështu kanë arritur në një kompromis për të dalë me një kongres sa për të kaluar radhën. Duket se nuk kishin si të bënë ndryshe. Kjo gjendje për ta është si puna e zjarrit që e mbulojnë me ca hi përsipër, por në fakt nën të prushi qëndron i ndezur.

Natyrisht, kjo situatë është në favorin tonë. Ndërsa revizionistët sovjetikë duan të japin përshtypjen sikur të gjitha partitë komuniste në botë janë me ta, kurse dy partitë tona, ajo e Kinës dhe Partia e Punës e Shqipërisë, gjoja paskan mbetur vetëm, sepse, sipas tyre, ato qenkan në kundërshtim me gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare! Këtë duan të nxjerrin në pah revizionistët sovjetikë me reklamën që po i bëjnë kongresit të tyre, duke u kapur nga fakti se në këtë kongres kanë dërguar delegacionet e veta edhe Partia e Punës e Koresë dhe Partia e Punonjësve të Vietnamit, kurse Kina dhe Shqipëria nuk kanë dërguar.

Në botë sot ka shumë parti e grupe marksiste-leniniste revolucionare që janë me ne, dhe që në të ardhmen do të shtohen në numër; ndërsa ka të tjerë që lëkunden, por që koha ka për t'i sjellë në pozita të drejta luftarake. Në pozitat e marksizëm-leninizmit, në mos sot, nesër, do të vijnë të tërë elementët e shëndoshë, që e duan komunizmin. Tradhtarët e Moskës dhe re-



vizionistët e tjerë, vazhdimisht do të përpiqen dhe do të bëjnë çmos për të dëmtuar luftën tonë, luftën e partive marksiste-leniniste. Por ata do të dështojnë me siguri, ashtu siç ka dështuar dhe imperializmi, padroni i tyre, sepse partitë marksiste-leniniste, duke qenë në unitet të çeliktë, bëhen kurdoherë e më të forta, dhe jo vetëm do të arrijnë t'i demaskojnë plotësisht përpjekjet e armiqve, por do të vijë dita që edhe t'i shkatërrojnë këta dhe të fitojnë përfundimisht idetë e mëdha të marksizëm-leninizmit në të gjithë botën.

Marksistë-leninistët nuk tërhiqen nga vështirësitë dhe disfatat e përkohshme. Ngjarjet në Indonezi, për shembull, dëmtojnë në radhë të parë popullin indonezian, por vala revolucionare me siguri atje do të ngrihet përsëri. Ajo që ndodhi në Indonezi që një grusht i rëndë kundër partisë komuniste të këtij vendi. Nga kjo del edhe një herë se sa aktual është mësimi që thekson shkenca jonë, marksizëm-leninizmi, që armët duhen mbajtur kurdoherë në gatishmëri të plotë. Ky mësim i madh, sipas të cilit revolucioni kryhet me dhunë, duhet t'u shërbejë të gjitha partive, të gjitha grupeve marksiste-leniniste revolucionare, të cilat është e domosdoshme të organizojnë punën e tyre në mënyrë shembullore e në nivel të lartë, të dinë të përfitojnë nga situatat e njëfarë «lirie», «demokracie», me të cilat, në koniunkturat aktuale, borgjezia aty-këtu i jep mundësi klasës punëtore të organizohet e të punojë hap-tazi. Por partitë dhe grupet marksiste-leniniste duhet të përgatiten që të jenë të afta të punojnë e të luftojnë edhe në ilegalitet, sepse është i paevitueshëm grushti i borgjezisë kur ajo e shikon të rrezikshme situatën. Kur-

se në kushtet kur komunistët, grupet dhe partitë marksiste-leniniste janë të përgatitura edhe për këtë luftë, grushti i borgjezisë kundër tyre bëhet i paefektshëm. Rasti i Indonezisë e dëshmon më së miri këtë, prandaj duhet përgatitur mirë që orvatjet e borgjezisë të thyhen. Edhe nga ky rast ne si marksistë-leninistë nxjerrim mësim.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë sonë, pas analizës që u ka bërë këtyre ngjarjeve, ka arritur në konkluzionin se lufta e të gjitha partive që qëndrojnë në pozita marksiste-leniniste, do të bëjë që gjendja, si copa e zezë e arnuar me pe të bardhë, e krijuar pas kongresit të revizionistëve sovjetikë, të shpërthejë në disfata të rënda për ta.

Në këto situata që po kalojmë ne mendojmë se duhet të veprojmë si një trup dhe t'u tregojmë gjithë armiqve se kush jemi. Prandaj Komiteti Qendror i Partisë sonë mendoi që delegacioni ynë të shkojë në Kinë brenda muajit prill. Me këtë vizitë ne do t'u themi revizionistëve sovjetikë: gjer tani në kongresin tuaj folët ju, tani e kemi radhën të flasim ne që qenkemi «të izoluar» e «të dobët». Kjo do të jetë një dush i ftohtë për mbarimin e punimeve të Kongresit të 23-të të revizionistëve dhe opinionin komunist e ai botëror nuk do t'u vënë më veshin revizionistëve për ato që do të grijnë, përkundrazi, forcat e vërteta revolucionare do të interesohen shumë dhe do të mësojnë se çfarë do të themi ne.

Nuk e dimë si e gjykon këtë moment partia juaj, por Partia jonë kështu e gjykon çështjen, që pas kongresit të revizionistëve sovjetikë ne duhet t'u hedhim.

atyre dhe këtij kongresi «topa» e «gjyle» të tilla që të mos luajnë dot më rol gënjeshtër e tyre dhe kështu bota të dëgjojë fjalën dhe të ndjekë veprën e marksistë-leninistëve të vërtetë.

Në caktimin e kohës së vajtjes së delegacionit tonë në Kinë ne patëm parasysh edhe atë që i thatë ju ministrit tonë të Punëve të Jashtme se shoku Çu En Lai ka ndër mend të vejë nga muaji maj në Rumani<sup>1</sup>. Datën e saktë kur ai do të vejë atje, ne nuk e dimë dhe nuk ka pse ta dimë, por marrim parasysh se meqenëse rumunët dhe jugosllavët shpallën që në 15 ditëshin e dytë të muajit prill Titoja do të vejë në Rumani<sup>2</sup>, pa ditur gjë mbi sa ka vendosur udhëheqja juaj, gjykojmë që shoku Çu En Lai sigurisht do të vejë në Rumani pas Titos. Pra, mendojmë, që kjo nuk e pengon vajtjen e delegacionit tonë në Kinë po të niset më 20 ose 25 prill. Kështu edhe Titos me vizitën e delegacionit tonë i japim përgjigjen që meriton.

*AMBASADORI KINEZ:* Nga sa di unë, koha e vizitës së shokut Çu En Lai nuk është vendosur. Kam dëgjuar se mund të bëhet në prill ose në maj, po ka mundësi që edhe të shtyhet. Udhëheqësit rumunë na kanë bërë shumë herë ftesë, ata kanë shkuar disa herë në Kinë, kurse një delegacion politik kinez nuk ka bërë ndonjë vizitë zyrtare në Rumani. Personalisht mendoj se shoku Çu En Lai, duke shkuar në Rumani, do të shfrytëzojë edhe kontradiktat që janë në mes tyre me sovjetikët, për të sqaruar me ta komplotet që kurdi-

---

1 Çu En Lai vizitoi Rumaninë prej datës 16-24 qershor 1966.

2 Titoja vizitoi Rumaninë prej datës 18-22 prill 1966.

sin revizionistët sovjetikë; ai vete që edhe të punojë ca me këta njerëz. Dihet se te rumunët ka lëkundje herë nga e majta, herë nga e djathta, kurse nga ana ideologjike ata janë një me revizionistët sovjetikë, por duhet pasur parasysh se shumë vende të Evropës kanë simpati dhe një interes për rumunët dhe këto ne duhet t'i shfrytëzojmë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Për arsyet që përmenda më lart ne e kemi gjykuar si të përshtatshëm këtë moment për vizitën e delegacionit tonë në Kinë. Ne e kemi parasysh që partia dhe qeveria kineze jetojnë dhe punojnë në një vend të madh, ato mund të kenë në plan zotime të tjera, te ju venë e vijnë shumë delegacione, prandaj mirëpritja e kërkesës sonë nga ana e shokëve udhëheqës kinezë, për të vajtur delegacioni ynë në Kinë në këtë kohë, është gëzim i madh për ne.

Shokët e delegacionit do t'i vënë në dijeni më në detaje shokët udhëheqës kinezë për të gjitha masat e rëndësishme që ka marrë kohët e fundit Partia jonë. Ne mendojmë se punët po na shkojnë mirë, sepse shihet një mobilizim i madh në Parti dhe në masa, se kudo ka një hov të madh revolucionar. Është detyra jonë që këtë vrull ta mbajmë ngritur, ta ngremë në një nivel edhe më të lartë politik dhe ideologjik dhe kjo të ndihmojë për të pasur rezultate në jetë. Qëllimi i vajtjes së delegacionit tonë, pra, është për t'i vënë në dijeni shokët kinezë për gjendjen morale, politike, ekonomike dhe kulturore të vendit tonë, të njohim eksperiencën tuaj dhe, sa të jetë e mundur, të përfitojmë nga eksperiencia e njëri-tjetrit. Nga të gjitha anët ne do të përfitojmë nga ky rast që po na jepet.

*Duke e marrë fjalën, ambasadori kinez tha, ndër të tjera, se edhe në Kinë do ta presin me gëzim vajtjen e delegacionit shqiptar. Pasi foli për gjendjen e mrekullueshme që ekziston në Shqipëri, pas masave të rëndësishme që ka marrë PPSH, lidhur me uljen e pagave të larta dhe masave të tjera revolucionare, ai shtoi se «edhe në Kinë kemi bërë diçka në këto drejtime por me zigzage, në praktikë kemi të meta e gabime».*

*Pastaj, duke e marrë fjalën përsëri shoku Enver Hoxha tha:*

Ne tani po përfundojmë punën për shkurtimin e organikave dhe organizimin e ndërmarrjeve, pasi të gjithë ata që do të shkurtohen nga administratat, do të punojnë drejtpërdrejt në prodhim. Masa e Komitetit Qendror të Partisë sonë për uljen e pagave të funksionarëve të lartë hyri në fuqi qysh nga 1 prilli dhe asnjë pakënaqësi nuk ka në radhët e kuadrove tanë. Lidhur me këtë vendim jemi nisur nga parimi që të rrojmë thjesht dhe në çdo gjë të veprojmë si marksistë. Prandaj populli ynë e ka pritur jashtëzakonisht mirë këtë masë. Ndërsa pagat e mesme dhe të vogla nuk i kemi prekur. Edhe këtë populli ynë e ka pritur shumë mirë. Populli e di që kuadrot tanë nuk rrojnë në luks, por prapë sheh se masa që po marrim është e drejtë.

Unë i studiova me hollësi masat që keni marrë ju në Kinë për këto probleme. Ish-ambasadori ynë në Pekin ka pasë biseduar me ministrin tuaj të Financave dhe me atë të Tregtisë, të cilët i kanë dhënë atij një material të hollësishëm mbi kategorizimin e puno-

njësve kinezë, si dhe shumë materiale të tjera, i kanë treguar edhe të metat që keni pasur ju në këtë sektor.

Zgjidhja e këtij problemi te ju në industri, në bujqësi, në kulturë, në arsim etj. mund të jetë ca i ndryshëm, por siç e thashë, rëndësi të dorës së parë kanë parimet, zbatimi me konsekuencë dhe mbrojtja e tyre. Edhe rregullimi i pagave të kryetarëve dhe të brigadierëve në kooperativat bujqësore, të normistëve, të drejtuesve të skuadrave dhe të kooperativistëve në vendin tonë është një problem i rëndësishëm për ne. Tani jemi duke e studiuar edhe këtë problem, punonjësit në bazë po japin mendime dhe kemi arritur në variante zgjidhjeje që janë shumë më të përparuara nga sa i kishim gjer tani. Kjo bëhet me qëllim që të nxitet prodhimi si në zonat fushore, ashtu edhe në malësi.

Rëndësi, siç thashë, ka vija. Zigzage për një gjë të re mund të ketë, përderisa të gjendet rruga më e mirë e zgjidhjes së çdo çështjeje, por është e domosdoshme që kurdoherë të bazohemi në parimet e drejta marksiste-leniniste, pastaj rruga e zbatimit do të gjendet.

Të gjitha këto i shërbejnë luftës për forcimin e situatës brenda në vend dhe sa më të fortë që ne të jemi brenda, aq më shpejt do të fitojmë. Le të na shajnë armiqtë, se imperialistët, reaksionarët dhe revizionistët për këtë kanë lindur, të na shajnë ne, marksistë-leninistët. Po të ecim drejt në rrugën tonë, ata do të na shajnë gjithnjë e më shumë, por, megjithatë, e kuptojnë që ne jemi të fortë. Ato që bëjnë armiqtë imperialistë dhe revizionistët hrushovianë janë si zjarr që lëshon përkohësisht flakë, por vetë ata brenda janë të

krimbur, kurse ne jemi si zjarri që nuk shuhet kurrë, si ai zjarr që ndizet dhe i përvëlton vazhdimisht armiqtë.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura që gjenden në Arkivin Qendror të Partisë*

## KODI I PUNËS MBRON PARIMET E KLASËS PUNËTORE

*Nga biseda me shokun Qimo Kocani<sup>1</sup> në lidhje  
me Kodin e Punës*

15 prill 1966

Shoku Qimo Kocani e vuri në dijeni shokun Enver Hoxha se Kodi i ri i Punës është ripunuar përfundimisht, sipas porosive të Komitetit Qendror të Partisë.

Në Kodin e Punës, tha ai, është menduar të konsakrohen me ligj disa orientime të Thirrjes dhe të Letrës së Hapur të Komitetit Qendror për të realizuar pjesëmarrjen e punëtorëve në drejtimin e shtetit. Të drejtat që kanë sot punëtorët janë ruajtur edhe në Kodin e ri, si e drejta e punës, e kohës së punës, e pushimit, e pagës, çështja e lejeve, e kushteve të mira higjienike etj. Në Kod gjen zbatim parimi që shteti u garanton punë të gjithë shtetasve, por del problem çështja e atyre fëmijëve që ndjekin shkollën 8-vjeçare dhe mbeten në klasë, të cilët as në shkollë nuk venë, as

---

1 Në atë kohë ka qenë sekretar i Këshillit Qendror të BPSH.



*në punë nuk i merr dot, se nuk të lejon ligji i detyrimit shkollor.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Çdo djalë apo vajzë është e detyruar me ligj të ndjekë shkollën gjer në moshën 15 vjeç, prandaj ligjin e detyrimit shkollor ne nuk duhet ta anulojmë me një ligj tjetër. Pastaj 14-vjeçari edhe nga mosha është i vogël. Në qoftë se një 14-vjeçar i shpëton ligjit të detyrimit shkollor për një vit, fundi le të mos hyjë në punë derisa të plotësojë moshën. Zakonisht as prindërit, as shkolla nuk do t'i lënë këta të brezhin. Pra është e arsyeshme që i riu të ketë të drejtë të futet në punë në moshën 15 vjeç, pasi ta ketë mbaruar shkollën 8-vjeçare, në qoftë se nuk dëshiron të vazhdojë më lart si nxënës i ditës.

**SHOKU QIMO KOCANI:** Sipas Kodit të vjetër punëtorët e kategorisë së katërt e lart mund të transferohen, kurse ata nga kategoria e tretë e poshtë mund të transferohen vetëm me pëlqimin e vetë personit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po pse ka qenë transferimi i detyrueshëm mbi kategorinë e katërt dhe jo edhe nën të?

**SHOKU QIMO KOCANI:** Se punëtorët nga kategoria e katërt e lart konsiderohen të kualifikuar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Dispozita e transferimeve të punëtorëve nga kategoria e katërt e lart nuk më duket keq. Ne në të ardhmen mund të vendosim që të transferojmë, kur është e domosdoshme, edhe punëtorët dhe nëpunësit që kanë një kualifikim të mesëm e të thjeshtë, por kjo çështje duhet parë dhe duhet studiuar mirë, se dihet që transferimi krijon mjaft pro-

bleme. Jeta na e ka provuar këtë. Pastaj kjo çështje duhet parë edhe nga pikëpamja e pagës. Punëtorët e kategorisë së ulët kanë pagë më të vogël. Në qoftë se e transferojmë, ekonomikisht ai do të dëmtohet për një kohë, kurse punëtori i kategorisë së pestë ose të gjashtë merr diçka më shumë se punëtori i kategorisë së ulët.

Të kemi kujdes që transferimet t'i bëjmë të menduara mirë nga çdo pikëpamje. Përse të transferojmë një njeri që punon në një vend të caktuar, kur vendin e tij të punës na duhet ta zëvendësojmë me një njeri tjetër dhe të mos dërgojmë atje ku na duhet këtë tjetrin që do ta zëvendësojë? Kështu, për shembull, tornoja ku punon tornitori i parë do të qëndrojë atje ku është dhe tek ajo do të vejë me siguri një tornitor tjetër të punojë. Atëherë më mirë të transferohet ky që do të vejë i ri. Mendoj që punëtori ose nëpunësi të merret në punë në bazë të specialitetit që ka dhe kur të transferohet në një vend tjetër, të bëjë edhe atje punë që i përket specialitetit të tij, se ndodh që e merr atë nga tornitor dhe e fut në një zanaf tjetër, ta zëmë elektrikist. Tornitorin nuk duhet ta çojmë elektrikist, por vetëm si tornitor. Tjetër punë është kur ai ka dy ose tri profesione. Në këtë rast, për nevoja të punës, mund t'ia ndryshosh profilin dhe kjo është e drejtë në kuptimin e politeknizimit, po kurdoherë të shohim nëse i intereson shoqërisë kjo gjë.

Transferimi brenda rrethit, kuptohet, do të bëhet nga komiteti ekzekutiv si për të gjithë ata që i takojnë nomenklaturës së tij.

*SHOKU QIMO KOCANI*: Kodi i vjetër i jep mun-

dësi nënës me fëmijë në gji që çdo tri orë të vejë të fëmija, por ka disa që nuk e realizojnë këtë të drejtë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Nënës me fëmijë në gji duhet t'i japin medoemos leje të vejë t'i japë fëmijës të pijë.

*SHOKU QIMO KOCANI:* Disa nënave që kanë fëmijë në gji u japin leje të venë më vonë në punë dhe të largohen më shpejt. Këto vendosen nganjëherë edhe me mjekun ose me infermieren.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kjo nuk është e drejtë, është e jashtëligjshme dhe jashtë normave shkencore. Mjeku, në bazë të shkencës, mund të përcaktojë që fëmijës brenda kaq muajve t'i jepet për të pirë kaq herë në ditë dhe duke u rritur diçka më shumë, dy herë në ditë e kështu derisa t'i fillohet ushqimi. Nëna duhet të vejë medoemos t'i japë gji fëmijës në kohën e dudur dhe jo kur i do qejfi drejtorit. Natyrisht, ne duhet të ndalojmë edhe abuzimet nga ana e ndonjë gruaje. Ndërmarrja duhet ta matë mirë kohën që u nevojitet nënave për të shkuar te fëmijët, sidomos atyre që e kanë shtëpinë larg. Të marrim si shembull kombinatin e tekstileve «Stalin» ku ka gjithë ato gra me fëmijë. Ndërmarrjes i intereson të mbajë në çerdhet e veta në radhë të parë fëmijët e atyre grave që i kanë shtëpitë larg Kombinatit. Ajo duhet të llogaritë nëse i intereson që punëtorja të humbasë nga puna një orë e gjysmë rrugë në ditë për shkak të largësisë së shtëpisë, apo të zgjerojë çerdhet dhe të futë fëmijët e këtyre grave, me qëllim që të pakësohet humbja e kohës së punës nëpër rrugë nga këto nëna, që me ligj e kanë të drejtë të venë t'u japin foshnjave të pinë? Nuk është e drejtë, është

antishoqërore të detyrohet gruaja të lërë fëmijën pa pirë më shumë nga norma. Kjo çështje duhet parë me shumë kujdes.

*SHOKU QIMO KOCANI:* Na del problemi i punës jashtë orarit. Në Kodin në fuqi ka një nen që thotë se nuk duhet të punohet më shumë se dy orë në ditë jashtë orarit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Në bujqësi këtë lloj pune e kemi vetëm në NBSH-të dhe në SMT-të. Për sa u përket fabrikave, uzinave etj. mendoj të qëndrojmë atje ku jemi. Edhe në NBSH-të mund ta lëmë, se kur gruri piqet, ai duhet korrur në kohë dhe të futet medoemos brenda sa më parë, që të mos priset. Për periudha të tilla pune intensive e të domosdoshme, ne duhet të manovrojmë me ndonjë përqindje, të mbajmë pagesën e orëve suplementare që marrin punëtorët. Punëtori për punën jashtë kohës normale të punës të marrë, ta zëmë, përveç pagës, edhe një shtesë jo më shumë se 25 për qind.

Për nëpunësit, që janë të panormuar, të mos vihet asgjë në Kod, se nuk do të kishte asnjë kuptim. Nëpunësit ne i ngarkojmë një detyrë, të cilën ai duhet ta kryejë. Rri 8 orë apo më shumë, punën nesër ai duhet ta dorëzojë të kryer. Po t'i duhet, le të punojë edhe natën. Është, pra, tjetër çështja me nëpunësit, tjetër me punëtorët e industrisë dhe tjetër me ata të bujqësisë. Kjo pjesë e Kodit duhet t'u përshtatet edhe kushteve të punës për sektorët ku nuk kemi organizata të bashkimeve profesionale, se edhe në këta sektorë punonjësit mund të thonë: «Përse ne të punojmë me orar të zgjatur?». Me rregullore ose me urdhëresa duhet të

përcaktohen disa caqe për këtë çështje; kjo sidomos për punëtorët e bujqësisë.

Të gjithë jemi dakord që interesi i përgjithshëm të lidhet me interesin personal, po duhet parë edhe ana shkencore e kohës së punës, se njeriu nuk është hekur. Ka disa norma dhe caqe shkencore për kohën e punës, të cilat duhet t'i kemi parasysh, si për ata që punojnë në turnin e natës, dhe sidomos për gratë, që ngrihen më herët në mëngjes dhe kthehen e bëjnë edhe disa orë të tjera punë në shtëpi etj. Kështu këtyre u mbetet të flenë vetëm pak orë. Një gjë e tillë nuk është aspak e drejtë.

*SHOKU QIMO KOCANI:* Pagesat personale i hoqëm.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po fondin e drejtorit?

*SHOKU QIMO KOCANI:* Këtë çështje nuk e trajtojmë fare në Kodin e ri, po edhe te ne ka mendime që duhet parë.

Në Kodin e ri është menduar të mos vihen karakteri, të drejtat dhe detyrat e bashkimeve profesionale, meqenëse këto dispozita janë në statutin e kësaj organizate dhe se në praktikë ka ndodhur që organizata ka mbrojtur edhe ndonjë punëtor të padisiplinuar.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Këto janë gjëra që ngjasin në jetë, janë gabime, disa njerëz mund të degjenerojnë, po parimi është parim.

*SHOKU QIMO KOCANI:* Vetë shteti te ne, për natyrën e tij, i tërheq punëtorët në veprimtarinë shtetërore dhe ekonomike. Në këtë drejtim edhe bashkimet profesionale ndihmojnë, por duke u vënë këto drejtpër-

drejt në Kod, mund të keqkuptohet çështja, sikur shteti te ne është mënjanë dhe bashkimet profesionale janë në anën tjetër. Kemi edhe çështjen e ankesave të punëtorëve. Mendimi i tyre është që kur kanë ankesë, të kenë të drejtë të venë në gjyq. Ne mendojmë se kur një punëtor ose një nëpunës ka një ankesë ndaj ndërmarrjes, t'i drejtohet organizatës së bashkimeve profesionale dhe vetëm në qoftë se kjo nuk arrin ta zgjidhë, ose punëtori apo administrata nuk është dakord me vendimin e saj, atëherë punëtori të vejë në gjyq.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Nga se shkaktohen këto ankesa?

*SHOKU QIMO KOCANI:* Për pushimet nga puna, për llogari jo të drejta në pagesat etj. Iniciatore për masat është kurdoherë administrata.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Gjersa punëtorit i halet e drejta, pushohet nga puna, i bëhen ndalesa nga paga etj., atëherë ai ka të drejtë të ankohet edhe në gjyq ose në komitetin ekzekutiv, por është më mirë që në fillim t'i drejtohet organizatës së bashkimeve profesionale. Parimi leninist që bashkimet profesionale, në kushtet e diktaturës së proletariatit, duhet të mos venë në kundërshtim me shtetin, po duhet medoemos t'i mbrojnë punëtorët nga abuzimet e administratës, është i drejtë. Në qoftë se do t'ua hiqnim bashkimeve profesionale këtë të drejtë, ato do të na mbeteshin vetëm për formë.

Prandaj unë s'jam shumë i bindur në mendimin që keni ju për të mos i vënë në Kodin e ri detyrat dhe të drejtat e bashkimeve profesionale. Këto mund të vi-

hen, pavarësisht se ato, si organizata masash, kanë statutin e tyre. Këto gjëra të mos i futim siç ishin, po të themi që bashkimet profesionale janë organizata punëtorësh, të cilat ndihmojnë Partinë dhe pushtetin ndaj veprimeve të jashtëligjshme të elementëve burokratë të administratës së ndërmarrjeve. Ato janë organizata të punonjësve, janë leva transmissioni, shkolla të komunizmit. Domethënë të vihet parimi ç'janë këto organizata. Pastaj Statuti i Bashkimeve Profesionale këto dhe gjëra të tjera i zhvillon më tej.

Vënia e rolit të organizatës këtu është një parim i rëndësishëm dhe do të ndihmojë që ankesa e një punëtorit të mos zgjidhet shkel e shko. Masa ose veprimi me karakter antipolitik, antimarksist, antishtetëror ndaj punëtorit duhet jo vetëm të gjejë kundërshtimin e Partisë, po edhe të bashkimeve profesionale. Partia i konsideron bashkimet profesionale si një organizatë të punëtorëve, e cila sinjalizon Partinë kurdoherë që shtrembërohet vija, ajo i shkon drejtorit dhe i thotë se ndërmarrja nuk po vepron drejt me të drejtat e punëtorëve. Domethënë bashkimeve profesionale u japim të drejtën të mbrojnë punëtorët nga shkeljet dhe drejtori të kuptojë se pa to nuk bën dot, se organizata e bashkimeve profesionale përfaqëson zërin e punëtorëve. Gjersa diçka që bën ndërmarrja ka lidhje me punëtorët, në përpunimin e çështjes duhet të marrë pjesë edhe organizata e bashkimeve profesionale. Përse të mos vihet në Kod ky karakter i organizatës së bashkimeve profesionale? Nga na i nxjerrin pikëpamjet disa që thonë se në këtë mënyrë organizata e bashkimeve profesionale vihet në kundërshtim me shtetin? Kur administrata bën një

plan joreal, si të mos reagojë organizata e bashkimeve profesionale dhe të mobilizojë punëtorët për të bërë një plan më të saktë? Pikërisht kështu ajo ndihmon shtetin dhe punëtorët kundër pikëpamjeve mikroborgjeze e të fjetura të një administrate të caktuar, që e zë gjumi dhe të drejtorit që mendon të jetë «brenda». Organizata nuk e lë atë të qëndrojë në këto pozita, as të shkëlë ligjet e shtetit. Ligjin mund të ndodhë që ta shkëlin edhe një ose pesë punëtorë, po me këtë askush nuk ka të drejtë të bëjë përgjithësimin se janë bashkimet profesionale ato që e shkëlin atë. Ligjet mund t'i shkëlin një ose pesë punëtorë, pikërisht atje ku puna politike nuk është në atë nivel që kërkohet.

Bashkimet profesionale kanë një rol të rëndësishëm në hartimin e planit, në kontrollin e punës etj. Gjersa ekzistojnë këto të drejta, përse të mos përcaktohet në Kod karakteri i bashkimeve profesionale? Këtu nuk e kam fjalën për shtetin, po për administratën e ndërmarrjeve etj. Një gjë e tillë do të frenojë abuzimet e administratës, domethënë jep mundësi të kontrollosh ndërmarrjet dhe ministrinë. Ne duhet të bëjmë që bashkimet profesionale edhe një ministrie t'i thonë ndal, nuk je në rregull, sikundërqë edhe i thuhet. Prandaj, duhet parë kjo çështje.

Natyrisht, pa u zgjatur në këtë çështje, në Kod të kujdesemi ta vëmë drejt parimin, duke mos e formuluar sikur organizata e bashkimeve profesionale bie në kundërshtim me shtetin. Përkundrazi, ajo bie e duhet të bjerë patjetër në kundërshtim me veprimet burokratike. Bashkimet profesionale ne t'i bëjmë organizata



për edukimin dhe për mbrojtjen e punëtorëve. Kjo organizatë, në qoftë se i bëhet padrejtësi një punëtori, ka të drejtë të ndërhyjë, po nuk e ndalon punëtorin të vejë edhe në gjyq, kur drejtori i ndërmarrjes e dënon pa faj.

Këto gjëra duhen kuptuar drejt nga ana politike. Kur administrata e ndërmarrjes, për shembull, dënon një punëtor dhe bashkimet profesionale gjykojnë se ajo nuk ka të drejtë, këto nuk duhet të qëndrojnë indiferente, po ta mbrojnë punëtorin. Atëherë përgjegjësi i organizatës shkon bisedon, arsyeton me drejtorin se masa nuk është e bazuar dhe po qe se ai nuk bindet, atëherë i drejtohet Partisë dhe punëtorit i thotë të drejtohet në gjyq. Punëtori në gjyq nuk do të thotë që Qeveria nuk është e mirë, po drejtori dhe shefi im më kanë bërë një padrejtësi të madhe. Ai, pra, hedh në gjyq administratën e asaj ndërmarrjeje që ka vepruar gabim e jo shtetin. Prandaj duhet parë edhe kjo çështje.

Edhe gjyqet luajnë një rol të rëndësishëm edukativ, po ato janë faza e fundit e zgjidhjes së problemit, prandaj është më e rekomandueshme që me edukimin e njerëzve të merren në radhë të parë bashkimet profesionale. Sigurisht, kur njerëzit bëjnë faje, ose kur ata nuk e kanë të qartë një gjë, nga faji ose nga paqartësia mund të lindin konflikte. Dhe gjersa ndodhin konflikte, përse të mos përpiqen bashkimet profesionale t'i pajtojnë palët në kundërshtim, t'u tregojnë punëtorëve çfarë duhet bërë, t'i edukojnë ata dhe të mos lejohet të merren masa jo të drejta nga ana e drejtorit? Këto gjëra duhen parë më thellë.

Ju, shokë të bashkimeve profesionale, kur ka shkele, të na sinjalizoni që të merren masa. Njerëzit të edukohen që të sundojnë kudo ndjenja të shëndosha socialiste. As favore të mos u bëni punëtorëve të pandërgjegjshëm, as lëshime të mos u bëhen punonjësve të administratës.

Shikoni ç'rol të madh luajnë bashkimet profesionale. Po të mos jetë syri juaj mbi ndonjë funksionar burokrat (dhe këtu çështja nuk duhet parë në prizmin sindikalist, se të gjithë ju jeni anëtarë partie), mund të bëhen lëshime, ligjet do të zbatohen në mënyrë të njëanshme, nuk do të dalë në dukje ajo që është në interes të përgjithshëm, pra mund të fshihen shumë gjëra. Këtu nuk është çështja për të mbrojtur një grup punëtorësh, po parimet e klasës punëtore që mund të dëmtohen nga burokratizmi.

Lidhur me transferimet, është i drejtë parimi që punëtori dhe nëpunësi të punojnë atje ku e do interesi i lartë i atdheut. Ky parim mund të vihet në Kod, gjersa nuk ka sanksione, domethënë masa detyrimi për të shkuar medoemos atje ku punonjësi është caktuar.

Për këto gjëra, si dhe për vërejtjen që bëra, ju duhet të mendoni një çikë më thellë.

Punëtori ose nëpunësi që për shkak sëmundjeje është bërë i paaftë për punë, mund të vihet në një punë tjetër të përshtatshme për atë kohë sa caktohet në raportin mjekësor, në qoftë se kjo kohë nuk është e gjatë, pastaj është e drejtë që ai të kthehet përsëri në punën e mëparshme.

Kohën normale ligjore të punës në Kod ta vëmë

8 orë. Ka rëndësi çështja që ju të shikoni të gjitha kategoritë e punëve, në mënyrë që për ata punonjës të cilët merren me punë më të vështira, të krijohen edhe disa mundësi për të ruajtur shëndetin e tyre, pra të mos anojmë nga administrata, të mos mendojmë për të rregulluar ndërmarrjen dhe të lihet pas dore kujdesi për njerëzit.

Në Projektkodin e ri thuhet që nga ora 22 e gjer në orën 6 të mëngjesit koha e punës të zbritet një orë, pa ulur pagën. Edhe me këtë jam dakord.

Për sa i përket pagës së punëtorëve të rinj, nën 16 vjeç, mendoj të mos largohemi nga formulimi që ekziston në Kodin e vjetër për t'i paguar për 8 orë, megjithëse punojnë 6 orë, sepse kjo ka të bëjë me shëndetin e tyre.

Në raste të veçanta punëtorët ose nëpunësit, duke pasur edhe pëlqimin e tyre, mund të punojnë tej kohës së punës.

Gruaja shtatzënë si para lindjes, ashtu edhe pas lindjes, me ligj ka të drejtë gjithsej 12-15 javë pushim. Kjo, natyrisht, duhet të vihet në Kodin e ri, por duhen marrë parasysh edhe favorizimet e tjera që parashikon ligji.

Shërbimi paraushtarak parashikohet me ligj, prandaj atyre që thirren për këtë shërbim t'u ulet një përqindje page gjatë kohës së stërvitjes, sikurse veprohet me të gjithë ata që bëjnë stërvitje ushtarake. Ata ta ndiejnë se kjo është detyrë patriotike.

Tani ju reflektoni mbi këto që biseduam bashkërisht që, kur ta paraqitni Projektkodin e ri në mbledh-

jen e Byrosë Politike, të na ndihmoni me eksperiencën tuaj çfarë mund të bëjmë që ai të dalë sa më i plotë.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## TE NA PREOKUPOJË SHUMË JETA LUFTARAKE NË ORGANIZATËN-BAZË

*Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë  
të Partisë ku bën pjesë*

**17 prill 1966**

Në pajtim me rendin e ditës të kësaj mbledhjeje për dhënie llogari e zgjedhje, sipas mendimit tim, këtë herë mund të na lejohet të kapim disa probleme në diskutimet tona, duke bërë gjithsecili edhe autokritikë për punën e vet, por në të ardhmen ne duhet të gjejmë mënyrën më të përshtatshme për të rrahur në organizatën-bazë të Partisë probleme më konkrete. Në organizatë të mos na shtrohen shumë probleme, se u kalohet përciptas, por të marrim një ose dy prej tyre dhe t'i thellojmë.

Nëse shoku që shtron problemin e ndien për detyrë të bëjë autokritikë, le ta bëjë, por edhe sikur të mos e bëjë, ne këtu jemi, do t'i drejtojmë pyetje dhe do ta kritikojmë po të ketë gabime. Autokritika nuk duhet të jetë e përgjithshme. Jemi mësuar me një lloj autokritike, duke mbyllur afërsisht diskutimin tonë me shprehjen: «Edhe unë kam përgjegjësitë e mia për kë-

të ose për atë çështje». Kjo nuk është autokritikë. Por nëse shokun do ta vëmë përpara disa pyetjeve, me të cilat i kërkojmë të na i zbërthejë në mënyrë konkrete përgjegjësitë që ka dhe të na thotë si mendon për ta përmirësuar punën, nëse e kritikojmë apo hapim debate me të, atëherë do të shohim si do të qëndrojë ai përpara këtyre mendimeve e kritikave të shokëve. Ai do të thotë mendimet e tij, ne do të themi tonat, atmosfera do të ndizet dhe do të bëhen përpjekje për të gjetur rrugët më të drejta për zgjidhjen e problemit që u diskutua. Mendimet e shokut dhe tonat nuk duhet të jenë të nxituara, përkundrazi, ato duhet të jenë serioze, se kështu kritika jonë do të jetë objektive jo vetëm në drejtim të shokut, por edhe për punën. Këtu do të shohim, gjithashtu, edhe reagimin e shokut ndaj kritikës. Atëherë vetë komunisti do të ngrihet dhe do të thotë se shokët e organizatës-bazë e ndihmuan të thellohet në autokritikën e tij.

Duhet të na preokupojë shumë jeta luftarake në organizatat-bazë të Partisë. Për ta bërë organizatën-bazë luftarake dhe shkollë për edukimin e komunistëve, kurdoherë të përqendrohemi te problemi që marrim në analizë. Në qoftë se kemi disa probleme që nuk presin, atëherë ne mund të mblidhemi më tepër se një herë në muaj. Kështu hap puna punën, shohim ku fle lepurit, ku i kemi dobësitë, ku duhet të marrim masa. Po të reflektojmë mirë, ne do të mund të nxjerrim mjaft gjëra.

Vëmë re se në diskutimet që bëjnë shokët japin shumë shembuj. Po prej tyre ne duhet të nxjerrim konkluzione, të shohim si i kemi format e punës dhe

të organizimit, i kemi këto në frymën e Letrës së Hapur të Partisë apo duhet t'i revolucionarizojmë në përshatje me situatat, me njerëzit, me rrethanat? Fjalën e kam të mos kënaqemi duke sjellë vetëm shembuj. Këtu, në një diskutim, u fol për punën politike. Mirë, drejt themi ne që politika ka prioritet, por më parë është mirë të mendojmë: a lyp kjo një diskutim të veçantë në organizatën-bazë? Po. Por ashtu siç u trajtua është mënyra më e thjeshtë. Kurse po të vendosim se ia vlen të diskutohet në një mbledhje organizate për punën politike me njerëzit, atëherë ne do të reflektojmë, do t'i thellojmë mendimet që kemi, do të vijmë të përgatitur mirë në mbledhjen e organizatës dhe do të dalim me disa konkluzione të sakta. Ose shoku që merret me letrat, po të ketë ndonjë problem, mund t'i thotë sekretarit se dëshiron të raportojë në organizatë mbi disa konkluzione që ka nxjerrë nga letrat që kanë ardhur në Komitetin Qendror. Nga informimi i hollësishëm që do t'i bëjë ai organizatës, ne mund ta gjykojmë të arsyeshme të informojmë udhëheqjen për atë çështje që paraqet më interes. Kështu organizatën-bazë ndihmon Partinë për ta forcuar punën në këtë ose në atë drejtim.

Pra shoku që ka një problem për të ngritur, më parë se të vijë në organizatë, ai duhet të ketë reflektuar thellë, të dijë si paraqitet gjendja në lidhje me të, në mënyrë që në organizatë të japë karakteristikat kryesore të problemit dhe të propozojë masat përkatëse.

Le të marrim një çështje tjetër.

Ditët e fundit më paraqitën një projektvendim për disa ndryshime në organikat e organeve të shtypit, pa

shtuar kontingjentin. Këtë vendim mund ta firmoja edhe ashtu siç m'u paraqit, por a ishte vallë i menduar mirë ky projekt? A do të zgjidheshin kështu problemet që ka shtypi? Për këtë duhet reflektuar. Të gjithë e lexojmë gazetën dhe secili ka mendimet e veta, po këto mendime ne duhet t'i konkretizojmë. Shtypi ka rëndësi të madhe, por me sa duket atje nuk kanë hyrë si duhet çështjet që përmban Letra e Hapur e Komitetit Qendror të Partisë. Gazetarët shkruajnë për luftën kundër burokratizmit dhe për probleme të tjera të rëndësishme, por për vete nuk kanë reflektuar thellë. Një pjesë të mirë të gazetës e zënë informacionet e vogla ekonomike, veçanërisht për bujqësinë. Ka edhe ndonjë informacion të tillë si, për shembull, «në fshatin Burizan kanë mbjellë 1 hektar me patate». E çfarë të jep ky fakt? Kurse një pjesë tjetër e gazetës zihet me lajme të jashtme. Informacionet dhe lajmet duhen në gazetë, po jo të zënë aq shumë vend, se vendin kryesor do t'ua lëmë artikujve të rëndësishëm që na sjellin në faqet e gazetës eksperiencën e punës për zbatimin e direktivave të Partisë. Po të rrijë të mendojë gazetari, ai do të gjejë shumë probleme që kanë interes për t'i trajtuar në shtyp dhe, po të veprohet kështu, nuk do të mbetet vend për informacione të panevojshme.

Mirëpo e keqja është se mjaft gazetarë priren më tepër nga stili, prandaj shihet që në shkrimet e tyre ka shumë ujë. Ata përpigën t'i veshin mirë shkrimet nga ana letrare e historike dhe lënë si në plan të dytë idetë. Stili ka rëndësi, por rëndësinë më të madhe e kanë problemet që trajton në artikull. Mjeshtëria e ga-



zetarit duket atëherë kur stili që përdor ndihmon për të komunikuar mirë me lexuesin dhe për t'i dhënë qartë problemet, aq sa, kur ta marrë lexuesi artikullin, ai ta studiojë dhe të kuptojë ku janë anët e mira dhe të metat e punës, të ballafaqohet me to dhe t'i ketë parasysh për gjithë vitin.

Ne jemi në gjendje të reflektojmë për çdo problem. Kur e shohim se diçka është e domosdoshme ta shqyrtojë organizata-bazë, ta vëmë në rendin e ditës dhe ta diskutojmë.

Edhe sekretari që do të zgjedhë organizata luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen e mbledhjeve, për zgjedhjen në mes të problemeve të tjera atë që është më aktual, që kërkon zgjidhje dhe që do të shërbejë si orientim në punën tonë. Por, që të bëhet kjo, sekretari i organizatës duhet të jetë në lidhje të ngushtë me të gjithë ne, gjithashtu edhe ne duhet të jemi në lidhje të ngushtë me të. Secili nga ne duhet t'i thotë atij se ç'problem mendon për ta shtruar në organizatë, ta njoftojë se ka reflektuar shumë, ka nxjerrë konkluzione dhe ka një varg propozimesh, të cilat ai mendon të diskutohen në mbledhje, të merren edhe mendimet e shokëve të tjerë. Problemet që diskutohen në organizatë, sipas rëndësisë që kanë, në rrugë partie mund t'i shtrohen edhe sekretarit të Komitetit Qendror të Partisë, të merren udhëzime prej tij dhe të gjenden format për t'i zgjidhur sa më drejt dhe për të përgjithësuar në Parti eksperiencën e mirë.

Sekretari i organizatës-bazë të Partisë e ka për detyrë që të na vërë në dijeni se më janë paraqitur 3-4 çështje për rendin e ditës të mbledhjes së ardhsh-

me të organizatës, prandaj dua të marr mendimin tuaj se cila prej tyre është më e domosdoshme të shqyrtohet. Njëkohësisht, ai edhe na thotë se ku duhet të përqendrohemi më shumë, rreth cilit problem. Ne të gjithë kemi një detyrë të madhe partie, prandaj secili prej nesh të sjellë në mbledhjen e organizatës kontributin e tij. Në këtë mënyrë diskutimet nuk do të jenë formale, po të përgatitura. Kur diskutohet, për shembull, për autokritikën dhe disiplinën në organizatën-bazë të Partisë, mbi këto probleme duhet thelluar dhe diskutimet të mos jenë stereotipe.

Të na preokupojë, pra, çështja se si ta bëjmë më luftarake organizatën-bazë, sepse pikërisht po të vendosim një metodë pune të mirë këtu, kjo do të ndikojë pozitivisht dhe do të ndihmojmë shumë edhe Partinë.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të nxjerra nga protokollin e mbledhjes së organizatës-bazë të Partisë që gjendet në AQP*

**KONGRESI I 23-TË I PK TË BS SANKSIONOI VIJËN  
E PERGJITHSHME TË REVIZIONIZMIT  
HRUSHOVIAN, POLITIKËN E TRADHTISË  
DHE TË KAPITULLIMIT**

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

**22 prill 1966**

Ka disa ditë që propaganda revizioniste sovjetike po reklamon me bujë të madhe në të katër anët, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, rezultatet e Kongresit të 23-të të PK të BS. Ajo mundohet të bindë popullin sovjetik dhe opinionin publik botëror se kongresi përfundoi me sukses, se ai u shndërrua, gjoja, në një ngjarje të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, se «idetë» e tij do të ushtrojnë një influencë të madhe në mendjet e njerëzve, se ai ka një karakter epokal në historinë sovjetike etj., etj.

Duket qartë se revizionistët hrushovianë mundohen që me anë të fjalëve e të propagandës të arrijnë atë çka dëshironin të ishte kongresi i tyre, të ngjallin pak entuziazëm në popull, të paralizojnë përshtypjet negative si në Bashkimin Sovjetik ashtu edhe në vendet e tjera, me një fjalë, të ngrenë moralin e gjithë

atyre që pritnin diçka të madhe e të rëndësishme nga mbledhja e organit më të lartë të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e që u deziluzionuan keqas.

«Pravda», «Izvestia» dhe organet e tjera të propagandës sovjetike akuzojnë tani shtypin borgjez për mungesë realizmi, pasi, sipas tyre, ai priste nga kongresi «sensacione», por tani paska mbetur i deziluzionuar, pasi të tilla nuk pati në të. Në qoftë se do të ishte vetëm shtypi borgjez, të cilit kësaj radhe nuk i paska ecur fati, siç thonë gazetat sovjetike, kjo do të ishte ndoshta krejt normale. Por nuk besojmë se mungesa e aftësisë së shtypit borgjez, për të parashikuar drejt ngjarjet, është ajo që i preokupon kaq shumë udhëheqësit revizionistë. E keqja për revizionistët është se punimet e Kongresit të 23-të kanë deziluzionuar popullin sovjetik, komunistët sovjetikë, të cilët, sigurisht, nuk pritnin sensacione, por një sqarim të përgjithshëm të vijës politike të partisë në etapën e sotme. Duke luftuar kundër «pritjes së sensacioneve», shtypi sovjetik kërkon t'u ngrejë vlerën e vërtetë rezultateve të kongresit, që ishte shumë e ulët e mediokre. Punimet dhe vendimet e Kongresit të 23-të të PK të BS nuk kënaqën, në radhë të parë e para së gjithash, popullin sovjetik, i cili edhe një herë pa qartë se udhëheqja e sotme sovjetike është po aq tradhtarë sa edhe Hrushovi, se vija që ajo përcaktoi në kongres është një vijë antimarksiste, vijë e degjenerimit politik, ekonomik e ideologjik të Bashkimit Sovjetik në kapitalizëm, vijë që goditi dhe errësoi mbi të gjitha perspektivat e së ardhmes së popullit sovjetik. Rezultatet e kongresit

jashtë Bashkimit Sovjetik mund të kenë njëfarë interesi, por kjo nuk është aspak kryesore. Përpjekjet për ta tërhequr në këtë drejtim vëmendjen e opinio-nit publik, siç bën shtypi sovjetik, tregojnë se revizio-nistët hrushovianë nuk i kanë mirë punët me popullin e tyre, se ata duan të largojnë vëmendjen nga atmos-fera e zymtë e pesimiste që krijoi kongresi në Bash-kimin Sovjetik.

Kongresi vetë ka qenë një preokupacion i madh për udhëheqjen hrushoviane. Të fliste apo të mos fli-ste hapur për të gjitha çështjet kardinale që preoku-pojnë sot popullin sovjetik, të dilte apo të mos dilte hapur me vijën e saj oportuniste — ja ku qëndronte dilema.

Gjatë dhjetë vjetëve të fundit, Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik ka bërë tri kongrese (kongreset 20, 21 e 22), në të cilat u përcaktua dhe u kanunizua vija revizioniste e grupit hrushovian, i cili uzurpoi me anë puçesh kundërrevolucionare udhëheqjen e PK të BS dhe të shtetit sovjetik. Në to u morën vendime, u përcaktuan direktiva, u shënuan objektiva dhe u caktuan afate. Tani erdhi koha për të dhënë llogari. A i duhej raportuar kongresit për këto? Brenda kësaj kohe Ba-shkimi Sovjetik ka ndjekur një politikë të jashtme krejt të ndryshme nga ajo që ishte përpunuar bashkë-riht nga vendet socialiste. A duhej folur për këtë? Udhëheqja e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, jo shumë kohë më parë (më 1957 e më 1960) kishte nënshkruar disa dokumente të rëndësishme të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, të cilat përcaktonin qartë programin e përbashkët të saj. Ajo i hodhi poshtë kë-

to dokumente dhe ndoqi një vijë e veprimtari të saj të veçantë. A duhej dhënë ndonjë shpjegim për këtë? Gjatë kësaj periudhe ajo ndoqi vijën e largimit nga marksizëm-leninizmi dhe të përçafimit gjithnjë e më shumë të revizionizmit modern. Në fushën e brendshme ajo iu vu me shumë zell minimin të fitoreve të Revolucionit të Tetorit dhe restaurimit të kapitalizmit, ndërsa në politikën e jashtme adoptoi vijën e bashkëpunimit me imperializmin amerikan për vendosjen e sundimit të dy fuqive të mëdha në botë; u largua nga miqtë e Bashkimit Sovjetik dhe u afrua me armiqtë e tij, punoi me të gjitha forcat për përçarjen e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të frontit antiimperialist, sabotoi lëvizjet çlirimtare të popujve dhe hoqi dorë nga revolucioni dhe nga idealet e komunizmit. Cilat qenë rezultatet e kësaj vije, të këtyre qëndrimeve e veprimeve? Në qoftë se klika hrushoviane do të kishin mbështetjen dhe përkrahjen e komunistëve dhe të popullit sovjetik, ashtu siç pretendon, atëherë pse të mos dilte hapur në kongres dhe të mbronte pikëpamjet e saj kur ajo i quan «të drejta», «leniniste», «realiste», «shkencore» etj.?

Duket se puna nuk qenka e lehtë. Lëmshi i kontradiktave të saj me partinë e popullin është pleksur kaq shumë, sa ajo nuk di nga ta zërë fillin. Po të dilnin hapur në kongres me vijën e tyre, udhëheqësit sovjetikë do të demaskonin veten si tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe kundërrevolucionarë të rrezikshëm, do të zbulonin përpara popullit sovjetik dhe gjithë botës komplotet dhe metodat e tyre të ulëta për të shtënë në dorë udhëheqjen e partisë dhe të shtetit, do të nxirrnin

në shesh planet e tyre djallëzore kundër revolucionit, socializmit dhe paqes. Ballafaqimi me realitetin, me të vërtetën, do të ishte vdekjeprurës për ta. Prandaj edhe kujdesi kryesor i tyre në këtë kongres ishte evitimi i ndeshjes me problemet themelore të jetës sovjetike dhe asaj ndërkombëtare, kalimi në heshtje i preokupacioneve të mëdha, dyshimeve dhe alarmimeve të njerëzve sovjetikë, mosdhënia e asnjë përgjigjeje pikëpyetjeve shqetësuese që jeta sovjetike, si rezultat i veprimtarisë tradhtarë të revizionistëve, ka shtruar tani në rendin e ditës.

### **Kongresi i 23-të ishte kongresi i «ngrirjes» së të gjitha problemeve që preokupojnë sot popullin sovjetik**

Në historinë e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik nuk ka pasur kurrë një kongres të tillë të pangjyrë si Kongresi i 23-të që organizoi dhe zhvilloi këto ditët e fundit udhëheqja e re hrushoviane. Në qoftë se do t'i karakterizojmë me një fjalë punimet e tij, mund të thoshim se ai ishte kongresi i «ngrirjes» së të gjitha problemeve që preokupojnë sot popullin sovjetik. Raporti që Brezhnjevi i paraqiti kongresit në emër të Komitetit Qendror të Partisë, më shumë se çdo gjë tjetër, i ngjante një fjalimi të një agjitorit të thjeshtë në një mbledhje solemne të zakonshme në ndonjë fabrikë. Diskutimet skematike dhe përsëritja monotone e shifrave të planit të ri pesëvjeçar, të marra nga projekti i tij, që ishte botuar e diskutuar mjaft kohë

më parë, nuk mund t'i jepnin jetë një kufome të pashpirt. Përderisa problemet e vërteta ishin varrosur që më parë, edhe recitimet në kongres do të ishin të vdekura.

Sigurisht, këtu nuk është puna se organizatorëve të Kongresit të 23-të u mungon oratoria, ose nuk dinë si përgatiten fjalimet. Ne i kemi parë këta paladinë të revizionizmit hrushovian në Kongresin e 20-të dhe sidomos në të 22-in, t'u priste palla para e prapa. Ulja e tonit të zërit të tyre nuk është ndonjë shprehje pjekurie ose urtësie, siç mund ta interpretojë ndokush. Ajo përcakton një gjendje të caktuar raportesh kontraktore, jo vetëm midis udhëheqjes së partisë, nga njëra anë, dhe komunistëve e popullit, nga ana tjetër, por edhe midis udhëheqjes revizioniste sovjetike dhe aleatëve të saj revizionistë të partive të tjera. Nuk është vështirë të vihet re, për shembull, se raporti politik i Brezhnjevrit është një përmbledhje e kujdesshme kompromisesh për të mos trajtuar çështjet më themelore që kanë pushtuar jetën sovjetike këto vitet e fundit dhe për të formuluar vijën revizioniste, duke evituar çdo gjë që mund të ngjallte diskutime ose pakënaqësi në aleatët e tyre. Nuk është i rastit fakti që pjesëtarë të tillë të rëndësishëm të klikës hrushoviane, si Suslovi, Shelepini, Mikoiani, Poljanski e të tjerë, nuk folën fare në kongres. Vështirë është të besojë njeriu se ata s'kishin gjë për të thënë. Por në një kongres plot rezerva, ku gjërat duheshin thënë të rrumbullakosura, ku edhe përpjekja më e vogël për t'u thelluar në ndonjë çështje sadopak të rëndësishme, kishte rrezikun që t'i hiqte petën lakrorit, në kushte të tilla, pra, heshtja është flori. Kjo heshtje, si dhe paraqitja kaq e dobët



ekonomike e politike e Bashkimit Sovjetik në kongres, u pëlqeu shumë aleatëve të revizionistëve hrushovianë, sepse ata janë të interesuar që Bashkimi Sovjetik të dobësohet nga çdo pikëpamje. Kështu ata i shpëtojnë më lehtë shkopit të dirigjentit dhe mund të sigurojnë mbështetjen e borgjezisë së tyre nacionale.

Në kongresin e një partie të vërtetë komuniste, komiteti i saj qendror nuk jep llogari vetëm përpara anëtarëve të partisë, por ai raporton mbi politikën dhe mbi veprimtarinë e partisë përpara gjithë popullit. Në mënyrë të veçantë në të bëhet bilanci i realizimit të detyrave dhe direktivave që ka caktuar kongresi i mëparshëm dhe analizohen të gjitha ngjarjet e rëndësishme që kanë ndodhur ose masat dhe veprimet e ndryshme që ka ndërmarrë komiteti qendror brenda periudhës gjatë dy kongreseve. Por një gjë e tillë nuk u bë dhe as që mund të bëhej në Kongresin e 23-të të PK të BS. Përveç disa fjalëve të përgjithshme, të papërcaktuara dhe të paqarta, asgjë nuk u tha se ç'ka ndodhur dhe ç'është bërë pas Kongresit të 22-të. Nuk u tha, për shembull, si është punuar dhe si është realizuar vija e Kongresit të 22-të. Në të, në mënyrë të veçantë, u sulmua Stalini, u shtrua çështja të luftohej deri në fund kundër «kultit të J. V. Stalinit». Pse nuk u raportua në kongresin e tanishëm për rezultatet e kësaj fushate? Në kongresin e mëparshëm Hrushovi sulmoi Partinë e Punës të Shqipërisë dhe Republikën Popullore të Shqipërisë, në rezolucionin e kongresit u bënë thirrje e kërcënime, u shprehën «shpresa» e «kërkesa» ndaj vendit tonë. Por ç'u bë pastaj? Ç'politikë ndoqi udhëheqja sovjetike ndaj Partisë e popullit tonë? Hrushovi dhe bashkë-

punëtorët e tij të afërt prenë marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, vendosën kundër vendit tonë një bllokadë të gjithanshme, komplotuan kundër lirisë dhe pa-varësisë së një vendi socialist, me të cilin e lidhnin detyrime të shumta të pranuar botërisht. A nuk u duhej dhënë partisë dhe popullit sovjetik njëfarë sqarimi për të gjitha këto?

Tanimë është fakt se lëvizja komuniste ka hasur vështirësi të shumta, ndërsa kampi socialist është përçarë, se ka një kohë të gjatë që po zhvillohet një polemikë e madhe dhe e ashpër midis marksistë-leninistëve dhe revizionistëve. Udhëheqësit sovjetikë kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë përpjekje të mëdha për të vendosur hegjemoninë e shkopit të dirigjentit mbi partitë komuniste, ata ndërhyjnë brutalisht në punët e brendshme të atyre partive që i qëndrojnë besnike marksizëm-leninizmit, përkrahin renegatët në partitë e ndryshme etj. Komunistët dhe populli sovjetik dëshirojnë shumë të dinë se ç'bëhet në këtë fushë, por në kongres organizatorët e tij i kaluan në heshtje këto çështje, sikur ato të mos ekzistonin fare, ose sikur ata të mos ishin vetë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në to.

Nga ata që e morën fjalën në kongres nuk mbeti njeri që të mos e ngrinte në qiell plenumin e tetorit 1964, i cili paska qenë «shpëtimtar». Por asnjëri nuk e përmendi emrin e Hrushovit, asnjëri nuk tha ç'u bë në atë plenum. Dihet se ai rrëzoi Hrushovin, i cili deri atëherë mbante funksionet më të larta në Bashkimin Sovjetik, atë të Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, pa mos përmendur të tjerat. Në atë kohë, në komunikatën

zyrtare të plenumit thuhej se ai u largua nga postet që mbante për shkak të gjendjes së keqe shëndetësore dhe të moshës së kaluar. Në kongres ky formulim as u konfirmua, as u përgënjeshtroa. Kushdo mund të pyesë: si është e mundur të mos i raportohet partisë ç'u bë me sekretarin e parë të saj, të mos i njoftohet popullit pse u ndryshua qeveria? Sido që të jetë puna, udhëheqësit e rinj sovjetikë ose duhej t'i bënin Hrushovit një homazh publik, pasi ai «u largua për shkak të moshës së kaluar dhe të gjendjes së keqe shëndetësore», ose duhej dënuar publikisht për «subjektivizëm», «voluntarizëm» etj. Një heshtje e tillë nuk është mbajtur kurrë nga një parti komuniste e vërtetë.

Më lart përmendëm vetëm disa nga problemet që preokupojnë shoqërinë sovjetike e që Kongresi i 23-të i injoroi plotësisht, sikur ato të mos ekzistonin fare. Sigurisht, për cilindo është e qartë se, duke mos i përmendur këto çështje, ato nuk zhduken, nuk e humbasin mprehtësinë dhe aktualitetin e tyre. Në një kryeartikull të datës 6 prill, kushtuar përfundimit të diskutimeve rreth pikës së parë të rendit të ditës të kongresit — raportit të Brezhnjev, gazeta «Pravda» reklamonte «unanimitetin dhe kompaktësinë» që gjoja u vu re në kongres gjatë pjesës së parë të punimeve. Gazeta nuk e shpjegon se ku konsistonte ky unanimitet, në ato që u thanë, apo në ato që nuk u thanë, ose që, sipas mendimit apo raportit të forcave në gjirin e udhëheqjes, nuk duhet të ngriheshin e të përballoheshin. Por kompromiset nuk e kanë jetën të gjatë, ato nuk japin kurrë një zgjidhje të plotë e të përhershme. Vetë historia e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që nga vdekja

e Stalinit e këtej, është një shembull i madh se sa të pafat kanë qenë këto kompromise dhe cilat kanë qenë pasojat e tyre.

Tanimë është një fakt i pamohueshëm se në shoqërinë sovjetike mungon uniteti politik e ideologjik dhe një gjë e tillë, me gjithë kujdesin e madh të udhëheqjes për të evituar shprehjen e kësaj gjendjeje në punimet e kongresit, prapëseprapë, në një mënyrë ose në një tjetër, doli edhe këtu. Mungesa e unitetit u vu re në shqetësimet e shumë diskutantëve, të cilët bënë thirrje për unitet politik dhe ideologjik, në preokupacionet e disave për shfaqjet jo të shëndosha në edukimin e rinisë, ose për liberalizmin që sundon tani në lëmin e letërsisë, të arteve, në shturjet në ekonomi etj.

Të mbërthyer midis kontradiktash të rënda të brendshme e të jashtme, të cilat kanë lindur dhe po zhvillohen si rrjedhim i disfatave që kanë pësuar hrushovianët deri tani, udhëheqësit e rinj sovjetikë bënë ç'është e mundur që nga kongresi të merrnin aprovimin për vijën e ardhshme. Për këtë qëllim ata përdorën të gjitha mjetet që nga kalimi në heshtje i problemeve më të mprehta, deri te lënia mënjanë e termave të tillë të preferuar të revizionistëve hrushovianë, si «shteti i gjithë popullit» dhe «partia e gjithë popullit»; që nga manovrimi me shifrat e planit të ri pesëvjeçar dhe deri te mungesa e mburrjeve të tipit hrushovian; që nga evitimi i ngritjes së çështjeve «të reja teorike», apo i formulimit të «kodeve» të reja të komunizmit dhe deri te shpërthimet demagogjike për «unitet» e qëndrim «antiimperialist» etj. Ky «stil» i ri, sigurisht, nuk u adoptua për të theksuar ndryshimin nga vija e Hrushovit. Ai bën pjesë në takti-

kën demagogjike të pasardhësve të Hrushovit, të cilët mundohen të ruajnë trashëgiminë ideologjike dhe vijën politike të paraardhësit të tyre, por pa bujë, pa zhurmë. Taktika e udhëheqësve të rinj është taktika e mirënjohur e dy fytyrave, e veprimeve nën rrogëz, e komplotëve të heshtura dhe e intrigave në prapaskenë. Punimet dhe vendimet e Kongresit të 23-të vërtetojnë përsëri se ata janë të vendosur të ecin në këtë rrugë, domethënë të zbatojnë hrushovizmin pa Hrushovin, të luftojnë marksizëm-leninizmin, por jo me metodat e tij brutale e autoritare, të ecin në rrugën e bashkëpunimit me imperializmin amerikan, por pa u mburrur hapur për këtë, të vazhdojnë minimin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të kampit të socializmit, por ta bëjnë këtë në emër të «unitetit», me një fjalë, tjetër të thonë e tjetër të bëjnë. Por asgjë nuk i shpëton dot udhëheqësit e rinj sovjetikë. Dialektika e ngjarjeve është e tillë që çdo orvatje për të kapërcyer vështirësitë dhe kontradiktat mbi bazën e asaj vije që i ka shkaktuar ato, nuk mund të sjellë tjetër veçse thellimin e mëtejshëm të këtyre vështirësive dhe kontradiktave, pra disfatën e pashmangshme dhe përfundimtare të revizionizmit hrushovian.

## Kongresi i hrushovizmit pa Hrushovin

Ç'tregoi Kongresi i 23-të? Ai tregoi se udhëheqja e re sovjetike vazhdon të ngulë këmbë në ndjekjen me besnikëri dhe deri në fund të vijës tradhtarë, kapitulluese, antimarksiste të kongreseve të 20-të e të 22-të, të zbatojë me çdo kusht vijën revizioniste hrushoviane të

tradhtisë e të kapitullimit, të mishëruar në programin e PK të BS. Në të gjitha çështjet e brendshme dhe të jashtme mbetet përsëri vija e përgjithshme e revizionizmit hrushovian. Tezat e kongreseve të 20-të e të 22-të, ashtu siç kanë qenë deri më sot, mbeten ungjilli i revizionistëve sovjetikë, tek i cili ata betohen dhe frymëzohen për veprime të reja kundërrevolucionare. Bile në disa drejtime, siç është ai i drejtimit dhe i administrimit të ekonomisë, udhëheqësit e rinj shkuan edhe më tej në rrugën revizioniste. Ata e detyruan kongresin të adoptojë reformat e reja ekonomike, të cilat shënojnë një hap të ri drejt krijimit të kushteve më të favorshme për rivendosjen e kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik.

Brezhnjevi, Kosigini dhe mjaft oratorë të tjerë sollën në kongres shumë shifra dhe luajtën me to ashtu siç luajnë me shkopinjtë zhonglerët në cirqe. Ata u munduan të bindin dëgjuesit për «të mirat» që gjoja ky plan pesëvjeçar do t'i sjellë popullit sovjetik, për vendin që do të zërë ekonomia sovjetike në botë, për influencën ndërkombëtare të saj etj. Por të tilla premtime populli sovjetik ka dëgjuar shumë herë gjatë këtyre viteve të fundit nga udhëheqësit revizionistë. Hrushovi dhe bashkëpunëtorët e tij, që qëndrojnë sot në krye të udhëheqjes së partisë e të shtetit, disa vjet më parë i prematuan popullit sovjetik se në vitin 1970 do të arriheshin kulmet më të larta të mirëqenies njerëzore, se në mos në komunizëm, ai do të ishte në këtë kohë në prapun e komunizmit. «Në projektin e planit të përgjithshëm është parashikuar rritja e prodhimit të mallrave të konsumit në të tilla përpjesëtime, deklaroi Kosigini në Ko-

ngresin e 22-të, aq sa rreth vitit 1970 ne do të kalojmë nivelin e vendeve më të zhvilluara kapitaliste në prodhimin për frymë të popullsisë, ndër të cilat edhe SHBA-në», por në kongresin e tanishëm Kosigini nuk bëri më fjalë për premtimet e mëparshme, bile ai u detyrua, në njëfarë mënyre, të pranojë se kursi revizionist ka sjellë disfata të shumta. Si për t'u justifikuar, ai u mundua t'ia hedhë fajin prapambetjes së bujqësisë, e cila, sipas tij, bëri që «të mos realizohen plotësisht detyrat për zhvillimin e industrisë së lehtë ushqimore, gjë që nuk mund të mos influenconte në ngadalësimin e ritmeve të rritjes së të ardhurave kombëtare dhe të mirëqenies materiale të punonjësve». Ai tha se një faktor tjetër që ka influencuar në këtë çështje ka qenë dhe rënia e rendimentit të punës, që gjatë pesëvjeçarit të fundit ka qenë më i ulët nga ai i mëparshmi. Në raportin e tij Kosigini u mundua mjaft të mos zbulonte shkaqet e vërteta të mosrealizimit të mjaft prej treguesve të planit shtatëvjeçar. Ai tha se janë bërë gabime dhe llogaritje të pabazuara, por nuk tregoi se kush i ka bërë këto gabime, se kush është ai, ose ata që kanë pasur një «qëndrim të pamenduar, voluntarist ndaj zgjidhjes së mjaft problemeve të komplikuar ekonomike», që kanë «parashikuar detyra ekonomikisht të pabazuara, të cilat nuk mund të plotësoheshin». Të gjithë e dinë se në kohën e hartimit të planit shtatëvjeçar të BS Kosigini, për postin që mbante në atë kohë, ka qenë një nga hartuesit e tij dhe para se të binte Hrushovi ishte një nga propagandistët më të zjarrtë që vinte shpesh në dukje bazën «shkencore» të planit, «realizmin» e tij etj., etj. Ja, për shembull, çfarë pati deklaruar ai në Kongresin e 22-të: «Zhvillimi me sukses i ekonomisë

kombëtare tregon në mënyrë bindëse se sa i drejtë dhe i kohës është kursi i ndërmarrë nga Komiteti Qendror i Partisë me shokun Hrushov në krye për perfeksionimin e mëtejshëm të strukturës ekonomike të prodhimit në bazë të të dhënave të shkencës dhe të teknikës... Ne kemi arritur tani një nivel të tillë zhvillimi që ndërtimi i komunizmit u bë një detyrë praktike e drejtpërdrejtë e popullit sovjetik... Programi i PK të BS, fjalimet e shokut Hrushov në kongres, përfaqësojnë në një shembull të shkëlqyer të analizës së thellë të jetës shoqërore, një zhvillim krijues dhe pasurim të teorisë marksiste-leniniste». Kurse në Kongresin e 23-të ai dënoi «subjektivizmin në zgjidhjen e çështjeve ekonomike, përbuzjen diletanteske të të dhënave të shkencës dhe të teknikës».

Nuk e dimë se ç'mund të thotë Kosigini në kongresin e 24-t. Por të tilla pehliuanllëqe nuk kanë të bëjnë as me shkencën as me marksizmin. Ai flet sipas situatës, ato që ka thënë dje i përgënjeshtrohet sot, ato që sot i shpall si kulmin e mbërritjeve shkencore e teknike, nesër i hedh poshtë si «përbuzje diletanteske ndaj shkencës». A mundet populli sovjetik, në kushte të tilla, t'u besojë premtimeve të reja të Brezhnjev, të Kosiginit dhe të shokëve të tyre? A mund t'u zërë besë ai sigurimeve «shkencore» për reformat dhe për planet e reja ekonomike? Populli sovjetik dhe të gjithë revolucionarët në botë shohin qartë se të gjitha këto manovra, gjithë kjo lojë fjalësh kanë për qëllim të fshehin një gjë: disfatën që ka pësuar vija tradhtarë revizioniste, e cila, nëpërmjet politikës së saj ekonomike antimarksiste, synon të restaurojë kapitalizmin në Bashkimin Sovjetik.



Shumë reforma bëri Hrushovi. Jo më pak po bëjnë edhe pasardhësit e tij. Por ato nuk i kanë sjellë asnjë dobi popullit sovjetik, përkundrazi, kanë bërë të shkojnë në mënyrë të mëdha materiale, të krijuara me punën dhe me djersën e popullit, kanë ngjallur në vend frymën pesimiste dhe kanë ndrydhur forcat krijuese; puna e gjallë e njerëzve sovjetikë mbytet nga organizimet dhe riorganizimet e njëpasnjëshme, të cilat kanë çorientuar dhe dizorganizuar njerëzit. Në qoftë se udhëheqja revizioniste ka sot ndonjë preokupacion, ky është preokupacioni për të kënaqur dhe për të plotësuar të gjitha dëshirat e shtresës së privilegjuar të funksionarëve të lartë të partisë e të shtetit, të teknokratëve dhe gradave superiore të ushtrisë, mbi të cilat ajo mbështetet për të ruajtur pushtetin e saj dhe për të zbatuar planet për degjenerimin borgjez të shoqërisë sovjetike.

Ekonomia e Bashkimit Sovjetik ka hyrë tani dhe po ecën me të gjithë forcën në rrugën jugosllave. Pak nga pak po adoptohen ato forma dhe metoda që e shndërrojnë ekonominë titiste në një shtojcë të ekonomisë së botës kapitaliste. Siç duket, udhëheqësit sovjetikë kanë gjetur receta të gatshme për të zbatuar planet e tyre tradhtarë, që minojnë nga themelet fitoret e mëdha të Revolucionit të Tetorit, rezultatet dhe sukseset e shkëlqyera që populli sovjetik gjatë disa dekadave pati arritur me luftë dhe me përpjekje të mëdha në ndërtimin e socializmit. Për këtë foli me shumë entuziazëm kryetari i delegacionit të klikës titiste në Kongresin e 23-të, Aleksandër Rankoviçi, xhelati i njohur i popujve të Jugosllavisë, antisovjetik i tërbuar dhe armik i egër i socializmit. Ai e shfrytëzoi tribunën e kongresit,

që i ofruan udhëheqësit revizionistë sovjetikë, për të reklamuar «eksperiencën jugosllave» dhe për të shtruar nevojën e «perfeksionimit të mëtejshëm të shkëmbimit të saj». Por sado që ta duartrokitnin atë simpatizantët dhe shokët e ngushtë të klikës titiste, që tani arbitrarisht qëndrojnë në krye të partisë dhe të shtetit në BS, populli sovjetik nuk mund të mos e dijë se ç'përfaqëson «rruga jugosllave», ai nuk mund të mos e dijë ç'po ndodh tani në Jugosllavi dhe cila është gjendja e popullit jugosllav.

Jugosllavia e sotme, me gjithë «certifikatat» dhe «dokumentet» e panumërta, me të cilat udhëheqësit revizionistë sovjetikë e shpallën «vend socialist», përfaqëson një shtet të vënë kokë e këmbë nën kontrollin politik e ekonomik të imperialistëve dhe të borgjezisë reaksionare të brendshme, të përfaqësuar nga klika titiste. Në ekonominë e saj përditë e më shumë shfaqen fenomenet e shëmtuara borgjeze të konkurrencës, papunësisë, zhvillimit të pabarabartë të rajoneve e të krahinave, presionet shoviniste të grupeve më të fuqishme ekonomike, lufta e tregjeve etj. Një «parajsë» e tillë e pret edhe Bashkimi Sovjetik po të ecë në rrugën në të cilën e shtyjnë udhëheqësit e tanishëm revizionistë. Dhe shenjat e para janë mjaft shqetësuese për popullin sovjetik. Krerët e tij, duke ecur me besnikëri në gjurmët e Hrushovit, kanë filluar e bëjnë thirrje për investime të kapitalit të huaj në Bashkimin Sovjetik. Bisedime të rëndësishme po zhvillohen me firmat e kapitalit japonez për investime në Lindjen e Largme, ndërsa firma e madhe italiane «Fiat» ka përfunduar një marrëveshje shumë të rëndësishme për hapjen në Bash-

kimin Sovjetik të një dege të saj. Nën formën e kredive me afat të gjatë, të shkëmbimeve të lira ekonomike ndërkombëtare, të cilat, siç pretendoi Kosigini në fjalimin e tij në kongres, «kërkohen për shkak të revolucionit tekniko-shkencor», udhëheqësit sovjetikë dëshirojnë ta lidhin ekonominë e vendit të tyre me ekonominë kapitaliste të SHBA-së, Anglisë, Gjermanisë Perëndimore, Japonisë etj. Duke e bërë një gjë të tillë, ata venë me shpresë se në këtë mënyrë shpejtojnë transformimin kapitalist të ekonomisë sovjetike dhe krijojnë një bazë tjetër për forcimin e pushtetit të vet. Sigurisht, këto janë llogaritë e tyre. Por fjalën e fundit do ta thotë populli sovjetik, i cili nuk ka luftuar dhe derdhur gjak që vendi i tij të bëhet një Rusi e re cariste.

### **Vazhdimi me vendosmëri i politikës proimperialiste**

Një nga çështjet që u rrahën më shumë në Kongresin e 23-të e përbënin problemet e politikës së jashtme, të cilat zunë një pjesë të madhe në fjalimet e udhëheqësve sovjetikë dhe të miqve të tyre të ftuar në kongres. I gjithë ky preokupim është plotësisht i kuptueshëm. Për shkak të politikës së tyre tradhtarë, kapitulluese e kundërrevolucionare, revizionistët sovjetikë kanë hyrë në një konflikt të përgjithshëm me të gjitha forcat antiimperialiste të botës. Vija e bashkëpunimit sovjeto-amerikan, për vendosjen e sundimit të dy fuqive të mëdha në botë, po has në kundërshtimin e vende-

ve e të popujve, të cilët në komplotet imperialisto-revizioniste shikojnë një kërcënim të drejtpërdrejtë të lirisë dhe të pavarësisë së tyre. Ngjarjet e rëndësishme revolucionare që kanë ndodhur në botë e kanë bërë dhe e bëjnë të pamundur ruajtjen e maskës antiimperialiste që revizionistët sovjetikë dëshirojnë të mbajnë për të mashtruar opinionin publik. Prandaj, ashtu siç edhe pritej, në kongres pasardhësit e Hrushovit u morën kryesisht me justifikimin e politikës së tyre kapitulluese dhe përpunimin e mëtejshëm të taktikës së tyre të mirënjohur demagogjike për të hedhur gurin e për të fshehur dorën. Edhe analiza që ata i bënë situatës ndërkombëtare, e cila përsëriste gati fjalë për fjalë atë të kongreseve të 20-të e të 22-të, kishte për qëllim gjetjen, ose më mirë të themi krijimin e disa pikëmbështetjeve për të siguruar «prova» të reja që të justifikojnë kursin e bashkëpunimit me imperializmin nën formën tanimë të njohur të «bashkekzistencës paqësore», «garës paqësore», «kalimit paqësor» etj.

Por, ndryshe nga Hrushovi, udhëheqësit e rinj qëllimet e tyre nuk i thonë hapur, bile po t'i gjykosh nga fjalët, këta mund të duken si antiimperialistët më intransigentë. Në Kongres pati aq shumë sulme të rrepta verbale kundër imperializmit amerikan, aq mallkime e anatema<sup>1</sup> të rënda në drejtim të tij saqë, kushedi ç'do të bëhej po t'i kishin me gjithë mend!

Por kushdo që ndoqi punimet e Kongresit të 23-të të PK të BS, nuk mund të mos vinte re se «antiimpe-

---

<sup>1</sup> Anatema (nga greqishtja) — çshenjtërim, çkishërim, mallkim. Përdorej për heretikët, që i përzinte kisha.

rializmi» i revizionistëve sovjetikë është fund e krye bluf, një ngjyrë e shpëlarë për të maskuar veprimet e tyre konkrete në përkrahje të imperializmit. Qoftë në raportin e Brezhnjev it dhe të Kosigin it, në diskutimin e Gromikos apo në ato të oratorëve të tjerë, dënimi i imperializmit amerikan dhe i politikës së tij agresive, nuk i kaloi asnjëherë kufijtë e një qortimi të përgjithshëm, abstrakt, formal. Për sa u përket çështjeve konkrete të marrëdhënieve ndërkombëtare, udhëheqësit sovjetikë, ashtu si deri më sot, shfaqën gatishmërinë për të bashkëpunuar me SHBA-në, për t'i zgjidhur ato në kuadrin e raporteve sovjeto-amerikane. Kështu, për shembull, Brezhnjevi, pasi i bëri në fjalimin e tij në kongres një reklamë të zhurmshme antiimperializmit revizionist, pasi foli gjerë e gjatë për agresionin amerikan në Vietnam, theksoi: «Ne kemi deklaruar shpeshherë për gatishmërinë tonë që të zhvillojmë marrëdhëniet tona me SHBA-në dhe tani mbajmë po këtë qëndrim». Me këtë ai donte t'u thoshte amerikanëve: «Mos i vini re fjalët që ne jemi të detyruar të themi për ju, ne do të ndjekim edhe në të ardhmen politikën e afritit dhe të bashkëpunimit». Dhe duhet thënë se imperialistët amerikanë e përkthyen drejt gjuhën që u përdor në Kongresin e 23-të. Gazeta amerikane «Krishçën: Sajëns Monitor», duke komentuar fjalimet mbi politikën e jashtme që u mbajtën në kongres, tërë esencën e qëndrimit revizionist e përmbloodhi vetëm me pak fjalë: «Vija e fortë, veprat e buta». I gjithë shtypi perëndimor tani tregohet shumë entuziast që kongresi «i la portat e hapëta për bashkëpunimin me Perëndimin».

Manovrat që u përdorën në kongres, për të bërë

demagogji me parullat e antiimperializmit, ishin të mëdha, por ato tanimë nuk mund të gënjejnë njeri. Të gjithë e dinë se ajo çka dëshirojnë me gjithë shpirt revizionistët sovjetikë, është vazhdimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit sovjeto-amerikan për sundimin e botës. Ashtu si deri më sot, udhëheqësit hrushovianë të Bashkimit Sovjetik po punojnë me ngulm të përfundojnë marrëveshjen e re me SHBA-në për mospërhapjen e armëve bërthamore, gjë që do t'u siguronte monopolin atomik të dy fuqive të mëdha, përpiqen me të gjitha mënyrat të nënshtrojnë OKB-në, dhe ta shndërrojnë atë në një vegël të kombinacioneve amerikano-sovjetike, luftojnë si të tërbuar që, së bashku me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të ndihmojnë në armatosjen e reaksionit indian, të koordinojnë aktivisht veprimet e tyre me «strategjinë globale» amerikane për të sabotuar luftërat çlirimtare në Azi, në Afrikë dhe në Amerikën Latine, ndjekin me këmbëngulje politikën e pajtimit me revanshizmin gjerman dhe, për hir të afrimit me SHBA-në, sakrifikojnë interesat jetike të popullit gjerman dhe të popujve të tjerë evropianë etj. Janë pikërisht këto veprime konkrete që përfaqësojnë politikën tradhtare revizioniste, që tregojnë drejtimit e saj të rrezikshme, synimet e saj kapitulluese. Të gjitha të tjerat janë demagogji për të mashtruar njerëzit, leqe të ngrehura për t'u hedhur litarin popujve, manovra të rrezikshme për të goditur me thikë pas shpine revolucionin dhe socializmin.

Tipike në këtë drejtim është demagogjia e shfrenuar dhe e papërmbajtur në lidhje me Vietnamin, e cila arriti kulmin e shëmtimit të saj në Kongresin e

23-të. Shumë fjalë të bukura u thanë në drejtim të luftës së popullit vietnamez kundër agresionit amerikan, dhe, sigurisht, nuk munguan premtimet për përkrahje e ndihmë. Por ç'është kjo ndihmë, ç'përfaqëson ajo tani, dhe si do të jetë në të ardhmen? Brezhnjevi tha se «agresorët do të ndeshen me përkrahjen gjithnjë në rritje të Vietnamit nga ana e Bashkimit Sovjetik», Kosigini tha se «do ta vazhdojmë këtë përkrahje në masën e nevojshme», ndërsa Gromikoja u mjaftua vetëm të thoshte se «amerikanët duhet t'i marrin seriozisht këto deklarata».

Po këto janë vetëm fjalë. Në fakt as Brezhnjevi, as Kosigini dhe as Gromikoja nuk thanë asnjë fjalë lidhur me komplotin imperialist të «bisedimeve paqësore», nuk e demaskuan dhe as nuk e hodhën poshtë këtë manovër djallëzore të imperializmit, që ka për qëllim kapitullimin e popullit vietnamez. Kjo nuk është aspak e rastit. Dihet se udhëheqësit revizionistë sovjetikë, ashtu si titistët, si reaksionarët indianë etj., janë përkrahës të tezës imperialiste të «bisedimeve pa kushte». Udhëheqësit hrushovianë u mburrën shumë për «ndihmën» që i japin Vietnamit, por vlera e saj për luftën kundër agresorëve është krejtësisht e parëndësishme. Kjo vërtetohet nga një fakt fare i thjeshtë: në qoftë se armët sovjetike do të ishin një faktor aq i rrezikshëm për imperialistët amerikanë, përse këta deri tani as shqetësimin më të vogël nuk shprehin për këtë veprim të sovjetikëve? Dihet se më 1962, kur Hrushovi dërgoi raketat sovjetike në Kubë, imperialistët amerikanë jo vetëm u shqetësuan, por e detyruan Hrushovin të kapitullonte plotësisht dhe t'i tërhiqte raketat

nga Kuba, duke pranuar edhe kontrollin amerikan. Pra çështja nuk është se amerikanët nuk i japin rëndësi problemit të ndihmës së armatosur. Por imperialistët amerikanë nuk bëjnë zë, sepse midis udhëheqësve sovjetikë dhe Xhonsonit e Pentagonit, pa dyshim, ekziston ndonjë marrëveshje e fshehtë (përse tjetër u duhet teletajpi i kuq?), me të cilën janë përcaktuar mirë kushtet e «ndihmës» sovjetike për Vietnamin, sa dhe çfarë mund të dërgohet pa rrezikuar aspak agresorët imperialistë.

Udhëheqësit sovjetikë u mburrën shumë se zotërojnë raketa kontinentale e ndërkontinentale, kozmike e universale, se nëndetëset e tyre atomike i sillen tani botës pa u diktuar, se kanë krijuar «rrethe të kaltra të mbrojtjes» etj., etj. Po sa influencën kjo në luftën e Vietnamit për ndalimin e agresionit imperialist? Këto mburrje nxjerrin më qartë në shesh të vërtetën e madhe se udhëheqësit revizionistë nuk i japin asnjë ndihmë efektive Vietnamit, se e ashtuquajtura ndihmë e tyre është fare e parëndësishme në krahasim me potencialin e mundësitë e Bashkimit Sovjetik. Kurse ndihma dhe përkrahja që i japin imperializmit amerikan në luftën e tij agresive është më efektive. A nuk e vërteton këtë fakti që amerikanët po largojnë dhjetëra mijëra ushtarë nga Evropa për t'i dërguar në Vietnam, meqenëse në Evropë asgjë nuk i shqetëson imperialistët?

Demagogjia revizioniste, që u përdor aq shumë në Kongresin e 23-të, nuk mund të mbulojë faktin e dukshëm se revizionistët hrushovianë nuk kanë aspak për qëllim të ndihmojnë popullin vietnamez dhe të përkrahin çështjen e tij të drejtë. Sepse lufta e çlirimit e



popullit të Vietnamit, kundërshtimi i tij dhëmb për dhëmb ndaj imperializmit amerikan, fitoret e tij historike në fushat e betejës kundër fuqisë më të madhe ushtarake në botën kapitaliste shkallmojnë nga themelet tërë,ndërtesën revizioniste të «bashkekzistencës hrushoviane». Ajo tani u jep goditjet më të tmerrshme teorive pacifiste e kapitulluese revizioniste mbi karakterin e luftërave në kohën e sotme, mbi revolucionin dhe bashkekzistencën paqësore. Mbi të gjitha, ajo është bërë gur prove i internacionalizmit socialist, që në mënyrë të pamëshirshme ndan miqtë nga armiqtë, tregon lakuriq përpara gjithë botës kush është me popujt dhe kush është me imperializmin. Pikërisht për këtë arsye revizionistët hrushovianë, që e kanë tradhtuar prej kohësh marksizëm-leninizmin, që janë larguar përfundimisht nga traditat revolucionare të Revolucionit të Torrit dhe parimet e internacionalizmit proletar nuk e dëshirojnë në asnjë mënyrë fitoren e popullit vietnamez, pikërisht për këtë arsye ata i koordinojnë planet dhe veprimet e tyre me ato të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për realizimin e «bisedimeve paqësore», domethënë për nënshtrimin e Vietnamit ndaj imperializmit amerikan.

### **Përçarësit dhe armiqtë më të rrezikshëm të lëvizjes komuniste ndërkombëtare**

Kongresi i 23-të shënoi një hap të ri, hapin përfundimtar, në përçarjen e lëvizjes komuniste dhe punëtore ndërkombëtare. Natyrisht, si për të gjitha çështjet e

tjera, edhe lidhur me problemet e lëvizjes komuniste, udhëheqja revizioniste sovjetike u përpoq të fshehë qëllimet e saj të vërteta. Kjo tregon se pasardhësit e Hrushovit kanë nxjerrë disa mësimë nga eksperiencia e hidhur e tij. Në Kongresin e 23-të udhëheqësit sovjetikë bënë një zhurmë të madhe për «besnikërinë» e tyre ndaj marksizëm-leninizmit dhe deklaratave të Moskës, u shprehën për «unitetin» e lëvizjes, bile Brezhnjevi në raportin e tij politik i «ofroi» «miqësinë» Partisë së Punës të Shqipërisë.

Ky qëndrim është jo vetëm hipokrit e mashtrues, por flet edhe për cinizmin e hrushovianëve. Ndërsa për sy e faqe bëjnë deklaratatë të tilla, fshehtazi ata komplotojnë kundër lëvizjes dhe partive komuniste që i qëndrojnë besnike marksizëm-leninizmit, afrohen e bashkëpunojnë hapur me klikën titiste, e cila është dënuar botërisht nga deklaratat e Moskës, organizojnë shpifje e komplete kundër PPSH. Jo vetëm kaq, por fill mbas raportit të Brezhnjevrit, shumë oratorë, vendas dhe të ftuar e përdorën tribunën e kongresit për të shpifur në mënyrë të shfrenuar kundër partive marksiste-leniniste, duke i akuzuar ato si «luftënxitëse», «pseudorevolucionare», «aventuriere», «përçarëse» etj. Bile pati edhe ndonjë që, «duke u thelluar» në teorizime, shpiku nga mendja edhe termin e «komunizmit antisovjetik», për të shpifur kundër partive marksiste-leniniste, megjithëse dihet se ky «shpikës» vetë është një ndër ata pionierë të revizionizmit modern, që, jo shumë vjet më parë, si flamurtar i antisovjetizmit dhe likuidator i partisë komuniste, u bë pjesëtar i një qeverie kundërrevolucionare.

Kjo fushatë brenda kongresit, e drejtuar kundër partive që u qëndrojnë besnike mësimëve të marksizëm-leninizmit, si dhe gjithë veprimtaria përçarëse e diversioniste e revizionistëve hrushovianë, zbuluan fare mirë demagogjinë dhe synimet e udhëheqësve hrushovianë. Nëpërmjet parullave false rreth «unitetit», ata duan të mashtrojnë opinionin publik komunist, të largojnë vëmendjen nga tradhtia e tyre, të arrijnë pushimin e polemikës publike, me qëllim që të fitojnë kohë për të zbatuar në qetësi planet e tyre tradhtare kundër marksizëm-leninizmit dhe revolucionit.

«Miqësia» që ata i ofruan Shqipërisë, është një demagogji pa skrupull, një gjest i paramenduar për qëllime diversioniste, një propagandë bajate për të maskuar qëllimet dhe veprimet e tyre kundërrevolucionare. Veprimtaria antimarksiste, antishqiptare, përbën sot një nga komponentët kryesorë të politikës së jashtme të udhëheqjes revizioniste sovjetike. Këtë të vërtetë revizionistët hrushovianë nuk mund ta mbulojnë me asnjë gjest propagandistik, me asnjë manovër e djallëzi.

Manovrat demagogjike të udhëheqësve sovjetikë diktohen edhe nga vështirësitë e kontradiktat e mëdha që vihen re në gjirin e grupimeve të ndryshme revizioniste, diktohen nga disfatat që kanë pësuar dhe po pësojnë ditë për ditë revizionistët. Si rrjedhim i luftës së vendosur e parimore të Partisë së Punës të Shqipërisë, të partive të vërteta marksiste-leniniste dhe të gjithë revolucionarëve të vërtetë për demaskimin e revizionizmit hrushovian, dhe si rrjedhim i veprimeve antimarksiste, kundërrevolucionare dhe i bashkëpunimit gjithnjë e më të hapët të revizionistëve sovjetikë e të

tjerë me imperializmin, hrushovizmit gjithnjë e më shumë po i shket toka nën këmbë. Falimentimi i Hrushovit ishte një paralajmërim tepër kuptimplotë. Midis udhëheqjes sovjetike dhe udhëheqjeve revizioniste të disa partive të tjera janë shtuar kontradiktat, qoftë si rrjedhim i veprimeve shoviniste të udhëheqësve sovjetikë ndaj këtyre partive e vendeve socialiste, qoftë nga vështirësitë ekonomike që u kanë lindur të gjithëve si rezultat i zbatimit të politikës revizioniste-titiste, qoftë edhe si rrjedhim i nacionalizmit borgjez, që ka nxjerrë kokën kudo ku revizionistët janë në fuqi. Nga ana tjetër, në gjirin e shumë partive revizioniste, përditë e më tepër po shtohet rezistenca e komunistëve revolucionarë, të cilët po e kuptojnë më mirë se drejt ç'gremine po i çon udhëheqja revizioniste. Kështu po ngjet në BS, kështu ngjet në vende të tjera ku janë në fuqi revizionistët, kështu ngjet në partitë komuniste e punëtoresh të vendeve kapitaliste. Diku forcat marksiste-leniniste veprojnë fshehtëazi, diku haptazi; diku janë krijuar parti e grupe të reja marksiste-leniniste, që veprojnë në kushtet e ilegalitetit të plotë, diku këto parti e grupe kanë dalë hapur kundër revizionizmit. Ky proces tani është në zhvillim e sipër. Ai është i pandalshëm dhe si ortek i fuqishëm do të fshijë nga faqja e dheut tradhtinë revizioniste. Hrushovianët, ata sovjetikë dhe aleatët e tyre, po e ndiejnë rrezikun. Atyre u duhet një periudhë qetësie sa të marrin veten dhe të grumbullojnë forcat për t'u hedhur në sulm me energji të reja.

Për të mashtruar komunistët dhe për të vënë në gjumë vigjilencën e tyre, udhëheqësit sovjetikë edhe në Kongresin e 23-të u përpoqën që të zvogëlojnë dhe të

fshijnë dallimin midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit, për t'i paraqitur divergjencat në lëvizjen komuniste si «jo fort të rëndësishme», duke theksuar me të madhe se «ajo që na bashkon është kryesore» etj.

Partia jonë e Punës më se një herë e ka theksuar se marksistë-leninistët asgjë nuk i bashkon, përkundrazi çdo gjë i ndan me revizionistët, të cilët kanë tradhtuar socializmin e komunizmin. Revizionistët sovjetikë edhe në Kongresin e 23-të folën shumë për «unitetin e veprimeve» në luftën kundër imperializmit. Por a i bashkon gjë edhe në këtë fushë marksistët me revizionistët? Asgjë. Ndërsa marksistët dhe gjithë revolucionarët luftojnë thikë më thikë kundër imperializmit, revizionistët janë aleatë e shërbëtorë të imperializmit dhe armiq të luftës antiimperialiste të popujve. Të vendosësh «unitet veprimi» me revizionistët do të thotë të heqësh dorë nga lufta kundër imperializmit, të kapitulosh e t'i nënshtrohesh imperializmit.

Kongresi i 23-të, edhe një herë tregoi se udhëheqësit hrushovianë janë përçarës dhe armiq të vendosur të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Marksistë-leninistët dhe revolucionarët e vërtetë duhet të forcojnë luftën e tyre për demaskimin e revizionizmit hrushovian. Me hrushovizmin duhet përcaktuar qartë vija e ndarjes: qoftë në lëmin politik e ideologjik, qoftë edhe në lëmin organizativ. Revolucionarët besnikë të çështjes së komunizmit kanë plotësisht të drejtë, bile ka ardhur koha, që të organizohen, të krijojnë grupe e parti të reja antirevizioniste. Lufta kundër revizionizmit, kësaj agjente të imperializmit, duhet të ngrihet në një shkallë akoma më të lartë. Revolucionarët e marksistë-leninistët

duhet të hidhen në një sulm të përgjithshëm në mënyrë që planet hrushoviane të mashtimit dhe të tradhtisë, që u përpunuan në Kongresin e 23-të, të dështojnë plotësisht. Çdo komunist, që është besnik i ideve fitimtare të marksizëm-leninizmit, duhet të përcaktojë qëndrimin e tij. Pozita e papërcaktuar, qëndrimi centrist, as andej as këndeje, qëndrimi asnjane, nuk u shërbejnë çështjes së revolucionit, çështjes së komunizmit. Revizionistët hrushovianë bëjnë përpjekje të mëdha për të bashkuar më fort rreth vetes revizionistët e bindur dhe për të krijuar me ta një front të përbashkët kundër marksistë-leninistëve revolucionarë, kjo u duk edhe në Kongresin e 23-të të tyre. Por ata përpiqen që të bëjnë për vete edhe «miq të rinj», duke ndjekur në fillim taktikën e neutralizimit të tyre, me shpresë që më vonë t'i tërheqin plotësisht në frontin revizionist.

Në kushtet aktuale, kur lufta midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit është ashpërsuar shumë, kur veprimtaria tradhtarë e revizionistëve hrushovianë nuk drejtohet vetëm kundër një grupi komunistësh brenda vendit ose vetëm kundër një reparti të lëvizjes komuniste, por drejtohet kundër gjithë lëvizjes komuniste, kundër revolucionit dhe socializmit, komunistët e vërtetë, pavarësisht se mund të gjenden edhe në strofkën e revizionizmit hrushovian, nuk mund të heqin dorë nga parimet, dhe as t'i zëvendësojnë ato me formula të errëta, abstrakte ose gjysmoportuniste. Historia ka provuar se qëndrimet gjysmake e ekuivoqe janë shumë të rrezikshme, ato janë në interes të revizionizmit, i cili i dëshiron dhe i inkurajon.

Vendosja e një kufiri të qartë, ndarja ideologjike,

politike dhe organizative me revizionizmin hrushovian, titist etj., është bërë një objektivitet historik i pashmangshëm, i domosdoshëm. Partia e Punës e Shqipërisë si gjithnjë, edhe në të ardhmen, do të forcojë luftën e saj parimore kundër revizionizmit modern, do të përkrahë pa rezerva gjithë komunistët dhe revolucionarët anti-revizionistë.

Në artikullin e «Zërit të popullit», botuar më 22 mars, me titull: «Tradhtarët revizionistë hrushovianë shkojnë në kongresin e tyre me një bilanc dështimesh të mëdha», ne shkruanim: «Veprimet e udhëheqësve tradhtarë hrushovianë, gjithë politika që ata kanë ndjekur deri tani tregojnë se në kongres ata do të kërkojnë të sanksionojnë hrushovizmin, por pa Hrushovin. Ata do të mundohen të marrin një vërtetim, qoftë edhe formal, në emër të një kongresi partie, për të ecur në vijën që e përpunuan së bashku me Hrushovin, për të ecur më tej në procesin e degjenerimit kapitalist të rendit shoqëror në Bashkimin Sovjetik, në rrugën e përçarjes së lëvizjes komuniste botërore, për ta shtuar dhe për ta thelluar bashkëpunimin me imperializmin amerikan në emër të sundimit të botës nga dy fuqitë e mëdha»<sup>1</sup>. Tani që përfundoi kongresi, mund të themi se nuk ka ndonjë gjë tjetër për t'iu shtuar këtyre konkluzioneve. Rezultatet e tij qenë ato që të gjithë revolucionarët e vërtetë i kishin parashikuar qysh më parë. Dhe s'mund të ndodhte ndryshe.

Udhëheqësit revizionistë sovjetikë shkuan në kongres si përçues të vijës për rivendosjen e kapitalizmit

---

1 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 31, f. 531-532.

në Bashkimin Sovjetik, por një gjë të tillë nuk mund t'ia thonin hapur popullit sovjetik. Ata shkuan atje si lakenj të politikës agresive imperialiste, po për ta kryer mirë misionin, veprimet e agjentit duhen fshehur me kujdes. Ata shkuan si përçarës dhe sabotatorë të lëvizjes komuniste, po, përderisa vepronë brenda saj, duhen ruajtur me çdo kusht maskat. Taktika me dy faqe e revizionistëve hrushovianë nuk është një gjë e zgjedhur lirisht nga ata. Ajo u është imponuar atyre nga rrethanat, nga misioni i tyre tradhtar, nga qëllimet kundër-revolucionare që ata kërkojnë të realizojnë.

Punimet e Kongresit të 23-të më mirë se çdo herë tjetër e nxorën në pah këtë taktikë demagogjike, duplicitetin, ndarjen e fjalëve nga veprat, hipokrizinë dhe cinizmin e revizionistëve. Por kjo taktikë kaq demagogjike dhe e ndërtuar mbi rërë, është produkt i kontradiktave të pakapërcyeshme, i nevojave të ditës, rezultat i frikës dhe i disfatave të pësuar. Si e tillë, ajo është e destinuar të falimentojë, ashtu siç do të falimentojë edhe vetë revizionizmi që e ka pjellë.

Udhëheqësit revizionistë hrushovianë tani, pas kongresit, përpiqen ta heqin veten të gëzuar që mundën të ruajnë në kongres aparenecat e unitetit, që evituan daljen në dritë të kontradiktave që ata kanë me partinë dhe me popullin e tyre, me miqtë dhe me aleatët e tyre revizionistë. Por ky është një gëzim fals, që nuk ka asnjë bazë dhe që paraqet dëshirat në vend të realitetit. Fryma e shqetësimeve, e preokupacioneve për diçka të panjohur që mund të ndodhë, mungesa e një sigurie të plotë për ato që thuheshin, që në një mënyrë ose në tjetrën u shfaqën nëpër diskutimet e delegatëve,



ishin nga ato simptoma që tregojnë se edhe kur udhëheqja revizioniste nuk do të lëvizë nga vendi, lëviz populli, zhvillohen procese që ajo nuk ka fuqi t'i ndalojë.

Populli sovjetik është një popull i madh, me një të kaluar revolucionare të lavdishme, me një ndërgjegje kombëtare dhe internacionaliste të zhvilluar. Sido që të vijë puna, ai nuk mund të durojë gjatë që një grup renegatësh të pandreqshëm, që kanë uzurpuar pushtetin në Bashkimin Sovjetik, ta tërheqin atë në një rrugë të rrezikshme, që është krejt në kundërshtim me interesat e tij jetike. Me siguri do të vijë një ditë kur flamuri i leninizmit do të valojë përsëri lart në qiellin e atdheut të Sovjetëve.

*Botuar për herë të parë si artikull redaksional në gazetën «Zëri i popullit», nr. 95 (5505), 22 prill 1966*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1965-1967», f. 310-334*

## FORCA E USHTRISË SONË QËNDRON TE POPULLI DHE TEK UDHËHEQJA E PARTISË

*Fjala në konferencën e parë të organizatës së Partisë  
të repartit nr. 8001*

27 prill 1966

Të dashur shokë ushtarë, komandantë dhe komisarë,

Jam shumë i gëzuar që ndodhem sot në mes jush për t'ju sjellë juve e gjithë shokëve ushtarë dhe oficerë të repartit numër 8001 urimet e nxehta të Komitetit Qendror të Partisë, të Qeverisë dhe të miat. Jam gjithashtu i gëzuar që marr pjesë në konferencën tuaj të parë, në punimet e së cilës ju dhatë një kontribut të madh.

Dëgjova me vëmendje raportin si edhe diskutimet e të gjithë shokëve të tjerë dhe dua të theksoj se punimet e kësaj konference më kënaqën shumë.

Është hera e parë që marr pjesë në një mbledhje partie në ushtri pas vendimeve të rëndësishme të fundit të Komitetit Qendror të Partisë<sup>1</sup>, në lidhje me për-

---

<sup>1</sup> Më 4 mars 1966 Plenumi i 16-të i Komitetit Qendror të PPSH mori vendime të rëndësishme për revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë, të pushtetit, të Ushtrisë Popullore dhe të

mirësimin e punës në Parti e në pushtet, dhe konstatova solidaritetin tuaj të plotë dhe të të gjithë shokëve oficerë e ushtarë me këto vendime historike të Komitetit Qendror. Por ajo çka më gëzon më shumë, është çështja se këto vendime ju i gjykoni thellë e me objektivitet.

Ju keni shumë suksese në punët tuaja. Natyrisht nuk jeni edhe pa të meta, por sukseset le t'ju shërbejnë për forcimin e punës dhe të metat, sikurse do të them pak më poshtë, t'ju shërbejnë për të nxjerrë mësim.

Neve na duhet të kemi një ushtri të fortë, të lidhur ngushtë me popullin punonjës, një ushtri të udhëhequr nga Partia, një ushtri të edukuar politikisht dhe ideologjikisht me frymën marksiste-leniniste, të edukuar më së miri me shkencën ushtarake marksiste-leniniste; një ushtri të armatosur me armë moderne, që të jetë kurdoherë në gatishmëri për të mbrojtur nga çdo rrezik i jashtëm ose i brendshëm atdheun tonë socialist, fitoret e popullit tonë punonjës, diktaturën e proletariatit.

Çdo shtet në botë ka ushtrinë e tij, të cilën e

---

gjithë jetës së vendit, vendime që iu njoftuan popullit me anë të Letrës së Hapur të Komitetit Qendror të PPSH drejtuar komunistëve, punonjësve, ushtarëve dhe oficerëve të vendit tonë, po më 4 mars 1966. Për Ushtrinë Popullore u morën këto vendime: heqja e gradave, krijimi i komiteteve të Partisë, si organe drejtuese të të gjithë punës së Partisë në njësi, në reparte dhe në institucione ushtarake, si dhe rivendosja e komisarëve politikë në komandat e të gjitha hallkave.

mban në këmbë dhe e armatos. Por qëllimet e mbajtjes në këmbë dhe të armatosjes së saj ndryshojnë nga karakteri, i cili lidhet drejtpërdrejt me formën e regjimeve në këto shtete, me synimin se kujt dhe për ç'qëllime u shërben kjo ushtri këtyre shteteve, këtyre regjimeve.

Në botë ka shtete kapitaliste, ka edhe shtete socialiste, pra ka ushtri borgjeze, ka edhe ushtri revolucionare-socialiste, ka ushtri të diktaturës së kapitalit, ka edhe ushtri të diktaturës së proletariatit. E para është një ushtri reaksionare, shtypëse, kurse e dyta është një ushtri revolucionare, çliruese dhe mbrojtëse.

Gjatë gjithë historisë mijëra vjeçare të popullit shqiptar që nga kohët më të vjetra, në kohën e luftërave të Skënderbeut, ashtu edhe pas vdekjes së tij e më vonë deri tek Ushtria jonë e lavdishme Nacionalçlirimtare, e cila pas Çlirimit u bë Ushtria jonë Popullore, ushtritë shqiptare, me përjashtim të ushtrisë së satrapit Ahmet Zog që kishte karakter reaksionar dhe shtypës, të gjitha, me forma dhe me organizime të ndryshme, kanë pasur karakter popullor, çlirimtar, mbrojtës dhe asnjëherë agresiv ose shtypës, qoftë brenda vendit, qoftë ndaj popujve të tjerë. Bile shumë herë ushtritë shqiptare kanë pasur, si të thuash, edhe një frymë të theksuar internacionaliste, ato edhe në shekujt e kaluar u kanë shkuar në ndihmë miqve dhe aleatëve, për të mos folur pastaj për ndjenjat internacionaliste të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, që u shkoi në ndihmë, me forca të konsiderueshme, popujve

të Jugosllavisë, ku la në fushën e luftës qindra partizanë shqiptarë.

Popullit shqiptar, pra, i është dashur kurdoherë të luftonte kundër armiqve të shumtë dhe të fortë, i është dashur të mbronte jetën e tij, të ardhmen e tij, t'i shpëronte shfarosjes dhe likuidimit si popull. Kësaj çështjeje jetike ai ia arriti duke luftuar me forma të ndryshme që i shpikte vetë dhe duke ua përshtatur kohës, vendit dhe forcave të armikut që i viheshin përballë.

Në të gjitha kohët dhe në çfarëdo forme që organizohej rezistenca, mbrojtja dhe sulmi i ushtrive të popullit tonë, politika që i frymëzonte ato ishte popullore, përparimtare, sepse luftohej për ide çliruese, kundër ideve gllabëruese, skllavëruese. Këto ide përshkojnë si një vijë e kuqe të gjitha luftërat e popullit tonë dhe u kristalizuan në një ide të ndritur në sajë të Partisë Komuniste të Shqipërisë, që udhëhoqi Luftën tonë të madhe Nacionalçlirimtare.

Po të studiojmë me kujdes Plutarkun, historianët e Romës së vjetër, ata të luftërave të Skënderbeut, do të shohim se formacionet ushtarake, të mëdha ose të vogla, qoftë në kohën e mbretit Pirro, të mbretëreshës Teuta, qoftë ato të Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut, kanë qenë formacione të organizuara dhe të stërvitura mirë me armët e kohëve; ato kishin taktikën dhe strategjinë e tyre dhe frymëzoheshin nga një politikë e përcaktuar. Legjionet dhe flota e Romës, konsujt romakë ose mbretërit e Greqisë së vjetër, sulltanët dhe ushtritë e osmanëve janë ndeshur keqas, kanë pësuar disfata të mëdha në luftërat e pandërprera kundër po-

pullit tonë dhe pavarësisht se të parët tanë humbitnin betejën e fundit për shkak të dyndjeve të mëdha të armiqve, prapëseprapë lufta vazhdonte, populli ynë nuk thyhej dhe në kushte të reja krijonte forma të reja organizimi të luftëtarëve, taktika të reja lufte, që ne, partizanët shqiptarë, i trashëguam nga prindërit, nga gjyshërit dhe nga stërgjyshërit tanë. Partia jonë e mençur e përpunoi këtë eksperiencë shekullore dhe këndeje e nëpërmjet luftërave të saj të përgjakshme dhe heroike, krijoi Ushtrinë Nacionalçlirimtare, e cila korri fitoren e madhe dhe nën drejtimin e Partisë, sot përbën ushtrinë tonë të lavdishme, një ushtri moderne të një shteti modern socialist.

Në sajë të Luftës Nacionalçlirimtare, nën udhëheqjen e drejtë dhe largpamëse të Partisë sonë, populli shqiptar fitoi përjetë lirinë, siguroi pavarësinë e atdheut, zhvilloi me sukses reformat e mëdha historike, shoqërore, ekonomike, kulturore, rindërtoi vendin e shkatërruar nga lufta, hodhi bazat e socializmit, i zhvilloi këto në rrugën marksiste-leniniste dhe sot po ndërton me sukses socializmin në fshat e në qytet.

Vendi ynë, dikur i prapambetur nga çdo pikëpamje, i sulmuar, i shtypur dhe i shfrytëzuar nga kapitalistët e huaj dhe feudo-borgjezia e vendit, është bërë sot një vend socialist i përparuar, i fuqishëm, ku punëtorët dhe fshatarët janë në fuqi, kanë vendosur diktaturën e proletariatit, në formën e demokracisë popullore.

Ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit në vendin tonë është një proces i madh, i vazhdueshëm. Partia jonë po e kryen me sukses dhe e drejton me pjekuri

këtë proces nga një etapë në tjetrën, kurdoherë dhe për çdo gjë e mbështetur në teorinë e saj krijuese revolucionare të marksizëm-leninizmit. Ky proces ka anët e tij politike, ideologjike, ekonomike dhe kulturore-arsimore, të cilat vazhdimisht duhet të zhvillohen paralelisht dhe në luftë të pandërprerë midis së resë dhe të vjetrës, progresit dhe prapambetjes, përparimtares dhe asaj që është reaksionare, në një luftë klasash të vazhdueshme për të zgjidhur në rrugën marksiste-leniniste kontradiktat e brendshme joantagoniste. Populli ynë vigjilon sypatrembur dhe është plotësisht i përgatitur për të përballuar me një shpirt dhe guxim revolucionar rreziqet që i turren atdheut tonë socialist, revolucionit, lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe paqes botërore, nga imperializmi botëror, me atë amerikan në krye, nga revizionizmi modern me atë hrushovian sovjetik në krye dhe nga aleancat e tyre me kapitalizmin dhe reaksionin botëror.

Prandaj diktatura e proletariatit në vendin tonë socialist duhet të jetë e fortë, e mprehtë, në kundërshtim me thëniet e tradhtarëve të marksizëm-leninizmit, revizionistëve modernë, të cilët pretendojnë sikur asaj i paska kaluar koha dhe s'duhet më. Këtë revizionistët e bëjnë me qëllim që në vendet socialiste të rivendosin diktaturën e borgjezisë dhe të kapitalit, për t'u hequr popujve nga duart armën e fuqishme që i mbron dhe fitoret e tyre të realizuara me gjak, me sakrifica, me revolucion.

Dhe pikërisht Ushtria Popullore është një nga armët më të fuqishme të diktaturës së proletariatit,

është arma më e dashur e punëtorëve dhe e fshatarëve, e të gjitha masave punonjëse të vendit tonë.

Imperializmi botëror, që është në kalbëzim dhe po i afrohet vdekja, ka në këmbë ushtri të mëdha agresive, shtypëse, të cilat i ka pajisur dhe po i pajis me armë nga më modernet, që i përdor dhe do t'i përdorë për të shtypur e për të skllavëruar popujt. Armët e tyre imperialistët agresorë do t'i përdorin në radhë të parë kundër vendeve socialiste, me qëllim që të likuidojnë socializmin, komunizmin dhe të vendosin në botë hegjemoninë e kapitalit.

Revizionistët modernë, shërbëtorë dhe agjentë të kapitalit botëror, bëjnë të gjitha përpjekjet për të dobësuar e për të çarmatosur ideologjikisht, politikisht dhe teknikisht ushtritë e vendeve socialiste, në mënyrë që ushtritë agresive dhe shtypëse imperialiste të mos gjejnë përpara rezistencë në veprën e tyre të dominimit botëror, ose të gjejnë një rezistencë shumë të dobët dhe t'ua arrijnë kështu qëllimeve të tyre.

Në këto kushte, pra, neve na vihet si detyrë imperative, jetike, nga më të rëndësishmet që populli ynë të ketë në këmbë një ushtri të tij, të fortë e të çeliktë nga çdo pikëpamje. Është për këtë arsye të madhe, që Partia dhe populli i kushtojnë një kujdes kaq të madh Ushtrisë sonë të lavdishme Popullore.

**Ç'e karakterizon Ushtrinë tonë Popullore dhe cilat janë karakteristikat e ushtrisë borgjeze?**

Ushtrinë tonë e karakterizon, në radhë të parë, fakti se ajo e ka origjinën e saj në popull. Kjo do të thotë se janë fshatarët, punëtorët, të rejtat dhe të rinjtë



përparimtarë të vendit tonë që e krijuan atë, të frymëzuar dhe të udhëhequr nga një Parti marksiste-leniniste. Ata mbushën radhët e ushtrisë, e ndihmuan atë dhe nga gjiri i tyre dolën kuadrot udhëheqës të saj. Pra, ushtria jonë nuk mund të ishte veçse një ushtri popullore, një ushtri revolucionare, e krijuar, e ndihmuar dhe e frymëzuar nga populli dhe nga Partia Komuniste e Shqipërisë për të kryer revolucionin.

Ç'do të thotë të kryente revolucionin me sukses? Kjo do të thotë që ajo të çlironte përgjithmonë fshatarët dhe punëtorët nga zgjedha shekullore e bejlerëve, e feudalëve, e agallarëve, e borgjezisë tregtare dhe fajdexheshë të qyteteve; të thyente përgjithmonë kapitalistët e fshatit dhe të qytetit, t'u hiqte atyre nga duart pushtetin ekonomik, politik dhe aparatit e tij shtypës, ta shkatërronte atë që nga themelitet dhe në vend të tij të krijonte pushtetin e ri popullor.

Në radhë të dytë, Ushtrinë tonë Popullore e karakterizon qëllimi i saj për të cilin u krijua nga Partia dhe nga populli. Brenda këtij qëllimi ekzistonte njëkohësisht dhe e pandarë lufta kundër pushtuesve fashistë italianë dhe nazistëve gjermanë.

Pra, Ushtria jonë Popullore kishte dy detyra të mëdha: çlirimin e atdheut nga zgjedha e huaj dhe çlirimin e fshatarëve dhe të punëtorëve nga zgjedha e kapitalistëve të brendshëm të fshatit dhe të qytetit, që kishin bërë kauzë të përbashkët me pushtuesit fashistë.

Forca e ushtrisë sonë, pra, që u formua nga populli, qëndron kurdoherë te populli, te punëtorët, te fshatarët dhe te të gjitha masat punonjëse të vendit

tonë. Jashtë këtij kuptimi nuk mund të ketë ushtri të pathyeshme. Ushtri ka, siç do ta shohim në rastin e ushtrive borgjeze, por ushtri të pathyeshme borgjeze nuk mund të ketë.

Një ushtri është e pathyeshme, kur ajo është një ushtri e punëtorëve dhe e fshatarëve të çliruar, kur ajo është ushtri e diktaturës së proletariatit dhe kur udhëhiqet nga një parti e vërtetë marksiste-leniniste. Si rrjedhim, një ushtri e tillë mbron dhe forcon çdo ditë pushtetin popullor të punëtorëve e të fshatarëve, forcon çdo ditë diktaturën e proletariatit, mbron me vigjilencë kufijtë e atdheut socialist dhe të gjitha fitoret e popullit të vet.

Një ushtri e tillë popullore është njëkohësisht një ushtri me karakter internacionalist, ajo nuk mund t'i hedhë armët për asnjë çast, derisa të shkatërrohet përgjithmonë kapitalizmi, derisa të ketë shtypës dhe skllëvër.

Këto janë karakteristikat e Ushtrisë sonë Popullore, karakteristikat e klasave që e përbëjnë atë, karakteristikat e Partisë së Punës të Shqipërisë që e krijoi, e udhëhoqi dhe e udhëheq sipas mësimëve të marksizëm-leninizmit, ideologjisë së klasës punëtore. Ushtria jonë, pra, është një ushtri politike dhe jo apolitike ose asnjëse. Ushtria jonë udhëhiqet, brumoset, çelikoset nga politika e Partisë sonë dhe e gjithë jeta dhe puna e saj është e pandarë, për asnjë minutë, nga objektivat e politikës së Partisë dhe të pushtetit popullor.

Ndërsa ushtria borgjeze ka karakteristika të tjera, krejt të kundërta nga ato të ushtrive popullore. Edhe

ushtria borgjeze përbëhet nga njerëz të rekrutuar në popull, por ajo ka tiparet, karakteristikat, qëllimet dhe politikën e klasës së kapitalistëve që e ka organizuar, e armatos, e edukon dhe e frymëzon.

Një nga karakteristikat e ushtrisë borgjeze është shtypja e popullit të vet, e punëtorëve, e fshatarëve, e mbajtjes së këtyre nën zgjedhën dhe nën robërinë e kapitalit shfrytëzues, shtypja e lirive demokratike, e grevave politike dhe ekonomike të punonjësve të vendit të vet.

Karakteristikë tjetër e ushtrisë borgjeze është shtypja e revolucioneve popullore, skllavërimi, kolonializimi dhe shfrytëzimi në palcë i popujve të tjerë.

Pra ushtria borgjeze është mbrojtëse e bankave të kapitalistëve, e fitimeve të tyre që rrjedhin nga shfrytëzimi i popullit, ajo është arma e trusteve kapitaliste, që frymëzojnë, edukojnë, stërvitin dhe armatosin ushtrinë për të shtypur popullin e vet dhe për ta përdorur për agresion kundër popujve të tjerë, kundër revolucioneve, kundër vendeve socialiste në radhë të parë dhe pushtetit popullor të këtyre vendeve, por edhe kundër çdo shteti borgjez ose force tjetër kapitaliste, që orvatet dhe rrezikon interesat e borgjezisë së vendit që e ka krijuar.

Pavarësisht se me kohët kanë ndryshuar strategjia, taktika, armatimet dhe veshja e tyre, të gjitha ushtritë, qoftë në kohën e perandorëve persë, romakë, kartagjenas, të mbretërve të ndryshëm, të Napoleonit dhe të Perandorisë së parë e të dytë franceze etj. qoftë ushtritë aktuale të shteteve borgjeze kapitaliste,

të imperializmit amerikan etj., nuk e kanë ndryshuar asnjëherë karakterin e tyre antipopullor, skllavërues, shtypës. Ky karakter ka evoluuar tok me periudhat historike, me ndryshimet shoqërore, me zhvillimin ekonomik, me shkencën, me shembjen e Perandorisë Romake, me kalimin e mesjetës, me formimin e monarkive dhe me shkatërrimin e tyre, me ngritjen e borgjezisë në revolucion, me evolucionin e saj në fuqi imperialiste, me transformimet e vazhdueshme deri në kohët tona.

Duke i studiuar të gjitha këto periudha nga ana ushtarake, ne shohim gjithashtu se idetë bazë që i përshkonin të gjitha këto epoka, kanë qenë konfliktet e vazhdueshme të grupeve sunduese, të cilat i shfrytëzonin popujt dhe i mbanin në skllavëri. Ushtritë kanë qenë mjete të dominimit, të skllavërimit, të zgjidhjes së konflikteve, të pushtimeve, të luftërave të përgjakshme të këtyre grupeve. Borgjezia kapitaliste në çdo kohë është përpjekur ta fshehtë karakterin banditesk dhe agresiv të ushtrisë së saj kundër popujve të tjerë që i sulmonte dhe që i shtypte, duke u mbuluar me parullat nacionaliste «për mbrojtjen e atdheut», «për mbrojtjen e kufijve» të mbretërisë ose të republikës, ose me parulla pseudohumanitare «për mbrojtjen dhe përparimin ekonomikokulturor të popujve» të ashtuquajtur nga ana e saj të egër e të prapambetur.

Nën të gjitha këto parulla fshihej politika grabitqare e borgjezisë, maskohej kolonializmi dhe krijimi i perandorive, luftohej për vendosjen e hegjemonisë kapitaliste. Nën këto parulla degjeneroi ushtria e revo-

lucionit borgjez francez pas Termidorit<sup>1</sup> në një ushtri cezariane, në shërbim të një njeriu, të një perandorie e kështu vazhdimisht deri në kohët tona.

Borgjezia kapitaliste përhap parullën se ushtria e saj është një ushtri apolitike. Ky është një bluf për të maskuar qëllimet e vërteta politike të ushtrisë borgjeze që ka dhe zbaton politikën e borgjezisë. Dhe këtë politikë borgjezia e bën nëpërmjet kuadrove të ushtrisë, të cilët nuk dalin dhe nuk zgjidhen nga populli, por i nxjerr e i zgjedh nga radhët e veta, i edukon politikisht dhe ushtarakisht me ideologjinë e saj, me qëllimet dhe me prirjet e borgjezisë kapitaliste, i frymëzon me urrejtjen më të madhe kundër popullit të vet, kundër revolucionit, i përgatit për të shtypur liritë dhe të drejtat e popujve të tjerë.

Pra, ushtria borgjeze nuk është dhe kurrë nuk mund të jetë një ushtri «asnjanëse», «apolitike», ose «pa tendencë», siç pretendon borgjezia.

Ushitari është element i rrezikshëm për ushtrinë borgjeze, sepse, i rekrutuar nga masat e popullit, me format që njihen, ai sjell me vete në ushtri, në forma dhe në shkallë të ndryshme, ide përparimtare, të cilat hyjnë në konflikt me vetë karakterin reaksionar të ushtrisë dhe të kuadrit të saj. Këndeji rrjedh dhe dobësia e ushtrisë borgjeze që e ka krimbin brenda. Ky krimb, sa më revolucionare të jetë gjendja e për-

---

1 Më 9 Termidor (27 korrik 1794) në Francë u krye grushti kundërrevolucionar borgjez që sollti përmbysjen e qeverisë revolucionare të Robespierit.

gjithshme, aq më tepër merr forma të rrezikshme për të. Borgjezia me politikën e vet përpiqet ta ketë ushtrinë nën ndikimin e plotë të saj. Nga ana tjetër, ajo përpiqet ta izolojë atë në kazerma ushtarakisht dhe politikisht, që të mos infektohet nga idetë revolucionare. Por ky qëllim është vështirë të arrihet ashtu si dëshiron borgjezia reaksionare. Ky është vetëm një iluzion. Shembull tipik është ai i ushtrisë borgjeze franceze, e cila në Vietnam dhe në Algjeri pësoi disfatë të dyfishtë: disfatë ushtarake, gjithashtu edhe disfatë drejt shthurjes së parimeve bazë të disiplinës së mendimit unik, jo vetëm tek ushtarët, por edhe te kuadrot e saj.

Pra, siç e shohim, ka dy lloj ushtrish: ushtri popullore dhe ushtri borgjeze, ushtri të diktaturës së proletariatit dhe ushtri të diktaturës borgjeze. Të dyja këto ushtri janë në antipod të njëra-tjetrës, si nga përbërja, nga ideologjia, nga politika, ashtu edhe nga qëllimet e tyre. E para, ushtria popullore, është një ushtri e fortë dhe forcohet çdo ditë, pse vetë ideologjia dhe qëllimet që e udhëheqin janë përparimtare, revolucionare; kurse e dyta, ushtria borgjeze, është një ushtri e dobët, dhe që dobësohet çdo ditë, pse vetë klasa që e udhëheq dhe e përdor atë është në kalbëzim dhe shkon drejt vdekjes, pse ideologjia dhe qëllimet që e frymëzojnë janë regresive, reaksionare, të dënuara nga historia. Pra, pavarësisht nga lloji dhe nga potenciali i armëve që ka secila nga këto të dyja, ushtria popullore do të mposhtë në çdo betejë dhe do të fitojë me siguri mbi ushtrinë borgjeze, sepse faktori njeri

dhe botëkuptimi i tij revolucionar është faktori i parë, faktori vendimtar. Armët janë faktori i dytë. Arma pa njeriun është e vdekur, kurse njeriu që di përse e përdor armën, qëndron kurdoherë në radhë të parë.

**Me ç'parime duhet të mbrohet Ushtria jonë Popullore dhe si duhet t'i kuptojë e t'i zbatojë ajo mësimet ushtarake të stërvitjes dhe ato të edukimit moralo-politik?**

Nuk mund të ekzistojë ushtri revolucionare popullore pa drejtimin e saj nga ana e partisë marksiste-leniniste. Ajo nuk mund ta kryejë misionin e saj të madh, si në kohë paqeje, ashtu edhe në kohë lufte, pa u frymëzuar dhe pa u udhëhequr nga parimet bazë të partisë, nga teoria marksiste-leniniste, pa qenë e ngritur politikisht dhe ideologjikisht, aq sa edhe ushtarakisht.

A i ka ushtria jonë tiparet dhe karakteristikat e një ushtrie revolucionare? Po, i ka. Të gjitha këto karakteristika janë zhvilluar dhe janë kalitur në rrugë të drejtë nga Partia jonë. Në rendin e ditës qëndron dhe do të qëndrojë kurdoherë kalitja e mëtejshme e ushtrisë sonë me këto parime revolucionare, edukimi moralo-politik i saj vazhdimisht në ngritje kualitative.

Lufta Nacionalçlirimtare ka qenë shkolla e madhe e luftës dhe e revolucionit për partizanët dhe për kuadrot tanë politikë dhe ushtarakë. Atje ne hodhëm themelet e ushtrisë sonë, atje mësuan kuadrot tanë të luftonin dhe të drejtonin në mënyrë revolucionare, pa kaluar fare nëpër shkollat ushtarake, por drejt nga punishtja ose nga fabrika, nga ara ose nga mali, nga bankat e shkollës ose nga katër muret e shtëpisë, në luftë, në një luftë të pabarabartë me armiq të egër, të cilët ishin

të armatosur, të stërvitur në shkolla dhe me tradita luftërash grabitqare, por prapë të stërvitur në luftëra.

Me këtë nuk dua të them se nuk duhen shkollat ushtarake; Partia kuadrot e luftës fill pas Çlirimit i kaloi dhe i mësoi nëpër shkolla ushtarake dhe në akademi, brenda dhe jashtë vendit tonë, por, e përsërit, **Partia i mëson ata të ruajnë derisa të vdesin freskinë dhe frymën revolucionare të kohës së luftës. Kjo freski e frymë revolucionare, kjo partishmëri, jo vetëm duhet ta përshtojë vazhdimisht ushtrinë tonë, por ajo duhet të lihet edhe si trashëgimi më i madh për brezat e ardhshëm të ushtarëve dhe të kuadrove të Ushtrisë sonë Popullore.**

Kuadri udhëheqës i ushtrisë, në të gjithë punën e tij në këtë kohë paqeje relative, duhet të ketë kurdoherë parasysh që në radhë të parë të mos lërë të ndryshken në personin e tij fryma dhe hovi revolucionar i kohës së luftës dhe me këtë ai vazhdimisht të edukojë dhe të frymëzojë ushtarët dhe kuadrot e rinj që ngrihen. Koha që kalon mund të lërë te njerëzit gjurmë të mira, po edhe gjurmë të këqija. Varet nga njerëzit, nga vullneti, nga kuptimi i drejtë prej tyre i politikës dhe i teorisë sonë, nga zbatimi në jetë në mënyrë revolucionare i kësaj politike dhe i këtyre parimeve. Partia na mëson vazhdimisht ta duam jetën dhe kurdoherë të luftojmë për të, të luftojmë për të rrënjosur thellë në zemrat dhe në mendjen e njerëzve virtytet e mira, të luftojmë me kurajë të këqijat, të luftojmë, pra, me vështirësitë objektive dhe subjektive.

Ushitari dhe kuadri ushtarak duhet të mos harroj-



në se më parë se të jenë ushtarë ose kuadro, ata janë pjesëtarë të shoqërisë sonë, janë qytetarë të Republikës sonë Popullore dhe si të tillë, përveç detyrave dhe të drejtave specifike të ushtrisë, kanë njëkohësisht detyra e të drejta edhe si të gjithë qytetarët e tjerë të Republikës. Veç detyrave civile si qytetarë, pjesëtarit të ushtrisë i shtohen edhe detyra në ushtri. Në regjimin tonë socialist ku udhëheq Partia, këto detyra dhe të drejta jo vetëm janë të lidhura e në harmoni, por detyrat specifike dhe të drejtat e pjesëtarit të ushtrisë, kurdoherë duhet të forcojnë tek ai ndjenjën e zbatimit të detyrave dhe njohjen e të drejtave që ka si qytetar, dhe detyrat e tij specifike të jenë kurdoherë në shërbim të Republikës, të popullit dhe të Partisë që na udhëheq. Historia me ndodhitë e saj na mëson se kurdoherë që ushtria dhe kuadrot i kanë harruar këto të drejta e detyra, klikat reaksionare kanë arritur t'i errësojnë këto parime dhe ushtrinë ta shndërrojnë në një ushtri pretoriane ose ta kthejnë nga një ushtri revolucionare, siç ishte ajo e «*sans-culotte-ve*»<sup>1</sup>, në një ushtri në shërbim të Napoleonit dhe të perandorisë, ose siç po kalon tash ish-Ushtria e lavdishme Sovjetike në një ushtri pretoriane në shërbim të klikës hrushoviane kundër popullit, kundër revolucionit, kundër socializmit.

Pra, Ushtria jonë Popullore revolucionare, të cilën e edukon dhe e udhëheq Partia, është kalitur me parimet bazë për të qenë e lidhur ngushtë si mishi me thoin me popullin, për të qenë kurdoherë në shërbim

---

<sup>1</sup> Emër i revolucionarëve në kohën e Konventës (1792-1794) në Francë.

të kauzës së popullit, të rrojë me popullin dhe si populli, kurrë dhe për asgjë të mos ngrihet mbi popullin, të jetë e pajisur me virtytet më të mira të popullit. Kjo është rruga e vetme që na tregon Partia neve, pjesëtarëve të Ushtrisë Popullore. Këtë rrugë ajo na e ndriçon fuqimisht me teorinë e saj revolucionare, marksizëm-leninizmin, që ne të gjithë së toku dhe gjithsecili do ta ndjekim sa të rrojmë.

Prandaj ne, shokë ushtarakë, komandantë dhe komisarë, të studiojmë dhe vazhdimisht të studiojmë rrënjësisht eksperiencën e Partisë sonë, në të gjitha drejtimet, të studiojmë me këmbëngulje marksizëm-leninizmin, **pse vetëm këto do të na bëjnë që t'i kuptojmë çdo ditë më mirë e më qartë këto probleme jetike, se vetëm kështu do të kuptojmë, do të zbulojmë dhe do të vëmë në jetë thesarin e madh të gjenisë së popullit tonë për çdo gjë, por veçanërisht edhe në lëmin ushtarak; sepse vetëm kështu do të jemi në gjendje të përfitojmë nga eksperiencia e madhe teorike ushtarake e klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe e revolucionarëve të tjerë.**

Lenini, diku në një vend, thotë për afërsisht se njohuritë ushtarake janë mjetet që përdorin klasat dhe popujt për zgjidhjen e problemeve të mëdha historike. Klasa punëtore ka njohuritë e saj ushtarake, ashtu sikurse ka edhe borgjezia të sajat. Ne duhet të kuptojmë, të mësojmë rrënjësisht që t'i zhvillojmë e t'i pasurojmë njohuritë ushtarake të klasës sonë punëtore dhe të aleates së saj revolucionare, fshatarësisë, dhe t'i zbatojmë ato si duhet në jetë, në mënyrë të zgjuar dhe me efikasitetin më të madh. Prandaj, në shkollat tona

ushtarake dhe në punën për edukimin dhe për stërvitjen e ushtarëve dhe të kuadrove ne duhet të udhëhiqemi kurdoherë nga parimi leninist i mësipërm.

Eksperiencia luftarake e popullit dhe e ushtrisë sonë është e pasur, prandaj ajo akoma më shumë duhet studiuar e duhet thelluar dhe të përbëjë bazën e njohurive ushtarake të kuadrove dhe të ushtarëve tanë. Eksperiencën tonë ne duhet ta pasurojmë më tej me njohuritë ushtarake revolucionare të popujve dhe të partive marksiste-leniniste. Natyrisht eksperiencia e tyre shumë e vlefshme duhet përpunuar kurdoherë në kushtet e vendit tonë, sepse ndryshe mund të biem fare lehtë në një shabllonizëm të pafund e pa perspektivë dhe njerëzit tanë t'i mësojmë me receta shumë herë të paaplikueshme për kushtet dhe për rrethanat tona, të cilat nuk mund të jenë kudo e kurdoherë të njëjllota. Zbatimi i këtyre recetave, jashtë realitetit tonë, mund të na shkaktojë dëme serioze, ashtu sikurse mund të na ndihmojë pa masë në rast se shfrytëzohet me zgjuarsë, me zotësi e me kompetencë.

Për kuadrot tanë ushtarakë, historia ushtarake, historia e betejave të zhvilluara gjatë luftërave të ndryshme taktiko-operative, strategjia dhe politika e përdorur nga kundërshtarë të ndryshëm në vende e në kohë të ndryshme, është e nevojshme të dihet, të mësohet për të marrë një kulturë të përgjithshme ushtarake. Një kulturë e tillë i jep kuadrit ushtarak një besim të madh në mendimet e në vendimet e tij. Por, kuadrot e mësuar në radhë të parë duhet të kenë parasysh ta shfrytëzojnë si duhet këtë dituri ushtarake, pse mund të bëhen skilevër të formulave, të skemave

që si kudo dhe në ushtri, sidomos, nuk mund të kenë rezultate të mira, mbasi skemat dhe shabllonet joreale krijojnë një letargji, të kundërtën e asaj fryme revolucionare, të atij hovi madhështor që karakterizonte kuadrot tanë gjatë luftës, të cilët, megjithëse pa shkollë, me nuhatjen e tyre revolucionare merrnin vendime të drejta, të shpejta, të sigurta e të studiuara.

Pra, në këtë drejtim, me këto parime duhet të edukohemi ne nga ana ushtarake dhe që të mos biem në gabime, çdo eksperiencë ushtarake që do të na vihet përpara, ta shikojmë në prizmin e marksizëm-leninizmit dhe në sitën e eksperiencës dhe të situatave tona. Të pajisur dhe të koracuar me të tilla dijeni, ne do të dimë të studiojmë edhe eksperiencën e armiqve tanë, taktikën dhe strategjinë e tyre. Këto ne nuk duhet t'i vazhdojmë në mënyrë statike, sikur armiku të mos u bënte atyre ndryshime të rastit, lidhur me gjendjen dhe me konditat e kundërshtarit.

Parimet e armikut në luftë ne duhet t'i njohim, por zotësia dhe epërsia jonë duhet të qëndrojnë në atë që, duke i njohur ato, të jemi në gjendje të parashikojmë ndryshimet dhe variantet që ai mund t'i bëjë taktikës operative dhe strategjisë së tij përpara taktikës dhe strategjisë sonë dhe të ndërtojmë kështu një taktikë dhe një strategji të re, të paparashikuar nga armiku, të cilat t'i krijojmë kondita të rënda, që të mos ketë mundësi t'i ndryshojë, të bjerë në kurth dhe ne ta shtypim në gjak. Pra, të gjitha rrethanat duhet të studiohen e të thellohen nga kuadrot tanë.

Natyrisht edhe armët kanë rolin e tyre vendimtar në luftë, por atë rol që theksova më lart. Në këtë drej-

tim, në shkolla dhe në ushtri, ushtarë dhe kuadro, duhet ta dinë në perfeksion armën që kanë në përdorim, në perfeksion matematik nga çdo pikëpamje, në mënyrë që arma të jetë, si të thuash, «skllavi i tyre». Kjo është ana teknike, por ushtar dhe kuadër me të njëjtën përpikëri të anës teknike duhet të dinë edhe politikën e armës. Ata as nuk duhet ta nënvleftësojnë, por as edhe ta mbivlerësojnë forcën e armëve të armikut.

Pavarësisht nëse armiku do t'i përdorë ose jo të gjitha armët moderne që posedon në një sulm kundër nesh, kuadro dhe ushtarë të ne duhet të dinë efektin e çdo arme dhe mënyrën e mbrojtjes ndaj saj, si nga ana teknike, ashtu edhe nga ana politike e morale, në mënyrë që ushtari dhe kuadri ynë asnjëherë të mos ndodhen në befasi, të mos njohin as frikën as panikun.

**Drejtimi i ushtrisë me anën e komiteteve të Partisë dhe vendosja përsëri e komisarëve politikë në ushtri ka një kuptim të madh.** Mua më duhet të theksoj kënaqësinë e madhe të Komitetit Qendror të Partisë në lidhje me kuptimin e drejtë që pati tek ushtarët dhe te kuadrot e ushtrisë, si dhe entuziazmin e besimin që ju shprehët në lidhje me këtë vendim historik.

Në emër të të gjithë Partisë, të Komitetit të saj Qendror dhe në emrin tim, dëshiroj t'ju përgëzoj dhe t'ju falënderoj për pjekurinë e madhe që tregoi ushtria jonë, si në të gjitha rastet, ashtu edhe me rastin e vendimeve të rëndësishme që u morën. S'mund të kisha as dyshimin më të vogël, se këto vendime do të kuptoheshin dhe do të zbatoheshin me një frymë të

madhe partishmërie, sepse Partia dhe puna e saj janë gjithçka për ushtrinë. Kjo është një situatë faktike dhe duke zgjedhur komitete partie për drejtimin e punës së Partisë në ushtri, ne nuk bëjmë gjë tjetër veçse e forcojmë akoma më tej këtë situatë të shkëlqyer të Partisë në Ushtrinë tonë Popullore.

Unë nuk do të zgjatem shumë në këtë çështje, se e di që vendimi për këtë problem, edhe para se të merrej, edhe mbasi u mor, u diskutua gjerësisht, hapur, me ushtarë dhe me kuadro, me komunistë dhe jokomunistë. Të gjithë shfaqën mendime të vlefshme që na mësuën, na forcuan besimin se vendimi që po merrej, pëlqejë dhe aprovohej njëzëri, kështu që rëndësia dhe oportuniteti i marrjes së këtij vendimi janë shumë të qartë për ju.

Tani, organizata e Partisë në ushtri, organizata e rinisë dhe gjithë kolektivi, që nga ushtari më i thjeshtë e deri te kuadri më i lartë, kanë për detyrë të madhe që në komitetet e Partisë të zgjedhin njerëzit më të mirë, njerëz me partishmëri të lartë dhe me kulturë ushtarake të gjerë. Ju, shokë komunistë, që do të zgjidhni këtë komitet, detyrë kjo shumë e rëndësishme për të cilën keni marrë mandatin nga organizatat-bazë, keni një përgjegjësi të madhe përpara shokëve tuaj, anëtarë të Partisë dhe të gjitha reparteve.

Prandaj, si në çdo punë, edhe në këtë detyrë me kaq përgjegjësi që po kryeni sot në këtë konferencë, duhet të vlejë fryma revolucionare marksiste-leniniste. Puna e Partisë nuk pranon formalizma, përkundrazi ajo duhet të kurorëzohet me realizime cilësore, objektive ose subjektive. Zgjedhja e njerëzve në komitetet e Partisë

të ushtrisë, ka sot veçanërisht shumë rëndësi, pse po i hyjmë një pune të re. Ne kemi për këtë një eksperiencë nga koha e kaluar e Luftës Nacionalçlirimtare, por aktualisht janë kohë të tjera dhe detyrat e kompetencat e komiteteve të Partisë janë shumë më të mëdha, shumë më të gjera e më me përgjegjësi. Eksperiencën e fituar në të kaluarën, ne duhet ta shfrytëzojmë dhe ta pasurojmë në kondita të reja, me eksperiencën e re që do të fitojmë.

Një nga detyrat kryesore të komiteteve të Partisë që po krijojmë, është që kuadrot ushtarakë dhe ata politikë t'i mësojmë që punën kolegjiale të drejtimit ta bëjnë me të vërtetë një jetë të dytë, një stil dhe një metodë pune të re. Kjo në forma është vendosur, por nuk mund të kënaqemi me format, ne duhet të pasurojmë brendinë, të cilën duhet ta kuptojmë drejt dhe të ecim përpara duke spastruar çdo pengesë, sepse në lidhje me drejtimin kolegjial nuk duhet menduar që kuadrot nuk do të hasin në pengesa subjektive. Pikërisht këtu është i nevojshëm një edukim politik dhe ideologjik për kuadrin dhe një ndihmë e kontroll në punën e tij praktike, mbasi do të ishte gabim të mendohej që praktika e vjetër e drejtimit dhe e komandimit do të zhdukej vetvetiu, pa një punë të madhe bindëse, sqaruese. Një gjë e tillë varet shumë nga metoda dhe nga puna që do të bëjnë komitetet e Partisë, sepse, të mos harrojmë, të gjithë shokët që do të zgjidhen, nuk ka si të bëjnë këtu përjashtim, janë mësuar me drejtimin unik. Format e studiuara dhe më të mira të punës që duhet të kërkohen dhe që do të gjenden, do të dalin me doemos nga një punë revolucionare në komitetet e Par-

tisë dhe në organizatat-bazë, punë revolucionare që kondicionohet nga zbatimi si duhet i Statutit të Partisë, i ligjeve marksiste-leniniste të Partisë, i demokracisë së brendshme të Partisë, i centralizmit demokratik, i kritikës dhe i autokritikës së shëndoshë, i vigjilencës revolucionare, i njohjes si duhet të materialit bazë të Partisë, i njohjes si në pëllëmbën e dorës të gjendjes së repartit dhe të ushtarëve. Të gjitha këto, edhe të tjera si këto që duhet të bëhen qenie e përbashkët e komunistit, do t'i bëjnë Partinë, komitetet e saj, ushtrinë, të forta si çeliku.

Ju, shokë, që konferenca do t'ju zgjedhë në komitet, si edhe ju, shokë të tjerë komunistë, që jeni zgjedhur në byrotë e organizatave-bazë ose si sekretarë të tyre, ju shokë komisarë politikë të reparteve, që në fillim, po edhe vazhdimisht të keni kujdes organizimin më të mirë të punës në këto forume. Këtë mos e merrni si një punë të lehtë dhe mos e konfondoni sikur është njëlloj si puna e shtabeve. Drejtimi i Partisë ndryshon nga puna e shtabeve. Drejtimi me anë të komiteteve frymëzon punën e shtabeve, por nuk konfondohet me të, ai është diçka më i lartë dhe i shumanshëm nga ana politike, ideologjike, organizative, teknike, ekonomike etj., etj.

Ju nuk duhet të harroni çështjen tjetër, që komitetet e Partisë nuk duhet të merren me cikërrima, me gjëra të vogla që u përkasin t'i kryejnë të tjerët. Megjithatë asnjë gjë e vogël nuk duhet t'i shpëtojë syrit të komitetit, nga ato ky duhet të nxjerrë mësim dhe konkluzione për të edukuar Partinë dhe masën e ushtarëve.



Duhet të përcaktohen mirë detyrat e çdo komiteti, të çdo anëtarit të tij dhe këto të ushtrohen plotësisht e me përgjegjësi. Është e nevojshme të përcaktohen kompetencat e komiteteve të ndryshme në reparte që të mos krijohet konfuzion, të mos ngjasin marrje kompetencash nga komiteti më i lartë komitetit më të ulët. Në kuadrin e centralizmit demokratik dhe të hierarkisë në komanda, duhet të përcaktohen drejt dhe të zbatohen mirë kompetencat nga çdo njeri, nga çdo forum partie, nga çdo komandë reparti. Kjo është e domosdoshme të mbahet parasysh në punën tuaj.

Gjithashtu komitetet, byrotë dhe organizatat-bazë të Partisë duhet të mos zhvillojnë kurrë një punë të fjetur, skematike dhe pa perspektivë. Rendi i tyre i ditës duhet të jetë i studiuar mirë, jo vetëm në bazë të një plani që duhet të përfshijë të gjitha problemet e ndryshme që preokupojnë ushtrinë, por ai të mos qëndrojë medoemos standard brenda kësaj kornize. Problemet e vëna në rendin e ditës, duhet të jenë të diktuar nga gjendja dhe nga nevojat reale të sektorëve të punës, nga të cilat dalin edhe çështjet që kërkojnë zgjidhje.

Këto që po ju them si këshilla pune mund të jenë pak. Jeta do t'ju mësojë gjëra të tjera më të mira. Është e vërtetë se ushtria ka probleme të shumta që duhet t'i zgjidhë, por sidoqoftë, po t'i krahasojmë ato me numrin e problemeve që u vihen përpara komiteteve të Partisë të terrenit për t'i studiuar dhe për t'i zgjidhur, këto të fundit janë më të mëdha, shumë më të koklavitura e më të zorshme për t'i zbatuar, pse vetëm po të marrim hapësirën e territorit dhe diversitetin e njerëzve, çështjet bëhen edhe më të vështi-

ra. Por, megjithatë, me gjithë eksperiencën e gjatë e të madhe që ka fituar Partia, prapëseprapë në punën e komiteteve të Partisë në terren ekzistojnë shumë nga gabimet që përmenda më sipër, bile edhe shumë të tjera. Pra, Partia ka eksperiencë të mirë, po ka edhe gabime dhe nga gabimet mëson dhe përmirëson punën.

Ju, shokë, që do të zgjidheni në forumet udhëheqëse të Partisë në ushtri, keni, pra, për të mësuar shumë nga komitetet e Partisë të terrenit, ashtu si dhe ata nga ju, prandaj ju rekomandoj të shkëmbeni me njëri-tjetrin në mënyrë të organizuar eksperiencën e mirë dhe të keqe, të mirën për ta forcuar, kurse të keqen për të mos e përsëritur. Këtë eksperiencë që do ta merrni nga organizata e terrenit, kuptohet se duhet ta përpunoni dhe t'ua përshtatni kushteve specifike të punës në ushtri.

Organizata e Partisë duhet të bëhet kudhra e kalitjes morale, politike dhe ideologjike të komunistëve. Kjo kalitje të futet pastaj në format e ndryshme të punës edukative dhe të stërvitjes në të gjithë ushtarët, të cilët janë pjesëtarë aktivë të organizatës së rinisë. Në rast se ju nuk do t'i vini rëndësinë e duhur kësaj organizate, që duhet të veprojë në çdo rast në mënyrë energjike dhe revolucionare, atëherë do të thotë se ju nuk i vini si duhet rëndësi edukimit të ushtarëve, nuk kuptoni si duhet punën e organizuar as të Partisë as të rinisë as të ushtrisë. Organizatën e rinisë nuk duhet dhe kurrkujt nuk i lejohet ta konsiderojë si një gjë formale, ajo është fidanishtja më me vlerë e Partisë dhe e popullit, prandaj komunistët duhet të jenë, si të thuash, bahçevanët më të mirë të saj.

Prandaj edhe një herë ju rekomandoj të tregoni një kujdes më të madh për rininë dhe për organizatën e saj në ushtri, të vetmen organizatë të masave që ju keni, dhe çfarë organizate, nga më heroiket! Ju duhet të jeni shumë më afër kësaj organizate, jo për ta mbajtur atë në tutelë, po për ta ndihmuar në mënyrë të kualifikuar, që të ketë iniciativë dhe t'i edukojë në mënyrë të përsosur e të gjithanshme të rinjtë tanë në ushtri.

A kemi ne mundësi t'ia arrijmë këtij perfeksionimi? A i kemi kushtet, kuadrot dhe njerëzit të atillë që t'i përvetësojnë si duhet këto orientime dhe t'i zhvillojnë ato më tej? A kemi ne një parti luftarake, revolucionare që ta çojë me siguri këtë punë kurdoherë edhe më përpara? Të gjitha këto i kemi dhe bile me një cilësi të lartë.

Puna e komiteteve të Partisë në ushtri duhet të jetë sinteza më e mirë e cilësive që i nevojiten karakterit të ushtarit dhe kuadrit komandues si: pjekuria, zgjuarsia, partishmëria, njohuria e artit ushtarak, dinamizmi, vendosmëria, shpejtësia, dashuria dhe kujdesi për shokun, patriotizmi, iniciativa dhe përgjegjësia në çdo hap, vendim etj., etj.

Komiteti i Partisë duhet të pasqyrojë këto virtyte komuniste proletare të ushtrisë, t'i zhvillojë me punë politike të dendur dhe të organizuar mirë, t'i rrënjosë këto në praktikë me stërvitjen luftarake, në kurse, në shkolla; t'i rrënjosë në vendimet e në çdo hap të tij, në çdo veprim të secilit anëtar të forumit, kështu që ky të bëhet shembull për çdo kuadër, për çdo ushtar.

Drejtimi i ri me anë të komiteteve të Partisë nuk

të fjetur. Ata që e kanë qejf gjumin, të venë të flenë jashtë organizatës së Partisë. Komunistët duhet të jenë revolucionarë, të dallohen nga masa, të jenë udhëheqës të masave. Në rast se nuk janë të tillë, pavarësisht se kanë karakteristikat e një njeriu pa zarar, ata nuk e kanë vendin në Parti. Në Parti duhen njerëz me karakteristika të mira, konsekuente dhe revolucionarë në detyra.

Disa komunistë kanë zënë nga një qoshe në Parti dhe tundin derën, disa mburren me të kaluarën dhe lidhin duart, disa të tjerë që dalin në pension mendojnë se tash e tutje s'kanë punë tjetër, veçse të venë që nga mëngjesi e deri në mbrëmje në klubin e «Dinamos» ose në Kafën e Gjahtarëve, ku bëjnë muhabetë të kota, në një kohë kur Partia dhe populli kanë nevojë për ta, për të zhvilluar një punë politike intensive në fshatra, në lokalitete, në lagje e kudo.

Mua më skuqet fytyra kur më thonë se filan major apo kolonel, i dalë në pension, nuk dëshiron të largohet nga Tirana për të shkuar në fshatin e tij ku të vazhdojë të punojë, qoftë si anëtar i këshillit popullor, anëtar i kooperativës ose në ndihmë të forcave vullnetare etj. Unë i këshilloj këta shokë, me një të kaluar kaq të mirë, të shkojnë menjëherë në shërbim të popullit dhe të Partisë, pse është turp që këta porsa i kanë kaluar të pesëdhjetat, të vendosin që edhe shumë vite të tjera të vijnë rrotull nëpër parqe e kafe më kafe.

Komunistët dhe çdo patriot do të dalin në pension në bazë të ligjeve të shtetit, por për ata puna do të vazhdojë derisa të kenë këmbë e dorë dhe mend në kokë. Domethënë derisa të kemi jetë, me ato mundësi

që kemi, ne duhet të jemi në shërbim të një çështjeje të madhe, siç është kjo e Partisë sonë. Kështu duhet ta kuptojmë ne, komunistët, daljen në pension dhe të bëhemi shembull për të tjerët.

Partia jonë është një parti e fortë, monolite, marksiste-leniniste. Uniteti i saj është i çeliktë, brenda radhëve të saj dhe me popullin. Armiqtë e Partisë sonë, si të jashtëmit, ashtu edhe të brendshmit, janë përpjekur ta dobësonin këtë unitet jetik, por ata kurrë s'kanë mundur ta bëjnë këtë, kanë ngrënë grushte vdekjeje dhe janë shpartalluar. Ata kanë qenë agjenturë e huaj në shërbim të imperialistëve, të titistëve, të hrushovianëve dhe si të tillë kanë marrë dënimin e merituar nga Partia ideologjike dhe politike dhe nga gjyqet e popullit për krimet e tyre. Disa nga këta armiq kanë pasë marrë pjesë edhe në Luftën Nacionalçlirimtare, por ajo shkollë e madhe atyre nuk u shërbeu. Atyre nuk u shërbyen gjithashtu as mësimet dhe lufta e Partisë pas Çlirimit, përpjekjet heroike dhe sakrificat e panumërta të popullit. Këshillat e panumërta të Partisë për të ndrequr gabimet dhe devijimet e tyre ideologjike e politike, jo vetëm nuk i dëgjuan dhe gabimet nuk i korrigjuan, por kaluan edhe në veprime sabotimi nën drejtimin e armiqve të jashtëm. Ata u degjeneruan në armiq dhe si të tillë, nuk kishte si t'i shpëtonin as vigjilencës së mprehtë revolucionare të Partisë dhe të popullit as gjyqeve popullore, nga të cilat morën dënimin e merituar.

Me këtë dua të them se Partia e ka mprehur dhe duhet ta mprehë vazhdimisht vigjilencën revolucionare

kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm. Në frontin e brendshëm ajo nuk duhet ta zbutë dhe as ta errësojë luftën e klasave. Armiqtë e jashtëm të Partisë dhe të Republikës, kurdoherë do të përpiqen të gjejnë aleatët dhe miqtë e tyre brenda vendit tonë, për t'i nxitur kundër marksizëm-leninizmit dhe socializmit. Ata do të përpiqen të influencojnë në radhë të parë në elementët e dobët politikisht dhe ideologjikisht. Në këtë drejtim shtypi dhe radiot e huaja po bëjnë një propagandë të madhe kundër vendit dhe Partisë sonë, të cilët i kanë halë në sy.

Por sulmet e armiqve Partia jonë i përballon me sukses. Vetëm duhet që luftën për kalitjen e njerëzve tanë, si nga ana politike ashtu dhe nga ana ideologjike, ta forcojmë dhe gjithnjë më shumë ta forcojmë.

Burimet e revizionizmit ne duhet t'i thajmë krejtësisht, rrënjët e tij t'i zbulojmë, t'i shkulim dhe t'i hedhim në zjarr. Këto rrënjë fshihen akoma në mentalitetin dhe në mbeturinat e ndryshme mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve, të cilat në kohë shfaqen në mënyra shumë të ndryshme, për arsye të ndryshme: disa herë ato nxjerrin majën e veshit, herë të tjera trashen dhe veprojnë pastaj me intensivitet e çoroditin politikisht dhe ideologjikisht personin që i ka dhe nuk i lufton.

Këto mbeturina të dëmshme e të rrezikshme, disa herë paraqiten në fillim si të parëndësishme dhe, pra, s'u kushtohet kujdes, hidhen në koshin e zakonit dhe të traditës, futen në kallëpe të atilla duke thënë se me kohë ato do të zhduken. Një qëndrim i tillë ndaj tyre është i rrezikshëm.

Kur flasim për botëkuptimet, ato që dimë rreth tyre shumë herë i përsëritim me formula, pa u thelluar në brendinë e tyre filozofike. Botëkuptimi ynë është materialist, por ka edhe nga ata që, megjithëse kanë taserën e Partisë në xhep, në shumë drejtime mendojnë dhe veprojnë si idealistë, jo vetëm në çështjen e fesë, por edhe në probleme shoqërore shumë të rëndësishme, si në atë të gruas, të punës, të pagës, në problemin e disiplinës revolucionare, të pronës socialiste etj.

Ka komunistë, bile edhe shokë shumë të mirë, besnikë deri në vdekje për Partinë dhe për popullin, që gruan s'e lënë të dalë në punë. Një komunist i tillë, për shembull, nuk mendon aspak mirë. Me punën e tij të mirë ai arriti të bëhet, për shembull, edhe kolonel, rroga i rritet, por gruaja e tij vazhdon të rrijë pa punë, pa shkollë, pa asnjë zanat. Koha kalon, ai bëhet edhe me shumë fëmijë. Kuptohet se ngaqë gruan e ka pa punë, ekonomikisht ai do të shtrëngohet.

Tani që po merren masa për uljen e pagave të larta, komunisti në fjalë e pranon këtë masë të drejtë, po ekonomikisht ai shtrëngohet. Mirëpo që të jetë në rregull me ndërgjegjen e tij si komunist dhe që ekonomikisht të mos vuajë, gruan duhet ta futë në punë, por për fat të keq atë ai e ka lënë pa zanat dhe ajo vetëm një punë të thjeshtë mund të bëjë, kurse këtë punë shoqërore nuk e pranon as ish-koloneli «komunist i mirë» as gruaja e tij, bashkëshortja e ish-kolonelit pse e quajnë poshtëruese. Natyrisht ndërgjegjja fillon t'u çalojë, dhe, në qoftë se nuk i thyejnë menjëherë këto mbeturina që ngrenë kokë, atëherë njëra

do të nxjerrë tjetrën dhe në vend që të qortojnë vet-veten, do të fillojnë të qortojnë vendimin e drejtë të Partisë.

Këtë shembull e solla pse si ky ka dhe plot të tjerë. Si luftohen këto mbeturina, si i ka luftuar dhe si duhet t'i spastrojë këto Partia nga ndërgjegjja e njerëzve? Vetëm me edukimin ideologjik, vetëm duke mësuar marksizëm-leninizmin jo si dogmë, por si teori në veprim, për të zbuluar psenë dhe për t'u gjetur ilaçin gjërave.

Mësimi i marksizëm-leninizmit dhe puna revolucionare me frymë partie, me drejtësi partie, me zemër partie, me mendje të freskët partie, janë shpata e Damokleut mbi kokën e mbeturinave mikroborgjeze ku mbështetet revizionizmi. Le ta përdorim drejt e pa mëshirë këtë shpatë kundër revizionizmit modern dhe kundër çdo shfaqjeje armiçësore në dëm të marksizëm-leninizmit, të Partisë, të socializmit.

Pra, të mësojmë dhe të punojmë, shokë, të mësojmë nga puna dhe me këto mësimë të përmirësojmë dhe të fuqizojmë më tej punën, të zbukurojmë e të ndërtojmë njeriun e vërtetë, njeriun komunist.

E gjithë puna e Partisë në ushtri, duhet të bazohet në Statutin e Partisë, në direktivat dhe në vendimet e kongreseve të saj dhe të Komitetit Qendror të Partisë. Duhet të mbahet kurdoherë parasysh se ushtria është një armë e diktaturës së proletariatit që përgatitet për të mbrojtur atdheun, për të goditur pa mëshirë të gjithë armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm të popullit, të Republikës, të Partisë dhe të socializmit. Këto ligje të Partisë çdo ushtarak duhet t'i kuptojë thellë, në perfek-



sion. Brenda këtyre ligjeve, brenda ligjeve të shtetit dhe urdhrave të Ministrisë së Mbrojtjes, ai duhet të ruajë si sytë e ballit sekretet ushtarake, fshehtësinë e armës dhe të vendimeve.

Disiplina në ushtri merr, pra, një kuptim të lartë, ashtu siç merr edhe ajo e ruajtjes së sekreteve, të depove, të fortifikatave, të aerodromeve dhe të çdo arme dhe objekti tjetër ushtarak, sado i vogël qoftë ky.

Disiplina në ushtri duhet të jetë e vetëdijshme dhe e rreptë në kuptimin marksist-leninist.

I gjithë efektiv i duhet të edukohet nga ana e Partisë që t'i përdorë si duhet kritikën dhe autokritikën dhe Partia me punën e saj të vërë të gjithë kujdesin që kjo të sjellë përmirësimin e kuadrit, ose të ushtarit dhe jo denigrimin dhe uljen e moralit të tij, të forcojë unitetin e repartit dhe të ushtrisë, të kalitë kuadrot dhe ushtrinë.

Forcimi i unitetit është fitorja më e madhe dhe duket që në këtë drejtim Partia zhvillon një punë shumë të mirë në ushtri. Dobësimi i unitetit të ndonjë reparti, është një gjë e keqe që vërteton se atje organizata e Partisë punon dobët.

Në ushtri njerëzit edukohen me një moral të lartë, për të shkuar, kur ta lypë nevoja e atdheut, në luftë, ku kërkohet që uniteti, disiplina, besimi dhe dashuria komuniste për njëri-tjetrin të jenë në kulm.

Partia dhe komandat kanë një eksperiencë të madhe dhe të vlefshme në ndërtimin e formave të edukimit ushtarako-teknik dhe politik-ideologjik. Por kjo nuk përjashton që në to të ketë edhe një sërë të metash dhe një barrë formash, të cilave u ka kaluar ko-

ha, se e kanë bërë efektin e tyre dhe tani kërkojnë freski. Ky ajër i freskët duhet të kalojë në to. Pra, duhet të ndërmerret një punë e mirë, të përmirësohen format e edukimit në dinamizmin e zhvillimit të përgjithshëm të kuadrove dhe në lidhje me rrethanat, me armët e reja dhe me metodat e luftës që përdor armiku, pse edhe ai i përpunon ato në dinamizmin e tyre.

Programi i punës në ushtri në shumicën më të madhe të kohës, duhet të bëhet jashtë, në hapësirë. Puna e gjallë duhet të bëhet në terren, në luftë me vështirësitë e kohës.

Më shumë se kudo, në ushtri duhet luftuar ndjenja e rehatisë, e fjetjes në punë. Oficer i mirë është ai që, duke qenë kuadër politik i mirë, njeh si duhet artin ushtarak, të cilin ua mëson ushtarëve në terren të hapët dhe në çfarëdo kohe, të mirë ose të keqe. Oficer i mirë është ai që nuk e njeh lodhjen fizike dhe që edukon edhe ushtarët në këtë drejtim.

Me kuadrot e rinj që mbarojnë shkollat ushtarake, ose që stërviten për oficerë rezervë, Partia duhet të tregojë kujdesin më të madh që ta kuptojnë mirë detyrën, që të kuptojnë se ushtria jonë pa zhvilluar aftësitë fizike bashkë me ato mendore, nuk mund të jetë një ushtri e fortë popullore.

Ushtri popullore pa sakrifica të panumërta nuk mund të ketë. Oficerët e rinj duhet t'i përvishen punës me zell të madh nëpër reparte, në të gjitha drejtimet, kurse Partia dhe komandat në reparte, në shkolla dhe në akademi t'u kalitin oficerëve vetitë e mira, sepse në ushtri duhet të ketë vazhdimësi revolucionare.

Oficerë të plogësht, të fjetur, që të mos kenë preokupacion të parë ushtrinë, jetën e saj, kalitjen dhe edukimin e saj, nuk duhet të ekzistojnë në Ushtrinë tonë Popullore, ashtu sikundër nuk duhet të ketë anëtarë partie të fjetur pa asnjë horizont, të plogësht, pa aktivitet revolucionar, njerëz që heqin këmbët zvarrë, duke u fshehur prapa tesarës së Partisë.

Sigurisht kuadrot tanë në ushtri, qofshin këta komisarët politikë, qofshin komandantët, kanë një eksperiencë të mirë në hartimin e konspekteve, në përgatitjen e tyre, në dhënien dhe në zhvillimin e lëndës ose të leksionit. Por do të ishte një fitim i madh për ta që të përfitonin nga eksperiencia e madhe e lektorëve të Partisë, e mësuesve dhe e pedagogëve të sektorit të shkollave civile dhe të universitetit. Shkëmbimi i eksperiencës midis tyre do të ishte një pasuri e madhe e fituar si për kuadrot ushtarakë, ashtu dhe për ata të sektorit civil.

I gjithë ky kompleks detyrash, nga të cilat unë përmenda këtu vetëm një pjesë të vogël të tyre, ka për qëllim të madh që ushtria jonë të jetë me të vërtetë e denjë për popullin tonë të mrekullueshëm, për Partinë tonë heroike.

Së shpejti ju do të vishni uniformën e re. Unë nuk do të flas shumë për këtë, sepse vendimi është i qartë për të gjithë, por vetëm dëshiroj t'u vë në dukje ushtarëve tanë, se vëllezërit e tyre oficerë, që nga më të ulëtit e deri tek oficerët madhorë, heqjen e gradave dhe të trajtimeve që rridhnin prej tyre, e kanë pritur me një kuptim të thellë partie, me entuziazëm dhe me frymë të lartë patriotike.

Kuadrot e kuptuan drejt këtë çështje, shokë ushtarë, pse ata janë bij të denjë të Partisë dhe të popullit, sepse ata janë edukuar drejt nga Partia, se vlera e madhe e tyre, besnikëria dhe puna e tyre nuk varen as nga forma as nga uniforma. Ata kanë jetuar gju më gju me ju, ata do të jenë me ju më të bashkuar, kurdoherë afër jush, jo formalisht, po me shpirt e me zemër, si në ditët e mira, ashtu edhe në kohë rreziku. Ju, shokë ushtarë, i keni dashur shumë dhe i keni respektuar oficerët tuaj, tani do t'i doni dhe do t'i respektoni edhe më shumë, pse ata ju kanë dashur shumë dhe do t'ju duan gjithashtu akoma më shumë.

Përpara, ju shokë ushtarë, pak si me zor mund të këshillonit një superiorin tuaj. Por tani sa gjëra të mrekullueshme më kanë raportuar, sa ndodhi të bukura po zhvillohen në ushtrinë tonë, në mes kuadrove dhe ushtarëve, ç'frymë e drejtë marksiste-leniniste, respekti, ndihme reciproke po vendosen.

Ç'kuptim të lartë marrin këto reforma kur sheh se në ushtrinë tonë aktualisht nuk gjen ushtar ose oficer në arrest. A nuk është për t'u mburrur, kur shikon oficerin të tërheqë tok me ushtarët e vet topin, të pastrojë mitralozin, apo të punojë me bel ose me kazëm tok me ushtarin?

Këto, shokë, janë rezultatet e mëdha të vijës së drejtë të Partisë, në të gjithë vendin, po veçanërisht në ushtri. Kjo bën që gjendja moralo-politike e ushtrisë dhe ngritja e saj ushtarake të jenë të shkëlqyeshme. Unë ju falënderoj shokë të ushtrisë për punën tuaj të madhe, për besnikërinë tuaj, për partishmërinë tuaj të lartë.

Ushtria jonë nuk rron e shkëputur dhe larg popullit, ajo është pjesë e pandarë e popullit, rron tok me të, me hallet dhe me gëzimet e tij, me sukseset dhe me disfatat e tij, me fitoret dhe me të metat e tij.

Lidhjet e ushtrisë sonë me popullin janë të gjalla nëpërmjet ushtarëve, nëpërmjet ndihmës konkrete që ushtria i jep sektorit ekonomik, nëpërmjet koordinimit të punës midis komiteteve të Partisë të ushtrisë dhe të terrenit, nëpërmjet gjithë vijës politike, ekonomike dhe kulturoro-arsimore të Partisë dhe të Qeverisë, nëpërmjet të gjitha rezultateve të arritura nga populli ynë në të gjithë sektorët e jetës socialiste të vendit tonë.

Ne kemi suksese në të gjitha drejtimet, për arsye se vija e Partisë është e drejtë, marksiste-leniniste. Ekonomia e vendit tonë ecën kurdoherë përpara sipas parashikimeve. Industria, bujqësia, arsimi, kultura zhvillohen dhe forcohen me ritme të shpejta. Rezultatet kudo janë të dukshme. Këto e kanë forcuar Republikën tonë, e kanë përmirësuar vazhdimisht e pa ndërprerje nivelin ekonomik të masave të popullit. Por duhet të kemi parasysh se këto fitore janë arritur me luftë e me përpjekje të mëdha nga punonjësit e vendit tonë, në kushte të bllokadës imperialisto-revizioniste. Prandaj ato tregojnë vitalitetin e madh të popullit dhe të Partisë, zjarrin dhe hovin e tyre revolucionar që thyejnë e shkatërrojnë çdo pengesë që gjejnë përpara. Pikërisht këtë zjarr dhe këtë hov revolucionar, ne jo vetëm duhet t'i mbajmë të ndezur vazhdimisht, por t'i ushqejmë për t'i bërë akoma më të mëdhenj.

Këtë qëllim kanë pasur të gjitha masat, të gjitha drektivat historike që mori Partia kohët e fundit dhe që ngritën peshë popullin në një entuziazëm të papërshkruar, me një përtëritje forcash të reja, kolosale, që bënë dhe do të bëjnë mrekulli. Ne shohim ç'iniciativa të mëdha po marrin Partia dhe populli, ç'aksione të guximshme dhe të frytshme, sa energji të mëdha që deri dje nuk shfrytëzoheshin si duhej, janë vënë në lëvizje dhe ndërtojnë, shpikin, krijojnë, realizojnë. Ja perspektiva, ja siguria, ja përparimi ynë! Të gjitha këto janë fryt i vijës së drejtë të Partisë.

Po të flasim ushtarakisht, dhe duhet të flasim pse e lypin momentet, ushtria është e fortë kur ka prapavija të forta. Ushtria pa prapavija të forta, dhe një nga faktorët e prapavijave është ekonomia, nuk mund të jetë e fortë.

Natyrisht, ju dini në përgjithësi, por jo në detaje, se Partia dhe Qeveria i kanë vënë një rëndësi të veçantë krijimit të rezervave. Këto janë të lidhura ngushtë dhe në varësi të zhvillimit të ekonomisë dhe të bujqësisë në radhë të parë; janë të lidhura ngushtë gjithashtu me ndjenjën e ekonomizimeve, të kursimeve, të mosharxhimit pa vend, qoftë edhe të vlerës më të vogël materiale dhe monetare. Pra, rritja sa më shumë e prodhimit dhe kursimet gjithashtu sa më të shumta janë për vendin tonë, të rrethuar gjeografikisht nga armiq, kurdoherë në rendin e ditës.

Rezervat po i shtojmë çdo vit, pa i rënduar masat e popullit në nivelin e tyre të jetesës. Këtu qëndron drejtësia e vijës së Partisë sonë dhe kuptimi i

lartë patriotik nga populli i momenteve që po kalojmë.

Por, tok me këto realizime dhe me këto suksese, sikurse e dini dhe siç e ka bërë të qartë Komiteti Qendror në dokumentet e tij historike, ne kemi pasur edhe të meta, të cilat duhej të spastroheshin me urgjencë, rrënjësisht dhe absolutisht.

Ju e dini se Partia iu përvesh luftës kundër burokratizmit dhe çdo shfaqjeje të tij në jetë, duke e nisur këtë luftë, në radhë të parë, nga burimi i tyre ideologjik. Në një kohë rekord ne spastruam rrënjësisht aparatet nga këto shfaqje të shëmtuara. Ky operacion u bë me sukses, sepse u mobilizua e tërë Partia dhe të gjitha masat e popullit, duke kuptuar politikisht dhe ideologjikisht drejt burimin e këtyre të metave e gabimeve dhe rrezikshmërinë e tyre.

Por, shokë, lufta kundër mbeturinave mikroborgeze në ndërgjegjen e njerëzve është e gjatë dhe e vështirë. Kjo luftë duhet të bëhet përditë, orë e çast nga Partia, nga vetë njerëzit. Që të kuptohet rrezikshmëria e mbeturinave në ndërgjegjen e njerëzve, ata duhet të ngrihen ideologjikisht, të mësojnë marksizëm-leninizmin, të mbruhen me parimet e Partisë, pse vetëm kështu do të mund të diktohet mikrobi, sepse vetëm këto parime janë i vetmi mjet që i bën njerëzit të aftë për t'i luftuar këto mbeturina. Prandaj Partia tërë jetën e saj ka luftuar dhe do të luftojë të kalitë, të ngrejë e të edukojë anëtarët e saj politikisht dhe ideologjikisht. Kjo është një detyrë primordiale, e para mbi të parat për ne komunistët. Ne komunistët, në

radhë të parë, duhet të jemi shumë të ndërgjegjshëm për këtë detyrë partie, të thyejmë pengesat, të vëmë në provë vullnetin tonë për të përvetësuar teorinë marksiste-leniniste dhe të dimë ta përdorim atë për kalitjen e karakterit tonë edhe të të tjerëve, ta përdorim në punën konkrete revolucionare.

Partia jonë, me një vijë të pastër marksiste-leniniste, është angazhuar në një luftë të rreptë dhe pa kompromis kundër revizionizmit modern, në dy drejtime: në planin ndërkombëtar dhe në planin e brendshëm. Kjo luftë vazhdon dhe duhet të vazhdojë njëkohësisht në të dy këto drejtime, sepse vetëm kështu ruhet pastërtia e marksizëm-leninizmit, i shkulet çdo rrënjë e i pritët çdo burim revizionizmit modern në vendin tonë, ndërtohet me sukses socializmi dhe komunizmi, vetëm kështu kontribuohet në shkatërrimin e revizionizmit si ideologji në shkallë ndërkombëtare.

Korrenti i revizionizmit modern në lëvizjen komuniste botërore është i fortë. Atë as duhet ta mbivlerësojmë, por as duhet ta nënvleftësojmë. Marrja e fuqisë në dorë nga hrushovianët në Bashkimin Sovjetik, i shkaktoi dhe vazhdon t'i shkaktojë dëme revolucionit botëror. Kjo situatë është duke u kapërcyer dhe patjetër do të kapërcehet totalisht nga të gjitha ato forca revolucionare në botë që luftojnë nën flamurin e marksizëm-leninizmit. Revizionizmi modern, me atë hrushovian dhe titist në krye, ka pësuar dhe po pëson disfata të mëdha. Ai po demaskohet keqas, qoftë si pseudoteori marksiste, qoftë në politikë, në ekonomi, në artin ushtarak, në lëmin kulturor e kudo.



Revizionizmi modern, megjithëse mori fuqinë edhe në Bashkimin Sovjetik, në djepin e parë të revolucionit proletar, në atdheun e bolshevikëve, të Leninit dhe të Stalinit, nuk mundi dhe kurrë nuk do të mund të vendosë hegjemoninë e vet në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe të zëvendësojë teorinë e marksizëm-leninizmit. Përkundrazi ai pësoi e po pëson disfata të mëdha, u përça dhe po përçahet në korrente të ndryshme borgjeze, reaksionare, kombëtare, gjendet në darrën e kontradiktave, të cilat thellohen çdo ditë e më shumë dhe që, pa asnjë dyshim, do të degjenerojnë në konflikte të hapëta. Këtu do ta çojnë revizionizmin natyra dhe qëllimet e tij.

Revizionizmi modern, ashtu si edhe ai i vjetri, është mishërimi i teorisë oportuniste në gjirin e klasës punëtore. Qëllimet e vërteta të revizionistëve maskohen me parulla, të cilat, pavarësisht nga variantet e diktuara nga rrethanat dhe koniunkturat, mbeten të njëjta: t'i shërbejnë pushtetit borgjez, kapitalist, në dëm të klasës punëtore dhe të revolucionit. Bazat ideologjike të revizionizmit modern, të zhveshura nga demagogjia, qëndrojnë po ato të ideologjisë së kapitalit, domethënë revizionizmi modern është një variant i ideologjisë borgjeze idealiste, e cila bazohet në ideologjinë e mbrojtjes së pronës private, të pajtimit të klasave, të zhdukjes së hegjemonisë së klasës punëtore, të mohimit të luftës së klasave dhe të revolucioneve. Revizionizmi është ideologjia e reformistëve, e reformave evolucioniste shoqërore dhe e kundërrevolucioneve shoqërore. Revizionizmi është pacifizmi borgjez, armik i vendosur i popullit që përpiqet të armatoset e të

ngrihet në revolucion kundër zgjedhës së kapitalit dhe për të vendosur diktaturën e proletariatit, për të ngritur shoqërinë socialiste.

Revizionizmi modern ka marrë fuqinë në shtet dhe në parti në Bashkimin Sovjetik, në Jugosllavi, në Poloni, në Çekosllovaki etj. Ai po shkatërron atje socializmin dhe po rivendos kapitalizmin, duke krijuar shtresën e borgjezisë së re, duke restauruar ideologjinë antimarksiste, duke adoptuar format kapitaliste të jetesës, të organizimit, të ekonomisë dhe të kulturës. Shtetet revizioniste janë futur në aleanca dhe në bashkëpunim ideologjik, politik, ushtarak dhe ekonomik me vendet imperialiste dhe në radhë të parë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në planin ndërkombëtar, revizionistët modernë, me tradhtarët hrushovianë në krye, në bashkëpunim dhe në aleancë të fortë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kanë për qëllim dominimin e botës nga të dyja këto fuqi imperialiste, pavarësisht nga kontradiktat që kanë dhe do të kenë në mes tyre, të cilat në të ardhmen do të shkojnë duke u shtuar. Si shtete kapitaliste, ato nuk mund t'u shpëtojnë kontradiktave antagonistike që do të rrezikojnë qenien e tyre. Për t'ia arritur qëllimit, ato koordinojnë veprimet në luftë kundër ideologjisë marksiste-leniniste, njëri nga pozita të hapëta agresive, tjetri nga pozita agresive të maskuara. Lufta e tyre në planin ideologjik zhvillohet paralelisht me aksione në praktikë. Që të dy luftojnë kundër popujve të botës që janë ngritur në revolucion, shtypin së bashku luftërat nacionalçlirimtare të popujve, konkurrojnë me njëri-tjetrin me anën e kredive sklla-

vëruese për të rikrijuar kolonitë e tyre moderne të shfrytëzimit dhe të ekspansionit, shtojnë armatimet moderne duke kërkuar të çarmatosen të tjerët, dhe sidomos vendet socialiste, për t'i pasur kështu popujt e botës në mëshirën e tyre.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe revizionistët modernë forcojnë, krijojnë rishtas ose mballosin traktatet e tyre ushtarako-politike, nëpërmjet të cilave përpigën të forcojnë dominimin mbi të tjerët, pa harruar rreziqet që kërcënojnë njërin nga tjetri.

Ne i shohim revizionistët sovjetikë të bëjnë përpjekje që Traktatin e Varshavës ta dominojnë vetë, por ata njëkohësisht po ecin drejt lidhjeve të traktateve të shumanshme me shtete imperialiste, për qëllimet që thamë më lart.

Në këtë kuadër, shkurtimisht të përmbledhur, zhvillohet lufta e marksistë-leninistëve të vërtetë, e partive marksiste-leniniste, e grupeve marksiste-leniniste revolucionare në botë, e shteteve socialiste, e Shqipërisë në radhë të parë, dhe e të gjithë popujve përparimtarë të botës, kundër armiqtë tanë të egër, imperializmit botëror, me atë amerikan në krye, dhe revizionistëve modernë, me ata sovjetikë në krye.

Kjo nuk është një luftë as e lehtë dhe as që mund të marrë fund në një kohë të shkurtër, por kampi i armikut është dobësuar dhe po dobësohet çdo ditë, jo vetvetiu, por nga lufta e pamëshirshme që i bëjnë partitë heroike marksiste-leniniste, vendet socialiste, popujt që janë ngritur në revolucion, që luftojnë dhe që do të luftojnë akoma më shumë e më mirë në të ar-

dhmen, nga lufta e revolucionarëve marksistë-leninistë kudo në botë dhe veçanërisht në strofkat e vetë revizionistëve modernë.

Shenjat e këtij dobësimi janë evidente, disfatat e tyre nuk mund të maskohen dhe nuk mund të mos thellohen. Kampi imperialisto-revizionist kalon një krizë të rëndë, të pandreqshme.

Detyra jonë është ta vazhdojmë luftën akoma më me tërbim, më me guxim kundër imperializmit dhe revizionizmit modern dhe t'u shkaktojmë atyre disfata të vazhdueshme e të pandreqshme, të cilat do të sjellin pa asnjë dyshim shkatërrimin e tyre të plotë.

Jemi ne, tok me popujt revolucionarë të botës, që e kemi rrethuar kalanë e armiqve dhe që po e godasim atë për vdekje, dita-ditës dhe nuk janë ata që na kanë rrethuar ne.

Shihni! Në çdo vend të botës ku agresorët amerikanë dhe kukullat e tyre kanë hyrë në luftë kundër popujve po pësojnë disfata vdekjeprurëse. Më kot revizionistët hrushovianë po i ndihmojnë agresorët amerikanë të shpëtojnë nga disfatat dhe nga vdekja. Vietnami është bërë varri i amerikanëve. Luftohet në Laos, në Tajlandë, në Malajzi, në Kongo, në Amerikën Latine. Bazat amerikane dhe trupat e tyre të shpërndarë në të gjithë botën, me qëllim që t'i rrethonin popujt, janë vetë të rrethuar nga këta. Më kot hrushovianët, titistët, revizionistët polakë, çekoslovakë e të tjerë po bëjnë kongrese, po mbajnë njërën pas tjetrës mbledhje tradhtarësh për të gënjer dhe për të ngadalësuar katastrofën dhe greminën ku po rrokullisen. Ata asgjë nuk mund t'i shpëtojë nga vdekja politike, ideologjike, ushtarake, eko-

nomike. Revolucioni do t'i përlajë, marksizëm-leninizmi do t'i futë në varr.

Kohët e fundit zhvilloi punimet Kongresi i 23-të i PK të BS, i cili tregoi dobësinë e madhe të revizionistëve modernë. Ata nuk guxuan të ngrinin në këtë kongres asnjë nga problemet themelore të jetës sovjetike dhe të asaj ndërkombëtare; as çështjen e Stalinit as të Hrushovit as problemet e tyre ekonomike as divergjencat e mëdha që ekzistojnë në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Pikërisht kjo tregon dobësinë e tyre, kjo tregon se radhët e revizionistëve po gërryhen përbrenda, se uniteti i tyre nuk ekziston, se presioni kundër tyre është i madh si nga masat e popullit, ashtu edhe nga ana e forcave përparimtare e revolucionare jashtë. Revizionistët ndodhen tani në mes dy rrugësh për shkak të këtij presioni të madh që u bëhet.

Duket se në udhëheqje të PK të BS ka pasur kontradikta të mëdha përpara hapjes së kongresit, kryesorja e të cilave ka qenë për çështjen e Stalinit, nëse do të vazhdojë të trajtohet kjo çështje në rrugën e poshtër të kongreseve 20 dhe 22. Këto kontradikta reflektojnë kundërshtimet dhe presionet që bëjnë nga jashtë masat e partisë dhe sidomos të ushtrisë, ku ka dy korrente, njëri nga të cilët është që të rehabilitohet Stalini, mbasi taktikën dhe strategjinë e tij në luftë e quan të drejtë, sepse Stalini në luftë vinte në radhë të parë faktorin «njeri», kurse Hrushovi faktorin «armë». Po a mund të bënin revizionistët orvatje serioze për të rehabilituar Stalinin? Natyrisht jo! Prandaj ata

dolën përpara kongresit me një zgjidhje jashtëzakonisht qesharake, që tani e shikojnë edhe ata vetë.

Kontradikta duhet të ketë pasur edhe për çështjen e Hrushovit, ish-sekretar i parë i partisë së tyre, të cilin e hoqën, nëse do të trajtohej në kongres kjo çështje apo jo. Këtu kanë ndërhyrë edhe revizionistët e partive të tjera, të cilët janë shumë të tronditur për këtë problem. Gomulka dhe udhëheqësit e tjerë në partitë revizioniste nuk donin që as çështja e Stalinit as ajo e Hrushovit të trajtoheshin në Kongresin e 23-të. Prandaj udhëheqësit revizionistë sovjetikë dolën përpara kongresit me variantin që çështja e Hrushovit të mos zihej në gojë, gjë që vërteton edhe një herë tjetër se ata nuk janë njerëz seriozë, parimorë, po revizionistë me damkë.

Revizionistët modernë fshehën dhe nuk trajtuan në kongres çështjen e kontradiktave që ekzistojnë në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ata nuk folën as kundër Partisë Komuniste të Kinës, as kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, kurse, siç dihet, kontradiktat e Partisë sonë me ta kanë arritur në thikë e në pikë. Po ky qëndrim i tyre nuk gënjen dot njeri. E gjithë bota e di se sot lëvizja komuniste ndërkombëtare është e përçarë për shkak të revizionistëve dhe se marksistë-leninistët janë në luftë të ashpër me ta. Por këta vendosën të heshtin në kongres nën maskën e unitetit, gjë që s'e beson njeri dhe që tregon gjithashtu shenjë të dobësisë së tyre.

Këto vërtetojnë se pozitat e revizionistëve qoftë në Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare janë jashtëzakonisht të dobëta dhe

se këto pozita do të vijnë vazhdimisht duke u dobësuar. Prandaj le të bëjnë sa të duan kongrese revisionistët, çdo gjë shkon në disfavorin e tyre.

Partia jonë është në ballë të kësaj lufte gjigante, ajo është sypatrembur dhe e pjekur, pse është e kalitur në luftëra dhe udhëhiqet nga ideologjia marksiste-leniniste. Ajo nderohet dhe respektohet nga lëvizja komuniste ndërkombëtare.

Shokë, populli ynë heroik ka një parti të fortë, marksiste-leniniste, një ushtri të pathyeshme popullore, një ekonomi të fortë socialiste. Prandaj duhet të shkrijmë në punë dhe në luftë të gjitha energjitë tona që t'i forcojmë këto çdo ditë e më shumë, me qëllim që populli ynë të rrojë i pavdekshëm në shekuj, i lirë dhe i lumtur në socializëm dhe në komunizëm.

Rroftë Partia!

Rroftë populli ynë!

Rroftë Ushtria jonë Popullore!

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha «Në ndihmë të Ushtrisë Popullore, vëll. III», f. 20-50.*

*Tiranë, 1975*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## TA BEJMË TË GJITHË ATDHEUN MBUROJË TË PAKAPËRCYESHME PËR ARMIQTË

*Fjala në drekën e shtruar në një repart ushtarak  
të Shkodrës*

28 prill 1966

Është hera e parë që vij në këtë repart. Me këtë rast dëshiroj të falënderoj komandën dhe organizatën e Partisë, si dhe të gjithë ushtarët dhe oficerët e repartit tuaj për organizimin e këtij takimi të përzemërt.

Sa herë që kam ardhur në Shkodër, e kam parë këtë mal shekullor që, natyrisht, të gjithë e konsiderojmë si një kështjellë për mbrojtjen e vendit tonë, të cilën dhe ju, ushtarë e oficerë të Republikës Popullore të Shqipërisë, e keni kthyer në një mburojë të pakapshme nga armiku. Duhet të vish këtu që të shikosh gjithë atë punë të madhe që keni bërë, për ta kthyer këtë vend në një mburojë të tillë të pakapërcyeshme për armiqtë. Them duhet të vish këtu, se midis jush e sheh më nga afër zotësinë mendore dhe vullnetin e madh në punë të ushtarëve dhe të oficerëve tanë, sheh më nga afër zhvillimin teknik të kombinuar me atë hov të



madh, të zjarrtë e revolucionar që vlon në shpirtin tuaj, me atë patriotizëm dhe dashuri të pafund që keni ju për atdheun e për Partinë.

Kështu si në këtë vend, të dashur shokë ushtarë dhe oficerë, është punuar dhe po punohet në të katër anët e atdheut. Kudo në Shqipëri janë bërë të tilla punime, të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen tonë. Këto bëhen që t'i kemi për kohë rreziku, në mënyrë që armiku të mos na gjejë kurrë në befasi dhe, po të guxojë të na prekë, ta shkatërrojmë, të gjejë vdekjen kudo në vendin tonë.

Rëndësi të madhe kanë fortifikatat që keni ndërtuar, të pajisura edhe me armë nga më modernet, po rëndësia më e madhe qëndron te ju, shokë ushtarë dhe oficerë, qëndron në kuptimin e lartë politik, në ndërgjegjen dhe në patriotizmin tuaj të lartë socialist. Është pikërisht për këto cilësi tuajat që në një kohë kaq të shkurtër ju keni bërë këtu në majë të malit gjithë ato gjëra të mrekullueshme që pamë. Unë kam hyrë edhe gjetiu në disa objekte të tjera të përfunduara dhe kam parë se ato janë ndërtuar gjithashtu me një perfeksion të madh e të lavdërueshëm nga ushtria jonë dhe janë pajisur me teknike moderne. Kjo tregon se për të bërë punime të tilla, për t'i kryer ato si duhet e brenda një kohe kaq të shkurtër, duhet të kesh një frymëzim të madh.

E thashë edhe në konferencën e Partisë të repartit tuaj që oficerët e ushtrisë sonë pas 1 Majit nuk do të kenë më grada. Po nga heqja e gradave nuk do të bjerë vlera e oficerëve tanë. Vlera dhe rëndësia e tyre nuk qëndrojnë te gradat, por te mendja që kanë, te ndjenja

fisnike e zemrës së tyre të çeliktë, te patriotizmi i zjarrtë, te dituria dhe te mençuria e tyre. Pra oficerët që ju kanë komanduar gjer tani ju, shokë ushtarë, do të jenë po ata që ishin edhe më parë, vëllezërit e shokët tuaj, të cilët kanë pasur dhe kanë një dashuri të madhe për ju, sepse ushtarët janë baza e ushtrisë sonë, janë bijtë e popullit tonë. Nuk mund të ketë oficerë pa ushtarë. Por që ushtari të kryejë detyrën si duhet, si na mësojnë Partia dhe populli, është e domosdoshme që si ai, ashtu edhe oficeri të duhen me njëri-tjetrin si vëllezër, si shokë. Kur ushtari ta dojë oficerin me zemër të hapët, kur ky të ushqejë për ushtarin një dashuri të madhe, atëherë është e sigurt çështja e zbatimit të vendimeve. Ju, ushtarët e Republikës, që ju edukojnë me kaq kujdes Partia dhe organizata e rinisë, nuk e kryeni këtë shërbim fisnik për qejfin e njërit ose të tjetrit, por se e ndieni që kjo punë është një detyrë e madhe patriotike e çdo qytetari për të mbrojtur atdheun e vet socialist, këtë liri që gëzojmë sot, popullin dhe fitoret e tij, malet dhe fushat e vendit tonë, shtëpitë, kopshtet, uzinat, fabrikat, minierat që i kemi ndërtuar me kaq djersë e mundime, për të cilat luftuam e derdhëm kaq gjak jo vetëm shekuj me radhë, por sidomos edhe gjatë Luftës sonë të madhe Nacionalçlirimtare.

Prandaj, kur ushtarët punojnë krahas me oficerët, e kuptojnë më mirë se ç'është ushtria jonë dhe kujt i shërbejnë ata si ushtarë. Ju, shokë ushtarë, kur vini këtu në reparte, gjeni oficerët, vëllezërit tuaj që kanë dalë edhe ata si ju nga populli. Ata bënë luftën, ata kanë eksperiencë të madhe dhe dituri, sepse Partia i ka mësuar dhe me punën e tyre të palodhur kanë përga-

titur mijëra ushtarë. Shokët oficerë dinë të gjykojnë dhe të kalojnë bashkë me ju brengat dhe hallet që mund të keni, vështirësitë në punë etj., këta dinë si të punojnë me njërin e si të punojnë me tjetrin, pse një-rëzit nuk janë njëlloj. Kështu edhe nga ushtarët njëri mund të jetë më i shpejtë, tjetri më i ngadalshëm, njëri është i disiplinuar, po nganjëherë e shkel rregullin. Në këtë rast, oficeri ynë, që është njeri me eksperiencë të madhe, ashtu si një mjek i mirë që di të gjejë kurdoherë ilaçin për çdo sëmundje, sado e vogël që të jetë ajo, e këshillon ushtarin e padisiplinuar dhe e bind të ecë në rrugë të drejtë. Pra, kur vini ju, shokë ushtarë, të kryeni shërbimin ushtarak, shihni tek oficerët vëllezërit tuaj më të mëdhenj, më të mësuar, më me eksperiencë që ju trajtojnë sikur të ishit bijtë ose vëllezërit e tyre. Ju, kur jeni në shtëpi, dashurinë, këshillat dhe respektin për prindërit dhe për vëllezërit tuaj më të mëdhenj i keni kurdoherë parasysh. Këto virtyte të rinisë sonë janë ngritur në një shkallë akoma më të lartë nga Partia, prandaj ne kemi sot një rini të mrekullueshme. Është për këtë arsye që ju edhe kur vini në ushtri, në çdo repart qoftë, gjeni ngrohtësi si në familje.

Me heqjen e gradave, pra, asgjë nuk ndryshon në ushtri, bile ju do t'i doni oficerët edhe më shumë, pse ushtria jonë në këto kushte do të ketë tamam karakterin e thjeshtë të një ushtrie popullore revolucionare. Edhe më parë shokët oficerë juve nuk ju janë imponuar, përkundrazi, për çdo gjë ju kanë porositur dhe ju kanë këshilluar në rrugën e bindjes. Prandaj tani e tutje oficerët do t'i përmirësojnë edhe më shumë dhënien e

urdhrave dhe të direktivave. Ata do të kujdesen edhe më tepër si ta perfeksionojnë këtë punë që ju t'i përvetësoni dhe t'i zbatoni më shpejt ato. Tek oficeri, si kurdoherë, ju do të keni përpara një shok dhe një vëlla, por ju, si njerëz të pjekur që jeni, e dini ç'rol të madh kanë komandanti dhe komisari i repartit, kështu që, vetvetiu do të ushqeni një respekt të madh për ata dhe çdo urdhër apo porosi të tyre ju do ta pritni me shumë dëshirë e do ta zbatoni me një patriotizëm she-mbullor.

Lidhur me heqjen e gradave gjer sot asnjë fjalë nuk është dëgjuar nga oficerët tanë, se si do të bëjnë pa to. Përkundrazi, kur Partia hodhi parullën për heqjen e tyre, oficerët pritnin me padurim kur do të vijë koha të hiqen. Por zbatimin e kësaj mase ne e lidhëm me festën e madhe të punëtorëve, ditën e 1 Majit, të cilën ju uroj ta kaloni gëzuar.

Prandaj, ju drejtohem juve, shokë ushtarë (se me oficerët fola), t'i doni me gjithë shpirt oficerët tuaj, t'i respektoni dhe t'i dëgjoni me vëmendje këshillat e tyre, t'i zbatoni me përpikëri urdhrat që ju japin, se janë në të mirën tuaj dhe të atdheut. Ndonjëherë ndonjë shoku juaj oficer edhe mund ta ngrejë zërin, por ju kurrë mos ia merrni për keq ose shtrembër. Edhe babai ka pasur rast që e ka ngritur zërin në familje, po ai kurdoherë ju do. Kështu është edhe me oficerët. Ata, kur shohin se në repart nuk shkon mirë ndonjë punë, mund t'ju flasin, t'ju kritikojnë, por edhe kur veprojnë kështu, kanë qëllim të mirë, se janë njerëz të Partisë. Oficeri nuk ka përse t'i bërtasë ushtarit, po kur sheh se një herë, dy herë

puna nuk ecën, atëherë ai thotë me vete: «Po sikur t'ia ngre një herë zërin këtij njeriu, se po shoh që kështu si po i flas ky nuk po e kupton shpejt këshillën ose urdhrin». Oficeri, pra, çdo veprim e bën me qëllim të mirë, në radhë të parë në të mirën e punës. Prandaj sjelljet, qëndrimet e vëllezërve tuaj oficerë i konsideroni kurdoherë si një diçka të mirë për ju dhe për çështjen e madhe të ndërtimit të socializmit.

Ju ushtarët detyrën që kryeni në ushtri, duhet ta konsideroni si më kryesoren, sepse kjo ushtri, e udhëhequr nga Partia, çliroi popullin, i cili sot punon e jeton i lirë dhe i lumtur në atdheun socialist. Ushtrinë ne e kemi të fortë, të edukuar, të armatosur me të gjitha mjetet që i duhen për t'u mbrojtur. Duke pasur një ushtri të tillë, ne po ndërtojmë me sukses socializmin, po zhvillojmë industrinë dhe bujqësinë tonë, po përmirësojmë jetën e popullit. Po të mos kishim ushtrinë të fortë, nuk do të ishte kështu siç është sot vendi ynë, sepse brenda këtyre 22 vjetëve sa komplete e plane janë organizuar nga armiqtë, nga imperialistët amerikanë, revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë, fashistët italianë e të tjerë për të përmbysur pushtetin tonë popullor. Shokët oficerë ju kanë treguar se si përpara disa vjetësh, kur ju ishit pionierë, armiqtë e jash-tëm na kanë futur brenda truallit të atdheut tonë me qindra diversantë e spiunë nga deti, nga ajri dhe nga toka. Ata, me tradhtarët që gjenin brenda vendit, organizonin komplete kundër nesh për të rrëzuar pushtetin tonë popullor, për të shkatërruar Partinë tonë, për t'i rrëmbyer lirinë atdheut dhe për të sjellë përsëri në fuqi bejlerët e Zëmblakut, Muharrem Bajraktari

rin e gjithë tradhtarët e tjerë të popullit. Po asgjë nuk u ndezi. Ata dështuan se, mbi të gjitha, Partia ishte në këmbë, e fortë, e mençur, vigjilente, se ajo diti të organizonte çdo gjë dhe, në radhë të parë, një ushtri të fortë, të çeliktë. Për të pasur një ushtri të tillë, Partia që në fillim dhe mbi çdo gjë edukoi e përgatiti kuadrot ushtarakë. Pothuaj të gjithë kuadrot që kemi sot kanë bërë shkollën e luftës, ku kanë treguar heroizëm kundër pushtuesve italianë e gjermanë, ballistëve e tradhtarëve në kushte shumë të vështira, me bukë e pa bukë, me fishekë e pa fishekë dhe gjatë gjithë këtyre vështirësive, ata fituan një eksperiencë kolosale. Po këtyre kuadrove të kalitur dhe të pajisur me eksperiencën e luftës, Partia pas Çlirimit u dha edhe shkollë, i bëri kuadro revolucionarë. Nga duart e tyre, në shkollën e madhe të ushtrisë, kanë kaluar dhe do të kalojnë me qindra e me mijëra djem të rinj të popullit, të fshatit dhe të qytetit. Edhe ju që mësoni dhe përgatiteni në mënyrë të posaçme për mbrojtjen e atdheut këtu në këtë repart për dy-tre vjet me radhë, nesër do të ktheheni përsëri në fshatra e në qytete pranë familjeve tuaja, ku do të bëheni mjeshtër të profesioneve që keni, po ushtrinë kurrë nuk do ta harroni. E tillë është bërë ushtria jonë. Ju tani ndoshta ju merr malli për nënën dhe për babanë dhe kjo është diçka e natyrshme, e drejtë, por, po ju them se, kur të ktheheni pranë familjeve tuaja, do ta kujtoni kurdoherë me mall edhe këtë vend shkëmb e gur, ju asnjëherë nuk do të harroni shoqërinë dhe jetën që po bëni këtu dhe kjo ka shumë rëndësi për ushtrinë tonë. Ne në ushtrinë tonë nuk i përgatitim ushtarët si automatë që të ve-

projnë pa ditur ç'bëjnë, por punojmë që t'i edukojmë ata ideologjikisht, politikisht dhe ushtarakisht për të ruajtur fitoret e atdheut. Ushtria, pra, është e domosdoshme, është jetike për popullin tonë.

Armët ju i keni të mira, mësoni t'i përdorni si duhet, i ruani dhe i mbani pastër. Kush i mban pastër, do të thotë se ai e ka kuptuar mirë detyrën që po kryen këtu si ushtar i popullit dhe kjo ka rëndësi të madhe për të pasur një ushtri të fortë. Kur Japonia përgatitej të fillonte luftën me carin e Rusisë më 1904, disa oficerë japonezë bënë një vizitë në anijet ruse, ku, përveç të tjerave, panë se topat e anijeve ruse kishin zënë pluhur. Atëherë oficerët japonezë propozuan t'u binin rusëve se ata nuk ishin asgjë, se oficerët caristë kujdeseshin vetëm për të kërcyer danc. Dhe propozimi u mor parasysh, japonezët u ranë dhe e shpartalluan plotësisht flotën ruse. Ja, pra, ç'bën pakujdesia dhe mungesa e përgatitjes dhe e edukimit të ushtrisë.

Shikoni çfarë gjërash me vlerë po bëjnë njerëzit e ushtrisë sonë. Këto që pamë sot këtu dhe që ju po i mësoni dhe po i përvetësoni, janë me të vërtetë të mrekullueshme. Ju ushtarë të popullit u vini kujdes këtyre mësimëve që merrni në ushtri, mësoni me zell që të dini t'i ndërtoni vetë të gjitha këto objekte të domosdoshme për mbrojtjen e atdheut dhe për shkatërrimin e armiqve dhe, kur të veni në fshat, si të keni kryer normat, ditë-punët, merrni qysqinë dhe këtë që po bëni këtu, bëjeni në çdo shpellë e në çdo shkëmb që keni rreth e rrotull tij. I nxitni për këtë punë të gjithë, të rinj e të moshuar. Kështu të bëhet në çdo fshat, pastaj le të afrohen po të duan armiqtë.

Në fshatrat tona nuk e njohin akoma gjithë këtë eksperiencë të madhe, por këtë do ta çoni ju atje, do t'u mësoni njerëzve këto gjëra që mësuat nga shokët oficerë. Ju që do të mbaroni ushtrinë, në rast të ndonjë rreziku jo vetëm do të mbushni radhët e saj, po shumë nga ju do të udhëhiqni edhe kompanitë që do të krijohen menjëherë në fshatra. Pse vallë, mos do të lejohet ne që të na vijë armiku dhe të na djegë fshatrat, të na kapë e të na përdhunojë motrat, gratë dhe nënat tona ose të na pushkatojë pleqtë nëpër hendeqe? Jo! Mbaroi ajo kohë! Çdo fshat në vendin tonë ne duhet ta bëjmë një kështjellë. Kështu, përpara se armiku të vejë në një fshat, ta grijmë dhe, po të drejtohet kundër tuneleve, atëherë ai me siguri do të shfaroset fare.

Shikoni, pra, sa gjëra të mira po mësoni ju këtu në ushtri për mbrojtjen e jetës së popullit tonë, prandaj ta doni shumë Ushtrinë tonë Popullore dhe ta keni për nder që bëni pjesë në radhët e saj. Kur ta keni kryer këtë shërbim, ju do të keni fituar një eksperiencë të madhe. Tani jeni burra, po shumë partizanë ishin 3-4 vjet më të rinj sesa jeni ju dhe megjithatë dolën në mal. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare kur dilte në mal qoftë edhe komandanti i njësitit, duke qenë njeri i rrjepur nga agallarët, ishte i rreckosur, pa bukë e pa këpucë, nënën dhe babanë i linte pa bukë, kurse tani ju nga kjo anë jeni të qetë, se babai dhe nëna e secilit, në fshat ose në qytet, kanë shtëpi të re, janë anëtarë të kooperativës bujqësore ose me punë në qytet, janë të gëzuar se po jetojnë gjithnjë e më mirë. Dua të them se për ushqim nuk keni qeder as ju, as babai dhe as



nëna që punojnë dhe rrojnë me punën e tyre dhe kur të ktheheni, ju do t'i gjeni ca më mirë akoma nga ç'i latë.

Në përgjithësi unë mbeta shumë i gëzuar nga sa pashë këtu dhe ju përgëzoj të gjithë ju, shokë oficerë dhe ushtarë të këtij reparti! Por në mënyrë të veçantë shokët komandantë dhe komisarë të batalionit, të brigadës dhe të baterisë, si dhe të gjithë ushtarët ju përshëndes dhe ju përgëzoj për sukseset që keni arritur dhe ju uroj me gjithë zemër, punë të mbarë, suksese të tjera të reja akoma më të mëdha në detyrën tuaj!

Kur të kthehem në Tiranë, do t'i raportoj Byrosë Politike për sa pashë këtu te ju, do të bëj edhe disa vërejtje kritike, të cilat janë kurdoherë të mira. Të meta ka edhe te ju, po në përgjithësi reparti juaj mendoj se është një nga repartet shembullore.

Edhe një herë përsëri ju uroj suksese në realizimin e plotë të detyrave që ju ka ngarkuar Partia!

Le ta pimë këtë doli për Partinë tonë të lavdishme!

*Gjatë drekës, një ushtarak e pyeti shokun Enver Hoxha se si është gjendja në Indonezi. Për këtë çështje shoku Enver tha:*

Partia Komuniste e Indonezisë kohët e fundit pësoi një humbje të rëndë. Thuhet se janë vrarë 300 mijë komunistë, bile bashkë me ta edhe Ajditi.

Po si ngjau një gjë e tillë? Ne dinim se Partia Komuniste e Indonezisë kishte një udhëheqje të mirë. Na dukej se ajo ndiqte një vijë pak a shumë të drejtë, po disfata që pësoi kjo parti të lë të mendosh se nuk ka qenë vigjilente. Shokët indonezianë neve na kishin thënë se, në situatat që zhvilloheshin, u vihej detyrë të

shihnin edhe anën ilegale, pa lënë pas dore shfrytëzimin e formave të punës legale. Bile shokët indonezianë i shikonin ngjarjet me shumë optimizëm. Ata e ndienin veten shumë të fortë nga të dyja anët, po ajo që ndodhi vërtetoi se nuk janë treguar në lartësinë e detyrës së madhe të partisë. Vija politike e NASAKOM-it deri diku, mund të themi, se ka qenë e drejtë, po udhëheqësit e Partisë Komuniste menduan të kishin liri veprimi në Indonezi, bile shpresonin shumë që t'i mbështeste Sukarnoja. Pikërisht këtu ata e kanë kapërcyer kufirin. Duke qenë optimistë më shumë nga sa duhej, harruan se borgjezia, po nuk u armatose, po nuk u përgatite dhe po nuk u tregove vigjilent, ajo të pret kokën. Prandaj partia duhet të ndjekë kurdoherë një politikë të drejtë, revolucionare, duhet ta mbajë gjithnjë të mobilizuar popullin dhe të punojë vazhdimisht për rritjen e influencës së saj në masat. Kështu duhej të punonte vazhdimisht edhe Partia Komuniste e Indonezisë për të fituar pozita të reja në vijën e NASAKOM-it. Ajo mund ta shfrytëzonte edhe Sukarnon, po këtë ta mbështeste gjer në atë shkallë ku duhej mbështetur. Ato që thoshte Sukarnoja të mos i merrte të gjitha për kapital e të mos ekzaltohej kur ai e mburrte partinë, po t'i peshonte mirë ato.

Siç duket, shokët indonezianë nuk i kishin si duhet parasysh këto mësimë dhe e ndienin veten aq të fortë, saqë arritën të thoshin: Edhe sikur reaksioni ta merrte fuqinë në dorë, nuk ishte në gjendje ta mbante më shumë se 10 ditë, bile pëshpëritnin se do të ishte më mirë që reaksioni të tentonte. Këto gjykime të

udhëheqësve të kësaj partie nuk ishin të pjekura, nuk ishin marksiste.

Natyrisht, për katastrofën që u ngjau duhet të ketë pasur edhe arsye të tjera. Gjendja në Indonezi nuk duhet të ketë qenë e qartë. Në udhëheqje duhet të ketë pasur iluzione në drejtim të marrjes së pushtetit në rrugë paqësore. Udhëheqësit komunistë indonezianë kanë menduar se ata do të ishin të parët në botë që do të merrnin pushtetin me këtë rrugë. Një pikëpamje e tillë, dashur padashur, i çonte ata nga ana e Hrushovit, sido që me ne mbanin qëndrime të mira, kundër të cilit ata asnjëherë nuk kishin dalë hapur, megjithëse hrushovianët i sabotonin dhe ishin zënë keqas me ta.

Marksizëm-leninizmi nuk është dogmë. Çdo parti marksiste-leniniste duhej të dijë se si ta zbatojë atë në mënyrë krijuese në kushtet e vendit të vet. Marksizmi është marksizëm, ai nuk është as i Shqipërisë, as i Kinës, as i Indonezisë, as i kurrkujt tjetër, ai u përket të gjithë popujve revolucionarë dhe secili ka të drejtë e detyrë ta zbatojë atë në përshtatje me kushtet e vendit të vet. Por ama shokët indonezianë flitnin shumë për një marksizëm-leninizëm «të indonezianizuar», bile këtë e thoshin edhe zyrtarisht, në deklarata publike.

Këto pikëpamje të udhëheqësve të Partisë Komuniste të Indonezisë rridhnin ngaqë ata nuk i kishin shumë të qarta parimet, e megjithatë pretendonin se ishin në pozita të forta partie. Ata mburreshin se partia e tyre kishte në radhët e saj 3 milionë anëtarë, se kishin «mbështetjen» e Sukarnos dhe vetëm në këto kushte mendonin ta merrnin pushtetin. Të gjitha këto, sipas tyre, ishin marksizmi «i indonezianizuar». Prandaj, me-

ndonin ata, nuk ishte nevoja të dilej kundër revizionizmit modern, se ndryshe Sukarnoja mund t'u ikte nga duart.

Kush e bëri puçin kundërrevolucionar në Indonezi? Thonë se Sukarnoja kishte dijani, po puna është kush e pësoi? Sigurisht Partia Komuniste e Indonezisë, pse reaksioni kundër saj komplotonte. Në një rast të tillë duheshin marrë armët, duhej filluar lufta e armatosur. Me revolucionin nuk bëhet shaka, prandaj, po e fillove, duhet t'i shkosh gjer në fund, se ja ç'të bën reaksioni, të vret 300 mijë anëtarë partie.

Gjendja në Indonezi tani është shumë e vështirë ngaqë udhëheqja e partisë nuk kishte marrë masa. Është e treta herë që i ndodh një tragjedi e tillë Partisë Komuniste të Indonezisë, bile në vitin 1948 ajo humbi tërë udhëheqjen, së cilës reaksioni i preu kokën. Mbase kësaj radhe mund të mos jetë likuiduar e tërë udhëheqja, po edhe ndonjë deklaratë zyrtare nuk është bërë akoma nga ana e partisë. Prandaj nuk dimë gjë të sigurt se çfarë po bëhet në këtë vend, vetëm nga disa deklaratatë të gjeneralëve reaksionarë marrim vesh se aty-këtu bëhet ndonjë sulm në këtë ose në atë fshat, se forcat komuniste u likuiduan në këtë ose në atë rajon etj. Nga këto thënie ne mendojmë se partia atje jeton. Ajo me siguri do ta marrë veten, prandaj tani është rasti të mendojë për të bërë revolucionin me armë dhe të vërë mend për gabimet e rënda që të mos përsëriten më.

Po Sukarnoja ç'është? Një borgjez liberal që ka luftuar kurdoherë për t'i siguruar pushtetin grupit të tij. Është fakt se grupi i tij borgjez ka qenë i lëkund-

shëm. Ai tani, në fakt, është likuiduar. Sukarnoja nuk është në burg, po nuk ka as më të voglën fuqi, pse aktualisht dominon klika kundërrevolucionare e gjeneralëve. Sukarnoja mund të ketë simpati në masa, se si përpara edhe pas çlirimit ka luftuar kundër asaj pjese të borgjezisë, e cila është përpjekur të merrte pushtetin dhe të lante hesapet me borgjezinë liberale. Udhëheqësit e Partisë Komuniste të Indonezisë ishin në ujëra jo të pastra. Ata nuk kuptonin se Sukarnoja, duke u sjellur si «mik» me komunistët, bënte politikën e partisë së vet. Prandaj duhen nxjerrë mësimet se kur të mburr një njeri i tillë ose një parti borgjeze, qoftë dhe pak më liberale, mos i merr të gjitha si të vërteta. Partinë Komuniste të Indonezisë Sukarnoja e ka shfrytëzuar kurdoherë si një kundërpeshë ndaj gjeneralëve reaksionarë për interesat e klasës së vet. Por reaksioni e goditi partinë, ai goditi edhe pjesën e partisë së Sukarnos që bashkohej me të.

Megjithëse situata në Indonezi ka qenë dhe është e vështirë, ne shpresojmë se komunistët nuk do të humbasin. Është e vërtetë se ata pësuan një goditje të rëndë, po kemi besim se do ta marrin veten, përsëri do të ngrihet atje vala e revolucionit, pse sado që mund të jenë vrarë 300 mijë komunistë, në një parti që ka pasur rreth 3 milionë anëtarë, do të gjenden me siguri disa qindra dhe mijëra komunistë të shëndoshë që do ta rifillojnë luftën nga e para, ashtu sikurse e filluan në vitin 1941 me 200 komunistë.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## ORGANIZATA PROFESIONALE TË PËRGATITË AKTIVISTË TË ZJARRTË E ME AUTORITET

*Nga biseda me drejtues dhe aktivistë të organizatës së bashkimeve profesionale të rrethit të Shkodrës*

28 prill 1966

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sekretariatit të Komitetit Qendror i intereson shumë të dijë nga afër gjendjen aktuale të punëve në bashkimet profesionale, eksperiencën e mirë, gabimet dhe të metat që ekzistojnë, që të mund të bëjë ndonjë përgjithësim dhe të udhëzojmë pastaj Këshillin Qendror të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, organizatat-bazë të bashkimeve profesionale si edhe komitetet e Partisë për një përmirësim të mëtejshëm të punës në këtë organizatë. Prandaj do t'ju lutesha të më thoni ç'mendoni ju për bashkimet profesionale, si punojnë ato, ç'masa duhen marrë për ta përmirësuar punën? Për këtë problem kaq të rëndësishëm dëshiroj të më flasë jo vetëm shoku kryetar i këshillit të bashkimeve profesionale të rrethit, por edhe ju të tjerët që jeni ftuar të merrni pjesë në këtë takim e që besoj se keni dhe duhet të keni me-

ndimet tuaja si punojnë organizatat e bashkimeve profesionale në fabrika, në ndërmarrje bujqësore, në ndërtim, në transport e kudo.

Gjatë bisedës do t'ju bëj edhe disa pyetje që kanë lidhje me këtë problem, për t'u informuar mbi disa çështje, me të cilat mendoj se duhet të merret organizata juaj.

*SHOKU HILMI HEBOVIA*<sup>1</sup>: Ne jemi munduar të zbatojmë vendimin që ka marrë Byroja Politike e Komitetit Qendror për bashkimet profesionale<sup>2</sup>, për ta bërë organizatën tonë të aftë që të kryejë si duhet detyrat që i janë ngarkuar si shkollë e edukimit komunist të klasës punëtore. Vendimi neve na ka hapur horizontin se si duhet ta kuptojmë që organizata e bashkimeve profesionale luan rol, në radhë të parë, si ndihmëse e Partisë për edukimin e klasës punëtore.

Pas masave që mori kohët e fundit Komiteti Qendror i Partisë menduam t'i hedhim bashkimet profesionale në luftë për zbatimin e propozimeve të punonjësve. Gjithashtu sugjeruam që komiteti i Partisë do të jetë mirë të shikojë ç'qëndrim mbahet nga organet shtetërore dhe ekonomike ndaj këtyre propozimeve.

Një e metë jona është se po vazhdojmë t'ia japim problemet të gatshme organizatës së bashkimeve profesionale në bazë.

1 Në atë kohë kryetar i këshillit të bashkimeve profesionale të rrethit të Shkodrës.

2 Është fjala për vendimin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi përmirësimin e mëtejshëm të punës së bashkimeve profesionale si shkolla të edukimit komunist të punonjësve» më 10.2.1965.

Një problem tjetër që preokupon organizatën tonë është rritja e rolit të organeve udhëheqëse të organizatës së bashkimeve profesionale. Kurse në aparat, me qëllim freskimi, kemi bërë një ripërtëritje të kuadrit. Tani jemi duke marrë masa për të përtërirë edhe aktivin në bazë, për të bërë disa korrigjime të nevojshme në këtë drejtim.

Në frymën e Letrës së Hapur të Komitetit Qendror ne tani kemi marrë disa masa, diçka kemi menduar në këtë drejtim.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Çfarë keni menduar, për shembull?

*SHOKU HILMI HEBOVIA:* Të argumentojmë teorikisht dhe praktikisht, për shembull, pse duhet që punëtorët ta ndiejnë veten zot të fabrikës ku punojnë, të jenë ata që ta aprovojnë planin, të japin mendime për organikën, të kërkojnë llogari për propozimet e bëra etj. Ne jemi kritikuar se nuk kemi punuar mirë kundër shfaqjeve të indiferentizmit. Për këtë problem mendojmë të hapim një diskutim në buletinin që nxjerrim.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Në ç'formë del buletini juaj?

*SHOKU HILMI HEBOVIA:* Në format të vogël prej 4 faqesh, një herë në muaj, po e vërteta është se e kemi lënë pas dore. Aty mendojmë të shkruajmë edhe si të mësojmë nga shembulli pozitiv.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Mësimi i Leninit që thotë se organizata e bashkimeve profesionale është shkollë e edukimit komunist të punonjësve, duhet të vihet në jetë. Ashtu si punon mësuesi për të edukuar nxënësit e vet, ashtu duhet të veproni edhe ju, shokët



e bashkimeve profesionale me punëtorët. Nga rastet e veçanta ju herë pas here duhet të bëni përgjithësim, të zhvilloni biseda me punëtorët, në mënyrë që këto t'u shërbejnë të gjithëve si një mësim edukativ, t'u shërbejnë edhe atyre që kanë gabuar për të mos e përsëritur, edhe të tjerëve që të mos bien në ato gabime. Le të marrim si shembull problemin e normave. Disa i realizojnë ato, ka të tjerë që nuk i realizojnë, por ka edhe punëtorë të përparuar që i tejkalojnë. Disa nga ata që nuk i realizojnë normat mund të kenë arsye objektive, po disa nuk i realizojnë se nuk e kuptojnë si duhet rëndësinë e problemit qoftë nga ana teknike, qoftë nga ana politike, kurse disa të tjerë nuk i realizojnë se janë dembelë ose se kënaqen me pak etj., me një fjalë për arsye subjektive. A ju ka takuar të mblidheni, ta diskutoni këtë problem dhe të caktoni një shok të përgatitet që t'u flasë të gjithë atyre punëtorëve që nuk i realizojnë normat? Po në rastet kur ka mungesë disipline, pastërtie etj. është bërë ndonjë referat ose ndonjë bisedë e lirë?

*NJË PUNËTORE:* Ne e kemi bërë një gjë të tillë në Fabrikën e Mëndafshit ku punoj.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, si e gjykoni ju, është bërë mirë kjo punë? Janë përgatitur në një shkallë të lartë këto referate? Nuk mjafton vetëm t'u thuash punëtorëve se duhet të mbahet pastërtia, po t'u shpjegosh mirë ç'do të thotë të jesh i pastër, se pastërtia e mbajtur mirë në fabrikë ndikon edhe në botëkuptimin e njerëzve, se një njeri i papastër nuk mund të ketë rregull as në punë as në shtëpi. Si vepron ju në qendrat e punës për të përgjithësuar eksperiencën e më të mirëve

dhe për të sinjalizuar punëtorët për të metat që vini re? Ju mbledhin ju sekretarët e organizatave-bazë të Partisë që të mendoni dhe të diskutoni bashkërisht për zhdukjen e një fenomeni negativ që vërehet jo te një ose te dy punëtorë, por, ta zëmë, te disa prej tyre? Do të jetë shumë mirë që këta punëtorë t'i marrësh një nga një dhe t'i këshillosh, por, natyrisht, kur janë disa, nuk të del koha. Atëherë duhet menduar për një formë tjetër pune, t'i mbledhim këta së bashku dhe t'ua shtrojmë problemin nga ana politike, ideologjike, morale, t'u thuhet se po vërehet një fenomen i tillë, i cili, po të mos bëjmë përpjekje si kolektiv që ta zhdukim, do të kemi pasoja jo të mira. Këtyre t'u flasim gjithashtu edhe për masat që duhen marrë për të mos u përsëritur më ai fenomen negativ. Dua të them, bëhen përpjekje në këtë drejtim nga organizata e bashkimeve profesionale dhe nga organizata-bazë e Partisë?

*NJË PUNËTORE:* Jemi përpjekur, por edhe do bësi kemi. Më mirë punojmë për problemin e normative. Tek organizata-bazë e Partisë drejtohem gjithnjë për të marrë orientime se si të punojmë. Konsultohemi edhe me shokë të drejtorisë së ndërmarrjes. Për këtë problem ne kemi aktivizuar gjithashtu punëtorët më të mirë. Këta i kemi ngarkuar për t'u folur, sidomos punëtoreve të reja që nuk i realizojnë normat dhe kjo punë ka bërë efekt.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Nga kjo bisedë po shoh se qahemi kot që nuk kemi njerëz dhe mundësi për të realizuar detyrat që u takojnë organizatave të bashkimeve profesionale në bazë. Ne kemi njerëz që mendojnë dhe punojnë jo keq për këto probleme.

Për rritjen e nivelit të punës edukative është me vend të shihet a i vihet kujdesi i duhur funksionimit të mirë të hallkave të organizatave të bashkimeve profesionale? Cilat janë hallkat që kemi ne në këto organizata?

*SHOKU HILMI HEBOVIA:* Kemi këshillin e bashkimeve profesionale të rrethit që mblidhet një herë në tre muaj dhe presidiumin e tij. Në bazë kemi komitetin profesional të ndërmarrjes, kurse në ndërmarrjet e mëdha kemi edhe komitetin profesional të sektorit ose të repartit. Kemi gjithashtu grupet profesionale që ngrihen në bazë të turneve, të brigadave ose të reparteve të vogla.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Është i përshtatshëm ky organizim, apo mos ju duket se ka hallka të shumta?

*SHOKU HILMI HEBOVIA:* Për organizatat e bashkimeve profesionale, struktura na duket pak e rëndë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po në Komitetin e Partisë e keni diskutuar çështjen e strukturës? Po rendit të ditës i vini rëndësi? Problemet që shtroni në organizatë, i mendoni më parë seriozisht dhe i lidhni me gjendjen konkrete të qendrës së punës, apo i qëndroni besnikë njëfarë plani të punës të caktuar në fillim të vitit? Apo në presidiumin e këshillit të bashkimeve profesionale të rrethit vini në rendin e ditës probleme të rastit, pa i studiuar mirë?

*SHOKU HILMI HEBOVIA:* Presidiumi i këshillit të bashkimeve profesionale të rrethit ka punuar me tematikë vjetore, po e shikojmë se puna nuk po na ecën

aq mirë, prandaj këtë vit hoqëm dorë nga një praktikë e tillë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Besoj se nuk keni hequr dorë nga parashikimi i disa temave kryesore që duhet të analizohen në këshill.

*SHOKU HILMI HEBOVIA:* Jo, njëfarë tematike perspektive duhet në organizatë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Nuk e kam fjalën për të hequr dorë nga parashikimi i disa temave kryesore që duhet të analizohen në këshill, por te kombinimi i planit perspektiv me çështjet aktuale. Të marrim Uzinën e Fermentimit të Duhanit që ka dy komitete, ka grupe profesionale etj. Si e caktoni rendin e ditës për komitetet e reparteve dhe për komitetin profesional të përgjithshëm të ndërmarrjes?

*NJË PUNËTORE:* Komiteti profesional i ndërmarrjes cakton rendin e ditës sipas problemeve që e preokupojnë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Para se të caktohet rendi i ditës nga ana e komitetit profesional të ndërmarrjes, konsultoheni me shokët e komiteteve profesionale të reparteve?

*NJË PUNËTORE:* Po, konsultohemi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Rendin e ditës këtyre tri komiteteve ua diktoni ju, apo e cakton vetë secili? Për shembull, për muajin prill në këto tri komitete ç' tematikë është caktuar?

*NJË PUNËTORE:* Njëri ka shtruar problemin e cilësisë, tjetri atë të ruajtjes së shëndetit, kurse i treti ka parë punën e shkollave dhe të kualifikimit të punëtorëve e të kuadrove.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Është më mirë kështu, apo të ketë vetëm një komitet profesional të fortë për të gjithë ndërmarrjen dhe të mos ketë komitet në repart? E them këtë se në ndërmarrje edhe gratë kanë këshillin e tyre, rinia ka gjithashtu organizatën e saj. Kështu çdo ndërmarrje është mbushur me komitete. Dihet se në fabrikë kemi byronë e organizatës-bazë të Partisë, kemi pastaj komitetin profesional, këshillin e gruas, komitetin e rinisë në shkallë ndërmarrje, pra bëhen 4, vijnë pastaj edhe tre këshilla të bashkimeve profesionale të grupeve dhe kështu bëhen shumë organizma.

*SHOKU SULË BAHOLLI*<sup>1</sup>: Në ndërmarrjet ndodh që disa punëtorë të njëjtën çështje e dëgjojnë disa herë, mbasi të gjithë janë anëtarë të organizatës së bashkimeve profesionale, të rinjtë dhe të rejat janë edhe në organizatën e rinisë, disa punëtorë janë komunistë. Në ndërmarrje organizohen edhe mbledhje të tjera si ato të prodhimit, të këshillit teknik etj. Prandaj mendoj se është e nevojshme që ky problem të shihet më mirë.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Po sikur ta studioni së bashku çështjen e gjithë këtyre hallkave? Duhet atje të gjitha këto? Të mendohet, si mund të organizojmë, nën drejtimin e Partisë, një punë më të harmonishme në qendrat e punës, në mënyrë që atje të mos ketë një numër kaq të madh mbledhjesh, tematikash, byrosh, komitetesh, sepse të gjitha këto na krijojnë konfuzion në punë, bëjnë që njerëzit të merren me shumë gjëra dhe si

---

1 Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës.

rrjedhim të mos i bëjnë mirë. Ndodh që i njëjti njeri të jetë edhe anëtar i organizatës së bashkimeve profesionale, edhe në organizatën e rinisë, edhe në atë të gruas, kështu që ai ndihmën e tij do të përpiqet ta japë vetëm te njëra prej këtyre organizatave.

Kam edhe një çështje tjetër. Ç'formë përdorni ju për mobilizimin e aktivistëve dhe ç'udhëzime u jepni për të zbatuar një vendim që merrni? Ta zëmë se morët në shqyrtim një çështje, si dhe vendimin përkatës. Atëherë si ua transmetoni këtë vendim aktivistëve të organizatës së bashkimeve profesionale dhe në ç'formë i aktivizoni ata? Çfarë ju ka treguar eksperiencia në këtë drejtim? Cilat mendoni se janë format më të përshtatshme për këtë punë? Në mbledhjen e fundit të komitetit profesional çfarë teme shtruat ju?

*NJË AKTIVIST I NBSH «P. REXHEPI»:* Ne diskutuam për tri çështje. E para kishte të bënte me organizimin e mbledhjeve për dhënie llogari e zgjedhje, e dyta ishte për shtrimin e planit të vitit 1966 dhe çështja e fundit si po zbatohen nga drejtoria e ndërmarrjes propozimet e bëra nga kolektivi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Të marrim këtë të fundit. Ju e diskutuat problemin dhe doli që një pjesë të propozimeve të bëra, ndërmarrja i ka aprovuar dhe i ka dhënë për zbatim, kurse të tjerat ajo nuk i ka parë. Për propozimet që janë aprovuar, ka predispozicion nga punëtorët për t'i zbatuar? Si i mobilizoni ju aktivistët për të punuar në këtë drejtim?

Keni bërë ju ndonjë temë për rëndësinë që kanë aktivistët, ku të flitet se ç'do të thotë të jesh aktivist i bashkimeve profesionale, në mënyrë që vetë këta, në

radhë të parë, ta kuptojnë rolin e tyre, të kuptojnë që aktivisti është një njeri i përgatitur, i cili, kur flet, i ngre peshë ata që e dëgjojnë? Ai u flet haptazi njerëzve, dhe atë që nuk i kupton shpejt çështjet e ndihmon t'i kuptojë në rrugën e Partisë, të rregullave, të moralit shoqëror dhe të ligjeve të shtetit. Ja, ti shoqja e ndërmarrjes bujqësore je një punëtore e dalluar në sektorin ku punon, je edhe brigadiere dhe aktiviste e organizatës së bashkimeve profesionale. Të kanë thënë ty ndonjëherë se organizatën e preokupon ky problem, të kanë ngarkuar të përgatitesh dhe të shkosh të flasësh për këtë ose për atë problem që nuk ecën në ndërmarrje dhe të mendohet si do të zgjidhet?

*NJË BRIGADIERE E NBSH «P. REXHEPI»:* Po, më kanë ngarkuar një herë për luftën kundër dëm-tuesve të hardhive dhe unë kam shkuar e jam konsultuar me punëtorët për këtë problem.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po me iniciativën tënde, kur shikon se diçka nuk ecën në rrugë të drejtë, kur veprohet jashtë ligjeve të shtetit ose të Partisë, i ke mbledhur ndonjëherë shokët dhe shoqet e tua atje ku punon dhe të diskutoni bashkërisht pse na ndodhin këto? Ke vepruar ndonjëherë kështu?

*BRIGADIERJA E NBSH «P. REXHEPI»:* Jo.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Pra, që të veprosh aktivisht kundër shkelësve të ligjit, është e domosdoshme të njohësh kuptimin, esencën e tij, se atëherë fjala ka forcë bindëse. Punëtorëve u duhen shpjeguar mirë ligjet, e jo vetëm sa t'u thuhet që ka dalë ky ose ai ligj e të mos bëhet asgjë tjetër.

*SHOKU HILMI HEBOVIA:* Duhet të pranojmë ha-

pur, shoku Enver, se në këtë drejtim ne punojmë shumë pak. Vetëm për Projektkodin e ri të Punës dhe për ligjin e sigurimeve shoqërore i organizuam mirë diskutimet, gjatë të cilave punëtorët kanë dhënë mendimet e tyre.

Ne kemi aprovuar një plan për popullarizimin e ligjeve nga ana e punonjësve të organeve të drejtësisë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ka shumë rëndësi që çdo qytetar i Republikës, dhe në radhë të parë klasa punëto-re, t'i njohin ligjet, të dinë esencën e tyre, që të mund t'i mbrojnë.

Punonjësit e organeve të drejtësisë mund t'i punojnë ligjet, por ju duhet të keni aktivistët tuaj për këtë punë. Në qoftë se juristi ngarkohet të flasë përpara njerëzve të ngritur nga ana kulturore, me këtë kategori punonjësish, po të dojë, le të zgjerohet, po me masën është aktivisti ai që do të dijë të komunikojë më mirë.

Ju keni një praktikë pune për lidhjen e detyrave politike me detyrat ekonomike në ndërmarrje, në administrata, në shkolla, me mësuesit etj. A rishikohet herë pas here kjo praktikë? Bëhet mirë lidhja e problemeve politike me ato ekonomike? Në detyrat që na ngarkon Partia, sa më shumë të thellohesh, aq më shumë nxjerr probleme të tjera. Dua të them se ne kemi shumë për të bërë.

Ju, drejtuesit e organizatave të bashkimeve profesionale, duhet të praktikoni edhe një metodë tjetër në punën tuaj, të mos pritni sa të bëhet mbledhja, pa të shtroni dhe të zgjidhni një problem. Ta zëmë se ju vjen një mendim në kokë për lidhjen e detyrave politike me ato ekonomike. Atëherë përse të presësh gjer në mble-



dhjen e zakonshme të presidiumit të këshillit të bashkimeve profesionale të rrethit? Ti, shoku Hilmi Hebovia, je drejtues i bashkimeve profesionale, prandaj me iniciativën tënde mund të bësh një mbledhje të veçantë të aktivistëve, ku të hapësh një diskutim për këtë çështje, pra shtron problemin, merr edhe mendimin e shokëve, të cilin e përpunon më tej. Po nuk është e domosdoshme të merresh vetë me të gjitha çështjet. Atë detyrë që mendon se mund ta kryejë një shoqe e thjeshtë, e cila është edhe anëtare e këshillit të rrethit, ngarkoja asaj; një shoqe ose një shok tjetër ngarkoje të interesohet për një problem tjetër. Këtyre shtrojua problemin, porositi të mendojnë dhe pastaj të vijnë e të diskutojnë përsëri më tej me ty. Edhe kjo mund të jetë një formë tjetër pune. Ti do të kesh kështu një sërë çështjesh për të shtruar në mbledhjen e presidiumit, për të cilat ke edhe mendimin e disa shokëve, aktivistë më të shquar, edhe vetë ke arritur në disa konkluzione. Prandaj kur ke arritur të kristalizosh disa mendime me rëndësi të madhe për problemin që ke ndjekur, atëherë i propozon këshillit se ke për të shtruar një, dy ose më shumë çështje jashtë planit, kërkon edhe mendimin e tij dhe këshilli del kështu me një orientim, ta zëmë, në lidhje me përmirësimin e metodës së punës. Kështu mund të dalim ca edhe nga sfera e rendit të ditës të caktuar.

Për të mirën e punës së Partisë dhe të organizatës së bashkimeve profesionale mendoni ju që në çdo fabrikë, në çdo shkollë apo institucion etj., të keni disa aktivistë të specializuar të bashkimeve profesionale? Për shembull, drejtuesi i organizatës së bashkimeve profesionale që punon në Fabrikën e Tisazhit mund të ndiejë

nevojën që atje organizata të ketë disa aktivistë, të cilët ajo synon t'i specializojë për problemet më të rëndësishme politike, ideologjike, ekonomike të tisazhit. Atje kemi drejtor, nëndrejtorë, inxhinierë, të cilët bëni mirë që i aktivizoni, se edhe inxhinierët janë njerëz partie. Këtyre t'u vëmë detyrën që diturinë e tyre ta vënë edhe në shërbim të organizatës, por më shumë e në mënyrë të veçantë duhet të punoni për të përgatitur aktivistë, kryesisht nga radhët e punëtorëve. Kjo ka rëndësi të madhe. Po të punojmë kështu, atëherë do të krijojmë një mori kuadros revolucionarë që të jenë specialistë të zotë për punën e organizatës. Në udhëheqje të organizatës së bashkimeve profesionale të ndërmarrjeve ne kemi shokë të zgjedhur që i kuptojnë mirë përgjegjësitë, por nuk mjafton të mbështetemi vetëm tek ata, ne duhet të punojmë që të ngremë edhe masat në një nivel të lartë, prandaj kudo duhet të fillojmë të përgatitim aktivistë të vërtetë që, kur t'i ngarkosh me një punë, pasi t'i kemi ndihmuar dhe orientuar mirë, të jenë në gjendje ta kryejnë atë plotësisht. Për këtë qëllim ne duhet t'i vëmë disa detyra vetes. Për shembull, organizata-bazë e Partisë në një fabrikë të madhe mund të përgatitë edhe 30 aktivistë të zjarrtë të bashkimeve profesionale, njerëz të zotë e me autoritet që të kenë aftësi të mobilizojnë punëtorët politikisht dhe ideologjikisht dhe të bëhen kështu dora e djathtë e komitetit profesional. Mendohet kështu për aktivistët? Është e drejtë të veprohet kështu?

Aktivistët duhet t'i pyetni për çfarë temash ndiejnë më tepër nevojë, ku gjejnë vështirësi, ose ç'material u duhet për t'u hapur horizonte dhe materialet t'ua përgatitni në mënyrë të thjeshtë. Kjo punë do t'i ndihmojë ata

për të kryer detyrat. Pastaj duhet menduar seriozisht për t'i bërë punëtorët të aftë që edhe të flasin, se ka njerëz që janë të drojtur, nuk flasin dot. Pra i thërritni dhe i mësoni edhe në këtë drejtim. Kur isha në Liceun e Korçës, kisha një shok që, po ta ngarkoje për të mbajtur ndonjë fjalim në raste festash, ishte i gatshëm, ishte bilbil nga goja. Ne çuditeshim dhe i thoshim: «Si flet ti kaq lirisht?». Ai përgjigjej se, kur ngarkohej të fliste, caktonte pikat mbi të cilat do të fliste dhe, kur merrte fjalën, e konsideronte sikur nuk kishte njeri përpara, prandaj nuk emocionohet. Çështja është t'i bëjmë të aftë aktivistët që të sqarojnë politikisht njerëzit. Kjo arrihet kur secili ta ketë të qartë problemin për të cilin do të flasë. Ata që e kanë të qartë problemin, nuk do të hezitojnë ta thonë atë thjesht.

Mban kontakte të rregullta komiteti profesional i ndërmarrjes me punëtorët? Ju vijnë punëtorët në mënyrë individuale ose kolektive në këshillin e bashkimeve profesionale të rrethit? Kur një punëtor shkon të ankohet në komitetin profesional për një masë që ka marrë ndërmarrja ndaj tij, të cilën ai nuk e gjen të drejtë, si veproni ju? Ndiqen këto ankesa nga ana juaj dhe u jepet përgjigje? Ka rëndësi të madhe kjo çështje, se punëtori e ndien si të vetën organizatën e bashkimeve profesionale. Pra, zhvillohen drejt këto marrëdhënie?

Punëtorëve duhet t'u bëhet vazhdimisht e qartë se shfaqjet e burokratizmit dhe subjektivizmi i një drejtuesi mund të shkaktojnë shtrembërimin e vijës së Partisë, prandaj të dinë kurdoherë të bëjnë dallimin midis orientimit të drejtë dhe ndonjë veprimi të gabuar, të kritikojnë atë që gabon dhe të mbrojnë vijën e Partisë.

Në përgjithësi kundërshtimet që kanë punëtorët me administratën, vijnë për faj të kësaj të fundit, apo për arsye të mbeturinave që kanë punëtorët, sidomos disa individë të veçantë? Dua të them në këto raste në përgjithësi, kush ka më shumë të drejtë, punëtorët apo njerëzit e administratës? Ç'tregon eksperiencia që keni ju në zgjidhjen e këtyre problemeve?

*SHOKU HILMI HEBOVIA:* Në përgjithësi punëtorët kanë më shumë të drejtë, kurse ngutje dhe mungesë durimi ka në përgjithësi nga njerëzit e administratës.

Përpara ne kishim disa hallka burokratike që e vështirësonin afrimin e punëtorëve me organin drejtues në rreth. Çdo gjë bëhej nëpërmjet lutjeve. Kurse tani këshilli i rrethit dhe sidomos organizata-bazë e bashkimeve profesionale mban lidhje më të afërta me punëtorët.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po drejtorët e ndërmarrjeve ç'konsideratë kanë për komitetet profesionale? Mos kanë konsideratë formale, mos nisen nga pikëpamja për t'i bërë qejfin, apo kanë koncept të drejtë për organizatën e bashkimeve profesionale dhe këtë e konsiderojnë si një ndihmëse të vërtetë të Partisë dhe të drejtorisë?

*SHOKU HILMI HEBOVIA:* Në përgjithësi ka drejtues që kanë një konsideratë të mirë për organizatën tonë, e që mbështeten shumë te kjo. Por te disa drejtorë ka edhe tendenca nënvleftësuese.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ai drejtor që nënvleftëson organizatën e bashkimeve profesionale duhet kritikuar, bile shumë rreptë. Drejtori duhet të dijë që të gjithë anëtarët e organizatës janë të qartë si për të drejtat, ashtu edhe për detyrat që ka ai si drejtor, por është e

domosdoshme që, edhe drejtori vetë të dijë detyrat dhe të drejtat e anëtarëve të organizatës. Kjo kërkon që çdo drejtor në mbledhje të organizatës së bashkimeve profesionale të vejë me mendimin se aty të gjithë janë të barabartë, e të mos ndodhë që t'u drejtohet punëtorëve sikur çoç do t'u bëjë. Këtë duhet ta kuptojnë mirë të gjithë drejtorët.

Po Komiteti i Partisë i Rrethit a ka ndonjë plan të veçantë edukimi për kryetarët e komiteteve profesionale të qendrave të punës dhe për anëtarët e tjerë të komiteteve profesionale të çdo rangu? Keni menduar ndonjëherë që të bëhen të gjitha këto që thamë? Organizata e Partisë duhet të ndihmojë dhe të vërë disa detyra në këtë drejtim. Ajo duhet të mendojë edhe për ngritjen e disa kurseve me një program jo shumë të rëndë, po për disa çështje, për t'u mësuar atyre njohuritë më të nevojshme. Këto janë të domosdoshme nëse duam të bëhen të gjitha ato që thamë. Pra keni një plan të veçantë edukimi nga ana e Partisë për t'i mësuar këta shokë?

*SHOKU SULË BAHOLLI:* Një plan të tillë e kemi, por del nevoja që pas kësaj bisede që po bëjmë ta rishikojmë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Mendoni të përcaktohet më drejt, cilat anë të edukimit të punonjësve duhet të marrë përsipër në mënyrë të veçantë Partia dhe cilat duhet të marrë organizata e bashkimeve profesionale? Ju ka rënë në mendje një gjë e tillë, apo konfondohen këto çështje? Detyra është shumë e rëndësishme. Shokët e organizatës së bashkimeve profesionale mund të ngarkojnë edhe sekretarin e komitetit të Partisë që merret

me çështjet e edukimit për të punuar një temë në një qendër pune, sepse ai është njëkohësisht edhe anëtar i organizatës së bashkimeve profesionale. Një punë të tillë mund ta bëjë gjithashtu edhe komiteti i Partisë, duke ngarkuar një komunist të përgatitur, të cilit, pasi ta ketë vënë në dijeni se gjendja, ta zëmë, në ndërmarrjen e trikotazhit, në këtë ose në atë drejtim nuk është e mirë, i thotë shko e fol për këtë problem. Pra, për disa raste të veçanta, për çështje të një rëndësie të madhe partie, mund të ngarkohen shokë, qofshin këta edhe drejtues të Partisë, për të punuar materiale për probleme të rëndësishme jashtë formave të zakonshme.

Mund të na thoni, pra, cilat janë çështjet ku ne mund të bëjmë dallimin, cilat prej tyre mund t'i trajtojnë bashkimet profesionale dhe cilat Partia?

**SHOKU SULË BAHOLLI:** Punën politike dhe ideologjike, që në përgjithësi bëhet nëpërmjet konferencave, bisedave, sqarimeve, ta marrin përsipër organizatat e masave, bashkimet profesionale, organizata e gruas dhe ajo e rinisë. Por në qendrat e punës të mërrën kryesisht organizatat e bashkimeve profesionale dhe jo organizatat e tjera, se pastaj do të bëhen konferenca pas konferencash.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Këtu duhet parë edhe çështja e specifikës së secilës organizatë, por problemet kardinale teorike duhet t'i marrë përsipër t'i trajtojë Partia. Është në të mirën e punës që të bëni edhe vërejtje për ndihmën që u jep komiteti i Partisë i rrethit dhe organizatat-bazë të Partisë në qendrat e punës e në institucionet kulturore organizatave-bazë të bashkimeve profesionale.

Po me organizatën e gruas dhe të rinisë si i ka lidhjet dhe bashkëpunimin organizata e bashkimeve profesionale? Si e bëni koordinimin e veprimtarisë suaj? Mendoni ndonjëherë si mund t'i keni më të qarta e më të shëndosha këto lidhje, si mund t'i koordinoni punët më mirë, qoftë me drejtuesit e këtyre organizatave në rreth, qoftë në bazë? Ju preokupon pra ju koordinimi i punëve ndërmjet organizatave të ndryshme? Nuk e kam fjalën vetëm për problemet specifike të gruas apo të rinisë, por edhe në drejtim të këmbimit të eksperiencës me njëri-tjetrin, për shembull, si mund të zgjidhet ky ose ai problem në fabrika. Kur merren përsipër për t'u kryer disa aksione ose për zbatimin e disa vendimeve, komiteti profesional mendon vetëm për organizatën e vet, apo ka parasysh se në ndërmarrje ka edhe një këshill gruaje dhe një organizatë rinie? I shkon ndër mend në raste të tilla ç'mendojnë edhe këto organizata për këtë problem, apo nuk mendon fare dhe shkon me mendimin që ato le të bëjnë ç'të duan për veten e tyre?

*SHOKU HILMI HEBOVIA:* Me shokët e komitetit të rinisë të rrethit ne jemi konsultuar vazhdimisht për problemet e përbashkëta. Koordinimi i punëve të organizatave të masave bëhet me orientimin që u jep atyre periodikisht sekretari i parë i Komitetit të Partisë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Në punën tuaj të përditshme ju duhet të mbani lidhje jo vetëm me sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të Rrethit, po edhe me sekretarët e tjerë, e në radhë të parë me sekretarin që merret me problemet e propagandës dhe të kulturës, pra me problemet e edukimit. Sekretari i parë jep vetëm orientimin e përgjithshëm. Ndryshe është puna me

sekretarët e tjerë për organizatat që mban secili në lidhje. Ju në konsultim me njëri-tjetrin duhet t'i zëbërtheni ato orientime dhe t'u hyni çështjeve në detaje. Një punë e tillë duhet të praktikohet edhe në ndërmarrje. Këtë problem, më duket, duhet ta shikojmë, se në këtë çështje nuk ka uniformitet. Detyra e bashkimeve profesionale është të ngrenë nivelin politik dhe ideologjik të punëtorëve. Ato janë një mbështetje e madhe e Partisë, prandaj duhet të kenë lidhje edhe me sekretarin e agjitacionit dhe të propagandës.

Keni gra instruktore në organizatën e rrethit?

*SHOKU HILMI HEBOVIA:* Jo, nuk kemi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Si e shpjegoni që gratë punëtore nuk e kanë me dëshirë të vihen në krye të organizatës së bashkimeve profesionale kur i zgjedhin?

*NJË PUNËTORE:* Gratë punëtore në shumë raste i kanë zgjedhur në udhëheqje të organizatës, por ato kanë hezituar, sepse janë me fëmijë të vegjël dhe kanë punë shumë edhe në shtëpi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Nuk keni gjetur shoqe që i kanë të rritur fëmijët, por që kanë prirje, njëfarë kulture dhe aftësi për të qenë në udhëheqje të organizatës e për të bërë edhe punë përgjithësuese? Puna e Partisë të synojë edhe në përgatitjen e shoqeve si kadro drejtuese të organizatës.

*NJË PUNËTORE:* Nuk e kemi parë çështjen nga kjo anë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Si është trajtimi ekonomik i shokëve që punojnë në aparatën e organizatës së bashkimeve profesionale? Është i mjaftueshëm? Si



barazohen me ata të organizatave të tjera? Që të realizohen të gjitha këto detyra që thamë, dhe kjo është një punë e madhe, duhet të kemi edhe kuadro të mirë, prandaj mund të jetë e nevojshme ta shikojmë pagën e tyre.

*SHOKU SULË BAHOLLI:* Kjo çështje ka vend për t'u parë. Pagat në të gjitha aparatet e organizatave të masave, po t'i krahasojmë me ato të punonjësve të organeve të Partisë dhe të pushtetit në rreth, janë më të ulëta.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kam edhe një çështje tjetër: Keni ju një metodë të përcaktuar në drejtim të përgjithësimit të vazhdueshëm të eksperiencës nëpërmjet ndërmarrjeve e institucioneve të ndryshme nga fabrika në ndërmarrje bujqësore, nga ndërmarrja në shkollë etj.? Keni menduar për ndonjë metodë që duhet perfeksionuar më tej? Duhet bërë përpjekje sidomos që eksperiencia e klasës punëtore të përhapet në fshatarësinë dhe në inteligjencien tonë. Vërtet ti e popullarizon një eksperiencë duke vënë në fabrikë fotografinë e punëtorit që e ka zbatuar atë dhe një shënim se si ka arritur ta zbatojë, por mësuesit në shkollë, apo punonjësit e qendrave të tjera të punës, nuk e shohin. Pra, çështjen e kam që të gjenden format më të përshtatshme për përhapjen e eksperiencës së përparuar.

Ju thatë se keni edhe një buletin si mjet për përhapjen e kësaj eksperience, e shfrytëzoni këtë?

*SHOKU HILMI HEBOVIA:* Për shembull, eksperiencën pozitive të një punëtori të përparuar të SMT-së ne e përhapim kudo ku ka traktoristë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Te traktoristë të tillë ka

disa qëndrime vendosmërie politike që i nxitin edhe shokët e tyre të ecin përpara në punë. Me këtë vendosmëri mund dhe duhet të frymëzohen edhe punonjësit e administratës, për një punë më të mirë, për kalitjen e vullnetit dhe për rritjen e pjekurisë së tyre. Kjo eksperiencë, pra, duhet të përhapet kudo, që t'i frymëzojë të gjithë për të punuar si traktoristët shembullorë.

Po kështu duhet ta përhapni edhe eksperiencën e punonjësve të tjerë. Në qoftë se një mësues, duke vrarë mendjen, ka arritur të gjejë një metodë të mirë në dhënien e mësimit dhe t'i bëjë nxënësit të shkëlqyer, kjo eksperiencë duhet përhapur.

Po për përhapjen e eksperiencës që del jashtë profesionit, e cila mund t'u shërbejë punonjësve të sektoreve të tjerë, çfarë bëhet? Për shembull, edhe njërit që nuk është traktorist, i intereson hovi i madh dhe entuziazmi që e shtyn përpara një traktorist të përparuar dhe e bën atë të ecë me ritme të shpejta në punë. Ky hov na intereson që të përvetësohet nga të gjithë, edhe nga punëtorët e bujqësisë, edhe nga ata të industrisë, edhe nga punonjësit e administratës etj.

*SHOKU HILMI HEBOVIA:* Nuk e kemi menduar një gjë të tillë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Bile e vlen që rrethi të nxjerrë edhe një buletin ose gazetë që do të ndihmojë shumë për përhapjen e shembujve të këtillë. Shoku sekretar që merret me problemet e edukimit mund të mendojë diçka për këtë. Një organ i tillë, natyrisht, nuk mund të dalë kudo. Ai fillimisht mund të dalë në dy-tri nga qytetet tona më të mëdha, për shembull, këtu në Shkodër, në Korçë e në ndonjë qytet

tjetër, ku kemi më shumë njerëz me kulturë, të cilët kanë mundësi të bëjnë diçka në këtë drejtim.

Sigurimet shoqërore tani ne ua hoqëm organizatave të bashkimeve profesionale. Po a mendoni ju që interesimi për këtë problem me rëndësi politike nuk duhet të mungojë nga ana juaj? Apo mendoni se tani ju i keni larë duart nga kujdesi për zbatimin drejt të ligjit të sigurimeve shoqërore?

*SHOKU HILMI HEBOVIA:* Ne, shoku Enver, duhet të heqim dorë vetëm nga dokumentacioni, kurse anën morale të këtij problemi organizata jonë duhet ta ndjekë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Prandaj nga ana morale dhe politike këtë çështje mos e harroni. Nga dokumentacioni tani ju u çliruat, u lehtësuat, kurse çështjen politiko-morale të sigurimeve shoqërore duhet ta mbani vazhdimisht gjallë, se ky është edhe njëfarë kontrolli mbi Ministrinë e Financave.

Pyetja e fundit: Keni ju ndonjë vërejtje për ndihmën që ju jepet nga qendra, dua të them nga Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale, si ju ndihmon ai për problemet tuaja? Po për ndihmën që ju jepet nga Komiteti Qendror i Partisë çfarë vërejtjesh keni?

*SHOKU HILMI HEBOVIA:* Në rrethin tonë, duke pasur parasysh peshën që zë dhe kuadrin drejtues të organizatës së bashkimeve profesionale të rrethit, ku janë dy shokë të rinj, mendojmë se ndihma e Këshillit Qendror duhet të ishte më efektive. Nga sa dimë ne, shoku Gogo [Nushi]<sup>1</sup> ka lënë porosi që këshilli i bashkimeve profesionale të rrethit të Shkodrës të ndihmo-

1 Në atë kohë President i Këshillit Qendror të BPSH.

hej në mënyrë të veçantë, por kjo porosi nuk është zbatuar sa duhet nga shokët e qendrës.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ju falënderoj shumë, shokë, për këtë ndihmë që më dhatë, për të cilën Komiteti Qendror ka nevojë që të dalë me disa konkluzione për përmirësimin e mëtejshëm të punës së bashkimeve profesionale. Besoj se edhe ju nuk u mërzitët, sepse nëpërmjet pyetjeve që ju bëra, këmbuem bashkërisht disa mendime, të cilat do të na shërbejnë si njëfarë orientimi për të reflektuar dhe për të përmirësuar punën e Partisë me organizatën tuaj. Ne do të përpiqemi në këtë drejtim, por diskutime të kësaj natyre, për gjëra të tilla, duhet të bëhen herë pas here dhe të mendoni edhe vetë për përmirësimin e mëtejshëm të punës. Këtu hodha disa pyetje që mendoj se kanë rëndësi. Për disa prej këtyre mbase mund të mos dilet menjëherë me konkluzione që të bëhet kështu apo ashtu, por mjafton që me hedhjen e pyetjes hapen horizonte dhe mendja e secilit do të punojë në punë e në shtëpi, duke u nisur nga qëllimi si e si ta përmirësojmë punën më mirë.

Këtë takim unë e konsideroj si një ndihmë që më dhatë, por edhe pyetjet që ju drejtova, mendoj se do të jenë një ndihmë që edhe ju të reflektoni e të gjeni rrugë të reja për ta përmirësuar më mirë punën, të na thoni edhe neve gjithashtu se ç'rezultate do të arrini. Edhe një herë ju falënderoj shumë për ndihmën që më dhatë.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## TE VEPRAT QË NDËRTOHEN, POPULLI SHEH SA PËRPARA KANË ECUR BIJTË E TIJ

*Nga fjala me rastin e inaugurimit të Uzinës  
së Telave të Bakrit në Shkodër*

29 prill 1966

Të gjithëve na pëlqeu Uzina e Telave të Bakrit që inauguroam sot, për të cilën mund të themi se është një nga uzinat e pajisura me makineritë më moderne. Unë nuk marr shumë vesh nga çështjet teknike, por me sa shikoj, shokët montatorë të talentuar, me duart e tyre të arta, kanë montuar makineri të shumëllojta. Kjo na gëzon dhe na krenon.

Me një vepër si kjo, të ndërtuar kaq bukur, ku ju, shokë punëtorë, montatorë e specialistë, vutë gjithë vullnetin, zotësinë dhe dijenitë tuaja, po i siguron Shqipërisë një bazë të rëndësishme për përpunimin e një lënde të çmueshme që del nga nëntoka e vendit tonë, duke gëzuar kështu me të zemrën e popullit.

Populli i Shkodrës është një popull patriot, i zgjuar dhe besnik i Partisë. Ai e meritonte plotësisht të ngrihej në qytetin e tij një vepër kaq e bukur dhe moderne si kjo, e cila jam i bindur që do të shfrytëzohet si duhet

për të mirën e gjithë ekonomisë së vendit tonë. Duke marrë parasysh zotësinë dhe aftësinë e klasës punëtore shkodrane, me tradita të vjetra revolucionare, të cilat pas Çlirimit u zhvilluan dhe u kalitën edhe më tepër, kam besimin se ju do t'i ruani kurdoherë këto tradita dhe, nën udhëheqjen e Partisë, do t'i zhvilloni ato edhe më shumë.

Populli ynë shikon njëkohësisht te kjo vepër se sa përpara kanë ecur bijtë dhe bijat e tij, ç'mjeshtëri e zotësi kanë fituar ata, shikon frymën e tyre revolucionare, patriotizmin e tyre të madh për t'i dhënë vendit vepra kaq të vlefshme. Të jeni të sigurt se jo vetëm te ju, shokë punëtorë, teknikë dhe inxhinierë që do të punoni këtu, por edhe tek i gjithë populli ynë, i cili do të shikojë në praktikë frytet e veprës që ndërtoat, do të shumëfishohet besimi në forcat e veta, do të forcohen besnikëria dhe dashuria ndaj Partisë, e cila bëri të mundur realizimin e të gjitha sukseseve që po gëzojmë, do t'u forcohet besimi se çdo gjë që ndërmerr Partia, realizohet me sukses dhe është në interesin e plotë të popullit punonjës të vendit tonë.

Krahas ndërtimit të veprave me vlerë në lëmin e industrisë, Partia ka pasur parasysh edhe zhvillimin e modernizimin e bujqësisë së vendit tonë, mbasi dihet që industria nuk mund të punojë pa një bujqësi të zhvilluar, e cila është baza e rëndësishme kolosale e ekonomisë sonë. Është për këtë arsye që Partia na mëson t'i vëmë rëndësi të veçantë bujqësisë, të futim në shpirtin e fshatarëve ndjenjën e mobilizimit dhe të organizimit, forcën e vullnetit, të kurajës, të zotësisë dhe në këtë drejtim sukseset janë të mëdha në gjithë vendin. Edhe

në rrethin e Shkodrës ne po shikojmë me kënaqësi që bujqësia ecën përpara për të mirën e popullit tonë.

Partia na mëson që për zgjidhjen e çdo problemi të vëmë politikën në radhë të parë. Kjo do të thotë se çdo gjë që bëjmë, çdo gjë që realizojmë dhe ndërtojmë, bile edhe çdo propozim që paraqesim, duhet ta shikojmë nën prizmin politik, nën prizmin e partishmërisë marksiste-leniniste. Në qoftë se ne do t'i shikojmë kështu çështjet, atëherë të gjitha pengesat dhe vështirësitë do t'i kapërcejmë me sukses dhe planet do t'i realizojmë. Mund të themi me bindje që Partia jonë ka bërë një punë kolosale në këtë drejtim, prandaj shikojmë që populli ynë është i ngritur politikisht, gjë që na mbush me ndjenja krenarie të ligjshme, se po të mos i kuptonte populli çështjet drejt politikisht, në rrugën e ideologjisë sonë marksiste-leniniste, nuk do të ishte e mundur të realizoheshin dot të gjitha këto suksese. Përvoja e Partisë sonë na mëson se në qoftë se njerëzit tanë nuk i bëjmë me të vërtetë revolucionarë në çdo hap të veprimtarisë së tyre, në çdo mendim e veprim të tyre, nuk do të mundim të ecim dot me hovin që dëshirojmë dhe nuk do të kemi ato rezultate që presin populli dhe Partia. Prandaj çështjes së edukimit të njeriut të ri, Partia jonë i ka vënë dhe do t'i vërë një rëndësi të jashtëzakonshme.

Duhet të jemi kurdoherë realistë se njerëzit nuk janë të prerë të gjithë me një gërshërë. E kaluara rëndon jo vetëm mbi masat, por edhe mbi ne, komunistët, prandaj sidomos ne komunistët, që jemi në pararojë, duhet të punojmë seriozisht që të kalitemi politikisht dhe ideologjikisht sa më mirë, të jemi ata që të bëjmë sa

më pak gabime, të kemi kujdes edhe për gjënë më të vogël, të luftojmë edhe me ndërgjegjen tonë, të luftojmë me këmbëngulje kundër disa veseve që trashëgojmë. Për shembull, disa prej nesh janë ca nevrinë, prandaj deri edhe në këtë drejtim duhet të bëjmë përpjekje të përmirësohemi, pse po të reflektosh pak më thellë, del se nuk është diçka e rastit kur bëhesh nevrinë. Të bëhesh nevrinë do të thotë të mos jesh i zoti të gjykosh me gjakftohtësi mendimin ose veprimin e tjetrit. Në këtë rast ti nevrinësish edhe kur shoku e ka drejt, por që ty nuk të pëlqen mendimi i tij, sepse ti mbivlerëson shumë mendimin tënd. Kështu nxjerr krye ndjenja e epërsisë së vetes tënde mbi tjetrin, të cilin e shikon si inferior. Duke menduar e duke vepruar në këtë mënyrë, largohesh nga rruga e Partisë.

Lufta kundër mbeturinave që ruhen për një kohë në ndërgjegjen e njerëzve përbën një detyrë të madhe për ne, por, siç thotë Stalini, komunistët janë të atij brumi që luftojnë e fitojnë kalanë dhe dalin kurdoherë në rrugë të drejtë. Ne po i marrim kalatë njërin pas tjetrës, po ndërtojmë me sukses socializmin, sepse mbështetemi në ideologjinë marksiste-leniniste, të cilën e zbatojmë me besnikëri, dhe pikërisht këtu qëndron forca kolosale e Partisë sonë.

Shikoni ç'ndodh në Bashkimin Sovjetik, ku ideologjia marksiste-leniniste është zëvendësuar me ideologjinë borgjeze revizioniste. Nuk do të zgjatëm për të treguar se ç'armiq të neveritshëm janë revizionistët sovjetikë, sepse e kemi të qartë që ata janë tradhtarë nga më të ndyrët që ka parë bota dhe lëvizja komuniste ndërkombëtare gjer më sot, janë kapitulluesit më të



poshtër, por dua të theksoj se detyra jonë është t'i luftojmë gjer në shkatërrimin e tyre të plotë. Në luftën kundër tyre duhet të përqendrojmë forcat tona, pse kështu do të mbrojmë marksizëm-leninizmin, i cili do ta shpëtojë botën, kështu do t'u vijmë në ndihmë edhe popujve të Bashkimit Sovjetik, që ata ta shohin më qartë e ta kuptojnë më shpejt rrezikun e kolonës së pestë revizioniste. Ne i kemi dashur dhe vazhdojmë t'i duam me gjithë shpirt popujt sovjetikë, sepse ata u ngritën të parët në Revolucionin Socialist dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore kontribuan fuqimisht për shkatërrimin e hitlerianëve. Kjo u bë e mundshme se në ato luftëra Partia Bolshevike udhëhiqej nga Lenini e më pas nga Stalini. Por, pas ardhjes në fuqi të revizionistëve, Bashkimi Sovjetik u kthye në një çerdhe armiqsh, të cilët sot ose nesër, për këtë ne s'kemi asnjë dyshim, do të gjejnë vdekjen.

Është fakt se pozitat e revizionistëve sovjetikë janë dobësuar, si brenda në Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe në lëvizjen komuniste botërore dhe në arenën ndërkombëtare. Revizionistët sovjetikë po ecin drejt forcimit të aleancave me imperialistët amerikanë, por këto janë si aleancat e padronit me shërbëtorin, prandaj, pavarësisht se forca ekonomike dhe ushtarake e Bashkimit Sovjetik është e madhe, në gjithë veprimtarinë e revizionistëve sovjetikë duket diktati dhe orientimi i përgjithshëm i politikës së imperializmit amerikan.

Ne shikojmë gjithashtu që ekonomia sovjetike ka marrë të tatëpjetën. Revizionistët sovjetikë nuk janë tani veçse kapitalistë, borgjezë të maskuar që po bëjnë çdo përpjekje të forcojnë prapavijat e tyre dhe, sikurse

thonë ata vetë, ekonominë do ta zhvillojnë vetëm në rrugën kapitaliste. Por në këtë rrugë ata janë dhe do të jenë kurdoherë inferiorë përballë kapitalizmit amerikan.

Hrushovi hodhi shumë parulla bombastike për gjoja zhvillimin e vrullshëm të ekonomisë sovjetike, por profekat e tij u venitën, asgjë s'u vërtetua në jetë, veç të kundërtës. Prandaj, në Kongresin e 23-të që bënë udhëheqësit e rinj revizionistë të Bashkimit Sovjetik, u detyruan të pohojnë një pjesë të vogël të realitetit të tmerrshëm në të cilin ndodhet ekonomia sovjetike. Frika për të folur hapur në kongres tregon se brenda në Bashkimin Sovjetik pozitat e revizionistëve janë dobësuar. Pa pasur as informatën më të vogël, po vetëm duke ndjekur me vëmendje punimet e këtij kongresi del qartë si në pasqyrë se pozitat e udhëheqjes revizioniste sovjetike janë si rrënjët e një peme që po e gërryejnë ujërat, ato janë tronditur së tepërmi, saqë ajo nuk është në gjendje të shprehë qoftë edhe besimin më të vogël për perspektivën.

Ne i njohim mirë revizionistët dhe oportunistët e kohëve të kaluara. Për llafe ata ishin të vetmit, «bomba» hidhnin sa të duash. Kështu, në gjurmët e të parëve të tyre, veprojnë edhe revizionistët e sotëm. Por kësaj radhe në kongresin e tyre nuk guxuan të lëshojnë më «bomba» siç bënte Hrushovi. E çfarë të thoshin? Është fakt se Kongresi i 20-të dhe i 22-të, që hodhën bazat e tradhtisë së tyre, shkaktuan një konfuzion të madh brenda në Bashkimin Sovjetik. Me demagogji ata u munduan të tregonin se lufta kundër gabimeve të Stalinit i gënjeu, por kjo ishte një perde, që nuk do të

mund ta mbulojë qëllimin e vërtetë të revizionistëve.

Pas rrëzimit të Hrushovit dështoi në mënyrë të turpshme fushata antistaliniane. Njerëzit me të drejtë po i vinin në dyshim të gjitha sa ishin, thënë kundër Stalinit nga Hrushovi dhe bashkëpunëtorët e tij, prandaj udhëheqja revizioniste sovjetike u ndodh ngushtë, si të vepronte, të fliste për rehabilitimin e Stalinit apo jo? Pavarësisht sa të vërteta janë informatat që kemi, çështja e rehabilitimit ose jo të Stalinit është vërtitur si një hije e zezë gjatë punimeve për përgatitjen e Kongresit të 23-të. Në klikën revizioniste ka pasur mendime të kundërta. Edhe shumë nga ata që janë për rehabilitimin, ne e kemi të qartë, janë armiq të tërbuar të Stalinit dhe të komunizmit, po këta janë të detyruar të flasin për këtë, se shikojnë që presioni i popullit, i komunistëve dhe i ushtrisë është i madh për këtë çështje. Nga sa dimë, në ushtrinë sovjetike kanë pikëpamje të ndryshme për shumë probleme. Disa thonë se njeriu është faktori kryesor në luftë, kurse armët janë në radhë të dytë, kurse një korrent tjetër i madh përbëhet nga përkrahësit e pikëpamjeve të Hrushovit, të cilët thonë se armët janë faktori vendimtar. Ndjekësit e këtij kursi tradhtar kanë lejuar që në Bashkimin Sovjetik të shkruhen deri romane, në të cilat diskreditohet ushtria sovjetike për luftën që ka bërë kundër fashizmit.

Lufta që bëjnë partitë tona marksiste-leniniste është kolosale, ajo nuk mund të shuhet kurrë, pse kjo është luftë për të ardhmen e proletariatit, të popujve. Ne u themi revizionistëve se ju jeni armiq të tanë, ju jeni kundër marksizmit, ju jeni kundërrevolucionarë, prandaj

ne jemi në luftë me ju dhe nuk do ta shuajmë kurrë këtë luftë, gjersa t'ju shpiem në varr. Ne e kemi të qartë se unitet me revizionistët nuk mund të kemi, pse pikëpamjet tona janë diametralisht të kundërta me të tyre, prandaj bashkëpunimi me ta nga ana jonë nuk mund të vendoset kurrë.

Edhe për çështjen e Vietnamit ata po bëjnë blofe. Luftën e popullit vietnamez ata duan ta mbytin. Përpara kësaj çështjeje të madhe me rëndësi botërore hesh-tja do të ishte një dobësi e madhe, kurse ata heshtin pikërisht se janë të dobët. Veç kësaj revizionistët, cilëndo qofshin ata, kanë shumë frikë. Revizionistët sovjetikë kanë frikë, në radhë të parë, brenda vendit të tyre, nga populli dhe nga komunistët sovjetikë, pastaj ata kanë frikë të madhe edhe nga ne, marksistë-leninistët, nga gjithë popujt revolucionarë të botës.

Revizionistët sovjetikë nuk e zotërojnë më situatën jo vetëm brenda në vendin e tyre, por gjejnë kundërshtime të mëdha edhe nga revizionistët e tjerë. Marksizëm-leninizmi na mëson se nuk mund të ketë unitet në radhët e revizionistëve, ata nuk kanë parime. Ne kemi të dhëna që me të dalë në udhëheqjen revizioniste sovjetike problemi i rehabilitimit të Stalinit, Gomułka dhe udhëheqësit revizionistë të vendeve dhe të partive të tjera revizioniste, të shqetësuar nga kjo ngjarje, i paralajmëruan revizionistët sovjetikë se edhe një grimë sikur të flitnin në favor të Stalinit, ata do të ishin kundër, për arsye se nuk mund të mbaheshin dot më në postet e tyre. Kjo tregon se çatia e shtëpisë së tyre nuk mund të mbahet me kleçka. Këtë na e tregon ligji i historisë, i marksizëm-leninizmit.

Revizionizmi modern është një rrymë e fortë tradhtare që mundi të merrte fuqinë në shumë shtete socialiste të Evropës dhe për një kohë t'i gënjente popujt, por kjo rrymë tradhtare do të vijë vazhdimisht në rënie, marksizëm-leninizmi është i pamposhtur.

Partia jonë e vogël ka mbajtur dhe vazhdimisht do të mbajë qëndrime të drejta marksiste-leniniste në çdo çështje. Ajo ka qenë vazhdimisht konsekuente në vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste. Kush është në vijë të drejtë nuk ka frikë nga askush, nuk ushqen shpresa të kota, po i sheh çështjet drejt, qartë dhe peshon mirë sa i vlen lëkura njerit dhe tjetrit, studion në rrugën marksiste-leniniste të gjitha koniunkturat, di të shfrytëzojë, duke ruajtur parimet, çdo rrethanë, ka të qartë strategjinë dhe taktikën dhe këto i përdor sipas rastit në çdo rrethanë. Kushdo që do t'i gjykojë çështjet kështu si i gjykon Partia jonë, kurrë nuk do të ketë as frikë, as tronditje, goftë edhe një parti, një popull apo vend i vogël.

Imperialistët dhe revizionistët modernë, duke i matur çështjet me metrin e tyre, nuk i kuptojnë dot qëndrimet e Shqipërisë. Si është e mundur, thonë ata, që Shqipëria e vogël të mbajë një qëndrim të tillë? Por tani edhe ata kanë filluar ta shikojnë më mirë realitetin. Shikoni pra, shokë, ç'forcë të madhe i jep politika dhe ideologjia marksiste-leniniste një populli të vogël, edhe pse është i rrethuar gjeografikisht, edhe pse ekonomikisht është jo i fortë. Por ekonominë po e forcojmë, vepra të reja po ngremë çdo ditë me djersën tonë.

Ta gëzojmë, shokë, këtë vepër kaq të bukur që

inauguruam sot, të ndërtuar me duart e arta të punëtorëve, të teknikëve dhe të specialistëve tanë.

Rroftë klasa jonë punëtore!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!

*Botohet për herë të parë, me  
disa shkurtime, sipas origjina-  
lit që gjendet në AQP*

**AI VEND QË E RRIT RININË TË SHËNDOSHË  
POLITIKISHT DHE IDEOLOGJIKISHT, AI BËN  
DHE DO TË BËJË MEDOEMOS PËRPARA**

*Nga biseda me kuadro dhe me aktivistë të organizatës  
së BRPSH të rrethit të Shkodrës*

**29 prill 1966**

**SHOKU ENVER HOXHA:** Rinia e Shkodrës është një rini patriote, revolucionare, e gjallë. Pikërisht për këtë arsye dëshiroja të bisedoja me ju.

Sigurisht, sekretari i parë i Komitetit të Bashkimit të Rinisë të Rrethit të Shkodrës mund të na flasë për problemet e organizatës, por, veç atij, duhet të na flitni edhe ju të tjerët.

*Sekretari i parë i Komitetit të BRPSH të Rrethit të Shkodrës Isa Rama e njohu shokun Enver Hoxha me punën që bëhet për edukimin klasor-revolucionar të rinisë dhe me problemet që është duke u marrë në këtë kohë rinia e këtij rrethi.*

*Udhëheqësja e çetës së pionierit të një shkolle dhe drejtori i shtëpisë së pionierit e vunë në dijeni për punën me pionierët. Pastaj e mori fjalën:*

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ekspozeja që po më bëni është një pasqyrë e mirë për t'u njohur me punën e organizatës së rinisë të rrethit tuaj. Puna me rininë është e një rëndësie të madhe, e gjerë, e shumanshme dhe për ta parë thellë, natyrisht, nuk është i mjaftueshëm ky takim, por sidoqoftë, nga sa diskutuan sekretari i parë i Komitetit të Rinisë të Rrethit, shoqja që merret me pionierët në një shkollë 8-vjeçare të qytetit dhe shoku përgjegjës i shtëpisë së pionierëve të qytetit të Shkodrës, krijova bindjen se njerëzit që i kemi ngarkuar të merren me pionierët, në përgjithësi, janë të pasionuar për këtë punë. Çdo njeri duhet të jetë i pasionuar për punën e vet, por veçanërisht ata që punojnë me organizatën e rinisë, sepse puna me këtë organizatë është me rëndësi të jashtëzakonshme për të ardhmen tonë. Ai vend që ka rininë në dorë, që e rrit të shëndoshë politikisht dhe ideologjikisht, të fortë dhe të përgatitur mirë nga ana kulturore e fizike, ai bën dhe do të bëjë medoemos hapa të mëdhenj përpara.

Partia jonë e ka pasur këtë çështje në plan të parë. Ajo kurdoherë e ka vlerësuar lart rolin e rinisë dhe është përpjekur ta bëjë atë të aftë që ta meritojë këtë mision të madh.

Por në punën për zbatimin e direktivave të Partisë, natyrisht, ne kemi edhe të meta. Sikur Partia të bënte më shumë kujdes për ta ndihmuar më nga afër organizatën e rinisë dhe t'ia përmbushte, sa të jetë e mundur më mirë, nevojat që ka ajo në fabrika, në shkolla, në kooperativa, ne do të kishim rezultate akoma më të mëdha. Sidoqoftë mundësitë ne prapë i ke-



mi dhe në të ardhmen do të krijohen të tjera edhe më të mira.

Duke ndjekur qëllimin tim për t'u ndihmuar nga ana juaj, kisha përgatitur edhe disa pyetje. Shumë prej tyre i sqarova gjatë ekspozesë që bëri shoku sekretar i parë i rinisë i rrethit. Vura re se ai kishte dëshirë të fliste edhe më gjatë, por, natyrisht, koha nuk na lejon. Për t'u kufizuar dhe për qëllimin që thashë, tani dua të bëj disa pyetje të tjera mbi çështjet që nuk i kam akoma të qarta, por shikoni, ato nuk kanë karakter provimi, prandaj mos kini frikë, nuk kam qëllim të shoh si po përgjigjet rinia e Shkodrës. Pyetjet që do t'ju bëj kanë vetëm karakter njohës dhe instruktiv. Unë po i zgjedh ato për të tërë ju, prandaj secili mund të përgjigjet dhe jo vetëm shoku sekretar. Ju do të më ndihmoni me përgjigjet tuaja, në mënyrë që në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror të mund të jap një pasqyrë sa më reale të eksperiencës së organizatës së rinisë të rrethit të Shkodrës dhe të organizatave të tjera, për të nxjerrë disa konkluzione të drejta, në mënyrë që ta ndihmojmë organizatën e rinisë për të punuar edhe më mirë se gjer tani.

A i keni bërë ndonjë studim serioz vijës së organizatës së rinisë, në lidhje me parimet organizative dhe orientimit të përgjithshëm që duhet të ndjekë ajo në bazë të direktivave të Partisë? Si i zbatoni në jetë këtë vijë dhe këto parime, sidomos nga ana organizative? Keni parë, i keni drejt? A u bëni ndonjëherë analizë pak a shumë shkencore? Zbatohen ato në bazë të direktivave të Partisë? Nga analiza që keni bërë, ç'eksperiencë ka, është i drejtë organizimi që keni apo

duhet parë? Është e nevojshme të bëjmë shumë ndryshime apo vetëm disa fare të vogla e të parëndësishme?

Pyetjet mund t'ju duken ca si të çuditshme, se ju vazhdimisht për këto probleme po punoni, por i bëj duke pasur parasysh se tani në vendin tonë janë bërë ndryshime të mëdha, rinia nuk është më ajo e para, sepse ka 20 vjet që edukohet në socializëm. Sot nuk ka të ri dhe të re që të mos vejë në shkollë, të gjithë të rinjtë dhe të rejat tani i kuptojnë mirë çështjet politike, pra rinia e sotme është më e zgjuar, më e kulturuar. Prandaj mos duhen bërë disa ndryshime në këto forma organizative, që ato t'i përshtaten më mirë hovit të madh që ka marrë sot rinia? I keni bërë ju pyetjen vetes, mos ka disa forma që e pengojnë punën e saj, mos ato forma janë të vjetruara e shabllone? Ju tani, vërtet jeni në moshë të re, por jeni të pjekur, te ju nuk ekziston një entuziazëm i zbrazët, por i bazuar. Me këtë dua të them se çdo gjë që bëni, ju e mendoni mirë më parë. Këtu qëndron forca e rinisë dhe e vijës së Partisë sonë. Në qoftë se e keni vështirë për të dhënë përgjigje për këtë pyetje, se mbase u duhet kohë të mendoni, mund ta lëmë tani dhe të më përgjigjeni një herë tjetër, bile më vonë mund të më dërgoni edhe ndonjë letër për të më treguar ç'mendoni për këtë problem.

Punën e letrave shokët e bazës sikur e kanë harruar. Ata përpiqen që çdo gjë ta bëjnë në kanale zyrtare, me protokolle. Por çdo njeri për punën e vet, për punën e Partisë ose të rinisë, kur ka mendime dhe propozime për të bërë, mund të më dërgojë një letër

edhe mua, apo shokëve të tjerë të udhëheqjes. Një komunikim i tillë është shumë i mirë dhe tregon afrim, jo zyrtarizëm. Ja, në këtë takim, ju më dhatë shumë mendime të vlefshme për çështjen e rinisë punëtore dhe fshatare, të cilat ne duhet të na bëjnë të reflektojmë.

Mendoni ju se puna që bëni me rininë është e diferencuar, për kategori të ndryshme të rinjsh dhe të rejash, nga pikëpamja e moshës, e seksit, e vendit të punës, e krahinave me zakone të ndryshme, në lidhje me shkallën e ngritjes së saj politike, ekonomike dhe shoqërore, apo punës së diferencuar e të larmishme, nuk i vini rëndësinë e duhur? Mos zhvillohet puna në të gjitha këto njëlloj? Diferencat ekzistojnë kudo, ndryshe është problemi i vajzës fshatare, ndryshe i vajzës punëtore, i asaj të qytetit dhe i asaj të fshatit, i të rinjve dhe i të rejave, prandaj puna e organizatës nuk mund të bëhet njëlloj në çdo vend, në mënyrë shabllone. Vajza e fshatit nuk flet dot si ajo e qytetit, e cila është më e zhvilluar. Te vajzat e qytetit nuk ekziston turpi mikroborgjez në atë shkallë si te fshataret. Ose siç mund t'i flasim hapur një të riu, nuk mund të flitet në të njëjtën mënyrë me një vajzë, kësaj duhet t'i marrësh krahët për të arritur atje ku synon organizata, që ajo ta kuptojë drejt problemin. Pra, mendoni ju, për të bërë një punë të diferencuar në përgatitjen e agjitacionit dhe të propagandës me shtresat e ndryshme të rinisë?

*SHOKU ISA RAMA:* Ne bëjmë punë të diferencuar me shtresat e ndryshme të rinisë, me rininë kooperativiste, me rininë punëtore e shkollore, me djemtë e

me vajzat, me rininë e zonave malore, si dhe me pionierët, por kjo është më tepër një punë në vija të përgjithshme.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Që të arrijë të bëjë një punë të diferencuar me rininë, organizata duhet të njohë mirë karakteristikat e një zone. Mësuesi i Gurit të Zi, për shembull, rron vazhdimisht në fshat, ai njih zakonet e fshatit, di se disa prej burrave dhe grave e hedhin hapin më përpara, të tjerët janë më të prapambetur, disa të reja janë më të zhvilluara dhe energjike, të tjerat janë më të druajtura dhe kanë nevojë të ndihmohen që të ecin krahas shoqeve. A mund t'u jepni ju materiale arsimtarëve të fshatit që të bashkëpunojnë me organizatën e rinisë për këtë qëllim? Bëni ju leksione për rininë me tema edukative si, për shembull, për mirësjelljen, për dashurinë etj.? Kur i jepni udhëzime organizatës së rinisë të një fshati, i keni parasysh këto veçori dhe si? Prandaj sa thellë duhet të mendohet për mësuesit që të ndihmohen për t'u aktivizuar në punët e organizatës së rinisë nën drejtimin e Partisë? Ka rëndësi të bëhet një punë e tillë, se në vendin tonë është e vërtetë që sa vete e zvogëlohen diferencimet midis shtresave të ndryshme të rinisë, është e vërtetë që është bërë një revolucion i madh në pikëpamjen e afirmimit të të drejtave të barabarta të vajzave dhe të djemve e të marrëdhënieve midis tyre, po megjithatë, duhet të jemi realistë, diferencimet ekzistojnë akoma.

Një shok këtu tha se e njih jetën e fëmijëve dhe ka vënë re se vajza, kur shkon në shkollën 8-vjeçare, megjithëse është plot gjallëri, tërhiqet nga disa akti-

vitete. Këtu ndikojnë disa rrethana shumë negativisht se, po të hapet një fjalë jo e mirë, kjo e dëmton atë. Prandaj vajzat druhen, megjithëse e dinë që të drejtat i kanë njëlloj si djemtë, e dinë që kanë mbrojtjen e Partisë dhe të organizatës të rinisë. Por, nga ana tjetër, ato dinë gjithashtu se edhe opinioni luan rol dhe ne jemi akoma në një nivel të tillë që nuk mund t'i likuidojmë plotësisht thashethemet. Po luftën kundër tyre ta vazhdojmë të rreptë. Nëse njëri sillet në mënyrë të papëlqyer, pse ne të lejojmë që rinia të tërhiqet nga aktivitetet, ose prindi ta dënojë vajzën duke kufizuar veprimtarinë e saj? Ashtu sikurse djemtë, edhe vajzat kanë të drejtë të punojnë, të luajnë, të dëfrenë brenda rregullave të shoqërisë. Opinioni shoqëror edhe në këto aspekte të jetës shoqërore luan një rol të rëndësishëm, prandaj sa më shumë ta përpunojmë këtë me një punë të dendur politike, aq më tepër do të luftohen thashethemet, e si rrjedhim vajzat do të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet. Kështu do të pakësohet diferencimi që ekziston sot midis tyre dhe djemve.

Sot ne jemi të detyruar të mos e atakojmë frontalisht opinionin e pagdhendur, se kjo nuk është një punë e lehtë, por me këtë nuk dua të them që rinia jonë t'i nënshtrohet një opinioni të tillë. Në zbatimin e vijës ne do të bëjmë disa manovrime, pa harruar qëllimin kryesor, atë të forcimit të gjithanshëm politik të rinisë sonë, në mënyrë që ajo të jetë në gjendje t'u vërë shqelmin këtyre mbeturinave dhe opinionit të pagdhendur, të jetë rinia që t'u imponojë këtyre qëndrimet e saj të drejta.

Si mund të bëhet që ne të ngremë nivelin e çdo

shtrese të rinisë? Natyrisht, për këtë ka shumë forma pune, si me konferenca, me libra, me artikuj etj., por këto sikur nuk mbahen parasysh nga organizata. Po si mund të bëhet kjo? Unë mendoj se një shoku, që punon me organizatën e rinisë, në qoftë se i ngarkohet të bëjë një temë për rëndësinë e lirisë së fjalës në vendin tonë, duhet të ketë parasysh që ky material të bëhet i kuptueshëm për të gjithë, edhe për masën e rinisë, edhe për banorët e malësisë, ku fjala liri ekziston, ku këtë liri ia garanton vetë socializmi, po gruaja atje në realitet e ka akoma vështirë të flasë. Atëherë aktivisti i organizatës së rinisë, që mund të jetë edhe një letrar i ri, përgatit një novelë të tillë që t'u pëlqejë edhe plakës, edhe plakut malësor, po njëkohësisht, edhe vajzës t'i japë shembullin se si ajo, me qëndrimin që do të mbajë ndaj ngjarjeve në jetë, me fjalën e guximshme që do të thotë, të fitojë respektin e babait dhe të nënës së vet. Kështu novela të arrijë atë qëllim edukativ, për të cilin kemi nevojë.

Ose për punën me fëmijët. Disa ankohen se u mungon literatura e nevojshme për edukimin e pionierëve, po në këtë drejtim kush mund të shkruajë më mirë se mësuesit? Në Shkodër unë di që vetëm rrallë ndonjë arsimtar, si Teufik Gjyli, shkruan për fëmijë. Po të isha mësues, do të kisha përgatitur më tepër se 20 hartime të mira dhe do të afirmohesha si shkrimtar për fëmijë. Mësuesi i do shumë fëmijët, prandaj edhe ata e duan shumë atë. Këta shkojnë dhe e pyesin mësuesin për çdo gjë, bëjnë si u thotë ai. Mësuesi i mirë njih botën e brendshme të fëmijëve, njih mirë dëshirat, mendimet dhe nevojat që ata kanë për edukim. Në

këto kushte mësuesi mund të shkruajë shumë gjëra të bukura për ndjenjat e tyre të natyrshme. Ky do të ishte një burim për të realizuar edukimin e shëndoshë me tema nga më të ndryshmet. Po sa mësues kemi në vendin tonë! Po të punojnë të gjithë me këtë preokupim, të tilla materiale do të ishin një ushqim i madh për edukimin e pionierëve.

Ju folët për drejtimin e pamjaftueshëm të organizatës së pionierit. Ju, si udhëheqëse profesioniste, ndieni më shumë drejtimin e organizatës së rinisë në organizatën e pionierit apo frymën, ndikimin e gjithë punës edukative të shkollës, të personelit mësuesor?

**NJË UDHËHEQËSE PIONIERËSH:** Në organizatë ndihet më shumë ndikimi i shkollës. Prandaj them se në goftë se shkolla do ta kapë seriozisht këtë problem, ajo mund të bëjë shumë më tepër.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Jam dakord që mësuesit duhet të mendojnë dhe të punojnë në mënyrë të tillë që në shpirtin e tyre të kenë preokupacion kryesor edukimin e fëmijëve. Mësuesi ka ndikim të madh te nxënësi, ai është i edukuar me frymën e Partisë, e njëj vijën e saj dhe bën të gjitha përpjekjet që fëmijën ta edukojë sa më mirë. Puna edukative e mësuesit nuk duhet të kufizohet në një punë të thjeshtë mësimore, sa për të mësuar lëndën, por ajo të synojë edhe për kalitjen shpirtërore, për edukimin e fëmijëve që i janë besuar. Ai e ka për detyrë ta bëjë një punë të tillë. Sot te ne, organizata e pionierit varet drejtpërdrejt nga organizata e rinisë, kurse për edukimin e pionierëve jashtë shkollës duhet të punojnë më shumë të gjithë mësuesit e saj, ti, pastaj, nuk do të jesh e vetme në këtë

punë. Ti mund të jesh udhëheqëse profesioniste, por po të interesohet më shumë shkolla, s'ka dyshim që do të kesh një ndihmë të madhe nga të tërë mësuesit. Edhe ata duhet ta ndiejnë përgjegjësinë e madhe që kanë për edukimin dhe argëtimin e nxënësve. Mësuesit duhet të bëjnë njëkohësisht edhe atë punë që bën ti, domethënë të jenë me nxënësit edhe mësues, edhe shokë. Në këtë drejtim, mendoj, nuk ka ndonjë rrezik. Ju vetë thatë që po të interesohen më shumë mësuesit, pionierët do të marrin një edukatë më të mirë.

Kam edhe një pyetje për rininë shkollore. Në «Zërin e rinisë» para nja dy muajsh është botuar një artikull kritik, lidhur me marrëdhëniet e rinisë shkollore me shkollën. Shokët e Komitetit Qendror të Rinisë bënë autokritikë për botimin e këtij artikulli, po dua t'ju pyes, si e keni kuptuar ju përmbajtjen e tij? Marrëdhëniet tuaja me shkollën në drejtim të punës me rininë i konsideroni të drejta dhe a duhet të ekzistojë bashkëpunimi midis organizatës së rinisë dhe personelit mësues? Këtu nuk është çështja për të bërë lojë fjalësh, duke përdorur termin e «edukimit unik» të rinisë nga ana e shkollës.

*Shoku Enver Hoxha shpjegoi përmbajtjen e termit «drejtimi unik» i shkollës, për të cilin ka folur edhe në datën 21 shkurt 1966<sup>1</sup>. Pastaj vazhdoi:*

Mund të na thoni ju shoku i rinisë së gjimnazit, keni pasur ndonjëherë mosmarrëveshje parimore me

---

1 Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 31, f. 295.



personelin mësitor, keni qenë ndonjëherë në kundërshtim me rregulloret e shkollës dhe, në qoftë se keni pasur kundërshtime, përse i keni pasur e si i keni zgjidhur këto? Apo keni gjetur mirëkuptim me personelin mësitor?

**SEKRETARI I RINISË I GJIMNAZIT:** Vitin e kaluar ishim në aksion. Shtabi i brigadës së rinisë bashkëpunonte ngushtë me mësuesit dhe merrte udhëzime e këshilla prej tyre. Edhe kur të dalim në jetë, ne do të kemi akoma nevojë për këshillat e mësuesve tanë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ti si sekretar i organizatës së rinisë të shkollës merr pjesë në mbledhjet e këshillit pedagogjik? Po në takimet që bëjnë mësuesit me prindërit?

**SEKRETARI I RINISË I GJIMNAZIT:** Nuk marr pjesë as në mbledhjet e këshillit pedagogjik dhe as në takimet që bëjnë mësuesit me prindërit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nuk keni nevojë ju që ata t'ju thonë se filan nxënës nuk shkon mirë me mësime, ai tjetri ka bërë këtë gjë të papëlqyer etj.? Nuk keni nevojë që drejtori apo mësuesi kujdestar t'ju thotë: «Shoku sekretar i rinisë së shkollës, unë dëshiroj të bisedoj pak me ty, sepse konstatojmë që disiplina në shkollë po dobësohet, ose jashtë në oborrin e shkollës gjatë pushimeve ndërmjet mësimit nga ndonjë i ri, dëgjohen fjalë jo të përshtatshme, të cilat nuk i shkojnë edukatës së rinisë sonë». Nuk keni ju nevojë t'ju vërë në dijeni personeli i shkollës për këto gjëra?

**SEKRETARI I RINISË I GJIMNAZIT:** Ne kemi shumë nevojë për gjëra të tilla, sidomos për arsye se

disa fenomene mund t'i kapim më vonë nga këshilli pedagogjik, nga drejtoria ose nga organizata-bazë e Partisë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po pse nuk e bëjnë ata një gjë të tillë?

*SEKRETARI I RINISË I GJIMNAZIT:* Gjer në njëfarë shkalle kjo ndihmë varet edhe nga qëndrimi ynë, sa ua kërkojmë ne këtë ndihmë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po sekretari i organizatës-bazë të Partisë të shkollës merr pjesë në mbledhjet e këshillit pedagogjik dhe në takimet e personelit mësimor me prindërit?

*SEKRETARI I RINISË I GJIMNAZIT:* Po, ai merr pjesë, se njëkohësisht është edhe vetë mësues.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po të isha në vendin tënd do ta merrja iniciativën dhe do t'i thosha drejtorit: «Shoku drejtor, unë dëshiroj të bëj një diskutim me ju, kërkoj të më jepni ndihmë që organizata e rinisë të ndihet më shumë në shkollë. Prandaj kur ta gjeni të arsyeshme kërkoj që të marr pjesë edhe unë në disa nga mbledhjet e këshillit pedagogjik për të çuar më mirë e më drejt porositë e tij, frymën e shkollës dhe të drejtorisë në mbledhjet e organizatës së rinisë».

Jam i bindur se drejtori do të pranojë që ti të marrësh pjesë. Drejtuesit e organizatës së rinisë të shkollës mund të marrin pjesë në këto mbledhje kur trajtohen probleme që u takojnë nxënësve, sjelljes, përparimit të tyre etj. Sidoqoftë ky është një problem që duhet parë dhe nuk mund të flasim e të vendosim

në mënyrë të prerë për këtë, pa dëgjuar edhe argumentet e atyre që e kanë vendosur një rregull të tillë.

A ka raste që ju, drejtuesit e organizatës së rinisë në shkollë, që jeni njëkohësisht edhe nxënës, merrni anën e mësuesit, kur ndonjë nxënës në klasë mban qëndrime jo të pëlqyera ndaj mësuesit të vet dhe ky me të drejtë detyrohet të mbajë qëndrim ndaj nxënësit? Ju si organizatë e rinisë në këtë rast merrni iniciativën për ta gjykuar e për ta kritikuar shokun tuaj që ka mbajtur qëndrim të gabuar dhe t'i thoni mësuesit të mos shqetësohet, t'i thoni se ju e kuptoni që ky apo ai nxënës u soll keq me të, se qëndrimin e sjelljen e tij ne nuk e aprovojmë, se për këtë do ta kritikojmë në organizatë etj. Ndodh një gjë e tillë? Në qoftë se po, kjo tregon personalitetin e organizatës dhe bën që mësuesit të marrin masa të drejta ndaj nxënësve që gabojnë. Mësuesi duhet të respektohet.

Por mund të ndodhë që një mësues të marrë dhe një masë të nxituar, jo të drejtë ndaj një nxënësi. Atëherë përsëri, përgjegjësi i organizatës së rinisë të klasës, mënjanë dhe me takt, mund dhe duhet t'i thotë mësuesit se më duket i nxituar qëndrimi ndaj atij nxënësi, prandaj sikur ta rishikoni me gjakftohtësi masën që morët ndaj tij. Jo vetëm organizata, po edhe sekretari i rinisë i shkollës duhet të krijojë personalitetin e vet, në kuptimin që në disa drejtime ai të ndërhyjë kur mësuesi duhet përkrahur, kur e ka drejt ose t'i bëjë një vërejtje me vend kur ai mban qëndrim të nxituar ndaj një nxënësi. Kështu mësuesi do të të shikojë ty me respekt si sekretar të rinisë dhe do të bisedojë me ty në platformën e marrëdhënieve të më-

suesit me përfaqësuesin e rinisë shkollore. Natyrisht në këto raste sekretari i rinisë duhet të jetë gjakftohtë dhe jo nervoz, edhe sikur mësuesi të ketë shumë gabim. Ky, kur do t'i drejtohet mësuesit, ta godasë, si të thuash, me pambuk. Mësuesi edhe mund të nxehet me të, po të jeni të sigurt, më vonë, pasi t'ia kesh bërë vërejtjen, ai do të reflektojë se sekretari i rinisë u soll drejt dhe do të kërkojë nga vetja të jetë gjakftohtë në marrëdhëniet me të herën tjetër.

*SHOKU ISA RAMA:* Ne mendojmë se edhe Universiteti Shtetëror që përgatit mësues për shkollat e mesme e 8-vjeçare duhet të bëjë diçka më shumë në drejtimin që studentët që do të mbarojnë për të dhënë mësim në këto shkolla, të dinë të komunikojnë më mirë me të rinjtë, se ka pedagogë që mundohen të qëndrojnë të shkëputur nga nxënësit e tyre, të mbajnë njëfarë autoriteti dhe harrojnë se edhe ata vetë dikur kanë qenë nxënës.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kjo vjen nga një koncept jo i drejtë. Duhet ta kuptojmë se kur një i ri mbaron shkollën e mesme dhe shkon në universitet, mendon, dhe në realitet kështu është, se tani ai kaloi në një stad tjetër të jetës, në kuptimin që është ca më i lirë. Të gjithë e kemi ndier një gjë të tillë. Edhe unë, kur mbarova shkollën e mesme dhe fillova të ndiqja universitetin, kam ndier një besim më të madh në veprimet e mia. Natyrisht, tek intelektualët e vjetër zinte vend pikëpamja e huaj për ne se me diturinë që do të merrnin, të ishin superiorë ndaj të tjerëve. Ky mentalitet ishte i theksuar për arsye se në të kaluarën kuadrot me arsim të lartë numëroheshin me gisht. Bile

edhe midis tyre kishte diferenca, kategori të ndryshme. Avokatët dhe gjykatësit, për shembull, ishin njerëzit më të preferuar të regjimit, sepse, kuptohet, ata mbronin ligjet e borgjezisë. Mjekët kishin të zhvilluar tendencën e fitimit material, të pasurimit në kurriz të shëndetit të popullit. Këto ishin profesionet më të preferuara në atë kohë për ata që do të ndiqnin universitetin. Megjithatë, të gjithë ata që mbaronin shkolla të larta, në përgjithësi ishin njerëzit më të privilegjuar. Edhe ata që kryenin studimet në shkencat humanitare mendonin se pa ta vendi ynë nuk mund të ecte dot përpara. Argumentet e tyre ishin argumentet e intelektualëve borgjezë e mikroborgjezë që synonin të kishin në çdo gjë epërsi mbi të tjerët dhe të shfrytëzonin diturinë për interesat e tyre. Të edukuar me një pikëpamje të tillë, ata mendonin të zgjidhnin çdo kundërshtim që do të hasnin përpara, sipas pikëpamjeve të tyre borgjeze, se këto kundërshtime do t'i spastronin vetëm me pamjen e tyre prej «doktori» apo «shkencëtari», kurse të tjerët duhet t'u përulëshin argumenteve të tyre.

Por tani ata që mbarojnë universitetin nuk kanë të tilla pikëpamje. Këto pothuajse janë zhdukur. Megjithatë, në qoftë se Partia nuk punon mirë me të rinjtë e universitetit, këto pikëpamje, sado të zbehta që ekzistojnë, dalngadalë mund të forcohen dhe të na bëhen problem. Prandaj edhe një arsimtar që ka kryer studimet e larta, në qoftë se Partia nuk e mban afër, nuk punon me të, ai do ta harrojë të kaluarën e tij, do të harrojë se edhe ai dikur ka qenë i ri dhe ka dashur që mësuesit e tij të ishin më të afruar me

të, kurse tani për vete ka frikë se, po të bjerë në rrogos me nxënësit, po të jetë i afruar me ta, do ta humbasë autoritetin, prandaj që «të mos i dalë boja», u qëndron larg nxënësve, mban një qëndrim të kundërt nga ai që dëshironte kur ishte vetë nxënës. Kështu, organizata e Partisë detyrohet ta lajë atë me vaj e me uthull. Por, si kalojnë disa vjet pas mbarimit të mësimeve, ky e kupton se qëndrimi i tij nuk është i drejtë. Prandaj organizata e Partisë dhe ajo e rinisë e kanë për detyrë të punojnë me arsimtarët e rinj, që këta të mos na shpëtojnë nga duart, të mos infektohen nga pikëpamjet e intelektualëve të vjetër se ka edhe të tillë që, megjithëse mbarojnë shkollat që ka hapur Partia, ngaqë nuk është punuar mirë me ta, arrijnë në sjellje të papëlqyera.

A ka konflikte shoqërore, të ç'natyre janë ato në shkollë? Të çfarë shkalle janë dhe si shfaqen në mes rinisë, në mes djemve dhe vajzave, në mes nxënësve dhe punëtorëve, në mes punëtorëve të rinj dhe fshatarëve të rinj? Si i zgjidhni ju këto konflikte nga ana teorike dhe politike? Natyrisht, mund të na flitni për këto probleme në qoftë se ka. Ka ndonjë rast që studenti të ketë përçmim për punëtorin, djali për vajzën? Ose më i rrituri të nënvleftësojë më të voglin?

**SHOKU ISA RAMA:** Konflikte të dukshme që të jenë bërë problem për organizatën nuk ka pasur, por diferencime midis nxënësve të rritur dhe atyre të klaseve më të ulëta, midis nxënësve dhe punëtorëve ka, në pikëpamjen që ndonjë nxënës ose student të thotë: «E mo, ai një punëtor është».

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ekziston në radhët e

rinisë mendimi që të tërë nxënësit e shkollave të mesme duan të venë në universitet? Në qoftë se është i theksuar ky mendim, nuk shpreh kjo një nënvleftësim për punën dhe punëtorin?

**SEKRETARI I RINISË I GJIMNAZIT:** Në shkollën tonë shumica e maturantëve shfaqin dëshirën për të vazhduar shkollën e lartë, por ka mjaft prej tyre që kërkojnë të shkojnë në degët më të lehta.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shfaqin, për shembull, nxënësit e shkollës suaj dëshirën për të shkuar në parkun automobilistik dhe së bashku me rininë punëtore të bëjnë një ekskursion ose të marrin përsipër të dyja palët një aksion? U bie atyre ndër mend një gjë e tillë? Kur vjen dita e punës praktike, e punës në prodhim, nxënësit venë në fabrikë entuziastë apo paraqiten si të lodhur dhe pa qejf? Çështjen e kam, lënë përshtypje te të rinjtë puna prodhuese dhe lidhjet me klasën punëtore, ç'ndikim kanë këto në rini? Që në shkollën 8-vjeçare rinia duhet të marrë edhe shprehitë e para të punës, sepse djali ose vajza në këtë shkollë arrijnë moshën 14-15 vjeç. Shkolla duhet t'i futë këta në punë të dobishme shoqërore dhe t'i edukojë deri në atë shkallë sa të duan edhe lulet, bimët dhe kafshët.

**SEKRETARI I RINISË I GJIMNAZIT:** Ne përpiqemi ta edukojmë rininë me frymën e aksioneve të mëdha të viteve të para të Çlirimit. Kemi menduar të ndër marrim disa aksione të përbashkëta me rininë punëtore, si rregullime rrugësh etj. Do të mundohemi ta bëjmë këtë.

Kurse puna praktike, shoku Enver, po lë përshtypje të mirë te nxënësit. Këta kanë respekt për

rininë punëtore. Shkolla jonë e bën punën praktike në një ndërmarrje industriale, po atje nuk ka front pune për të gjithë ne.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Këtu u tha se në qytetin tuaj janë shtuar shumë klasat e shkollave të mesme, prandaj ndërmarrjet e qytetit e kanë të vështirë t'u hapin front pune të gjithëve. Ne jemi duke studiuar raportin që duhet të kemi midis shkollave të arsimit të përgjithshëm dhe teknikumeve. Ky është një problem i madh. Por gjimnazet do të na duhen edhe në të ardhmen. Mund të mos hapim të tjera të reja, po ato që janë do të vazhdojnë të mbahen hapur. Megjithatë këto nuk do t'i përfshijnë dot të gjithë të rinjtë që do të dëshironin të ndiqnin shkollat e mesme në vitet e ardhshme, prandaj duhet të hapim patjetër teknikume të reja. Kjo nevojë na vë detyrën të mendojmë që të përgatitim kuadro edhe për këto shkolla. Po nuk janë vetëm teknikumet që do të kenë nevojë në këtë drejtim. Të gjithë kërkojnë kuadro të lartë. Ja, vetë organizata e rinisë ka nevojë për kuadro të lartë në udhëheqje të saj, për kuadro të lartë kanë nevojë shtypi, organet e pushtetit etj., me një fjalë të gjithë sektorët. Shkenca zhvillohet, prandaj duhet të mendojmë për të siguruar kuadrot e lartë për nevojat e së ardhmes në të gjitha degët, gjer tek arkeologjia. Ne tani kemi pak arkeologë, këta janë fare të pamjaftueshëm për perspektivën, ku do të na duhen shumë të tillë, prandaj duhet t'i përgatitim që tani. Neve na duhen gjithashtu kuadro edhe për sektorin e rëndësishëm të gjeologjisë. Nëntoka e Shqipërisë ka akoma minerale të pazbuluara. Me gjithë përparimet që



kemi bërë, sa prapa jemi në këtë drejtim, sa gjëra i duhen e do t'i duhen vendit tonë! Po inxhinierë mekanikë sa duhen? Sa të duash! Këta hyjnë kudo. Ky problem nuk zgjidhet dot menjëherë. Të gjitha këto nevoja neve do të na i plotësojë universiteti, ku do të dërgojmë jo vetëm gjimnazistë, po edhe nga ata që mbarojnë teknikumet.

Kisha edhe një pyetje tjetër: Ç'qëndrim mban rinia e Shkodrës në lidhje me fenë? Si shfaqen mbeturinat fetare në jetën e të riut dhe të së resë? Shkojnë këta në kishë, në pagëzime, mbajnë ramazan etj.? Ç'qëndrim mban rinia ndaj zakoneve të vjetra prapanike? Ç'qëndrim mban ajo ndaj prindërve dhe familjes? Ç'qëndrim mban ndaj dashurisë? Si i përballon rinia shkollorë e rritur nevojat minimale financiare jashtë nevojave për mjete mësimore, për shembull, për të blerë ndonjë libër, për të vajtur në kinema, për një akullorë etj.? Në përgjithësi rinia jonë tregohet ekonomë, por a ka mosmarrëveshje në këtë drejtim me prindërit? Në rininë e qytetit të Shkodrës a ka tendenca luksi apo atë e karakterizon thjeshtësia dhe ç'metodë përdorni ju për ta ruajtur rininë nga këto rreziqe?

*SHOKU ISA RAMA:* Në qëndrimin ndaj fesë qyteti ka veçoritë e veta, fshati të vetat, bile veçoritë duken edhe në qëndrimin ndaj fesë katolike e asaj myslimane.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Duhet ditur që xhamia ka qenë e ndaluar për femrën. Karakteristika e kësaj feje është që gruan kërkon ta mbajë të mbyllur në shtëpi, megjithatë nëpër disa nga xhamitë ka pasur

një dhomë të veçantë edhe për gratë, të ndarë me kafaz nga pjesa ku faleshin burrat. Por edhe në këtë dhomë shkonin vetëm plakat, jo të rejat.

*SHOKU ISA RAMA:* Ka akoma një pakicë të rinjsh që në raste festash fetare, si për pashkë, për krishtlindjet etj. frekuentojnë kishën.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po si mendoni ju, ata shkojnë në kishë për shkak të bindjeve fetare, apo se i tërheq forca e zakonit, për të mos u prishur qejfin babait ose nënës, apo për t'u takuar me njëri-tjetrin?

*SHOKU ISA RAMA:* Ka edhe të rinj e të reja që në kishë venë, sepse kanë mbeturina fetare në ndërgjegjen e tyre, po shumica venë se kisha është vend grumbullimi, vend për t'u parë me njëri-tjetrin, sidomos në fshat.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Mban meshë prifti në kishë? Po një njeri që dëshiron të marrë fjalën kur flet prifti, mund të ngrihet dhe të flasë, apo kjo gjë mund të bëhet pas meshës?

*NJË SEKRETARE E KOMITETIT TË RINISË:* Jo, këtë mënyrë nuk e lejojnë rregullat fetare.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po në oborrin e kishës, porsa mbaron mesha, mund të flasë njeriu? Rinia, për shembull, mund të përgatitë një propagandist të mirë, i cili pret jashtë oborrit të kishës të mbarojë mesha. Mbasi dalin të gjithë besimtarët, ai mund t'i drejtohet priftit dhe t'i thotë: «Imzot, ti fole në kishë për Shën Thomanë, mund të na shpjegosh, është e vërtetë një ngjarje e tillë?» dhe i fton të tjerët që kanë dëgjuar meshën të qëndrojnë. Pasi mbaron prifti shpjegimin, atëherë propagandisti kthehet dhe i drejton atij shumë

pyetje, gjersa ta vërë në rrugëkryq. Po ama organizata duhet t'i përgatitë mirë këta njerëz dhe mundësi ka, se kudo ka literaturë ateiste shkencore. Disa libra të tillë kam edhe unë. Në një libër me përmbajtje ateiste që kam, jepen argumente të kundërta nga ato të dogmave dhe liturgjive fetare. Për shembull, për çështjen e ngjalljes së Krishtit, që predikon feja, ose për çështjen e rrëfimit gjithashtu, ky libër flet mjaft dhe, me fakte, të tëra i rrëzon si teori. Por ne nuk e bëjmë një gjë të tillë. Në qoftë se duam të zhdukim mbeturinat fetare, rinisë duhet t'i japim më shumë mundësi dhe materiale të lexojë, në mënyrë që të përfitojë prej tyre. Atëherë ajo e ka më të lehtë për t'i mundur këto mbeturina që akoma janë të forta. Priftërinjtë katolikë janë njerëz të përgatitur, prandaj duhet të mendojmë që më parë të përgatitim edhe ne njerëzit tanë që me argumente të rrëzojnë teoritë idealiste fetare, në mënyrë që populli gradualisht të çlirohet prej tyre, të shikojë, të kuptojë e të nxjerrë konkluzione vetë se nuk janë asgjë ato që thotë prifti, se ato janë vetëm përralla.

Natyrisht, duhet të kemi kujdes që të mos preken direkt ndjenjat fetare të popullit, prandaj duhet menduar për të gjetur format si ta bëjmë këtë punë. Mund, për shembull, që jashtë kishës, jashtë predikimeve fetare, të bëhen biseda ateiste shkencore si në oborrin e kishës, në rrugë afër saj etj. Në punën tonë ateiste, për ta demaskuar fenë, mund të përdoren shumë pika të dobëta të saj. Feja katolike, për shembull, kërkon nga prifti që askujt të mos i tregojë kurrë sekretet e atyre që shkojnë në kishë dhe rrëfihen, qofshin këta

edhe kriminelë. Këtë duhet ta shfrytëzojmë. Ne nuk e kemi vështirë të marrim vesh cilët janë ata që bëjnë krime ose jetë të shthurur dhe që, për «të lehtësuar» ndërgjegjen, për «të larë» mëkatet, venë rrëfihen te prifti. Në këto raste ne mund t'i themi popullit që filan njeri, mbasi ka bërë këtë apo atë faj ose krim, ka shkuar e i është rrëfyer priftit dhe ky i është lutur zotit t'ia «lajë» mëkatet dhe njëkohësisht mban sekret krimin, pra vepron në kundërshtim me ligjet e shtetit. Prandaj të mendojmë të përgatitim kundërpropagandistë për këtë punë, si dhe të gjejmë forma e mënyra që prifti të bjerë brenda dhe besimtarët që frekuen-tojnë kishën, pas këtyre debateve, të shikojnë se ç'është feja.

Pyetjeve të tjera që ju bëra nuk u jeni përgjigjur akoma. Si e kuptojnë të rinjtë dhe të rejat dashurinë? Dashuria është një hap i rëndësishëm përpara në jetën e njeriut, kur ajo është e sinqertë. Këtu nuk e kam fjalën për veprimet e nxituara të ndonjë të riu, por a e kupton drejt rinia këtë çështje si një nga më të rëndësishmet e jetës? Po ju, shokë të organizatës së rinisë, e prekni këtë problem në organizatë, apo i shmangeni? Jeta është jetë, prandaj edhe në çështjen e dashurisë ne duhet ta drejtojmë rininë në rrugë të mbarë, të drejtë.

Në përgjithësi në shkollën e mësme i riu shoqen e vet të klasës e konsideron vetëm shoqe dhe marrëdhëniet në mes tyre janë të shëndosha. Gjersa shohim që këto marrëdhënie janë të shëndosha, shoqërore, atëherë përse të ketë pëshpëritje? Ka njerëz që po të shohin një djalë që bisedon me një vajzë, të ci-

lën e ka shoqe në shkollë apo në klasë, flasin vesh më vesh, thonë ja, shikoni, ata «dashurohen», «u fejuan», domethënë fjalë të kota, të dëmshme. Natyrisht këta nuk bëjnë aspak mirë, se pengojnë vajzën të ketë shoqëri të shëndoshë me shokët e vet të shkollës ose të punës. Prandaj duhet punuar, sidomos me rininë, që të dallohet ç'është shoqëria, ç'është miqësia dhe ç'është dashuria. Natyrisht, kur dy të rinj, vajzë dhe djalë, janë në një klasë, puna e sjell që ata të bisedojnë me njëri-tjetrin, sidomos për problemet e shkollës dhe të mësimeve, mund të bisedojnë për probleme të organizatës, për çështje shoqërore etj., sepse janë shokë. Por me kohë ata mund të kuptohen me njëri-tjetrin më mirë, pra mund të bëhen edhe miq për tërë jetën. Gjatë marrëdhënieve të tilla shoqërore ose miqësore nuk përjashtohet rasti që midis tyre të lindë edhe ndjenja e pastër e dashurisë, e cila duhet të mos kalojë në rrugë negative. Por gjersa dy të rinj, vajzë dhe djalë, janë vetëm shokë ose miq, gjersa nuk kanë asnjë marrëdhënie dashurie midis tyre, përse të hapen fjalë për të tilla marrëdhënie, aq më tepër fjalë në kuptim të keq? Një vajzë, nxënëse, mund të qëllojë që sot bisedon me një shok të klasës për një problem, nesër ajo mund të bisedojë për çështje të mësimit me një shok tjetër të klasës, një herë tjetër, duke dalë nga shkolla, ajo mund t'i thotë një shoku të klasës që e ka komshi të shkojnë së bashku në shtëpi, ose të shëtisin në park. Këto janë marrëdhënie normale midis të rinjve, po njerëzit e paformuar, konservatorë, nuk i shikojnë me sy të mirë dhe flasin vend e pa vend. Të tilla thashethemë duhet të luftohen me vendosmëri dhe

të punohet që të forcohen në rrugë të shëndoshë miqësia dhe shoqëria midis nxënësve e nxënëseve, punëtorëve dhe punëtoreve, kooperativistëve dhe kooperativisteve. Në rastet kur miqësia shndërrohet në dashuri, kjo të mos konsiderohet si diçka e jashtëzakonshme, jashtë rregullave etj., pse dashuria është një ndjenjë e natyrshme dhe e gëzuar në jetën e njeriut, pas së cilës vjen fejesa dhe martesja. Këta janë faktorë pozitivë, këtej do të kalojnë i riu dhe e reja, por këto duhet të bëhen në rrugë të drejtë. Gjersa bëhet kështu, dashuria e një djali me një vajzë nuk duhet të konsiderohet si diçka joserioze. Prandaj kur marrëdhëniet e shoqërisë, të miqësisë apo të dashurisë midis dy të rinjve ndjekin zhvillimin e tyre normal, këto duhen trajtuar drejt.

Jashtë punëve të organizatës së rinisë, a bëhen diskutime të lira në mes të rinjve dhe të rejave, në grupe shokësh e shoqesh, në shoqëri, apo i lini në spontancitet këto gjëra? Në përgjithësi, diskutimet e lira në shoqëri, janë të pjekura dhe serioze apo zhvillohen bisedime pa përmbajtje, të parëndësishme? Për shembull, ju qëllon juve të qëndroni në një bankë me një shoqe dhe të hapni me të një diskutim serioz shoqëror, fjala vjen, të gjykoni mbi sjelljen e disa njerëzve, ose për probleme të tjera shoqërore? Kup-tohet, ata që bëjnë pjesë në rini janë në moshë të re dhe nuk mund të kërkojnë prej tyre që çdo bisedë të jetë e përsosur, se ka edhe të rritur që diskutojnë përçart, po çështja është te përgatitja e rinisë në mënyrë serioze që ajo të jetojë dhe të mendojë, me të vërtetë, në atë nivel gjithnjë më të lartë që po arrin

vendi ynë socialist. Është pozitive që në vendin tonë nuk ka shturje si në vendet kapitaliste e revizioniste, ku rinia ka degjeneruar.

Nuk na thatë si i përballon rinia nevojat financiare për kinema, sport, për libra, gjen pengesa nga prindërit? Rinisë së sotme, më shumë se ajo e para, i duhen disa të holla që të plotësojë disa nevoja minimale, prandaj prindërit është mirë t'ua sigurojnë këto, që të mos hidhen në rrugë të tjera. Ka tendencë luksi në rini?

Ç'mendon rinia punëtorë për punën, për zënatin, për mjeshtrit që e mësojnë dhe ç'qëndrim mban ndaj tyre? Ç'mendon për trajtimin ekonomik të saj? Pagën që marrin të rinjtë dhe të rejat si e përdorin? Po të rinjtë fshatarë? Ç'mendojnë nxënësit për mësuesit dhe për lëndët që zhvillojnë ata? Në ç'drejtime shfaqen prirjet për të mësuar më shumë, në drejtim të shkencave ekzakte apo të atyre humanitare? Ç'mendojnë të rinjtë dhe të rejat për të ardhmen e tyre? Komiteti i rinisë preokupohet për këto probleme, nxjerr konkluzione dhe jep orientime? Për shembull, në një shkollë konstatohet se 30 veta kanë nota të dobëta në shkencat ekzakte, atëherë është mirë që organizata të përgatitë një leksion mbi rëndësinë e madhe të këtyre shkencave dhe mbi përpjekjet që duhen bërë për t'i përvetësuar ato. Ndërsa kur organizata shikon se ka nota të dobëta në mësimin e edukatës fizike, për arsye se rinia nuk i vë rëndësi, në këtë rast ajo del me konkluzionin se është e nevojshme të bëhet një referat për rëndësinë e saj. Në një rast tjetër, kur organizata konstaton se disa punëtorë ose

kooperativistë të rinj nuk mbajnë qëndrim të drejtë ndaj punës, ose të ardhurat që marrin i konsiderojnë personale, në vend që t'i përdorin mirë, duke kontribuar edhe ata në jetën e familjes, atëherë përgatit dhe jep udhëzime të punohet me rininë një leksion me përmbajtje të mirë morale dhe edukative që të ketë si objekt luftimin e kësaj dobësie.

**SHOKU ISA RAMA:** Të rinjtë tanë e duan punën. Lidhur me prirjet, rininë shkollore e tërheq më shumë letërsia dhe fizika, por në përgjithësi rezultatet më të mira arrihen në shkencat humanitare, kurse në shkencat e përpikta më pak.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kjo reflekton, siç dihet, traditat e qytetit. Qyteti i Shkodrës është me traditë më të mëdha kulturore nga çdo qytet tjetër, sidomos në shkencat humanitare. Shkodra ka qenë dhe është më përpara në letërsi e në disa zhanre të tjera të artit. Pavarësisht nga brendia, nga përmbajtja e veprave letrare artistike të autorëve shkodranë të paraqirimit, në të cilat ka mbisunduar idealizmi, prapë këtu te ju, në këtë drejtim, ka traditë më të mëdha, të cilat ushtrojnë edhe tani ndikim të madh në masën e rinisë, prandaj është fare e natyrshme që në këto drejtime të ketë më shumë prirje nga ana e rinisë shkodrane. Atëherë ç'mendon rinia e rrethit tuaj për zhvillimin aktual të arteve, si letërsisë, muzikës, pikturës, skulpturës, teatrit, estradës etj.? Ç'duan të bëhen të rinjtë dhe ç'masa duhet të marrim? Është e kënaqur rinia me botimet që nxjerrim, si i shfrytëzon ajo ato dhe ç'mund të bëhet më tepër? Ç'mendon ajo për filmat që shfaqen në ekranet tona, a është e kë-



naqur dhe a bën vërejtje për ta? A krijon rinia dhe a nxitet të krijojë? Kjo ka rëndësi shumë të madhe, sidomos në një qytet si Shkodra, nga më të zhvilluarit e vendit tonë.

Në rrethet letrare sot diskutohet shumë çështja e tablosë, e pikturës. Problemi i figurave në botën e sotme perëndimore është bërë një gangrenë sociale, sepse figurat në libra, në kinema, në televizion, në shtyp e kudo, ashtu si paraqiten në shumë vende, janë kthyer në një mjet për t'i degjeneruar njerëzit. Kam lexuar, se një djalë i ri në një vend kapitalist, e shikon televizionin 6 orë në ditë. Ai thotë se jeta e tij është bërë kolltuku dhe gota e likerit që mban afër, prandaj mendja nuk i punon aspak. Një tjetër, ndjekës i filmave, thotë se shikon shumë filma, i kalojnë parasysh mijëra fotografi, por këto i dalin kaq shpejt, sa nuk e lejojnë të mendohet dhe të thellohet për jetën. Ka njerëz në vendet perëndimore, që janë kundër kinemasë dhe i vënë rëndësi më të madhe pikturës, pse piktura të lejon të reflektosh mbi ndjenjat që e kanë shtyrë piktorin të bëjë një tablo. Atje spektatori shikon me hollësi atë që do të shprehë artisti, idetë dhe mendimet e tij dhe e nxit njeriun të mendojë, t'i punojë koka. Piktura luan rol të madh në edukimin estetik të njerëzve, por ajo nuk po zhvillohet shumë tene. Prandaj i përkrahni talentet e reja që të zhvillohet kjo degë e bukur e artit.

Po për sport interesohet rinia? Cilat lloj sportesh pëlqehen më shumë dhe si orientohet ajo në praktikimin e sporteve të ndryshme? Futbollin rinia patjetër e pëlqen më tepër, por ajo duhet të pëlqejë

edhe sportet dhe aktivitetet e tjera. Duhet menduar edhe për argëtimin dhe për kalitjen e rinisë në fshat, duhet treguar interesim sidomos për lojërat popullore. Kurse propozimin tuaj për t'i pajisur këndet sportive edhe me lodra të karakterit ushtarak, sidomos për fëmijët, do t'i them qysh sonte shokut Vehbi Hoxha, t'i bisedoni dhe pastaj bashkërisht t'i vini në zbatim. Propozimet dhe kërkesat që bëni, mendoj se janë shumë të mira dhe kam besim që shokët e ushtrisë këtu në rreth do të tregohen të gatshëm t'ju ndihmojnë në këtë drejtim.

Takimi që bëra me ju ishte shumë interesant për mua dhe dua t'ju them se mësova shumë gjëra. Ky diskutim do të na ndihmojë ne në shqyrtimin që mund t'i bëjmë problemit të rinisë në udhëheqje për të marrë disa masa të mëtejshme që ta përmirësojnë edhe më shumë punën me rininë, masa që do të jenë rezultat i këtij shkëmbimi mendimesh dhe i eksperiencës suaj e të organizatave të rinisë të rretheve të tjera.

Jam plotësisht dakord me mendimet që shfaqët ju këtu. Nëpërmjet tyre unë shikoj se ju i gjykoni drejt problemet e rinisë, bile me pjekuri të madhe dhe në rrugë partie. Këtë e them jo vetëm për shokun Isa Rama, që është në krye të organizatës së rinisë të rrethit ose për shokun Angjelin Kumria që drejton shtëpinë e pionierëve të qytetit, por edhe për të gjithë shokët e tjerë që morën pjesë në këtë bisedim, te të cilët konstatoj një pjekuri të madhe politike, morale dhe ideologjike. Ju them hapur se duke i bërë një retrospeksion rinisë së kohës sonë e them pa frikë se

atëherë ne kemi qenë në hall. Po ta krahasoj, për she-mbull, ngritjen e shoqes sekretare të rinisë për të rejat në rrethin tuaj, me ngritjen që kishte brezi ynë kur ishim të rinj si ju, ndryshimi është si nata me ditën. Është një sukses i madh që Partia ka arritur të edukojë një rini të tillë në vendin tonë. Prandaj jam dakord me mendimet tuaja, me metodën tuaj të punës dhe me rezultatet e mira të dukshme që ju keni arritur.

Ne nuk kemi të dhëna për situata të vështira, për qëndrime jo të mira në radhët e rinisë të rrethit të Shkodrës. Po të kishte ndonjë situatë të tillë do të na e kishin thënë shokët e Komitetit të Partisë, do të na e thoshit edhe ju këtu. Kjo tregon se në Shkodër bëhet një punë e shëndoshë.

Byroja Politike dhe Sekretariati i Komitetit Qendror do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të gjetur disa forma pune e mundësi materiale për t'i dhënë rinisë një ndihmë akoma më të madhe, sepse rinia për organizatën e Partisë ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Partia duhet t'i vërë një rëndësi shumë të madhe punës së saj me organizatat e masave, me bashkimet profesionale, me gruan, e në radhë të parë me rininë. Disa thonë: «Mjaft po bëjmë për rininë», por në të vërtetë për edukimin e saj ne duhet të bëjmë akoma më shumë. Sa më mirë ta edukojmë rininë, aq më mirë do të zgjidhim të gjitha problemet që na dalin. Pra, Partia dhe të gjithë njerëzit, po ta kuptojnë drejt kështu problemin, e vlen sikur edhe të shtrëngohemi ca në drejtime të tjera, po rinisë t'i japim disa mjete që janë shumë të nevojshme për edukimin e saj ideo-

logjik, politik, fizik dhe moral, që ajo të zhvillohet, si kurdoherë, në rrugën e drejtë të Partisë. Kështu ne do të kemi bërë një punë kolosale.

Ju falënderoj për ndihmën që më dhatë në këtë bisedë dhe ju kërkoi ndjesë që ju lodha. Ju uroj suksese kurdoherë e më të mëdha në punën tuaj!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## GRUSHTI FASHIST NË INDONEZI DHE MËSIMET QË NXJERRIN PREJ TIJ KOMUNISTËT

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

11 maj 1966

Kaluan 6 muaj që nga shpërthimi i hapët i reaksionit fashist në Indonezi. Dhe këta 6 muaj janë karakterizuar nga një terror i pashembullt i fashistëve, veçanërisht kundër komunistëve dhe njerëzve përparimtarë. Flitet se numri i të vrarëve, të masakruar pa gjyq dhe barbarisht, ka arritur në disa qindra mijëra. Disa agjenci lajmesh bëjnë fjalë për 300 000 veta, disa të tjera për 500 000 veta. Thuhet, gjithashtu, se midis viktimave të terrorit të bardhë janë edhe disa nga udhëheqësit kryesorë të Partisë Komuniste të Indonezisë.

Tragjedia që po jetojnë populli dhe komunistët indonezianë duhet të tronditë ndërgjegjen e të gjithë njerëzve përparimtarë. Fashistët indonezianë, të përkrahur haptazi dhe tërthorazi nga imperialistët amerikanë dhe nga revizionistët hrushovianë, po përsëritin, në një shkallë akoma më të lartë, atë që dikur bënë nazistët

pasi morën fuqinë. Atyre u duhet ndalur dora. Kundër masakrimit të komunistëve dhe të njerëzve përparimtarë të Indonezisë duhet të ngrihet zëri i fuqishëm i protestës nga çdo njeri i ndershëm, nga çdo revolucionar, dhe nga çdo antifashist. Kjo është sot për të gjithë kërkesa më elementare, sepse është krim i vërtetë që reaksionarët më të tërbuar të vrasin qindra mijëra njerëz të pafajshëm (ndoshta në asnjë luftë, me përjashtim të luftërave botërore, nuk ka pasur kaq viktime) dhe të mbeten pa u dënuar.

Populli dhe komunistët shqiptarë shprehin solidaritetin e tyre internacionalist me komunistët indonezianë, viktime të terrorit fashist. Ne jemi të bindur se Partia Komuniste e Indonezisë, pavarësisht nga dëmet e mëdha që ka pësuar, do t'u përgjigjet fashistëve me një luftë të vendosur revolucionare për shpartallimin e plotë të reaksionit. Tani është e qartë se për kundërshtimin e fashizmit dhe të terrorit, për komunistët dhe për patriotët indonezianë ka vetëm një rrugë: dhunës kundërrevolucionare i duhet përgjigjur me dhunë revolucionare, me luftën e armatosur të punëtorëve dhe të fshatarëve për mbrojtjen e lirisë dhe të demokracisë.

Zhvillimi i ngjarjeve në Indonezi është një fakt i hidhur për komunistët dhe për të gjithë revolucionarët. Por megjithëkëtë ajo që ndodhi në Indonezi përbën një eksperiencë të madhe, e cila duhet studiuar me kujdes dhe duhen nxjerrë prej saj mësimet të vlefshme. Revolucionari kurrë ndonjëherë nuk zhvillohet në vijë të drejtë. Ai ecën përpara nëpërmjet fitoresh e disfatash. Detyra e revolucionarëve, e marksistë-leni-

nistëve, është që fitoret t'i çimentojnë, ndërsa nga disfatat e përkohshme të mësojnë, të nxjerrin konkluzionet e nevojshme, në mënyrë që revolucioni të ngrihet në një shkallë më të lartë dhe të zhvillohet me një forcë akoma më të madhe. Eksperienca e një revolucioni nuk është e dobishme vetëm për revolucionarët dhe për komunistët e një vendi, po për të gjithë revolucionarët, për të gjithë marksistë-leninistët e botës. Për këtë arsye nga ngjarjet në Indonezi duhet të nxjerrin mësimet përkatëse jo vetëm komunistët indonezianë, por të gjithë revolucionarët dhe komunistët e vendeve të ndryshme. Kjo ka rëndësi të dorës së parë.

Partia Komuniste e Indonezisë u rrit e u zhvillua si parti marksiste-leniniste, në një luftë të ashpër klasore kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm. Pas goditjeve të rënda që ajo mori nga reaksioni më 1927 dhe më 1948, kur u masakruan mijëra komunistë dhe gjithë udhëheqja e partisë, Partia Komuniste e Indonezisë e mori veten me luftë dhe me përpjekje, derisa u bë një forcë e tillë që nga numri i anëtarëve përfaqësonte partinë më të madhe komuniste të vendeve kapitaliste. Nuk ka dyshim se ajo përsëri, edhe pas humbjeve të mëdha që po pëson tani, pak nga pak, nëpërmjet një lufte të guximshme dhe konsekuente revolucionare marksiste-leniniste, do ta marrë veten. Ne, komunistët shqiptarë, kemi besim të patundur se komunistët indonezianë do të analizojnë me kujdes punën e tyre të deritanishme, se ata do të zbulojnë të metat, gabimet dhe dobësitë që janë shfaqur në punën e partisë, do të nxjerrin konkluzionet e nevojshme, në mënyrë që PK e Indonezisë të udhëheqë me

sukses në të ardhmen popullin indonezian në revolucion. Më mirë se vetë ata askush nuk mund ta bëjë këtë.

Ngjarjet në Indonezi nuk janë një fenomen i shkëputur. Ato janë hallkë e një zinxhiri, pjesë përbërëse e sulmit të reaksionit ndërkombëtar kundër lëvizjes komuniste dhe luftës çlirimtare të popujve. Ato kanë lidhje me veprimtarinë agresive të imperializmit amerikan në Vietnam e gjetkë, me ndërhyrjet gjakësore të imperialistëve në Santo-Domingo e në gjithë Amerikën Latine, me organizimin e grushteve kundër-revolucionare në disa vende të reja të Afrikës, me veprimet diversioniste e përçarëse që revizionistët hrushovianë po kryejnë prej kohësh në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, me sabotimin që ata po i bëjnë luftës nacionalçlirimtare të popujve, me përkrahjen aktive që ata u japin imperializmit amerikan dhe gjithë reaksionarëve të ndryshëm etj.

Për këtë arsye revolucionarët dhe komunistët e vendeve të ndryshme duhet të ndalen seriozisht në këto fenomene, t'i analizojnë me kujdes dhe të nxjerrin mësimet e nevojshme, në mënyrë që lufta revolucionare të shkojë gjithnjë përpara nga fitorja në fitore.

### **Sa vlejnë e si duhen shfrytëzuar «liritë demokratike» në një shtet borgjez**

Borgjezia, e bashkë me të edhe revizionistët modernë, flasin e llogaritin shumë në të ashtuquajturat liri demokratike. Në të vërtetë, sa për sy e faqe, në



çdo shtet borgjez, të quajtur demokratik, ekzistojnë disa «liri» relative demokratike. Themi relative, sepse ato kurrë nuk e kalojnë kufirin e konceptit borgjez mbi «lirinë» e «demokracinë», sepse ato shtrihen deri aq sa të mos prekin interesat jetësore të borgjezisë në fuqi.

Natyrisht, këto kushte i shfrytëzojnë edhe klasa punëtore dhe njerëzit përparimtarë për t'u organizuar, për të propaganduar pikëpamjet dhe ideologjinë e tyre, për të përgatitur përmbysjen e klasave shfrytëzuese dhe marrjen e pushtetit në dorë.

Pas Luftës së Dytë Botërore, në shumë vende kapitaliste të Evropës, për shkak të fitores mbi fashizmin e të rolit të luajtur nga partitë komuniste në luftën antifashiste, partitë komuniste arritën të marrin pjesë edhe në qeveri (si në Francë, në Itali, në Finlandë etj.), të kishin një numër të madh deputetësh në parlament, poste të rëndësishme në aparatin shtetëror, bile edhe në ushtri etj.

Gjithashtu, kushte të favorshme për partinë e klasës punëtore dhe për forcat përparimtare në këta 15 vjetët e fundit, në periudha të ndryshme, u krijuan edhe në disa vende të Lindjes së Mesme, si në Iran e në Irak, në Amerikën Latine, si në Guatemalë, Brazil, Ekuador, Venezuelë etj. Një situatë mjaft e favorshme u krijua në Indonezi. Partia Komuniste e Indonezisë u rrit me shpejtësi, ajo bënte pjesë në qeveri, ushtronte një influencë të madhe në politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit etj.

Por edhe në kushtet e «lirive demokratike», mi-

dis revolucionit e reaksionit, midis proletariatit e borgjezisë, zhvillohet një luftë e ashpër klasore, një luftë për jetë a vdekje. Në qoftë se proletariati dhe partia e tij punojnë për të forcuar pozitat e tyre, reaksioni dhe borgjezia, nga ana e tyre, nuk flenë. Përkundrazi, duke përdorur aparatit shtetëror borgjez, policinë dhe forcat e armatosura, korrupsionin dhe diversionin, duke ushqyer oportunizmin dhe iluzionet reformiste e paqësore në gjirin e klasës punëtore etj., përgatiten seriozisht për të forcuar pozitat e tyre dhe për të shpartalluar forcat revolucionare.

Zhvillimi i ngjarjeve pas Luftës së Dytë Botërore tregon se, në kuadrin e «lirive demokratike», borgjezia, në mënyra të ndryshme, ka vepruar energjikisht për likuidimin e lëvizjes revolucionare të klasës punëtore.

Kur borgjezia dhe reaksioni forcuan pozitat e tyre, ata i dëbuan komunistët nga qeveria, nga postet e rëndësishme shtetërore dhe nga ushtria, siç ngjau në Itali, në Francë e në Finlandë. Në Angli, Austri etj. komunistëve nuk u lanë një vend as në parlament, ndër- sa në Greqi i plasën në burgje dhe u vunë pushkën.

Kur borgjezia dhe reaksioni vënë re se pushteti i tyre rrezikohet, si rrjedhim i rritjes së fuqisë e i prestigjit të partisë komuniste dhe i lëvizjes revolucionare të masave, ata luajnë edhe kartën e fundit: vënë në lëvizje forcat e armatosura, organizojnë pogromet për të thyer e për të likuiduar lëvizjen revolucionare e partitë komuniste, siç ka ndodhur në Iran dhe në Irak e, tani së fundi, me ngjarjet tragjike të Indonezisë. Në raste të tilla reaksioni dhe borgjezia e një

vendi kanë shfrytëzuar drejtpërdrejt edhe ndihmën e reaksionit botëror, bile edhe përkrahjen e forcave të tij të armatosura, siç ka ndodhur në Santo-Domingo e gjetkë.

Ç'konkluzione mund të nxirren nga kjo eksperiencë historike?

Së pari, të ashtuquajturat «liri borgjeze» e «liri demokratike» në vendet kapitaliste nuk janë të atilla sa t'u lejojnë partive komuniste dhe grupeve revolucionare të arrijnë qëllimet e tyre. Jo. Borgjezia dhe reaksioni lejojnë veprimtarinë e revolucionarëve derisa kjo nuk rrezikon pushtetin klasor të borgjezisë. Kur ky pushtet rrezikohet, ose kur reaksioni gjen momentin e përshtatshëm, ai i mbyl liritë demokratike dhe përdor çdo mjet, pa skrupull moral e politik, për të shkatërruar forcat revolucionare. Borgjezia dhe reaksioni në të gjitha vendet ku partitë komuniste lejohen të punojnë hapur, e shfrytëzojnë këtë situatë për të njohur gjithë aktivitetin, njerëzit, metodat e punës dhe të luftës së partive marksiste-leniniste dhe të revolucionarëve. Prandaj komunistët dhe partitë e tyre të vërteta marksiste-leniniste do të bënin një gabim fatal po të kishin besim në «liritë» borgjeze që u jep koniunktura dhe të afishojnë çdo gjë hapur, të mos ruajnë të fshehta organizimin dhe planet e tyre. Komunistët duhet të shfrytëzojnë kushtet e punës legale, bile t'i përdorin ato për të zhvilluar një punë të gjerë propagandistike e organizative, por në të njëjtën kohë ata duhet të jenë të përgatitur edhe për punën në ilegalitet.

Së dyti, iluzionet oportuniste mbi «rrugën paqë-

sore» të marrjes së pushtetit janë një bluf dhe përbëjnë një rrezik të madh për lëvizjen revolucionare. Në pamjen e jashtme Partia Komuniste e Indonezisë duket se kishte terrenin më të përshtatshëm për t'ia arritur qëllimit në këtë rrugë. Megjithëkëtë, komunistët indonezianë, më se një herë, kishin deklaruar se ata nuk kishin iluzione për «rrugën paqësore». Në përsëritjen e delegacionit të KQ të PK të Indonezisë, drejtuar Kongresit të PK të Zelandës së Re, ata konfirmuan se «ngjarjet në Indonezi provuan edhe një herë se nuk ka asnjë klasë sunduese... dhe forcë reaksionare që të lejojnë forcat revolucionare të arrijnë fitoren me «rrugë paqësore»». Nga ngjarjet tragjike të Indonezisë komunistët nxjerrin mësimin se nuk mjafton vetëm të hedhësh poshtë iluzionet oportuniste mbi «rrugën paqësore», as të njohësh se rruga e vetme për marrjen e pushtetit është rruga revolucionare e luftës së armatosur. Partia e proletariatit, marksist-leninistët dhe çdo revolucionar duhet të marrin masa efektive për të përgatitur revolucionin, që nga edukimi i komunistëve dhe i masave me një frymë militante revolucionare, deri te përgatitja konkrete për t'i bërë ballë dhunës kundërrevolucionare të reaksionit me luftën e armatosur revolucionare të masave popullore.

Së treti, pavarësisht nga kushtet dhe nga pozitat e favorshme që mund të gëzojë në një kohë të caktuar, partia e klasës punëtore nuk duhet për asnjë çast të ulë vigjilencën revolucionare, të mbivlerësojë forcat e veta e të aleatëve të saj dhe të nënvleftësojë forcën e kundërshtarit, të borgjezisë dhe të reaksio-

nit. Partia Komuniste e Indonezisë kishte një influencë të madhe në vend, por, siç duket, ajo ka mbivlerësuar dhe ka pasur besim jashtë mase, veçanërisht në forcën politike të Sukarnos dhe të asaj pjese të borgjezisë që e mbështeste atë. Në të njëjtën kohë, duket se ajo ka nënvleftësuar forcën e reaksionit, veçanërisht atë të reaksionit në ushtri. Shokët indonezianë, siç duket, kishin mendimin se kush ka Sukarnon nga ana e tij, ai ka në dorë kyçin e Indonezisë, pa analizuar mirë ku qëndronte forca e Sukarnos dhe sa reale ishte kjo, veçanërisht në popull. Ngjarjet e fundit në Indonezi treguan qartë se prestigji dhe autoriteti i Sukarnos nuk kishin një bazë të shëndoshë as shoqërore, as ekonomike e politike. Gjeneralët reaksionarë arritën ta neutralizojnë Sukarnon, bile, aq sa u duhet, edhe ta shfrytëzojnë atë për qëllimet e tyre kundër-revolucionare.

Së katërti, partia marksiste-leniniste dhe çdo revolucionar i vërtetë duhet të ndjekin me konsekuencë e me vendosmëri një vijë revolucionare dhe të luftojnë me guxim kundër oportunizmit dhe shfaqjes së tij më të shëmtuar, revizionizmit modern, atij hrushovian e titist. Oportunistët dhe revizionistët modernë kanë bërë flamur të tyre luftën për «liritë» borgjeze dhe kanë hequr dorë nga revolucioni, ata predikojnë «rrugën paqësore» si rrugën e vetme për marrjen e pushtetit. Pikërisht vija oportuniste dhe revizioniste, influenca e revizionistëve hrushovianë etj., i kanë kthyer shumë parti komuniste, që dikur përfaqësonin një forcë të madhe revolucionare, në parti të reformave sociale, në bisht e ndihmëse të borgjezisë reaksionare.

Kjo ndodhi me partitë komuniste të Italisë, të Francës, të Finlandës, të Anglisë, të Austrisë etj. Ndjekja e vijës oportuniste të Kongresit të 20-të të hrushovianëve çoi drejt katastrofës dhe likuidimit Partinë Komuniste të Irakut, Partinë revizioniste Braziliene, Partinë Komuniste të Algjerisë etj. Partia Komuniste e Indonezisë e kundërshton revizionizmin modern. Ngjarjet e fundit në Indonezi dhe roli minues që luajtën atje revizionistët hrushovianë, tregojnë se një parti e vërtetë revolucionare, besnike e marksizëm-leninizmit, e vendosur ta çojë përpara me guxim revolucionin, duhet të ketë një qëndrim të prerë ndaj oportunizmit, ndaj revizionizmit hrushovian e titist. Nuk mjafton vetëm të solidarizohesh me luftën e marksistë-leninistëve kundër revizionizmit, por duhet që partia të luftojë pa kompromis dhe hapur kundër tradhtisë revizioniste, sepse vetëm kështu edukohen komunistët me një frymë revolucionare dhe mbrohet partia nga çdo rrezik i revizionizmit. Pa luftuar me guxim dhe me konsekuencë kundër oportunizmit e revizionizmit hrushovian, nuk mund të luftohet imperializmi, nuk mund të luftohet reaksioni, nuk mund të çohet përpara çështja e revolucionit dhe e socializmit.

## **Komunistët dhe aleancat me forcat përparimtare**

Eksperiencia historike tregon se komunistët në luftën e tyre revolucionare kurdoherë kanë hyrë dhe hyjnë në aleancë me forca të ndryshme përparimtare. Sepse, veçanërisht kur është fjala për revolucionet demo-

kratike, apo për çlirimin nacional nga shtypja imperia-  
liste e koloniale, janë të interesuara, veç komunistëve  
e revolucionarëve të vërtetë, edhe shtresa të tjera të  
gjera të popullsisë, që nga punëtorët e fshatarët dhe  
deri te borgjezia nacionale e njerëz të tjerë përparim-  
tarë. Do të ishte e gabuar, sektare dhe e dëmshme  
për revolucionin në qoftë se për triumfin e tij nuk  
do të bashkoheshin të gjithë ata që mund të bashkohen.  
Komunistët dhe revolucionarët e vërtetë, si luftëtarët më  
të guximshëm dhe përfaqësuesit më besnikë të masave  
të gjera popullore, janë kurdoherë të interesuar për  
bashkimin e gjithë atyre që duan ta çojnë përpara re-  
volucionin.

Ngjarjet në Indonezi janë një mësim i rëndësishëm  
edhe lidhur me çështjen e aleancave. Atje prej kohësh  
ekzistonte NASAKOM-i, që përfaqësonte aleancën e  
forcave nacionaliste, fetare e komuniste. PK e Indone-  
zisë ka bërë mirë që mori pjesë në NASAKOM. Ajo  
nëpërmjet tij forcoi pozitën e veta e të klasës punëtore  
në gjithë jetën e vendit. Por, siç e tregojnë ngjarjet, aty  
nuk u bë një punë organizative dhe revolucionare e  
shëndoshë, u lejua një eufori e dëmshme dhe u rekla-  
mua jashtë mase vetë NASAKOM-i, uniteti i tri forca-  
ve përbërëse dhe «liria» e veprimit. Fakt është se  
mjaftoi një tufan dhe gjithë kalaja e NASAKOM-it u  
rrëzua. NASAKOM-i nuk ishte një digë aq e fuqishme  
sa t'i bënte ballë dallgës së kundërrevolucionit.

Prandaj komunistët dhe revolucionarët në luftën e  
tyre kurrë nuk duhet të kënaqen me realizimin formal  
të aleancave. Ata nuk duhet të entuziazmohen nga de-

klaratat për «vitalitetin» e këtyre aleancave, por duhet të punojnë që ato t'i shërbejnë sa më mirë revolucionit.

Për këtë është e domosdoshme që në frontet e ndryshme popullore, demokratike, kombëtare e nacionalçlirimtare, partitë e vërteta marksiste-leniniste, me punën dhe me luftën e tyre, të fitojnë besimin e aleatëve të tyre, të dalin në krye të këtyre fronteve dhe t'i udhëheqin ato efektivisht. Udhëheqja e partisë marksiste-leniniste, vija e saj e drejtë revolucionare, në interes të masave të gjera të bashkuara në front, janë garancia e forcës dhe e vitalitetit të fronteve dhe e rolit të tyre të madh në arritjen e qëllimeve të revolucionit. Është provuar më se një herë se, kur këto fronte udhëhiqen nga forca shoqërore e parti të tjera politike, nuk janë të qëndrueshme, nuk ndiqet një vijë konsekuente revolucionare, përdoren shpesh për qëllime kundërrevolucionare dhe shkatërrohen si flluska sapuni në ndeshjen e parë me reaksionin.

Duke ndjekur vijën e unitetit me të gjithë ata që mund të bashkohen në front, partitë marksiste-leniniste, në kundërshtim me pikëpamjet e revizionistëve modernë, jo vetëm që duhet të ruajnë pavarësinë e tyre dhe rolin udhëheqës, por ato duhet të bëjnë në të njëjtën kohë edhe luftën kundër lëkundjeve të aleatëve të ndryshëm, kundër tendencave të tyre reaksionare, orvatjeve për të përçarë frontet e për të hyrë në pazarllëqe me forcat e reaksionit. Vija e unitetit dhe e luftës u shërben forcimit të fronteve, pastrimit të tyre nga elementët reaksionarë e kundërrevolucionarë, rritjes së kompaktësisë dhe frymës revolucionare, arritjes



së një uniteti më të lartë e në baza më të shëndosha. Ndjekja vetëm e vijës së unitetit dhe lënia pas dore e luftës krijojnë një unitet të rremë, formal dhe u japin mundësi elementëve e forcave reaksionare ta minojnë dhe ta likuidojnë atë me lehtësi, duke i dhënë një goditje të fortë vetë qështjes së revolucionit.

Në aleancat me shtresa dhe me forca të ndryshme shoqërore për arritjen e këtyre apo atyre qëllimeve në etapat e ndryshme të revolucionit, komunistët nuk duhet të harrojnë kurrë qëllimin e tyre të fundit — fitoren e socializmit.

*«Duhet ta lidhësh luftën për demokraci me luftën për revolucionin socialist duke ia nënshtruar të parën së dytës, — ka thënë Lenini. — Këtu qëndron gjithë vështirësia; këtu qëndron i gjithë thelbi. . . mos lër të të shpëtojë kryesorja (revolucionin socialist); vëre atë në vendin e parë. . .; nënshtroja atij, koordinoji me të, vari prej tij të gjitha kërkesat demokratike. . .»<sup>1</sup>.*

Komunistët janë të sigurtë në aleancat e tyre me forcat e tjera shoqërore, ata janë luftëtarë të vendosur për zbatimin në jetë të programeve të fronteve unike, por në të njëjtën kohë ata nuk i fshehin aspak idealet e tyre dhe, pas kryerjes së detyrave demokratike e kombëtare, ata janë të vendosur të mos ndalen në mes të rrugës, por ta çojnë përpara revolucionin deri në fitoren e socializmit dhe të komunizmit.

---

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 35, f. 260-261.

Lufta e Partisë sonë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, marrëveshjet, bisedimet me elementët përparimtarë, bile edhe me fraksionet e borgjezisë reaksionare, na mësuan si të orientohehim drejt dhe me sukses në këtë labirint. Kjo eksperiencë, e fituar në luftë, i shërbeu Partisë sonë dhe i shërben pa masë në politikën e saj të drejtë me masat e gjera të punonjësve, e ndihmon atë në politikën e brendshme dhe në orientimin në politikën e jashtme, në studimin dhe në zgjidhjen e kontradiktave joantagoniste dhe antagoniste, si brenda dhe jashtë vendit ashtu edhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

### **Të forcohet uniteti ndërkombëtar i marksistë-leninistëve**

Proletariati botëror, partitë marksiste-leniniste dhe gjithë revolucionarët e vërtetë janë angazhuar në një luftë të ashpër kundër imperializmit, kundër borgjezisë reaksionare, kundër revizionistëve modernë, kundër ideologjisë së tyre. Kjo është një luftë për jetë a për vdekje, një luftë me rëndësi të madhe botërore. Lufta midis nesh dhe armiqve është një luftë klasore, e ashpër, e pamëshirshme, as armiq të nuk na falin, as ne nuk i falim ata. Zhvillimi i kësaj lufte klasore nuk paraqitet njëjloj kudo, jo vetëm nga intensiteti, por edhe nga format, nga dinamizmi i zhvillimit, nga botëkuptimi i pjesëmarrësve në luftë, nga koniunkturat, nga zigzagjet, nga përparimi i revolucionit, nga tërheqjet e për-

kohshme, nga sulmi dhe nga shumë faktorë të tjerë objektivë e subjektivë.

Partive komuniste e punëtoresh marksiste-leniniste u bie barra e rëndësishme dhe e domosdoshme që të gjitha këto t'i kenë parasysh, t'i analizojnë shkencërisht nën prizmin e marksizëm-leninizmit krijues, të zbatuar jo si dogmë, por si teori e gjallë revolucionare në veprim, duke ruajtur kurdoherë të pastra parimet bazë, ligjet e përgjithshme të zhvillimit dhe të revolucionit dhe jo nën parullën e gjoja «kushteve reale të vendit» apo të «koniunkturave speciale, të kohës apo të momentit» të fshihet oportunizmi i djathtë, ose sektarizmi i dëmshëm.

Ngjarjet e fundit, sulmi i egër i imperialistëve, i revizionistëve hrushovianë e i reaksionarëve të ndryshëm kundër socializmit, luftës çlirimtare të popujve dhe kundër partive komuniste e revolucionare të vendeve të ndryshme, tregojnë se uniteti internacionalist marksist-leninist, si në çdo kohë, por sidomos tani më shumë se kurrë, është kusht i domosdoshëm. Kush nuk e kupton këtë të vërtetë të madhe, ai nuk e kupton parullën e madhe të Marksit «Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!». Marksizëm-leninizmi na mëson se gjithë revolucionarët duhet të bashkohen kundër armiqve të proletariatit dhe të popujve, kundër kapitalistëve, imperialistëve dhe aleatëve të tyre, kundër borgjezisë reaksionare, kundër varianteve të ideologjisë së saj, një nga të cilat në kohën aktuale është revizionizmi modern, me atë sovjetik në krye.

Unitetin ndërkombëtar marksist-leninist e kanë luftuar me të gjitha forcat armiqte e proletariatit dhe të

marksizëm-leninizmit. Për këtë ata kanë përdorur të gjitha mjetet që kanë në dispozicion dhe koordinojnë të gjitha veprimet e tyre. Këtë po bën sot imperializmi botëror, me atë amerikan në krye; këtë po bën revizionizmi modern, me atë hrushovian në krye; këtë po bëjnë gjithë reaksionarët e ndryshëm në botë. Uniteti i marksistë-leninistëve të botës është për ta vdekjeprurës, kurse për ne marksistë-leninistët është shpëtimtar.

Tradhtarët e marksizëm-leninizmit, revizionistët hrushovianë, titistë dhe shërbëtorët e tyre kanë punuar me një plan të caktuar mirë për të penguar unitetin e marksistë-leninistëve dhe përgjithësisht për të diskredituar nevojën objektive të këtij uniteti. Në radhë të parë, për qëllimet e tyre tradhtarë, ata sulmuan idenë e çdo organizimi ndërkombëtar të komunistëve. Kjo u duhej revizionistëve për të rehabilituar tradhtarët dhe tradhtinë trockiste, dhe veçanërisht për të diskredituar idenë e unitetit marksist-leninist internacionalist, i cili në çdo kohë ka qenë dhe do të jetë për ta rreziku më i madh. Revizionistët sovjetikë shkuan nga rruga e diskreditimit të çdo gjëje të shëndoshë marksiste-leniniste që të mund të rindërtonin një unitet të ri me baza revizioniste dhe nën diktatin hrushovian. Natyrisht, kjo ishte një kështjellë mbi rërë, sepse nuk mund të ekzistojë asnjë unitet i vërtetë jashtë marksizëm-leninizmit. Predikimi i revizionistëve hrushovianë për «unitet» drejtohet tërësisht kundër idesë së unitetit marksist-leninist dhe bëhet për të penguar realizimin e tij. Revizionistët hrushovianë predikojnë atë farë «uniteti» për të luftuar unitetin e vërtetë marksist-leninist, për të cilin ne, marksistë-leninistët, luftojmë e do të luftoj-

më deri në fund dhe me siguri do t'ia arrijmë qëllimit. Revizionistët bëjnë fjalë për «unitetin» e tyre, por në gjirin e këtij «uniteti» çdo ditë e më tepër po marrin zhvillim shumë forma dhe ide të dezintegritit, ide centrifugale, të cilat do të çojnë në degjenerimin e hapët të pseudomarksistëve, nën çdo maskë që ata të fshihen. Lufta heroike e konsekuente e marksistë-leninistëve do të çjerrë shumë maska. Në mos sot, nesër do të demaskohen edhe manovrat e atyre që duan të luajnë rolin e centristëve, që me fjalë gjoja mbrojnë parimet, por në realitet i shtrembërojnë ato nën maskën e «pavarësisë», të «kushteve specifike», të cilat përdoren akoma për të fshehur shkëputjen e tyre graduale nga marksizëm-leninizmi dhe largimin nga uniteti internacionalist i marksistë-leninistëve në botë. Marksistë-leninistët duhet të forcojnë unitetin e tyre pa u vënë veshin shpifjeve dhe konsideratave të revizionistëve. Për sa u përket formave organizative që duhet të marrë ky unitet, ato duhen menduar e duhen gjetur konkretisht.

Revizionistët hrushovianë bëjnë zhurmë të madhe lidhur me tezën e pavarësisë së partive komuniste e punëtoresh dhe të veprimit të tyre sipas kushteve konkrete të secilit vend. Kjo, në fakt, është një tezë leniniste, të cilën vetëm ne marksistë-leninistët e respektojmë me konsekuencë. Por revizionistët modernë përpiqen të spekulojnë me të ashtuquajturën pavarësi të partive. Këtë e pranojnë vetëm me fjalë, sepse në realitet revizionistët hrushovianë duan varësi të të gjithë lëvizjes në drejtimin e tyre. Ata pavarësinë e kuptojnë të shkëputur nga internacionalizmi, që marksistë-leninistët të mos ke-

në një vijë të përbashkët për çështjet më themelore, siç janë qëndrimet ndaj imperializmit dhe renegatëve të marksizëm-leninizmit, respektimi i ligjeve të përgjithshme të revolucionit dhe të ndërtimit socialist etj. Marksistë-leninistët, duke respektuar me rreptësi pavarësinë e çdo partie për të përcaktuar vijën e politikën e saj, duhet, në të njëjtën kohë, t'u nënshtrohen parimeve të internacionalizmit proletar, ligjeve të përgjithshme të revolucionit dhe të ndërtimit socialist, duhet të përpunojnë një vijë të përbashkët dhe qëndrim të përbashkët për çështjet më themelore, sidomos për sa u përket luftës kundër imperializmit dhe luftës për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit nga revizionizmi modern.

Ngjarjet në Indonezi dhe sulmi i përbashkët i imperialistëve dhe i revizionistëve hrushovianë kundër popujve, kundër marksizëm-leninizmit e socializmit tregojnë se ne duhet të forcojmë unitetin ndërkombëtar të marksistë-leninistëve. Të gjithë komunistët revolucionarë, të gjitha partitë e vërteta marksiste-leniniste duhet të kapërcejnë me guxim e pa ngurrim dhe t'i shqelmojnë përfundimisht të gjitha pengesat që revizionistët modernë kanë mbjellë në rrugën tonë të unitetit marksist-leninist. Do të na akuzojnë se ne po krijojmë organizma të rinj ndërkombëtarë: ky do të jetë një nder që do të na bëjnë.

Marksistë-leninistët e botës bëjnë një bllok të çeliktë. Ky bllok i tmerron imperialistët dhe revizionistët, prandaj ata përpiqen me çdo kusht të na luftojnë, përpiqen që marksistë-leninistët të çoroditen pas parullave të tyre, për të cilat folëm më lart.

Por më kot e kanë: parulla leniniste «Proletarë të të gjithë botës, dhe popuj të shtypur, bashkohuni!» do të triumfojë.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 112 (5522), 11 maj 1966*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1965-1967», f. 335-349*

## DY PARIME THEMELORE TË METODËS SË PUNËS TË ORGANIZATAVE TË PARTISË

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

12 maj 1966

Vendimet e fundit të Komitetit Qendror të Partisë dhe Letra e Hapur po sjellin në gjithë jetën e Partisë sonë një përmirësim të dukshëm të stilit dhe të metodës së punës. Kjo vihet re në ngritjen e rolit të luftëtarit të pararojës, të vrullit krijues të komunistëve dhe të organizatave të Partisë për të çuar përpara lëvizjen e madhe revolucionare që ka përfshirë të gjitha masat punonjëse për të realizuar planet në ndërtimin e socializmit, duke u mbështetur në forcat e veta, për të qenë gjithmonë të gatshëm për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit, për mbrojtjen e atdheut.

Dy nga parimet themelore të metodës dhe të stilit të punës së komitetit të Partisë, që përcaktojnë në një shkallë të madhe zgjidhjen e problemeve në mënyrë revolucionare, në bazë të mësimëve të ideologjisë sonë marksiste-leniniste, në dobi të çështjes së socializmit, në dobi të interesave të Partisë, të popullit dhe të atdheut, janë pa dyshim, **puna kolegjiale dhe vënia e politikës së Partisë në plan të parë.**



Puna kolegjiale ka rëndësi të dorës së parë dhe përbën një nga parimet bazë të punës sonë. Kjo metodë është e rëndësishme për shumë arsye:

Me anë të saj sillen dhe hidhen për diskutim e vendim shumë mendime, shumë ide të ndryshme, për problemin që diskutohet, pra sillen mendime të formuara nga eksperiencia praktike e punës, nga konkluzionet e nxjerra nga lufta dhe nga puna e shumë njerëzve, të cilët ose kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në kryerjen e këtyre punëve, ose kanë përgjithësuar mendimet e masës së gjerë të punonjësve që luftojnë për realizimin në praktikë të detyrave.

Këto mendime, me metodën e punës kolegjiale, shoshiten thellësisht, në të kundërtat e tyre, sipas metodës dialektike materialiste, për të gjetur zgjidhjen e drejtë; pra u bëhet një analizë kritike problemit dhe pikëpamjeve të ndryshme të shfaqura për këtë problem.

Kjo metodë ndihmon që të shkëmbehet një eksperiencë e pasur mendimesh e veprimesh dhe njëkohësisht të sqarohen e të spastrohen, nëpërmjet një kritike dhe autokritike të shëndoshë, mendimet e gabuara politike, ideologjike ose organizative të ndokujt, si dhe anët subjektive, të përcipta e të njëanshme të trajtimit të problemit.

Krijohet një ambient i shëndoshë në udhëheqje, një unitet marksist-leninist, që bazohet jo në format, por në brendinë; jo në hierarkinë, por në barazinë shoqërore; jo në imponimin, por në bindjen; jo në ndrydhjen e mendimeve, por në rrahjen e tyre dhe në pranimin e vendimeve pas një analize marksiste-leniniste.

Metoda e punës kolegjiale rrënjos te njerëzit nevo-

jën dhe respektin për mendimet e të tjerëve, i edukon ata të jenë të thjeshtë, të afrueshëm me njëri-tjetrin, ia nënshtron «egon» së përgjithshmes, zhduk mendjemadhësinë dhe arrogancën subjektiviste e të dënueshme, zhvillon sinqeritetin te njerëzit, kurajën për të thënë të vërtetën për punën ose për shokun, qoftë ajo edhe e hidhur dhe krijon kështu një ambient shoqëror pune ku nuk ekzistojnë ngurrime, ndrydhje ose druajtje në shfaqjen e mendimeve, në bërjen e kritikës, në propozimet etj., etj.

Një punë e tillë kolegjiale siguron që problemi të studiohet dhe të zgjidhet drejt, siguron masa organizative të drejta për të vënë në jetë vendimin, siguron shpjegimin më të saktë politik të problemit, pasi ky është rrahur nga të gjitha anët dhe janë marrë parasysh të gjitha rrethanat e mundshme në një situatë të caktuar.

Që metoda e punës kolegjiale të bëhet një shprehje dhe të japë rezultate të mira, duhet të kihen parasysh shumë gjëra.

Kjo metodë kërkon që gjithsecili të mos vijë në mbledhje as me mendjen bosh as me duar bosh. Çdo njeri duhet të vijë i armatosur me të dhëna dhe me mendime konkrete, të sakta dhe serioze. Kjo do të thotë që cilido duhet të jetë i lidhur ngushtë me punën, me jetën, me njerëzit, me luftën, me problemet. Pra, te cilido praktika dhe teoria duhet të jenë të pandara, të ecin krahas. Të gjithë duhet të punojnë dhe të mendojnë, të mendojnë dhe të punojnë, të krijojnë, të reflektojnë dhe të krijojnë përsëri e kështu vazhdimisht, pa pushim.

Metoda e punës kolegjiale dhe drejtimi kolegjial i punëve jo vetëm na mëson, na edukon me një metodë pune të drejtë, por ajo nuk përjashton, përkundrazi, kërkon që metoda e punës së gjithsecilit të jetë e organizuar sipas parimeve të drejta, të atilla që kjo të përputhet dhe të fuqizojë metodën e punës kolegjiale.

Një metodë pune e tillë kolegjiale, e zbërthyer në përgatitjet individuale të gjithsecilit, ngjall dhe vë në binarë të drejtë si përgjegjësinë personale të cilitdo, ashtu edhe përgjegjësinë kolegjiale. Ajo nxit dhe ngjall atë që, për të mësuar nga një punë dhe drejtim kolegjial, duhet të aftësohesh, të mësohesh, të punosh intensivisht dhe thëllësisht vetë në punë dhe në drejtimet që je caktuar, të krijosh materialisht dhe racionalisht, në mënyrë që jo vetëm të japësh kontributin tënd në të gjithë punën, por veçanërisht të sjellësh në punën dhe në drejtimin kolegjial kontributin e vlefshëm, i cili, duke iu shtuar kontributit të të tjerëve në format që thamë më sipër, e ngre më lart nivelin dhe vlerën e punës e të drejtimit kolegjial.

Metoda e punës kolegjiale duhet të kontrollojë punën individuale të gjithsecilit dhe ta nxitë atë. Ajo duhet të bëhet një shkollë vullneti të çeliktë për të kapërcyer vështirësitë dhe pengesat objektive e sidomos ato subjektive të njerëzve. Kërkimi i llogarisë nuk është i plotë kur bëhet për rezultate globale dhe materiale. Ai është i plotë kur bëhet sidomos për shfaqjet politike, në radhë të parë ideologjike, të cilitdo dhe të gjithë atyre që shkaktuan suksesin ose dështimin.

Puna kolegjiale dhe drejtimi kolegjial, në të gjitha

aspektet që ta marrësh, janë të nevojshëm për drejtimin dhe për zgjidhjen e problemeve.

Problemet që i vihen përpara Partisë dhe udhëheqjes janë të rëndësishme, të shumta, të thjeshta dhe të koklavitura. Ato duhet të studiohen thellë, të zgjidhen drejt, herë veç e veç dhe herë në varësi e të lidhura me njëra-tjetrën. Çdo problem ka radhën e vet por shumë herë rrethanat kërkojnë që kjo radhë të priset, sepse një problem mund të marrë prioritet mbi tjetrin, e njëri të lihet për më vonë, megjithëse ishte parashikuar për t'u studiuar e për t'u zgjidhur më përpara. Këtë e kërkojnë dinamizmi i jetës, rrethanat objektive politike dhe ekonomike të brendshme, ose në lidhje me situatat ndërkombëtare etj., etj.

Një udhëheqjeje të mirë partie, që zbaton një metodë pune të mirë, nuk duhet t'i shpëtojë asnjë problem, i madh ose i vogël qoftë, nuk duhet t'i shpëtojë oportuniteti i marrjes ose jo menjëherë në shqyrtim i këtij ose i atij problemi, nuk duhet t'i shpëtojë problemi kyç që lidhet me një sërë problemesh të tjera, të cilat kërkojnë zgjidhje të përbashkët, nuk mund dhe nuk duhet t'i shpëtojnë pasojat që mund të ketë zgjidhja e një problemi në këtë ose në atë mënyrë. Pra, duhet të zërthehet një problem në të tanishmen, por duhet të përgatitet edhe zërthimi i problemeve të së ardhmes që parashikohen në vija të përgjithshme, por që për këto, në kohën e tyre, duhet të bëhen studime të reja e të merren vendime të reja në bazë të rrethanave dhe të situatave të krijuara.

Sekretari i parë i komitetit të Partisë, i cili udhëheq dhe drejton punët e komitetit duhet të qëndrojë

në lartësinë e detyrës që i është besuar. Ai duhet të jetë, në radhë të parë, një njeri politik dhe, që të jetë i tillë, duhet të jetë i pajisur me ideologjinë marksiste-leniniste. Kjo, natyrisht, fitohet me punë dhe me studim, me një punë racionale në praktikën e përditshme dhe pasurohet me eksperiencën e madhe të Partisë, me mësimet e klasikëve të marksizëm-leninizmit. Sekretari i parë duhet të jetë një organizator i mirë partie për të gjitha punët e saj, qofshin këto politike, ideologjike, ekonomike etj.

Mungesa e këtyre cilësive, që nuk janë të lindura te njeriu, por fitohen dhe perfeksionohen, e dëmton punën e drejtimit të Partisë. Si të gjithë komunistët, si të gjithë anëtarët e komitetit të Partisë, sekretari i parë veçanërisht, në rast se nuk bën çdo ditë përpjekje serioze që të pajiset me këto cilësi të mira dhe t'i perfeksionojë vazhdimisht ato duke i lidhur më ngushtë me jetën, me punën, me eksperiencën dhe me mendimet e shokëve, do të dëmtojë kolegjalitetin në drejtimin e punëve. Ai nuk do të jetë në gjendje t'i ndihmojë shokët me një punë të kualifikuar, nuk do të jetë në gjendje të koordinojë punën dhe mendimet e tyre krijuese, nuk do të jetë në gjendje të përgatitë drejt materialet ku parashtrohen problemet, gjë që ka një rëndësi të madhe, pasi kjo përbën bazën e studimit të çështjes, të anës politiko-ekonomike dhe organizative të saj.

Prandaj, duke e parë problemin në këtë prizëm, të gjithë komunistëve, njerëzve që janë zgjedhur ose punojnë në udhëheqje të organizatave të Partisë dhe të organeve të pushtetit, duke filluar që nga sekretarët

e organizatave-bazë e deri te sekretarët e komiteteve të Partisë, me sekretarët e parë në krye, si drejtues, nuk u lejohet të bëjnë një punë shkel e shko, nuk u lejohet një praktikizëm i vogël në punë dhe në drejtim, as edhe një pozitë prej «filozofi» ose «dijetari» që flet nga maja e Olimpmit.

Të gjithë njerëzit e Partisë duhet t'i kombinojnë dhe t'i zhvillojnë të dyja këto, punën praktike dhe zhvillimin mendor, në mënyrë të harmonishme, dialektike, marksiste-leniniste.

Imponimi fals mbi të tjerët duhet luftuar pa mëshirë, mungesa e përpjekjeve për të punuar dhe për të mësuar duhet të kritikohet ashpër e duhet dënuar.

**Parim tjetër themelor i metodës së punës të komitetit të Partisë, të byrove të organizatave-bazë, të organeve të pushtetit e të ekonomisë, të çdo komunisti është parimi i vënies së politikës në plan të parë, shqyrtimi dhe zgjidhja e problemeve në prizmin politik, me syrin politik e ideologjik të Partisë, në interesin e përgjithshëm të popullit, të atdheut, të socializmit. E gjithë jeta e Partisë sonë gjatë këtyre 25 vjetëve është karakterizuar, në përgjithësi, nga zbatimi i këtij parimi fort të rëndësishëm. Por ka edhe ndonjë shok, i cili, duke dëgjuar shprehjen «politika në plan të parë», të formuluar kështu, e merr këtë si diçka «të re», me të cilën ndeshet për të parën herë; kurse fakti i thjeshtë është që ky shok tërë jetën e tij në Parti dhe në çdo gjë ka vënë në plan të parë politikën e Partisë, është udhëhequr nga ky parim, të cilin Partia për 25 vjet me radhë e ka shkruar me gjak, me djersë, me bojë e me çfarë të duash, në të gjithë jetën e popullit dhe të ven-**

dit; dhe kjo politikë e Partisë s'ka lënë qoshe të vendit pa prekur, s'ka lënë skaj të ndërgjegjes së njerëzve tanë pa prekur dhe pa revolucionarizuar.

Kjo tregon se ky shok nuk reflekton, nuk mendon thellë, nuk krijon. Ai mendon në mënyrë automate se formulat dhe parullat janë çdo gjë për të, por këto nuk i zhvillon, nuk kontrollon zbatimin e tyre dhe nuk nxjerr konkluzione. Ai pret të dalin «simitet nga furr» që të ushqehet, përndryshe e griu uria.

Ndoshta një qëndrim i tillë vjen nga fakti se, kur ky shok thotë se «kjo është politika e Partisë», ai nuk e ka analizuar në të gjithë komponentët që e përbëjnë këtë. Politikën e Partisë ai e ka zbatuar dhe e zbaton në të gjithë veprimtarinë e tij, por në realitet me fjalën «politikë» ai kupton sidomos qëndrimet e Partisë dhe të shtetit tonë në marrëdhëniet me botën e jashtme dhe, kur ia përmend se politika duhet të predominojë mbi çdo gjë, ai habitet dhe i duket si diçka e re.

Ai nuk ka kuptuar lidhjet e ngushta të politikës me ideologjinë. Këto i shikon si dy gjëra të veçanta, pa lidhje me njëra-tjetrën, ose me lidhje të dobëta dhe kjo e ngatërron shumë. Ai mendon se të bësh politikë është një gjë dhe të mendosh, të veprësh e të udhëhiqesh nga ideologjia marksiste-leniniste, është një gjë tjetër. Ai, megjithëse vepron në bazë të politikës së Partisë, nuk mendon se në bazë të kësaj politike qëndron ideologjia marksiste-leniniste, ideologjia e klasës punëtore. S'ka politikë jashtë ideologjisë së klasës. Politika është e varur nga ideologjia, politika është kurdoherë me tendencë dhe shpreh drejtimet, qëlli-

met, programet e klasës, në rastin tonë të klasës punëtore dhe të udhëheqjes së saj, të Partisë.

Pra, kur themi që politika duhet të jetë në plan të parë, me këtë duhet të kuptohet se politika e Partisë duhet të mbizotërojë kudo, në çdo gjë. Kjo do të thotë se politika e Partisë ka në bazë të saj ideologjinë e klasës punëtore, ideologjinë marksiste-leniniste, e cila e krijon, e brumos, i jep drejtimin, e orienton në çdo gjë.

Zbatues i mirë i politikës së Partisë është, pra, ai që kupton dhe zbaton kurdoherë e në çdo gjë në mënyrë revolucionare ideologjinë e Partisë, ideologjinë marksiste-leniniste. Për këtë arsye të madhe dhe vendimtare për fatet e socializmit dhe të komunizmit në atdheun tonë dhe në shkallë ndërkombëtare, Partia jonë vë në rend të ditës, në radhë të parë, si detyrë të detyrave jetike për anëtarët e saj dhe për të gjithë punonjësit edukimin ideologjik marksist-leninist, vë në radhë të parë politikën dhe ideologjinë marksiste-leniniste revolucionare.

Njerëzve vazhdimisht e vazhdimisht duhet t'u bëhet e qartë politika e Partisë në çdo drejtim, në çdo sektor, në çdo situatë, në çdo ndryshim të ecjes përpara ose të tërheqjes; t'u bëhet e qartë strategjia dhe taktika e Partisë dhe të mos mendohet se ato kuptohen plotësisht, drejt dhe përnjëherë e nga të gjithë. Të mos shkohet nga mendimi se kjo politikë zbatohet nga të gjithë dhe kurdoherë drejt e pa gabime, të mos mendohet se, meqë u shpjegua një ose dy herë, kjo është një punë e mjaftueshme dhe e bërë përgjithnjë. Që njerëzit të kuptojnë dhe të zbatojnë drejt politikën



e Partisë në të gjitha drejtimet, duhet të edukohen ideologjikisht, të mësojnë marksizëm-leninizmin, ideologjinë e klasës punëtore, parimet bazë të kësaj ideologjie dhe këto parime t'i kenë aq të qarta sa t'u shërbejnë si busull në jetë, në luftë, në prodhim, në politikë e kudo.

Ai që ideologjikisht i shikon keq problemet, politikisht do të ecë në rrugë të gabuar; ai që ideologjikisht është i turbullt, do të jetë i turbullt edhe politikisht; ai që i sheh drejt ideologjikisht çështjet dhe orientohet nga ideologjia marksiste-leniniste, ai është i kthjellët edhe politikisht.

Le të marrim tani një shembull të thjeshtë, por që mund të shërbejë si mësim i madh, se si politika dhe ideologjia duhet të jenë në plan të parë dhe si duhet t'i edukojmë pa pushim njerëzit që të ngrihen ideologjikisht dhe të kuptojnë e të zbatojnë drejt e me sukses politikën e Partisë në çdo sektor.

Të marrim një punëtor tornitor. Ky vë në lëvizje tornon dhe prodhon me të vegla të caktuara. Tornoja punon, por punojnë edhe duart e punëtorit, të gjitha shqisat e tij; punon gjithashtu mendja e tij, e cila nuk fle. Ai, pra, prodhon me tornon e tij dhe mendon me mendjen e tij. Puna i zhvillon mendimet për prodhimin, për jetën jashtë prodhimit, për politikën, për familjen, për shoqërinë etj., etj. Ai rron në një vend socialist, e njeh në përgjithësi vijën dhe politikën e Partisë, e njeh dhe e do mjeshtërinë e tij.

Në qoftë se ky punëtor përpara tornos mendon se kjo është një mjet i mrekullueshëm, pronë e përbashkët e shoqërisë sonë, se puna që kryen është një

punë shoqërore dhe prodhimi, gjithashtu është një pronë shoqërore e përbashkët, ideologjikisht mendon drejt dhe e kupton drejt politikën e Partisë.

Po të mendojë kështu, atëherë rrjedhimisht, do të mendojë se këtë copë hekur duhet ta ruajë si sytë e ballit, të mos i prishet, ta mbajë pastër dhe të prodhojë sa më shumë e për një kohë sa më të gjatë me të, sepse tornoja është pronë e shtetit të tij, e popullit të tij dhe, pra, e tij.

Në goftë se mendon kështu, atëherë kjo do të thotë që ai, si pjesëtar i kësaj shoqërie, e cila i ka besuar këtë mjet, duhet të përsoset në mjeshtëri, të realizojë planin, ta tejkalojë atë, të kapërcejë normat, të bëjë sa më shumë kursime të lëndës së parë, të nxjerrë prodhim me cilësi sa më të mirë, të bëhet shembull për të gjithë dhe këto duhet t'i kryejë medoemos, sepse socializmi nuk ndërtohet pa njerëz të mësuar, sepse populli ka nevojë për prodhimin e tij dhe ai dëshiron e punon që ky prodhim të jetë i mirë, i lirë e me shumicë. Duke menduar kështu, ky punëtor, vë në radhë të parë politikën, pra politikisht mendon drejt.

Duke menduar kështu, ky punëtor njëkohësisht prodhon, por duke prodhuar, vë politikën në plan të parë dhe është kjo që komandon prodhimin. Ky punëtor mendon drejt dhe prodhimi ecën, shtohet, normat thyhen, përmirësohet cilësia, bëhen racionalizime e shpikje, pasi të gjithë këtë punë e udhëheq politika e drejtë e Partisë, ideologjia marksiste-leniniste.

Në vazhdim, ky punëtor mendon edhe për pagën e tij, për buxhetin familjar, për edukimin e fëmijëve, por këto i lidh me mësimet e Partisë, me politikën e

saj, me gjendjen e përgjithshme të popullit të vet, me ligjin «sa i jep shoqërisë, aq duhet të marrësh nga ajo», këto i lidh me drejtësinë dhe me ndershmërinë proletare.

Ky punëtor që vë në plan të parë politikën dhe që ideologjikisht është i qartë, kupton ç'është lufta e klasave, lufta kundër mbeturinave mikroborgjeze, vë në lëvizje kritikën dhe autokritikën bolshevike, i do njerëzit e mirë, e do socializmin, e do Partinë dhe i qëndron kësaj besnik e konsekuent.

Të marrim tani anën e kundërt, një punëtor që nuk e vë politikën në plan të parë dhe ideologjikisht është i paqartë.

Edhe ky gjendet përpara tornos dhe prodhon; tonon, sigurisht, e konsideron si një vegël që prodhon, por mendjen e ka te paga e tij, si të fitojë më shumë të holla dhe, duke u nisur nga kjo, ai prodhon pa cilësi, nuk u vë asnjë kujdes racionalizimeve, kursimeve e mirëmbajtjes së makinerisë. Ai nuk e kupton disiplinën proletare dhe moralin proletar, ai gënjen, është arrogant dhe servil njëkohësisht, përpiqet të përfitojë më shumë nga sa i jep shoqërisë etj., etj. Ky punëtor nuk vë aspak në plan të parë politikën e Partisë, por një politikë të huaj nga ajo e Partisë. Ky punëtor nuk është i qartë ideologjikisht dhe, pavarësisht se tornoja e tij prodhon, ajo prodhon keq.

Kështu është në të gjithë sektorët, në të gjitha drejtimet, në çdo punë, në qoftë se s'duhet të zgjatemi, duke marrë shembullin e ndonjë kooperativisti, ushtari, nëpunësi, intelektual, natyrisht me karakteristikat e tyre të ndryshme të klasës.

Por në jetë mos gjenden vallë vetëm këto dy kategori që morëm si shembull? Jo, në asnjë mënyrë. Ka edhe të tjerë që janë më të përparuar në mendime e në veprime se ai që shikon më shumë interesin personal, por që, nga ana tjetër, nuk kanë arritur akoma atë shkallë të formimit klasor sa ta kenë të zhvilluar ndjenjën e sakrificës për çdo gjë që ka të bëjë me interesin e përgjithshëm. Dhe pikërisht pse ka nivele të ndryshme në formimin ideologjik dhe politik të njerëzve, prandaj Partia, në mënyrë të vazhdueshme, duhet t'i edukojë politikisht anëtarët e saj dhe gjithë punonjësit. Mendimet e njerëzve, të cilat e kanë burimin nga materia, nga praktika, bëjnë ndryshime drejt së mirës, por edhe drejt së keqes, në rast se nuk edukohen politikisht dhe ideologjikisht, në rast se nuk edukohen njëkohësisht nëpërmjet punës.

Disa mendojnë se për rastin e parë, të punëtorit të mirë, çdo gjë është e qartë për të dhe nuk ekziston asnjë rrezik. Nuk është e drejtë të flihet mendja dhe të mos vazhdohet edukimi si për të mirin ashtu edhe për atë që ka lakra në kokën e tij. Populli ynë thotë një fjalë të urtë, të nxjerrë nga praktika, por me kuptim të madh filozofik: «Peshku qelbet nga koka». Kjo do të thotë se çoroditja dhe devijimet antimarksiste fillojnë në mendimet, në gjykimet, në politikë, në ideologji.

Është, pra, e domosdoshme të zhvillohet një luftë e vazhdueshme klasash në praktikë dhe në mendime në mes ideologjisë sonë socialiste materialiste dhe asaj borgjeze idealiste. Moszhvillimi i rreptë i kësaj lufte, në të gjitha shfaqjet e jetës, të punës dhe të mendimit, dobëson pozitat e socializmit, të Partisë, të marksizëm-

-leninizmit, i jep mundësi të forcohen pozitativat e ideologjisë së borgjezisë, të revizionizmit modern.

Prandaj politika e Partisë duhet të jetë në plan të parë në çdo gjë, kudo, në çdo kohë dhe vazhdimisht. Partia duhet t'i vërë rëndësi të madhe politikës dhe ideologjisë marksiste-leniniste, pasi vetëm kështu do të arrihet me sukses çdo objektiv i saj.

Ashtu siç është pa vend mendimi për ta paraqitur parullën e Partisë «politika në plan të parë» si diçka «të re», «abstrakte», ashtu është gabim dhe i dënueshëm nënvleftësimi i punës ideopolitike, edukuese e sqaruese që duhet bërë në organizatat e Partisë dhe me masat punonjëse për t'i armatosur ato sa më mirë, që në veprimtarinë e përditshme, në çdo front të punës, çdo çështje ta shqyrtojmë politikisht, duke vënë politikën në plan të parë.

Partinë dhe anëtarët e saj në çdo gjë, në punë dhe në luftë, duhet t'i karakterizojë një stil revolucionar, që fitohet në punë dhe në luftë. Këtu fitohet besimi në vijën, në politikën, në vetvete, fitohet pjekuria në mendime, luftohen javashllëku dhe rrëmbimi, fitohet shkathtësia në punë e në mendime dhe nga të gjitha këto arrihet në një stil e metodë revolucionare, që ka kurdoherë vulën e pashlyeshme të ideologjisë së klasës punëtore, karakteristikat e mira të Partisë sonë marksiste-leniniste.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 113 (5523), 12 maj 1966*

*Botohet sipas gazetës «Zëri i popullit», nr. 113 (5523), 12 maj 1966*

## ME KËTO TEZA TË KINEZËVE NUK MUND TË JEMI DAKORD

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH*

14 maj 1966

Sikurse jeni lajmëruar, shokë, sot këtë mbledhje po ia kushtojmë veprimtarisë së delegacionit të Partisë dhe të Qeverisë sonë, të kryesuar nga shoku Mehmet, i cili vizitoi Republikën Popullore të Kinës<sup>1</sup>.

Deklaratën<sup>2</sup> e lexova. Ajo është e mirë dhe, sipas mendimit tim, nuk ka asgjë për të diskutuar. Shokët e delegacionit i kanë mbrojtur mirë çështjet e Partisë sonë, prandaj duhet t'i përgëzojmë për këtë. Materialet e shokëve kinezë që na kanë sjellë shokët duhet t'i lexojmë të gjithë.

Për sa u përket kundërshtimeve në mes Çu En Lait dhe shokëve tanë, mendoj ta shikojmë ca më nga afër këtë çështje dhe, kur të na jepet ndonjë rast nga

---

1 Kjo vizitë u bë prej datës 28.4.1966 deri në datën 11.5.1966.

2 Deklarata e përbashkët shqiptaro-kineze. Botuar në gazetën «Zëri i popullit», më 15 maj 1966.

shokët kinezë, ne mund t'ua përcaktojmë edhe më mirë gjendjen e klasave në vendin tonë. Jam i mendimit se u duhet bërë e qartë kinezëve që te ne nuk ekzistojnë klasa shfrytëzuese siç mendojnë ata. Me tezën e tyre ne nuk mund të jemi dakord. Në qoftë se kinezët pranojnë për veten e tyre se nuk e kanë zhdukur akoma borgjezinë si klasë brenda vendit<sup>1</sup>, kjo nuk do të thotë se ata kanë të drejtë të mendojnë kështu edhe për vendin tonë, se kushtet ndryshojnë. Për sa i përket ekzistencës ose jo të klasave shfrytëzuese gjatë gjithë periudhës tranzitore nga kapitalizmi në socializëm duhet gjykuar si marksistë, duke u nisur nga kushtet konkrete të secilit vend dhe nga fakti se si janë zbatuar parimet dhe tezat e teorisë marksiste-leniniste nga njëri vend socialist e si janë zbatuar nga tjetri, ndryshe do të dilnim në konkluzione të gabuara.

Zhvillimi dialektik dhe historik i vendit tonë duhet parë me kujdes, duke u mbështetur në parimet marksiste-leniniste. Shteti te ne para Çlirimit ishte gjysmëfeudal, borgjezia nuk arriti të zhvillohej deri në atë shkallë sa të formonte tiparet e plota si klasë, siç ka ndodhur në vendet kapitaliste. Kur filloi Lufta Nacionalçlirimtare, feudalët e vendit tonë si klasë u katandisën keq e mos më keq politikisht,

---

1 Kjo tezë e udhëheqjes kineze e ka burimin te koncepti antimarksist i Mao Ce Dunit, sipas të cilit «Republika neodemokratike do të përbëhet nga katër klasa antiimperialiste dhe antif feudale: proletariati, fshatarësia, borgjezia e vogël dhe borgjezia nacionale»(!).

ideologjikisht dhe ekonomikisht. Gjatë këtyre 20 vjetëve të diktaturës së proletariatit lufta e klasave në asnjë mënyrë nuk ka qenë e fshehtë te ne, por është zhvilluar hapur, e ashpër, shkallë-shkallë dhe si pasojë e kësaj lufte raporti i klasave në vendin tonë ka pësuar ndryshime rrënjësore. Në fuqi është klasa punëtore, e cila ka aleate klasën tjetër mike, fshatarësinë punonjëse, kurse nga klasa shfrytëzuese e përmbysur kanë mbetur vetëm elementë të saj.

Ne e kemi studiuar dhe e dimë si kanë lindur klasat në Shqipëri, si janë zhvilluar, si është dobësuar klasa shfrytëzuese, si është përmbysur dhe eliminuar ajo, prandaj të thuash se gjatë ndërtimit të plotë të socializmit do të duhen edhe 20 apo 40 vjet që të likuidohen klasat shfrytëzuese, kjo nuk mund të pranohet nga ne, pse klasë pa bazë ekonomike nuk mund të ekzistojë. Pra si mund të thotë Çu En Lai që ne nuk bëjmë luftë klasash meqenëse themi që nuk ka klasa shfrytëzuese te ne? Ne bëjmë luftë klasash, bile të ashpër e të pandërprerë, por të themi që në vendin tonë ka klasa shfrytëzuese dhe të vihet pyetja, kush do të fitojë, ne apo ato në Shqipëri, kjo është e papranueshme, se nuk ka asnjë bazë.

Prandaj edhe mua më duket se drejt e kanë parë shokët e delegacionit tonë këtë çështje dhe në sajë të qëndrimit të mbajtur, ata arritën rezultate. Ne nuk mund të binim dakord që në deklaratën e përbashkët të vihej formulimi kinez, sipas të cilit klasat shfrytëzuese vazhdojnë të ekzistojnë gjatë periudhës së ndërtimit të plotë të socializmit, gjersa kjo pikëpamje nuk na duket e drejtë. Neve nuk na duket e drejtë, gjithash-



tu, të mendohej që në një dokument si deklarata të përcaktoheshin me detaje orientime edhe për lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Një gjë e tillë nuk mund të bëhet vetëm prej nesh.

Mendimet që ka Çu En Lai për luftën e klasave në Shqipëri, po të dojë, le të na i thotë dhe të na e sqarojë këtë çështje me fakte e të dhëna, pastaj ta shohim. Kur të vijë ai në Shqipëri, t'ia shpjegojmë edhe ne pikëpamjen dhe realitetin tonë, që flet qartë si vihen në jetë parimet marksiste-leniniste për klasat dhe për luftën e klasave në socializëm.

Edhe në çështjet e tjera që janë diskutuar, qëndrimi i shokëve tanë në Pekin ka rëndësi. Për çështjen e Stalinit shokët e delegacionit më duket bënë shumë mirë që i evituan diskutimet, se nuk ishte as momenti as qëllimi i vizitës për t'u ndalur te kjo. Çështjen e Stalinit ne e mbrojmë dhe duhet ta mbrojmë në bazë të tezave që kemi trajtuar gjer tani. Një nga konkluzionet tona është se revizionistët sovjetikë i krijuan gradualisht bazat e tyre në vend dhe se Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik duhet të ishte më vigjilente e të bënte një luftë më konsekuente për t'i spastruar këto, prandaj asaj i bie përgjegjësia e rëndë. Nga ajo që ngjau në Bashkimin Sovjetik, ne duhet të reflektojmë akoma më thellë, t'i bëjmë analizën si e qysh ngjau dhe konkluzionet që do të nxjerrim të jenë një mësim i madh për ne e të na vlejné për t'u armatosur më tej në luftën kundër revizionizmit. Askujt nuk i lejohet që, në vend që të bëjë këtë analizë, të thotë se Stalini ka gabuar. Po të pranonim formulimet në të cilat kanë arritur kinezët për Stalinin, qoftë duke u bazuar edhe

në disa thënie të vetë Stalinit, nuk do të bënim mirë. Ne nuk duhet të nxito kemi, po të thellohemi në analizën e fakteve. Natyrisht as nuk duhet të mendojmë se kinezët i kanë stisur këto gjëra. Ne nuk e besojmë që kinezët të jenë si revizionistët që të veprojnë me qëllime të këqija, po thëniet e Stalinit e kemi për detyrë t'i gjykojmë në lidhje me situatën kur ka folur për një çështje të caktuar dhe me zbatimin e tyre në jetë. Në qoftë se Stalini ka thënë që kuadrot zgjidhin çdo gjë<sup>1</sup>, kjo nuk do të thotë se ai mohon rolin e masave në zhvillimin e historisë, sepse në veprën e tij gjen përcaktime dhe konkluzione të tilla që tregojnë qartë se Stalini udhëhiqej nga parimi që masat janë krijueset e historisë.

Stalini është shprehur edhe për teknikën se kjo zgjidh çdo gjë, por këtë e ka thënë në kushte të caktuara, lidhur me rëndësinë e zhvillimit të industrisë ose të një dege tjetër të ekonomisë, në rrethana të tilla që duhej medoemos një shtytje e madhe për t'i nxjerrë ato degë nga prapambetja e theksuar.

*«Kjo parullë — thotë vetë Stalini më vonë për të — na ndihmoi që të zhdukim zinë në teknikë dhe të krijojmë një bazë teknike shumë të gjerë në të gjitha degët e veprimtarisë për t'i pajisur njerëzit tanë me një teknikë të dorës së parë»<sup>2</sup>.*

1 Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 26, shënimi 1, f. 3-4.

2 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 7.

Po që të mohojë Stalini rolin e njeriut, këtë ai nuk e ka bërë kurrë. Shokët kinezë këto formulime për kuadrin e për teknikën, këto parulla taktike i kanë marrë të shkëputura nga qëllimet dhe nga detyrat strategjike të përcaktuara prej Stalinit dhe Partisë Komuniste Bolshevike të udhëhequr prej tij. Në zbatimin e këtyre thënieve të Stalinit mund të ketë pasur gabime nga partia, por të dalësh me konkluzionin që vija ka qenë e gabuar, nuk do të ishte e drejtë. Në qoftë se vija nuk është zbatuar drejt nga partia, natyrisht edhe Stalini, si e gjithë udhëheqja, ka përgjegjësi, sepse duhet të kishte marrë masa. Kështu duhet gjykuar kjo çështje mendoj unë. Por shokët e delegacionit vendosën drejt që nuk hynë në diskutime për çështjen e Stalinit sepse, siç e theksuam, nuk ishte momenti për trajtimin e kësaj çështjeje.

Ne nuk duhet të biem në asnjë mënyrë në pozitat e hrushovianëve dhe të revizionistëve të tjerë, të cilët përpiqen të përqendrojnë vëmendjen në luftën kundër Stalinit, as nuk duhet t'u japim armë për të na luftuar. Revizionistët tani janë në aktivitet. Kritika që po bëjnë rumunët kundër Stalinit ose Kominternit synon, në fakt, të godasë marksizëm-leninizmin, pse në qoftë se ata merakosen të bëjnë kritikën e Kominternit, duhet të vënë në dukje edhe anët e tij të mira. Këtu çështja është për të cenuar unitetin, se, siç kemi thënë, rumunët mbajnë një vijë centriste, gjoja të pavarur, por në fakt vija e tyre është revizioniste, vijë e shpartallimit të unitetit marksist-leninist.

Çështja e Stalinit është edhe ca më e madhe, se, duke e sulmuar atë, sulmon në fakt marksizëm-leni-

nizmin. Këtë e pranojnë edhe kinezët. Në qoftë se ata duan të na bindin që ne të mos jemi për mbrojtjen e Stalinit, nuk kanë gjetur argumentet e përshtatshme dhe argumente për këtë çështje nuk do të mund të gjejnë. Ne e duam Stalinin pikërisht për veprën e tij gjeniale në shërbim të popujve, të revolucionit e të socializmit, dhe jo symbyllurazi. Ne e kuptojmë se Stalini mund të ketë bërë edhe gabime, por jo parimore, jo ato që thotë Hrushovi. Kontributi i Stalinit për zbatimin, mbrojtjen dhe pasurimin e teorisë marksiste-leniniste është i një rëndësie të tillë historike, sa ndonjë gabim që mund t'i vëmë në dukje nuk e errëson aspak figurën e tij si marksist-leninist i shquar. Gabime ka edhe Mao Ce Duni, gabime kemi edhe ne, por, siç e kemi thënë dhe siç e ka vërtetuar jeta, ne nuk kemi gabuar në vijë. Ne nuk ngulim këmbë që kinezët ta ndryshojnë pikëpamjen që kanë për këto çështje, por që të mundohen të na bindin ne për të pranuar tezat e tyre, këtë nuk e lejojmë. Të kritikosh Stalinin, do të thotë t'i bësh qejfin Hrushovit, të çosh ujë në mullirin e imperializmit dhe të revizionizmit modern. Ky është dhe do të ishte një gabim i madh.

Pavarësisht se kemi respekt marksist për PKK, kjo nuk do të thotë t'i pranojmë ato pikëpamje të saj që nuk na duken të drejta. Po të viheshin në deklaratë formulimet për këto çështje ashtu siç i kishte menduar udhëheqja kineze, do të ishte një minus edhe për ata, edhe për ne, sepse ky është një dokument me rëndësi që do të ketë reperkusione në lëvizjen komuniste ndërkombëtare; marksistë-leninistët,

kudo në botë, atë do ta studiojnë me vëmendje dhe do të frymëzohen prej tij.

Sidoqoftë, ajo që bënë udhëheqësit kinezë është puna e tyre. Rëndësi për ne tani ka çështja që këto kundërshtime u zgjidhën dhe kështu si i kanë zgjidhur shokët e delegacionit tonë është më e drejtë, është marksiste.

Pra, e theksoj se jemi plotësisht dakord me veprimtarinë e delegacionit tonë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# **MBI EKSPERIENCËN E ORGANIZATËS SË BASHKIMEVE PROFESIONALE DHE TË ORGANIZATËS SË RINISË NË RRETHIN E SHKODRËS**

*Fjala në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH*

**19 maj 1966**

Gjatë vizitës në rrethin e Shkodrës, në datën 28 dhe 29 prill, bëra edhe dy takime me kuadro e me aktivistë të organizatës së bashkimeve profesionale dhe të organizatës së rinisë të rrethit.

## **I Mbi eksperiencën e punës të bashkimeve profesionale**

Siç dihet, bashkimet profesionale janë levat më të rëndësishme të Partisë. Ato kanë luajtur dhe luajnë një rol të madh në edukimin e punonjësve, prandaj ne duhet të marrim masa që t'i gjallërojmë ato. Përsëri e Leninit, që organizatat e bashkimeve profesionale t'i gjallërojmë në jetë, jo vetëm ta themi, por edhe ta zbatojmë si duhet.

Në takimin me shokët e bashkimeve profesionale kryetari i këshillit të rrethit tha se tani po punojnë për zbatimin e vendimit që ka marrë Byroja Politike e Komitetit Qendror për bashkimet profesionale, për ta bërë organizatën sa më të aftë në kryerjen e detyrave që i janë ngarkuar si shkollë e edukimit komunist të klasës punëtore, por në këtë drejtim ka akoma shumë për të bërë. Vendimi u ka hapur horizontin dhe i ka mësuar si duhet ta kuptojnë rolin e kësaj organizate për ndërtimin e socializmit.

Në Shkodër, tani po punojnë që idetë dhe detyrat që cakton ky vendim t'ua bëjnë të qarta anëtarëve të plenumit dhe aktivistëve, për të thyer pikëpamjet jo të drejta e të ngushta sindikaliste të disave, që mendojnë sikur roli i organizatës së bashkimeve profesionale drejtohet vetëm në «mbrojtjen» e interesave të punëtorëve. Për kuptimin e drejtë të detyrave të bashkimeve profesionale, atje kanë zhvilluar disa tema të veçanta, për shembull, si duhet ta bëjnë bashkimet profesionale punën politiko-edukative me njerëzit; për emulacionin socialist si mjet për edukimin e punonjësve; për rolin e mbledhjeve të prodhimit; për lidhjet e organizatës profesionale me masat dhe dëgjimin e zërit të tyre etj.

Eksperienca e kohëve të fundit u ka treguar se po të organizohen mirë mbledhjet e bashkimeve profesionale, organizata gjallërohet. Qysh nga fundi i vitit të kaluar, kur u shtrua për diskutim hartimi i planit pesëvjeçar në qendrat e punës, në organizatat e bashkimeve profesionale vihet re një gjallëri. Kjo e ka shtuar shumë entuziazmin e punonjësve, të cilët

gjatë diskutimit kanë bërë mjaft propozime. Kohët e fundit, duke u mbështetur në orientimin e Partisë, ata kanë menduar që bashkimet profesionale t'i aktivizojnë më tepër për zbatimin e propozimeve të bëra, duke kërkuar, së pari, që drejtorët e ndërmarrjeve të japin herë pas here llogari përpara punëtorëve se si po i shqyrtojnë propozimet dhe vërejtjet e tyre. Gjithashtu kanë kërkuar që komiteti i Partisë të shikojë ç'qëndrim mbahet nga organet shtetërore dhe ekonomike ndaj propozimeve të punonjësve. Edhe në shtyp kanë bërë kritika për qëndrimet jo të drejta dhe për neglizhencat ndaj propozimeve që kanë bërë punonjësit. Lidhur me propozimet ka edhe çështje që nuk varen nga ndërmarrjet, po nga organet qendrore. Megjithatë bashkimet profesionale mund t'i nxitin udhëheqësit e ndërmarrjeve të ndërhyjnë në ministri për t'u dhënë përgjigje më të shpejta kërkesave dhe propozimeve të bazës e të mos ndodhë si me propozimin për shfrytëzimin e disa mbeturinave, për të cilin përgjigjen e morën pas një viti.

Në qoftë se organizatat e bashkimeve profesionale do të merren si duhet me problemet që porosit Partia, ato do të kenë patjetër rritje në punë. Kur u shtrua plani, diskutimet e punëtorëve ishin të gjalla. 78 propozime u bënë në Fabrikën e Letrës në Shkodër, 100 në NIL-Ushqimoren etj. Propozimet ishin për probleme që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm, prandaj rëndësi ka çështja që organizata e bashkimeve profesionale dhe organet shtetërore t'i përgjigjen hovit të punëtorëve.

Problemin e luftës kundër burokratizmit e kanë



shtruar edhe në organizatat e bashkimeve profesionale dhe u ka dhënë rezultate. Nga punëtorët janë bërë me këtë rast mjaft propozime për shkurtimin e organikave dhe për probleme të tjera.

«Ne, tha kryetari i këshillit të bashkimeve profesionale të rrethit, akoma nuk kemi arritur të gjejmë me se duhet të merren bashkimet profesionale, megjithëse jemi munduar të kapemi pas një boshti qendror. Në qoftë se organizata e bashkimeve profesionale do të bëjë një punë të gjithanshme politike edukative me njerëzit dhe nuk do të merret vetëm me disa probleme kulturore ose për «mbrojtjen e interesave të punëtorëve», rezultatet në punë do të jenë më të mëdha». Megjithatë ajo duhet të kujdeset edhe për hallet dhe kërkesat e punëtorëve të veçantë. Këtu duhet pasur parasysh se në organizatat e bashkimeve profesionale venë më shumë për t'u ankuar punëtorët që kanë të meta në punë sesa të tjerët, të cilët është mirë të venë për të ngritur probleme që janë në dobi të punës, të shoqërisë, por e keqja është se bashkimet profesionale në bazë nuk merren sa duhet me këtë çështje.

«Një e metë jona, tha kryetari i këshillit, është se nuk kemi bërë akoma që bashkimet profesionale në bazë të mendojnë vetë. Baza mendon dhe punon akoma me një metodë pune të vjetruar se është mësuar t'i jepen problemet të gatshme». Në mjaft raste, edhe tani kryetarët e komiteteve profesionale të qendrave të punës kërkojnë të mblidhen në fund të muajit për t'u caktuar rrethi me se do të merren muajin e ardhshëm, në vend që, me përjashtim të ndonjë orientimi,

secila organizatë të mendojë vetë sipas nevojave që i dalin. Në këtë drejtim pak vepron organizata-bazë e bashkimeve profesionale.

Organizatave të bashkimeve profesionale të ndërmarrjeve të reja industriale u del problem edukimi i punëtorëve me ndërgjegjen e klasës, me traditat e punës, me formimin e shprehive të disiplinës në punë, me ndjenjën e kursimit të lëndës së parë, me kujdesin për ruajtjen e pronës së përbashkët, me edukimin e punëtorëve të rinj për marrëdhënie e sjellje të mira, mbasi ka raste që në disa të rinj punëtorë shfaqen sjellje të papjekura.

Të tjera probleme kanë organizatat-bazë të bashkimeve profesionale në ndërmarrjet bujqësore. Në këto, për shembull, shtrohet çështja për një jetë më të kulturuar në familje, lufta kundër zakoneve prapanike etj., por organizatat këtu janë më të dobëta. Një dobësi tjetër në këto ndërmarrje është se vetë organizatat-bazë të Partisë nuk e njohin mirë rolin e bashkimeve profesionale, që t'u caktojnë atyre pastaj detyrat që duhet të kryejnë.

Një problem që preokupon organizatën e bashkimeve profesionale të Shkodrës, është vënia në vend e rolit të organeve udhëheqëse të organizatave profesionale: të këshillit të bashkimeve profesionale të rrethit, të presidiumit të tij dhe të komiteteve profesionale në bazë. Këshilli i rrethit duket se nuk e ndien si duhet përgjegjësinë si organ udhëheqës, pasi çdo gjë u ngarkohet ta kryejnë aparatet, instruktorët. Te këta mbështetet e gjithë puna e tij. Me qëllim fres-

kimi në aparat kanë bërë një ripërtëritje të kuadrit. Tani janë duke marrë masa edhe në bazë për të përtërirë aktivin, sepse del nevoja për të bërë korrigjime. Për shembull, në Fabrikën e Cigareve dhe në atë të Tisazhit, kolektivi në shumicën dërrmuese përbëhet nga shoqe, ndërsa kryetarë të bashkimeve profesionale janë zgjedhur burra. Ky fenomen e ka burimin edhe te konservatorizmi i burrave, edhe te mungesa e besimit në vetvete të vetë grave ose të vajzave që hezitojnë të dalin në udhëheqje të organizatës.

Atje kanë marrë masa për punimin e Letrës së Hapur të Komitetit Qendror, po akoma nuk kanë arritur t'i thellojnë dhe t'i konkretizojnë parimet e rëndësishme të saj. Vetë kanë disa mendime, po në bazë nuk i kanë argumentuar, për shembull, teorikisht dhe praktikisht që punëtorët ta ndiejnë veten zot të fabrikës, që ata vetë të aprovojnë planin dhe organikën e ndërmarrjes, të kërkojnë llogari për propozimet e bëra etj.

Në rrethin e Shkodrës më thanë se po punojnë për zhvillimin e mendimit krijues te punëtorët, që këta të ndiejnë më mirë përgjegjësinë për fatet e prodhimit, si dhe për ta organizuar më mirë luftën kundër shfaqjeve të indiferentizmit, të cilat vërehen në punë, brenda ndërmarrjes, në lagje e gjetkë. Për luftimin e këtyre shfaqjeve më treguan se kanë studiuar disa materiale teorike dhe materialet e Plenumit të Korrikut të 1964-ës të Komitetit Qendror dhe po punojnë për forcimin e vigjilencës revolucionare ndaj çdo fenomeni negativ, veçanërisht në drejtim të zhvillimit të kritikës nga poshtë dhe asaj paralele.

Një punë të mirë ata kanë bërë me buletinet e rrethit, duke propaganduar shembullin pozitiv të dy punëtorëve të moshuar të Fabrikës së Çimentos, të cilët kishin dalë në pension. Këta, kur morën vesh se fabrikës i mungonin punëtorët, megjithëse nuk kishin asnjë nevojë ekonomike, sepse marrin pension të mirë, u lutën të riktheheshin në punë, bile në cilindo turn që të ishte, derisa të zëvendësoheshin me punëtorë të rinj, me qëllim që fabrika ku ata kishin punuar tërë jetën, të mos dëmtohej. Ky qëndrim tregon ndërgjegjen e lartë socialiste të këtyre punëtorëve.

Pastaj, për t'u sqaruar, unë u drejtova disa pyetje shokëve të bashkimeve profesionale.

1. — Cili është në përgjithësi rendi i ditës i komitetit ose i këshillit të bashkimeve profesionale?

2. — Ç'forma përdoren në punën me aktivistët, si mobilizohen ata dhe përse?

3. — Si zhvillohet puna për edukimin dhe për sqarimin e punonjësve mbi të drejtat dhe mbi detyrat e tyre në bazë të ligjeve në fuqi?

4. — Si punohen me punonjësit detyrat që u dalin në bazë të urdhëresave dhe të rregulloreve të Qeverisë, të ministrive dhe të ndërmarrjeve?

5. — Si i lidhin detyrat politike me detyrat ekonomike në ndërmarrje, në zyra, në shkolla, a ka në këtë drejtim një praktikë pune dhe a rishikohet herë pas here kjo praktikë?

6. — A specializohen aktivistët për sektorë të ndryshëm, a mbledhen në grupe për diskutim proble-

mesh dhe a ndihmohen e kontrollohen ata për temat që përgatitin, për shtruarjen e tyre dhe për zhvillimin e diskusioneve për këto tema?

7. — Çfarë kontaktesh mban këshilli i bashkimeve profesionale me punonjësit dhe si ua zgjidh kërkesat që kanë karshi ndërmarrjes ose hallet e tyre personale?

8. — Ç'konsideratë kanë drejtoritë e ndërmarrjeve karshi këshillit të bashkimeve profesionale dhe pse e kanë ose nuk e kanë sa duhet këtë konsideratë?

9. — Ç'metoda edukimi përdoren për ngritjen e kryetarëve të komitetit profesional dhe si është në përgjithësi niveli politik, ideologjik dhe kulturor i tyre?

10. — Cili është niveli i trajtimit ekonomik të kuadrove të organizatës që janë funksionarë dhe paguhen? A është i mjaftueshëm? Me kë duhet të barazohen?

11. — A ka gra profesioniste në drejtim të bashkimeve profesionale? Po në këshilla?

12. — Cilën pjesë të edukimit të punonjësve duhet të marrë në mënyrë të veçantë Partia dhe cilën bashkimet profesionale?

13. — Si funksionojnë komisionet e pajtimit, a janë të nevojshme dhe pse kërkoni t'i prishni?

14. — Si mendoni të zgjidhen konfliktet në mes një punëtori dhe administratës?

15. — Si mendoni, mund të bien bashkimet profesionale në kundërshtim me shtetin, siç pretendojnë disa? Po me administratën?

16. — Ç'procedurë duhet të ndiqet për zgjidhjen e problemeve që dalin në ato raste kur bashkimet profesionale bien në kundërshtim me administratën dhe të ç'natyre mund të jenë këto kundërshtime?

17. — Si duhet të ndihmoni ju tani për çështjet e sigurimeve shoqërore që s'varen më nga ju, por nga Ministria e Financave? A e keni vënë këtë ujë në zjarr, apo keni larë duart fare?

18. — Si i keni lidhjet e punës me organizatat e rinisë dhe me ato të gruas për problemet e përbashkëta dhe për ato indirekte? Si i kuptoni ju këto lidhje dhe ç'duhet të bëni që t'i forconi?

19. — Si e përgjithësoni eksperiencën tuaj në rreth ndërmjet ndërmarrjeve të ndryshme, nëpunësve, arsimtarëve, punonjësve të ndërmarrjeve bujqësore dhe me rrethet e tjera?

20. — Ç'vërejtje keni për ndihmën që ju japin Komiteti i Partisë i Rrethit, organizatat-bazë të Partisë dhe çdo komunist në veçanti në punën tuaj?

Çfarë përmirësimesh mendoni ju se duhet t'i bëjë udhëheqja e Partisë ndihmës që ju jep?

E njëjta pyetje edhe për Këshillin Qendror të Bashkimeve Profesionale.

Lidhur me pyetjet që u drejtova, ata dhanë shpjegime.

Presidiumi i keshillit të bashkimeve profesionale të rrethit më parë ka punuar në bazë të një plani tematik vjetor, por në praktikë u pa se kjo punë nuk i ecte, sepse parashikimet për tërë vitin nuk është e mundur të bëhen si duhet. Në përgjithësi është e drejtë që njëfarë perspektive duhet të ketë organi-

zata, por që t'i qëndrosh skllav planit kur jeta ecën, nuk është e drejtë.

Hallkat e organizatës së bashkimeve profesionale në rreth janë: këshilli i bashkimeve profesionale të rrethit, presidiumi i tij, komiteti profesional i ndërmarrjes dhe në ndërmarrjet e mëdha, komiteti profesional i sektorit ose i repartit, si dhe grupet profesionale<sup>1</sup> që ngrihen në bazë të turneve, të brigadave ose të reparteve të vogla. Mendimi i shokëve atje është se struktura për organizatat e bashkimeve profesionale është e rëndë dhe e ndërlikuar, nuk ka një përcaktim të studiuar se si duhet të jetë ajo. Grupi profesional është njësia më e vogël. Ky mund të ketë 50-100 veta, aq sa është turni ose reparti. Në çështjen e strukturës atje kanë pikëpamje të kundërta me ato të shokëve të Këshillit Qendror. Edhe mendimi i aktivistëve ndahet më dysh. Disa, për Ndërmarrjen e Tisazhit, për shembull, mendojnë të ketë dy komitete profesionale, një për tisazhin dhe një tjetër për repartin e mëndafshit, ndërsa të tjerët thonë të ketë një komitet për krejt ndërmarrjen. Kështu mendohet edhe për Fabrikën e Çimentos. Në Uzinën e Fermentimit të Duhanit ka tri zona dhe një repart. Në çdo zonë ka një komitet profesional që lidhet direkt me atë të ndërmarrjes. Atje, pra, nuk e kanë të qartë këtë problem.

---

1 Në Statutin e BPSH, miratuar nga Kongresi i 7-të i BPSH në maj 1972, «grupi profesional» nuk përfshihet më në strukturën e organizatës së bashkimeve profesionale; ai u hoq si hallkë e tepërt.

Mendimi im është që duhet ta shikojmë problemin e hallkave të shumta që ekzistojnë në organizatën e bashkimeve profesionale. Çështjen e strukturës duhet ta shohim edhe nga pikëpamja se organizata e bashkimeve profesionale nuk ka të njëjtën përgjegjësi të rëndë si organizata-bazë ose komiteti i Partisë i ndërmarrjes, prandaj për organizatat e bashkimeve profesionale në bazë mund të mos kemi shumë hallka të fryra drejtuese. Me këtë nuk dua të them që organizatat e bashkimeve profesionale të reparteve t'i likuidojmë, as të bëhet një punë shkel e shko në to, përkundrazi ato duhet të forcohen, po në vend të komiteteve të fryra në repart mund të kemi bërthama drejtuese të shkathëta, të manovrueshme, të cilat marrin direktiva nga komiteti profesional i ndërmarrjes dhe luftojnë t'i zbatojnë ato duke mobilizuar punëtorët në realizimin e detyrave.

Pastaj duhet pasur parasysh se në ndërmarrje ka edhe organizata të tjera, në radhë të parë organizata-bazë e Partisë, këshilli i gruas, komiteti i rinisë, vijnë pastaj grupet profesionale etj. Duke pasur shumë organizma, ndodh që disa punëtorë të njëjtën çështje e dëgjojnë shumë herë, një herë në organizatën e bashkimeve profesionale, punëtorët e rinj dhe të reja nga mosha e dëgjojnë edhe në organizatën e rinisë, gratë punëtore në organizatën e tyre, kurse punëtorët që janë komunistë edhe në organizatën e Partisë. Veç kësaj, në ndërmarrje bëhen edhe mbledhje të tjera si ato të prodhimit, të këshillit teknik, të repartit, ku punëtorët mblidhen për problemet që nuk ecin etj. Prandaj ky problem, nëse



duhen të gjithë këta organizma, mendoj të shihet në kompleks, të mendohet, pra, se si mund të organizohet, nën drejtimin e Partisë, një punë më e harmonishme në qendrat e punës, në mënyrë që atje të mos ketë një numër kaq të madh mbledhjesh, tematikash, byrosh, komitetesh, sepse të gjitha këto na krijojnë konfuzion në punë, bëjnë që njerëzit të merren me shumë gjëra dhe si rrjedhim asnjë të mos e bëjnë mirë. Porosita shokët e bashkimeve profesionale që këtë çështje ta studiojnë së bashku me Komitetin e Partisë.

Një ndihmë të madhe i kanë dhënë aktivistët komitetit profesional të NBSH-së «Perlat Rexhepi». Këta u kanë shtruar punëtorëve propozimet e tyre që janë aprovuar nga drejtoria, duke u dhënë shpjegime cilat do të viheshin në jetë dhe cilat jo, kanë propaganduar te qytetarët për kushtet e mira të punës në ndërmarrje bujqësore, kanë ndihmuar me qëllim që të shtojnë radhët e punëtorëve nga qytetarët e pasistemuar në punë. Si rrjedhim i kësaj pune propagandistike, ata kanë mundur të sigurojnë punëtorë në sezonet që kanë pasur shumë nevojë. Gjithashtu, aktivistët kanë bërë një punë të mirë me punëtorët për rritjen e cilësisë së prodhimit. Kjo punë, thanë ata, e bërë me anë të aktivistëve, ka sjellë gjallëri te punonjësit.

Kur e pyeta një aktiviste të bashkimeve profesionale të ndërmarrjes bujqësore, që ishte një punëtoare e dalluar në sektorin e saj, nëse e ka ngarkuar ndonjëherë organizata për t'u përgatitur për ndonjë problem të caktuar që nuk shkon mirë dhe pastaj

të flasë për këtë çështje, u përgjigj se e kishin ngarkuar një herë për luftën kundër dëmtuesve të hardhive. Kjo kishte shkuar dhe ishte konsultuar për këtë problem me punëtorët. I thashë se, kur ajo shikon që diçka nuk ecën në rrugë të drejtë, kur veprohet jashtë ligjeve të shtetit ose të Partisë etj., ka marrë vetë iniciativën të konsultohet me shokët dhe shoqet ku punon, të diskutojë me ta përse ndodhin këto fenomene, apo pret të aktivizohet vetëm kur e ngarkojnë? E pyeta gjithashtu a e ndien ajo veten si një anëtare aktive e bashkimeve profesionale, që i ka sytë edhe në punë për të realizuar detyrën e saj si punëtores, por njëkohësisht edhe të shokët dhe shoqet që ka rreth e përçark për të parë nëse punojnë mirë ose jo, nëse sillen apo nuk sillen mirë etj., ose vetë, pa e ngarkuar kurrkush, të thërresë punëtorë të dalluar, t'i udhëzojë për një problem që nuk ecën mirë dhe të kërkojë që ata vetë të luftojnë e ta zhdukin këtë dobësi? Këtyre pyetjeve ajo iu përgjigj negativisht.

Puna e aktivistëve ka rëndësi shumë të madhe. Ata janë leva shumë të rëndësishme të organizatës së bashkimeve profesionale. Më kujtohet se kur kam qenë student në Francë dhe mbaja lidhje me anëtarë të Partisë Komuniste të Francës, njëri prej tyre më ftoi një ditë të shkoja në një takim që do të bëhej midis aktivistëve të organizatës sindikale të firmës «Rëno» dhe një mjeshtri të kësaj firme. Në këtë takim pashë se si luftonin punëtorët pararojë për mbrojtjen e të drejtave të tyre kundër përfaqësuesve të kapitalistëve, pashë se aktivistët ishin njerëz të

përgatitur shumë mirë, i kërkonin mjeshtrit llogari dhe e luftonin atë me argumente të forta.

Natyrisht, roli i aktivistit në vendin tonë, ku klasa punëtore është në fuqi, është krejt ndryshe. Këtu aktivistët duhet të jenë të edukuar me një frymë të tillë që në shpirtin e punëtorëve të rrënjosin vijën e Partisë, disiplinën proletare kundër të gjitha fenomeneve negative, si burokratizmit, javashllëkut, indiferentizmit, kënaqjes me pak etj. Aktivisti, kur vëren një fenomen negativ, duhet t'i bëjë pyetjen vetes, përse ndodh kështu dhe t'i edukojë punëtorët ashtu si na mëson Partia. Të tillë aktivistë duhet të përgatitim ne, pasi udhëheqësit e organizatës janë të paktë, ata nuk mund të jenë kudo. Por që aktivistët të kryejnë rolin e tyre, me ta duhet bërë një punë e kualifikuar. Në radhë të parë, vetë këta të kuptojnë rëndësinë e detyrës që ka aktivisti, ç'do të thotë të jesh aktivist i bashkimeve profesionale, se aktivisti është një njeri i fortë, i përgatitur ideologjikisht e politikisht, që kur flet ngre peshë të gjithë ata që e dëgjojnë. Ai u flet haptazi njerëzve, jo me doreza. Ata që nuk i kuptojnë shpejt çështjet, ai i ndihmon t'i kuptojnë në rrugën e Partisë, të rregullave, të moralit shoqëror dhe të ligjeve të shtetit.

Aktivistët kanë nevojë për ngritjen e tyre, prandaj duhet parë ku gjejnë vështirësi, çfarë temash ose ç'material u duhet për t'u hapur horizonte, dhe ato t'u përgatiten në mënyrë të thjeshtë. Kjo punë do t'i ndihmojë ata për të kryer mirë detyrat, prandaj të mendohet seriozisht për t'i bërë të aftë që

të flasin, të sqarojnë politikisht punonjësit. Kjo arrihet kur secili ta ketë të qartë problemin për të cilin do të flasë. Ata që e kanë të qartë problemin nuk do të ngurrojnë pastaj ta shtrojnë atë në mënyrë të thjeshtë, të qartë e të drejtë.

Të marrim, për shembull, çështjen si zbatohen propozimet e bëra nga kolektivi. Vënia e tyre në jetë nuk varet vetëm nga administrata e ndërmarrjes, por edhe nga punëtorët, se disa i zbatojnë, disa nuk i zbatojnë, ashtu siç ndodh që disa administrata të ndërmarrjeve nuk i vënë në jetë propozimet, sepse i neglizhojnë ose pse drejtuesit e ndërmarrjes nuk janë të bindur për realizimin e tyre. Kur drejtori i ndërmarrjes, ta zëmë, nuk është i bindur për të vënë në jetë një propozim, mund të ngarkohen aktivistët të dalin para tij e ta mbrojnë propozimin në mënyrë të argumentuar, pasi të jenë këshilluar më parë me autorët e propozimit. Ose kur shihet se disa punëtorë nuk po e realizojnë një detyrë, aktivistët përdorin forma të përshtatshme takimesh e mbledhjesh me këta punëtorë, flasin me ta, përpiqen t'i bindin etj., etj. Këto janë disa forma që mendoj se mund të praktikohen me aktivistët. Këtë kuptim kanë aktivistët. Jeta do të japë forma dhe mënyra nga më të ndryshmet për t'i vënë ata në lëvizje.

Mendimi im është se organizata e bashkimeve profesionale është mirë që kudo, në çdo fabrikë apo në çdo institucion, të ketë disa aktivistë, njerëz të specializuar për këtë punë, për problemet e rëndësishme të ndërmarrjes, si ato politike, ideologjike, ekonomike. Ndërmarrja ka inxhinierë, ka drejtorin,

nëndrejtorët që natyrisht edhe këta janë njerëz partie, por ne duhet të kemi aktivistë nga radhët e punëtorëve. Kjo ka rëndësi të madhe. Po të punohet në këtë mënyrë, ne do të krijojmë një mori kuadrosh revolucionarë, specialistë për punën e organizatës. Në udhëheqje të organizatës së bashkimeve profesionale të ndërmarrjeve ka shokë të zgjedhur, që i kuptojnë mirë përgjegjësitë, por nuk mjafton të mbështetemi vetëm tek ata, ne duhet të punojmë që të ngremë edhe masat në një nivel të lartë, prandaj kudo duhet të fillojmë të përgatitim aktivistë të vërtetë, njerëz me autoritet dhe të zotë, që kur t'i ngarkosh për një punë, pasi t'i kemi ndihmuar dhe orientuar mirë, të jenë në gjendje ta kryejnë atë plotësisht, të jenë në gjendje të mobilizojnë punëtorët politikisht dhe ideologjikisht dhe të bëhen dora e djathtë e komitetit profesional.

Edukimi i anëtarëve të bashkimeve profesionale, sqarimi i punonjësve për të drejtat dhe për detyrat e tyre në bazë të ligjeve në fuqi, është një temë e gjerë. Ne kemi në fuqi ligjet shtetërore dhe vendimet e orientimet e Partisë. Ligjet tona kryesore duhet t'i dijë çdo punëtor jo vetëm thjesht për të mbrojtur të drejtat e tij personale, por, në radhë të parë, për të mbrojtur interesat e shtetit dhe të ndërmarrjes. Prandaj, kur del një ligj i ri ose një rregullore, organizatat e bashkimeve profesionale duhet t'ua bëjnë të njohur përmbajtjen e tyre punëtorëve, mbasi kjo është një punë me rëndësi të madhe. Vetë punëtorët, që punojnë në ndërmarrjet e shtetit, duhet t'i zbatojnë ligjet, por, që t'i zbatojnë, ata duhet të njo-

hin esencën e tyre. Të marrim ligjin e madh, Kodin e Punës ose ligje të tjera. Organizatat e bashkimeve profesionale duhet t'i edukojnë punëtorët që t'i njohin, të kuptojnë esencën e tyre, të dinë se ky ose ai ligj ka këtë qëllim, se kjo është ideja e këtij ose e atij ligji. Ligjin ne duhet t'ua bëjmë të qartë punëtorëve, në radhë të parë, nga ana politike, ideologjike dhe ekonomike dhe pastaj t'i edukojmë ata që ta zbatojnë si duhet. Natyrisht, po ta bëjnë organizatat e bashkimeve profesionale këtë punë, punëtorët do t'i kuptojnë mirë ligjet dhe këta pastaj do të dinë t'i mbrojnë ato. Kështu, kur ndonjë e shkel ligjin, ai që e di rëndësinë e tij, i tërheq vëmendjen, e bën ta ndreqë gabimin, nuk e lejon ta përsëritë më. Por në këtë drejtim nga ana e organizatës së bashkimeve profesionale në rrethin e Shkodrës nuk punohet fare, sikurse e pohoi vetë kryetari i bashkimeve profesionale të rrethit.

Ky problem ka rëndësi se ka të bëjë me edukatën civike<sup>1</sup> të qytetarëve. Çdo qytetar i Republikës ka të drejtat e veta të caktuara me ligj, të cilat duhet t'i dijë që të mund t'i mbrojë dhe të detyrojë të tjerët që t'i zbatojnë ato drejt. Në radhë të parë, klasa punëtore duhet të dijë esencën e ligjeve.

Propagandimi dhe popullarizimi i ligjeve mund të bëhet edhe nga punonjësit e organeve të drejtësisë, siç veprojnë në Shkodër, por organizata e bashkimeve profesionale duhet të ketë aktivistët e saj për këtë

---

1 Nga latinishtja — qytetare:

punë. Ndër këta aktivistë mund të jetë edhe prokurori, edhe gjykatësi, por mund të jetë edhe inxhinieri, punëtori, mësuesi e të tjerë. Kur një jurist ngarkohet të punojë një ligj dhe flet në detaje për çështje që masës nuk i hyjnë në punë, shokët e organizatës së bashkimeve profesionale duhet t'i kërkojnë të mos i futë njerëzit në pyllin e ligjeve, po t'u shpjegojë esencën, konsideratën thjesht politike dhe ekonomike të tyre.

Sidoqoftë nuk duhet ta harrojmë këtë çështje, se kjo bën pjesë në edukatën civike të qytetarëve. Për këtë ka disa norma, sipas të cilave ligjet duhet t'i dinë jo vetëm ata që merren me to, por edhe ne të tjerët që të mund t'i zbatojmë mirë dhe të mos i shkelim. Sipas Leninit, organizatat e bashkimeve profesionale kanë edhe funksionin e ruajtjes së ligjeve nga shtrembërimet administrative.

Për lidhjen e detyrave politike me detyrat ekonomike në ndërmarrje, në zyra, në shkolla, me mësuesit etj., organizata e bashkimeve profesionale ka një praktikë pune, por kjo mendoj se duhet të rishikohet herë pas here. Për normat, për shembull, flitet që janë një element ekonomik i punës. Ky është një problem që ka edhe anën e vet politike dhe ideologjike. Por a e orienton dhe e ndihmon Partia organizatën e bashkimeve profesionale që, kur të flasë për normat, ta kapë problemin në gjithë kompleksin e tij dhe jo vetëm pse nuk realizohen ato? Rëndësi ka çështja që punëtorit t'i futësh mirë në kokë jo vetëm anën ekonomike të normës, po edhe anën politike dhe ideologjike të saj, që ai të dijë ideologjikisht dhe politikisht ku e kanë burimin normat. Kur punëtori e

realizon normën, ai duhet të parashikojë edhe pasojat pozitive që ka kjo punë për zhvillimin e Republikës, për forcimin e pushtetit. Kuptohet se që të realizojë normën punëtori, duhet të zhvillohen tek ai disa aftësi të veçanta, se vetëm me forcën fizike ajo nuk realizohet. Por që të zhvillohen këto aftësi, duhet t'ia shpjegosh politikisht punëtorit ç'të mira do të ketë shoqëria nga realizimi i saj. Po të kuptohet kjo mirë, qind për qind politikisht, atëherë punëtori do të mobilizohet me të gjitha forcat e veta që ta realizojë normën.

Organizatat e bashkimeve profesionale duhet t'i kushtojnë kujdes kësaj pune. Një punëtoare e Uzinës së Fermentimit të Duhanit dhe anëtare e presidiumit të bashkimeve profesionale të rrethit, ngriti problemin se në ndërmarrjen e saj e kanë pasur preokupacion të vazhdueshëm realizimin e normave. Vjet, para mbylljes së sezonit të duhanit, kishin 400 punëtoare që nuk e realizonin normën, bile edhe vetë drejtuesit e organizatës kishin pikëpamjen se normat nuk mund të realizoheshin. Puna qëndronte se njerëzve nuk u shpjegohej si duhet problemi, u thuhej vetëm një fjalë «realizoni normat!», pa parë qëndrimin e tyre ndaj punës, ardhjet me vonesë, mosshfrytëzimin si duhet të kohës, hallet që kishin ata dhe arsye të tjera. Kur organizata-bazë e Partisë dhe organizata e bashkimeve profesionale të uzinës i kapën, i analizuan këto çështje dhe filluan të punonin konkretisht me këto punëtoare që nuk i realizonin normat, duke ua shpjeguar problemin në radhë të parë politikisht, u arrit që nga të 400 të prapambeturat, pjesa dërrmuese e tyre



të bëhen të përparuara dhe ta realizojnë normën. Tani në uzinë kanë vetëm 70 veta që nuk e realizojnë normën dhe kjo për arsye se kanë vajtur rreth 200 punëto-re të reja.

Kudo ka punëtorë shumë të mirë, ka edhe të tjerë që kanë të meta. I pyeta shokët e Shkodrës si ve-projnë ata për të përgjithësuar eksperiencën e më të mirëve, njëkohësisht si i sinjalizojnë dhe si punojnë me punëtorët për të metat që u vënë re? Mendojnë e diskutojnë ata për zhdukjen e një fenomeni nega-tiv që vërehet jo te një ose te tre, por te dhjetëra punëtorë? U rekomandova se do të ishte shumë mirë që çdo punëtor që ka një dobësi të këshillohej në mënyrë individuale, por, natyrisht, kur këta janë shumë, nuk të lejon koha. Prandaj kur vërehet një fenomen negativ në fabrikë ose në ndër-marrje, shokët e komitetit profesional duhet të mendojnë se si të punojnë për t'i edukuar tërë këta njerëz, jo në mënyrë individuale, por në grup, të organizojnë në këtë rast me ta një bisedë në mënyrë të përgjithësuar, t'u shtrojnë problemin nga ana politike, ekonomike, mo-rale, ideologjike, t'u bëjnë një referat për atë fenomen negativ që, po të mos bëhen përpjekje për ta luftuar, të sjell pasoja jo të mira, dhe në fund t'u flasin për masat që duhen marrë për të mos u përsëritur. Pra, nga rastet e veçanta herë pas here duhet të bëhen përgjithësime, të organizohen mbledhje me punëtorët, për të zhvilluar me ta biseda, në mënyrë që këto t'u shërbejnë të gjithëve si një mësim edukativ. Le të vijmë edhe një herë në problemin e normave. Disa i realizojnë ato, ka të tjerë që nuk i realizojnë, disa

i realizojnë më mirë, ka edhe punëtorë të përparuar që i tejkalojnë. Ata që nuk i realizojnë mund të kenë arsye edhe objektive, po ka që nuk i realizojnë për arsye subjektive, sepse nuk e kuptojnë si duhet politikisht rëndësinë e problemit ose janë të dobët nga ana teknike, disa sepse janë dembelë ose kënaqen me pak etj. Atëherë shokët e bashkimeve profesionale duhet ta diskutojnë këtë problem dhe të caktojnë një njeri që t'u flasë të gjithëve atyre që nuk i realizojnë normat ose që kanë shfaqje indisiplinimi etj.

Organizata e bashkimeve profesionale në Fabrikën e Mëndafshit kishte aktivizuar disa punëtorë të moshuar, po të përparuar, njerëz të qartë politikisht, për t'u folur disa grave e vajzave punëtore që, për faj të tyre, nuk i realizonin normat, sepse gjatë punës disa bënin muhabet, të tjerat lëviznin pa nevojë nga një vend në tjetrin etj. Ky takim, duke e shtruar problemin në radhë të parë politikisht, bëri efekt, punëtoreve u erdhi turp për qëndrimin që mbanin ndaj punës, prandaj u mobilizuan dhe arritën që normat t'i realizojnë.

Edhe në Uzinën e Fermentimit të Duhanit organizata e bashkimeve profesionale organizoi mbledhjen e punëtorëve të një reparti, ku u diskutua çështja e 15-20 punëtoreve të reja, të cilat vinin vazhdimisht me vonesë pa arsye, duke u bërë shembull negativ. Duke e trajtuar drejt problemin nga ana politike, organizata arriti të mobilizojë opinionin e tërë kolektivit të repartit, i cili e dënoi këtë qëndrim. Puna politike dhe forca e kolektivit i edukoi këto punëtore.

Natyrisht, lidhja e detyrave ekonomike me ato politike në përgjithësi bëhet, por çështjen e kam që të gjenden forma më të përshtatshme që t'u bëhet shprehje njerëzve që kur flasin për një gjë, kur shtrojnë një detyrë ekonomike, ta shpjegojnë atë në radhë të parë politikisht dhe ideologjikisht. Kjo nuk duhet kuptuar ngushtë, sikur të zbrazim në kokën e punëtorit tërë veprat e Marksit apo të Engelsit, të Leninit apo të Stalinit, por, po të reflektohet pak nga secili, do të gjendet mundësia e shpjegimit të anës ideologjike dhe politike të çdo problemi që i del përpara një aktivisti ose udhëheqësi të organizatës. Sekretari i organizatës-bazë të Partisë mund të jetë njeri jo me ndonjë zhvillim të gjerë teorik, po pranë ai ka plot njerëz me eksperiencë, me arsim të lartë e me horizont të gjerë. Atëherë t'i drejtohet njërit prej tyre dhe t'i kërkojë si ta trajtojë teorikisht me kolektivin çështjen e normës, ose t'i rekomandojë ç'vepër të lexojë për këtë problem që preokupon ndërmarrjen. Disa shokë që i shikojnë ca si ngushtë këto probleme, arrijnë në konkluzionin e gabuar «ç'na duhen neve organizatat e bashkimeve profesionale», kurse këto për Partinë kanë një rëndësi të jashtëzakonshme. Sa shumë detyra kanë ato!

I këshillova shokët e Shkodrës të praktikojnë edhe një metodë tjetër në punën e tyre, të mos presin sa të bëhet mbledhja, pastaj ta shtrojnë për zgjidhje një problem. Në qoftë se për lidhjen e detyrave politike me ato ekonomike, ta zëmë, të vjen një mendim në kokë, atëherë përse të presësh deri në mbledhjen e zakonshme të presidiumit të këshillit të bashkimeve

profesionale të rrethit? Udhëheqësi i bashkimeve profesionale, me iniciativën e tij, mund të organizojë një mbledhje të veçantë me aktivistët, me të cilët hap një diskutim për këtë çështje dhe merr mendimin e tyre. Pastaj ai vetë i përpunon më tej këto mendime dhe, mbasi të ketë arritur në disa konkluzione, i propozon këshillit se ka për të shtruar një problem, shfaq pikëpamjet e tij, kërkon edhe mendimin e forumit, i cili aprovon një orientim të caktuar për atë problem.

Lidhur me kontaktet që mban këshilli i bashkimeve profesionale me punëtorët dhe si i zgjidh ai ankesat e punëtorëve ndaj ndërmarrjes, më thanë se më parë kishte disa hallka burokratike që e pengonin këtë afrim me këshillin e rrethit, çdo gjë bëhej nëpërmjet lutjeve, kurse tani në këtë drejtim po punohet më mirë si nga këshilli ashtu edhe nga organizatat në bazë.

Kontaktet e këshillit të bashkimeve profesionale me punëtorët duhet të jenë të rregullta. Kur një punëtor vjen të ankohet në organizatën e bashkimeve profesionale për një masë që ka marrë ndërmarrja ndaj tij dhe që nuk e gjykon të drejtë, duhet t'i jepet zgjidhje nga organizata. Është e qartë se kur një ankesë nuk shqyrtohet me kujdes, punëtorit nuk i vjen mirë, prandaj ankesat duhet të ndiqen dhe t'u jepet përgjigje. Kjo ka rëndësi të madhe. Përpjekjet e organizatës së bashkimeve profesionale për ta mbrojtur punëtorin nga veprimi arbitrar i ndonjë drejtori krijojnë te punëtori mendimin se organizata e bashkimeve profesionale është e tij, se Partia e ka krijuar atë jo vetëm ta edukojë, po edhe t'i japë kurajë që,

kur i bëhet një e padrejtë, të shkojë të ankohet në organizatën e vet, ose të kërkojë sqarime nëse ka të drejtë për ankesën që bën apo jo.

Kontaktet e organizatës me punëtorët duhet të jenë të afërta jo vetëm si forum, por edhe si individë. Duhet të punohet që punëtori, për të kërkuar një të drejtë ose për një sqarim, të drejtohet edhe te një anëtar i këshillit të bashkimeve profesionale të rrethit, të cilit t'i flasë për padrejtësinë që mund t'i ketë bërë ndonjë nga drejtuesit e ndërmarrjes.

Shokët në Shkodër tani po punojnë që punëtori të mos ketë nevojë të shkojë të ankohet deri në këshillin e rrethit, po ta zgjidhë çështjen në organizatën e bashkimeve profesionale të ndërmarrjes ku ai punon, e cila ka forca që të vërë në vend çdo padrejtësi dhe, kur punëtori nuk ka të drejtë, ta sqarojë e ta bindë për këtë, ose kur organizata e bashkimeve profesionale nuk mund t'ia zgjidhë ankesën, se nuk është në kompetencat e saj, ta mësojë atë ku duhet të drejtohet.

Në rrethin e Shkodrës në përgjithësi drejtuesit e ndërmarrjeve kanë konsideratë të mirë për organizatën e bashkimeve profesionale, bile disa mbështeten shumë në të. Por te disa drejtorë shfaqen qëndrime negative. Ka nga ata që në mbledhjet e organizatës së bashkimeve profesionale nuk e konsiderojnë veten të barabartë me të tjerët, prandaj ose u bëjnë bisht mbledhjeve, ose kur ngrihen të diskutojnë nisen nga pozita si drejtor dhe jo si një anëtar i thjeshtë i organizatës. Ka të tjerë që nuk vijnë në mbledhjet e organizuara me punëtorët e një turni që ka mbaruar punën, kur kjo bë-

het brënda orarit zyrtar, duke gjetur ndonjë justifikim. Më treguan se në një ceremoni, që u organizua me rastin e dekorimit të punëtorëve të dalluar, drejtori nuk kishte shkuar dhe ata me të drejtë e kishin kritikuar më vonë në mbledhjen e kolektivit. Unë i porositë shokët që ndaj veprimeve të tilla mospërfillëse të mbahen qëndrime të rrepta. Ka edhe raste që disa drejtorë diskutojnë sikur janë udhëheqës të organizatës së bashkimeve profesionale, sikur japin vijën, bërtasin se do të marrin masa etj. Edhe qëndrime të tilla nuk duhet të lejohen. Çdo drejtor duhet të dijë se detyrat dhe të drejtat që ka, Partia atij ia ka dhënë t'i zbatojë drejt, prandaj kur vjen në mbledhjen e organizatës së bashkimeve profesionale të mos e ndiejë veten mbi të tjerët, po njëlloj si të gjithë pjesëtarët e mbledhjes. Këtë ta kenë të qartë të gjithë. Punëtori e respekton dhe e do shumë drejtorin e vet kur ai vepron drejt në zbatimin e ligjeve të Partisë dhe të shtetit. Pikërisht këtë të drejtë ka edhe organizata e bashkimeve profesionale, ku ai është anëtar i saj, kështu që ai duhet të vejë në mbledhjen e kësaj organizate i zhveshur nga paragjykimet jomarksiste. Prandaj duhet punuar vazhdimisht për një kuptim politik të rolit të organizatës së bashkimeve profesionale nga punëtorët dhe nga drejtorët e ndërmarrjeve.

Edukimi në mënyrë të veçantë i kryetarëve të komiteteve profesionale të qendrave të punës dhe i anëtarëve të tjerë të organizatave të bashkimeve profesionale është gjithashtu një problem me rëndësi të madhe. Organizata e Partisë në rrethin e Shkodrës ka një plan temash për problemet themelore politike dhe ideolo-

gjike. Edhe këshilli i bashkimeve profesionale ka parashikuar tema për disa çështje të veçanta të organizatës për edukimin e anëtarëve të zgjedhur në udhëheqje, vetëm se këto plane ata nuk i zbatojnë mirë.

Organizata e Partisë duhet të ndihmojë dhe të vërë disa detyra në këtë drejtim. Ajo mund të mëndojë edhe për ngritjen e disa kurseve me një program jo shumë të rëndë, për t'u mësuar aktivistëve të zgjedhur çështjet më të domosdoshme që ata të ndihmohen në kryerjen e detyrave të tyre.

Për të realizuar detyrat shumë të rëndësishme që u vihen bashkimeve profesionale, në krye të tyre duhet të kemi kuadro të zotë. Kur i pyeta shokët e Komitetit të Partisë të Rrethit, ata kishin mendimin se ka vend për t'u parë çështja e shpërblimit jo vetëm të funksionarëve të kësaj organizate, por të të gjitha organizatave të masave, sepse po të krahasohen këto me ato të punonjësve të organeve të Partisë dhe të pushtetit në rreth, janë më të ulëta në mënyrë të ndjeshme. Ky trajtim vështirëson sigurimin dhe zgjedhjen e kuadrove të përshtatshëm në krye të organizatave të masave.

Më tërhoqi vëmendjen fakti se në Shkodër nuk ka asnjë grua profesioniste në drejtim apo në aparatet e organizatës së bashkimeve profesionale. Edhe në komitetet profesionale të bazës zgjidhen pak gra. Gratë punëtore në shumë raste, sikurse më thanë me gojë e tyre shoqet që pyeta, kur u propozojnë për t'i zgjedhur në udhëheqje të organizatës, ato vetë nuk pranojnë, se janë me fëmijë, kanë punë si në prodhim ashtu edhe në shtëpi, ku duhet të kujdesen për rrit-

jen dhe për ushqimin e fëmijëve, për larjen e rrobave, për përgatitjen e gjellës, për të blerë ushqime etj.

Në NBSH-në «Perlat Rexhepi» përpara kishte vetëm një grua në komitetin profesional, sepse në këtë drejtim punohej shumë dobët. Këtë të metë kanë filluar ta ndreqin dhe tani atje kanë zgjedhur 18 gra në udhëheqje të organizatës. Kryetari i bashkimeve profesionale të rrethit tha se në drejtim të zgjedhjes së grave në këtë organizatë ka edhe mungesë besimi nga ana e vetë grave, por këtu pengon edhe konservatorizmi i burrave.

Një aktiviste e bashkimeve profesionale të NBSH-së «Perlat Rexhepi» na tha se në ndërmarrje 50 për qind e punëtorëve janë gra dhe se ato janë punëtore shumë të mira. Jeta në familjet e tyre është përmirësuar shumë. Gratë marrin pjesë në të gjitha proceset e punës njëjloj si burrat, në prashitje, në spërkatje, në harrje, në seleksionimin e prodhimit, në punimet me raketë dhe me shatë etj. Shumë prej tyre janë bërë specialiste të vreshtarisë. Por gratë punëtore atje kanë edhe disa preokupacione, në radhë të parë për rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Shumë i preokupojnë ato pastaj punët e shtëpisë, sepse kanë pak ndihmë nga burrat. Gratë e ndërmarrjes bujqësore dëshirojnë edhe të dëfrejnë, por nuk kanë kohë të lirë, prandaj nuk marrin pjesë në aktivitete të kësaj natyre. Në këtë drejtim ato i pengojnë gjithashtu edhe zakonet prapanike.

Këtë problem e kam trajtuar në mënyrë të veçantë në mbledhjet e kaluara. Tani mbetet që Partia ta ndjekë vazhdimisht, ta ketë kurdoherë në qendër të



vëmendjes zbatimin e detyrave që kanë të bëjnë me zgjidhjen e problemit të madh të gruas.

Një çështje tjetër me rëndësi është që të përcaktohet më drejt se cilat anë të edukimit të punonjësve duhet të marrë përsipër t'i kryejë Partia dhe cilat organizata e bashkimeve profesionale. Dihet se komunistët janë të gjithë anëtarë të organizatës së bashkimeve profesionale, ata marrin direktiva nga Partia që të punojnë në këto organizata. Kryetari i organizatës së bashkimeve profesionale ka të drejtë të ngarkojë çdo komunist për të përgatitur një temë ose një leksion dhe këtë ta punojë me punëtorët pa parti. Po ka edhe punë edukative që duhet t'i marrë përsipër e t'i kryejë vetë organizata e Partisë, natyrisht punë të një niveli më të rëndësishëm, sidomos të atilla që kanë të bëjnë me disa probleme ideologjike. Këtu nuk e kam fjalën vetëm për edukimin e disa njerëzve, por për tërë masën. Për një temë me rëndësi ideologjike komiteti i Partisë mund të ngarkojë në mënyrë të veçantë një kuadër të përgatitur mirë që t'u flasë punëtorëve. Por edhe organizata e bashkimeve profesionale mund të ngarkojë cilindo komunist, deri edhe sekretarin e komitetit të Partisë që merret me çështjet e edukimit, të përgatitë një temë për ta punuar ai vetë në një qendër pune ku është dukur një shfaqje negative që duhet luftuar, se edhe ky është anëtar i organizatës së bashkimeve profesionale. Natyrisht, këto çështje nuk duhet të konfondohen. Partia vërtet i vë një rëndësi të jashtëzakonshme organizatës së bashkimeve profesionale dhe kjo duhet të merret vazhdimisht me edukimin e punëtorëve, por kur t'u thuhet

këtyre se një shok i ngarkuar nga komiteti i Partisë do të vijë t'ju flasë në mbledhje të organizatës së bashkimeve profesionale për disa probleme ideologjike, një gjë e tillë do të pritej shumë mirë nga punëtorët.

Lidhur me këtë kërkova edhe mendimin e shokëve të Shkodrës se cilat çështje mund të trajtojnë bashkimet profesionale dhe cilat Partia. Ata ishin të mendimit se problemet e punës politike masive është mirë t'i ngarkohen organizatës së bashkimeve profesionale. Kurse problemet që kanë një karakter më të thellë ideoteorik, siç janë ato për luftën kundër revizionizmit modern, për luftën e klasave etj., pra çështje themelore teorike dhe ideologjike, për përgatitjen e të cilave duhet të merren kuadro shumë të përgatitur nga ana ideologjike, t'i bëjë Partia. Me këtë mendim isha dakord, prandaj mendoj që ta shohim këtë çështje, problemet kardinale teorike t'i marrë përsipër dhe t'i trajtojë Partia.

Sigurisht kjo nuk duhet kuptuar që Partia të heqë dorë nga roli i saj udhëheqës në drejtimin e gjithë punës ideopolitike dhe kulturore që zhvillojnë organizatat e bashkimeve profesionale ose të vihet një mur në mes punës ideopolitike që bën Partia dhe asaj që bëjnë bashkimet profesionale.

Nga konsultimet me shokët e bazës dhe sipas mendimit tim, del se komisionet e pajtimit nuk janë të nevojshme të ekzistojnë, për arsye se problemet me të cilat merren këto komisione mund t'i zgjidhin shumë mirë vetë organizatat e bashkimeve profesionale në të dyja drejtimet, si në ato pozitive, ashtu edhe në

ato negativet. Kur konstatohet se punëtorëve u halet e drejta nga ndërmarrja, organizata e bashkimeve profesionale mundet dhe duhet të ndërhyjë, dhe kur ndërmarrja nuk e merr parasysh këtë ndërhyrje, të kërkohet ndihma bile edhe e komitetit të Partisë. Kur komiteti profesional i ndërmarrjes, nga ana tjetër, gjykon se punëtori nuk ka të drejtë, gjithashtu përsëri ai duhet të merret vetë, duke bërë punë edukative bindëse me punëtorin që nuk vepron drejt dhe, në rast se komiteti profesional nuk e sqaron dot, atëherë çështja t'i shtrohet kolektivit, forca e të cilit, natyrisht, është shumë më e madhe se e cilitdo komision pajtimi. Për këtë çështje, kryetari i këshillit të bashkimeve profesionale të rrethit tha se ka pasur edhe diskutime. Shokët e Ministrisë së Drejtësisë thonë se, kur punëtorin nuk e bind as kolektivi për një ankesë të tij, çështja t'i kalojë gjyqit. Ndërsa ka edhe një mendim tjetër që këto çështje të mos i referohen gjykatës, por të zgjidhen në rrugë shtetërore, duke i dhënë të drejtë punëtorit të ankohet në cilëndo instancë shtetërore që të dëshirojë, duke filluar nga seksioni përkatës i komitetit ekzekutiv dhe deri në Qeveri e në Kuvendin Popullor.

Punëtorët e kanë të qartë politikën e shtetit tonë. Niveli i tyre tashmë është ngritur prandaj, kur ata bien në kundërshtim me ndërmarrjen, e kuptojnë se kjo nuk është për faj të shtetit, po të administratës. Megjithatë, kjo çështje prapë duhet t'u bëhet vazhdimisht e qartë, sidomos punëtorëve të rinj, se ka të bëjë me kuptimin e rolit të bashkimeve profesionale. Atyre duhet t'u bëhet e qartë vazhdimisht se janë bu-

rokratizmi, subjektivizmi i një drejtuesi etj., që mund të shkaktojnë shtrembërimin e vijës së Partisë.

Sigurimet shoqërore ne ua hoqëm organizatave të bashkimeve profesionale, por interesimi i tyre për këtë problem me rëndësi të madhe politike nuk duhet të mungojë. Një frymëzim, një orientim, njëfarë kontrolli për sigurimet shoqërore përsëri duhet të ekzistojë nga ana e organizatës së bashkimeve profesionale, natyrisht jo si përpara, po prapë është i nevojshëm, mbasi nga ana e organeve të financës, të cilave u janë ngarkuar, mund të bëhen veprime jo të drejta, prandaj ndaj tyre duhet ndërhyrë që të ndreqen. Nuk duhet menduar se organizata e bashkimeve profesionale tani duhet t'i lajë duart nga kujdesi për zbatimin e drejtë të ligjit të sigurimeve shoqërore në favor të punonjësve. Kjo çështje ka rëndësi nga ana morale dhe politike, prandaj të mos harrohet. Nga ana e dokumentacionit organizatat e bashkimeve profesionale tani janë lehtësuar, këtë punë po e bëjnë organet financiare, kurse çështja politiko-morale e sigurimeve shoqërore duhet të mbahet vazhdimisht e gjallë. Ky do të jetë edhe njëfarë kontrolli mbi Ministrinë e Financave.

Rëndësi ka gjithashtu koordinimi i veprimtarisë së organizatës së bashkimeve profesionale me organizatën e gruas dhe me atë të rinisë, forcimi i lidhjeve dhe i bashkëpunimit midis tyre, qoftë me udhëheqësit e këtyre organizatave në shkallë rrethi, qoftë në bazë. Këtu nuk e kam çështjen në koordinimin e punëve që u bën organizatave të masave komiteti i Partisë i rrethit, me orientimet që u jep atyre periodikisht

sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit, i cili jep vetëm orientimin e përgjithshëm dhe nuk u hyn çështjeve në hollësi. Sekretarët e tjerë të komitetit të Partisë, duke u konsultuar me njëri-tjetrin, duhet t'i zbërthejnë ato orientime dhe t'i ndihmojnë organizatat që të bashkërendojnë punët. Një gjë e tillë duhet të praktikohet edhe poshtë në ndërmarrje. Shokët e Shkodrës thanë se janë munduar ta bëjnë këtë punë, po mbetet ta organizojnë edhe më mirë, prandaj përgjegjësit e organizatave të masave të rrethit duhet të konsultohen reciprokisht që të mos bien në paralelizëm. Kur u diskutua për dërgimin e një numri punëtorësh nga qyteti në fshat, zgjidhja e këtij problemi u koordinua mirë nga të tria organizatat kryesore të masave dhe u arrit të dërgoheshin nga qyteti në fshat 300 e ca punëtorë.

Koordinimi i veprimtarisë së organizatave të masave duhet të praktikohet edhe në bazë. Për shembull, kur merren përsipër për t'u kryer disa aksione ose për të zbatuar disa vendime, komiteti profesional nuk duhet të mendojë vetëm për organizatën e vet, por të ketë parasysh se në ndërmarrje ka edhe një këshill gruaje, edhe një organizatë rinie, me të cilat duhet të konsultohet dhe të mendojnë çfarë duhet të bëjë njëra organizatë e çfarë duhet të bëjë tjetra.

Për pyetjen që u drejtova shokëve nëse praktikojnë një metodë të përcaktuar për përgjithësimin e vazhdueshëm të eksperiencës në rreth nëpërmjet ndërmarrjeve e institucioneve të ndryshme nga fabrika në ndërmarrje bujqësore e në shkolla etj. dhe nëse kanë menduar që ndonjë metodë të perfeksionohet më tej,

më thanë se këtë problem nuk e kanë parë në tërë gjerësinë e tij. Shembujt dhe eksperiencën pozitive ata i përhapin në forma fare të lehta. Eksperienca pozitive e klasës punëtore, sidomos fryma e saj revolucionare i duhet bërë e njohur edhe fshatarësisë, edhe inteligjencies. Për këtë qëllim duhen menduar e duhen gjetur format më të përshtatshme. Në rast se një eksperiencë popullarizohet vetëm duke varur, në fabrikën ku ajo ka dalë, fotografinë e punëtorit, mësuesi i shkollës apo nëpunësi i komitetit ekzekutiv nuk e shohin këtë fotografi, po edhe sikur ta shohin, kjo nuk u thotë gjë, se nuk dinë ku konsiston metoda dhe eksperienca e punës së këtij punëtori, që të nxjerrin konkluzione edhe ata për punën e tyre. Eksperienca pozitive apo iniciativa e mirë e një punëtori të përparuar të SMT-së, për shembull, e cila përhapet kudo ku ka traktorë (në ndërmarrje bujqësore, në kooperativa, në ndërmarrjet e ndërtimit etj.), ka në brendi disa qëndrime vendosmërie politike që, duke i popullarizuar, u shërbejnë të gjithëve si nxitje dhe edukim për të rritur mobilizimin në punë. Kjo vendosmëri duhet dhe mund të frymëzojë edhe punëtorët e administratës për kalitjen e vullnetit dhe rritjen e pjekurisë së tyre, kështu që ajo ka rëndësi të përhapet kudo, që të gjithë të frymëzohen për të punuar si traktoristi shembullor. Prandaj duhet punuar që kjo eksperiencë të dalë jashtë kuadrit të sektorit dhe të përvetësohet jo vetëm nga punëtorët e bujqësisë, po edhe nga ata të industrisë, edhe nga punonjësit e administratës etj.

Duhet punuar që të përhapet edhe eksperienca e arsimitarëve më të mirë. Një mësues, për shembull,

duke vrarë mendjen arrin të gjejë një metodë të mirë për dhënien e mësimit dhe të bëjë që nxënësit e tij të dalin të shkëlqyer. Metodën e mirë të këtij mësuesi organizata e bashkimeve profesionale duhet t'ua bëjë të njohur të gjithë propagandistëve të bashkimeve profesionale, duke u shpjeguar se si ky arsimtar arriti të krijojë këtë metodë dhe t'u futë fëmijëve në kokë aq mirë përmbajtjen e programit mësues. Ne kemi nevojë për përhapjen e kësaj eksperience të mirë në radhë të parë te të gjithë arsimtarët. Propagandistët e bashkimeve profesionale duhet ta kenë për detyrë të nxjerrin disa konkluzione nga kjo eksperiencë dhe ta përhapin këtë, me ndihmën e së cilës çdo mësues të nxitet të reflektojë për të përmirësuar punën e tij në drejtimet që ajo ka boshllëqe. Popullarizimi i kësaj eksperience i mëson edhe punonjësit e sektorëve të tjerë të mendojnë si ta përmirësojnë edhe ata punën e tyre, pra, ushtron një influencë të madhe edukative.

Iu dhashë mendimin shokëve të Shkodrës se për këtë çështje të rëndësishme e vlen që ata të përgatitin edhe një material në formë gazete. Një organ i tillë mund të dalë në dy-tri nga qytetet tona më të mëdha, për shembull, në Shkodër, në Korçë e në ndonjë qytet tjetër, ku ka një aktiv më të gjerë dhe më të përgatitur njerëzish me kulturë, të cilët mund të bëjnë diçka në drejtim të përhapjes së eksperiencës së përparuar.

Në Komitetin e Partisë të Rrethit të Shkodrës deri tani lidhjet me këshillin e bashkimeve profesionale i mbante sekretari i komitetit të Partisë që merrej

me ekonominë, ndërsa me organizatën e gruas mbante lidhje sekretari që merrej me çështjen e fshatit dhe të bujqësisë. Tani lidhjet kryesore për problemet e shumanshme politike, ideologjike, edukative, pra, për probleme të veçanta të edukimit, organizatat e masave i mbajnë me sekretarin e propagandës dhe për problemet ekonomike me sekretarin që drejton këto probleme, kurse lidhjet e përgjithshme kryesore përgjegjësit kryesorë të organizatave të masave i mbajnë me sekretarin e parë. Këtë problem mendoj që ne ta shikojmë. Organizata e bashkimeve profesionale duhet të mbajë lidhje edhe me sekretarët e tjerë të komitetit të Partisë të rrethit, por detyra e bashkimeve profesionale është edukimi i gjithanshëm, ngritja në radhë të parë e nivelit politik dhe ideologjik të punëtorëve. Ato janë një mbështetje e madhe e Partisë në këtë drejtim, prandaj mendoj të kenë lidhje më shumë me sekretarin e agjitacionit dhe të propagandës.

Nga eksperiencia e punës së tyre, shokët e rrethit më thanë se bashkimet profesionale duhet të mbajnë lidhje të ngushta dhe të sigurojnë vazhdimisht ndihmën e Partisë, por udhëheqësit e tyre nuk duhet vetëm të presin t'i thërresin në raport nga komiteti i Partisë, por edhe vetë ata duhet të kërkojnë ndihmën e komitetit të Partisë kur kanë përpara një problem, për të cilin është e nevojshme kjo ndihmë. Veç kësaj të kërkojnë e të propozojnë gjithashtu çfarë duhet të bëjnë komiteti dhe organizatat-bazë të Partisë për gjallërimin e organizatave të bashkimeve profesionale në qendrat e punës.

Së fundi, pyeta nëse kishin ndonjë vërejtje për



ndihmën që u jepet nga Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale, si i ndihmon ky për problemet e organizatës, si dhe të më thoshin vërejtjet që mund të kishin për ndihmën që u jepet nga Komiteti Qendror i Partisë.

Shokët e rrethit thanë se kohët e fundit kishte qenë një ekip i Këshillit Qendror për studimin e problemit «si duhet punuar nga organizata që punëtorët ta ndiejnë veten zot të ndërmarrjes», por duke pasur parasysh karakteristikat, peshën dhe kuadrin udhëheqës të organizatës së bashkimeve profesionale të rrethit, ku janë dy shokë të rinj, ndihma e Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale duhet të ishte më efektive.

Shoku i bashkimeve profesionale të rrethit ngriti çështjen nëse duhet t'i orientojnë ose jo organizatat-bazë që të mos zgjidhen në udhëheqje disa njerëz, kur konstatojnë, për shembull, se në një qendër pune zgjedhin kryetar ose anëtar të komitetit profesional një njeri jo të përshtatshëm, qenia e të cilit në forum e ul autoritetin e organizatës. M'u desh t'ua sqaroja këtë çështje. Kur një punë e tillë bëhet për të mirën e organizatës, kur është çështja për mbrojtjen e vijës së Partisë, organet më të larta dhe të deleguarit duhet t'i sqarojnë në vend çështjet që dalin dhe kjo nuk duhet të konsiderohet si ndërhyrje në kuptimin e keq të fjalës. Ne, nuk duhet të lejojmë që të kalojnë vite të tëra derisa të tjerët ta kuptojnë një çështje. Zgjidhja e një problemi që del përpara nuk i duhet lënë spontaneitetit. Në një rast të tillë medoemos duhet ndërhyrë dhe kjo nuk do të thotë të diktosh. Kur bë-

hen zgjedhjet e organizatës së bashkimeve profesionale medoemos duhet të jepen orientime, për shembull, që në komitetet profesionale të zgjidhen edhe gra në udhëheqje etj. Kur vërehet se orientimi nuk vihet në jetë, atëherë duhet ndalur në këtë çështje dhe kjo nuk është ndërhyrje, por përpjekje për të zbatuar drejt vijën e Partisë. Kjo duhet të bëhet, se është detyrë me rëndësi dhe do të bëhet kur shokët e bazës nuk janë në gjendje ta zbatojnë, ose kur shihet se në bazë shkelen porositë e Partisë.

Kur ndonjë anëtar i kolektivit propozon një njeri jo të përshtatshëm në udhëheqje të organizatës së bashkimeve profesionale, sekretari i organizatës-bazë të Partisë ose ai që është i deleguar ka të drejtë të sqarojë pjesëmarrësit se ky njeri nuk është i përshtatshëm për të udhëhequr organizatën dhe jep arsyet. Kjo nuk duhet të konsiderohet ndërhyrje. Njerëzit duhet të bëhen të qartë që organizata-bazë e ka vetë në dorë kë do të zgjedhë në udhëheqje të saj, por edhe i deleguari ka të drejtë të japë mendimin dhe të parashtojë të dhënat që ka për atë që propozohet dhe që nuk është i përshtatshëm, kurse një shoqe që nuk propozohet, ai mund ta rekomandojë si njeri politikisht të pastër, që punon mirë, prandaj ia lë organizatës ta gjykojë dhe, në qoftë se ka mundësi, të vihet kandidatura e saj. Në qoftë se mbledhja ka ndonjë mendim të kundërt, i deleguari lejon të flitet dhe sqaron se nuk është e domosdoshme që pse e propozova unë këtë shoqe, ju duhet ta zgjidhni medoemos. Zgjedhjen do ta bëni vetë, prandaj gjykojeni, e vini ose nuk e vini në listë, këtë e keni të drejtë ta vendosni ju.

Shkurtimisht, këto ishin problemet për të cilat u interesova dhe bisedova me shokët e bashkimeve profesionale të rrethit të Shkodrës.

## II Mbi eksperiencën e punës të organizatës së rinisë

Në Shkodër, si kudo në vendin tonë, ne kemi një rini patriote, revolucionare, të gjallë, të ngritur politikisht e ideologjikisht dhe të lidhur ngushtë me punën. Ajo punon mirë kudo, në fabrika, në bujqësi, në shkolla. Unë u interesova dhe zhvillova një bisedë edhe me shokët e organizatës së rinisë për të marrë eksperiencën e saj, me qëllim që të nxjerrim disa konkluzione për përmirësimin e mëtejshëm të punës së kësaj organizate.

Për t'i dhënë Sekretariatit të Komitetit Qendror një pasqyrë të eksperiencës së organizatës së rinisë të rrethit të Shkodrës dhe për të nxjerrë disa konkluzione të drejta për punën që duhet bërë në të ardhmen, si në rastin e takimit me shokët e bashkimeve profesionale, kisha përgatitur për t'u drejtuar shokëve të rinisë pyetjet e mëposhtme:

1. — A i keni bërë ju ndonjë studim serioz punës së organizatës së rinisë në lidhje me parimet e saj organizative dhe orientimin e përgjithshëm që duhet të ndjekë ajo?

2. — A ka të meta në format organizative, në format dhe në metodën e punës të organizatës lidhur me zhvillimin e shumanshëm të rinisë dhe të vendit?

3. — Puna që bëni me rininë, a mendoni se është mjaft e diferencuar për kategori të ndryshme të rinjsh e të rejash nga pikëpamja e moshës, e seksit, e vendit të punës dhe e krahinës, me zakonet e me shkallën e ngritjes së saj politike, ekonomike e shoqërore?

4. — Si e drejtoni ju organizatën e pionierit? A e gjykoni ju të mjaftueshëm këtë drejtim të saj?

5. — Sipas mendimit tuaj, kush mund ta drejtojë më mirë këtë organizatë, ju apo shkolla? Në se qëndron specifika e drejtimit tuaj nga drejtimi faktik i shkollës?

6. — Si e kuptoni dhe si e zbatoni ju, shokë të organizatës së rinisë, specifikën e drejtimit dhe të edukimit të rinisë shkollore?

7. — Si qëndrojnë marrëdhëniet tuaja me shkollën në zbatimin e kësaj specifike të drejtimit dhe të edukimit? Si e zhvillon ju punën për edukimin e rinisë shkollore dhe si e koordinoni këtë punë me shkollën?

8. — A keni mosmarrëveshje parimore apo praktike me trupin mësimor ose me rregulloret e shkollave dhe pse?

9. — A ka konflikte shoqërore dhe, në qoftë se ka, të çfarë natyre e të çfarë shkalle janë dhe si shfaqen ato në mes rinisë së rritur, në mes meshkujve dhe femrave, në mes nxënësve dhe punëtorëve, në mes punëtorëve të rinj dhe fshatarëve të rinj? Si i zgjidhni ju këto nga ana teorike e politike?

10. — Kuadrot profesionistë të rinisë quhen profesionistë sepse dinë vetëm rregullat e mbledhjeve, kryesojnë mbledhjet, zgjidhin gjërat praktike, organi-

zojnë shëtitjet dhe mbrëmjet, apo pse janë të ngritur ideologjikisht, janë në gjendje të bëjnë përgjithësime dhe në forma të përshtatshme të drejtojnë edukimin e rinisë?

Ç'duhet të bëjmë, çfarë masash duhet të marrim që të kemi kuadro të tillë profesionistë dhe joprofesionistë?

11. — Ç'ndihmë konkrete ju jep Partia dhe shkolla në këtë drejtim dhe çfarë përpjekjesh bëni ju vetë si organizatë e rinisë? Çfarë ndihme ju jep juve Komiteti Qendror i Rinisë?

12. — Ç'vështirësi hasni ju në punën tuaj dhe të çfarë natyre janë? Ç'përpjekje bëni dhe si i kapërcëni ato? Ç'ndihmë të mëtejshme kërkoni?

13. — Si qëndron rinia në Shkodër në marrëdhëniet me fetë, me zakonet e vjetra, të këqija dhe idealiste shoqërore, në lidhje me prindërit, në lidhje me dashurinë?

14. — Si i përballon rinia shkollore e rritur nevojat e domosdoshme financiare jashtë nevojave për mjete mësimore? A tregohet ekonomë dhe a ka mosmarrëveshje në këtë drejtim me prindërit? Në rini-në tuaj ka tendenca luks (relativ) apo atë e karakterizon thjeshtësia?

15. — A zhvillon leksione politiko-teorike dhe ekonomike me rini-në për të gjitha këto probleme shoqërore?

16. — Ç'mendon rinia punëtore për punën, për profesionin, për mjeshtrit që e mësojnë dhe ç'qëndrim mban ajo ndaj tyre? Ç'mendon për trajtimin ekonomik të saj dhe si e përdor ajo pagën që merr?

Po rinia fshatarç si qëndron përpara të njëjtave çështje?

17. — Ç'mendojnë të rinjtë në shkolla për mësuesit, për lëndët dhe për të ardhmen e tyre? Në ç'drejtim synojnë ata më shumë për të mësuar dhe për të punuar në jetë?

18. — A preokupohet për të gjitha këto probleme organizata e rinisë, a nxjerr konkluzione dhe a jep orientime?

19. — Kështu siç i ka Partia lidhjet me rininë, janë të mjaftueshme këto, janë të gjalla, revolucionare, apo duhet të gjallërohen më shumë? Ç'duhet bërë, sipas mendimit tuaj, në drejtim të forcimit të punës së Partisë që nga komiteti i Partisë për komitetin e rinisë dhe nga organizatat-bazë të Partisë për organizatat-bazë të rinisë?

20. — Ç'mendon rinia për zhvillimin e arteve, të muzikës, të skulpturës, për fizkulturën etj.? Ç'mendon ajo për filmat që shfaqim në ekran? Ç'mendon ajo për shfaqjet teatrale, për shfaqjet e estradave? A është e kënaqur me to dhe në se përmbliiden vërejtjet e saj?

21. — A kanalizohen nga ju këto vërejtje, a bëhen vërejtje e konkluzione edukative nga ju për praktikat e ndryshme të kulturës popullore socialiste, qoftë për rininë spektatore, receptive, qoftë ndaj shkrimtarëve, artistëve, teatrove etj.?

22. — A u vihet rëndësi e veçantë prirjeve letraro-artistike të rinisë në shkollë e në punë dhe a inkurajohen në mënyrë serioze talentet e ndryshme, apo këto prirje konsiderohen si të rastit, të përkohshme ose, si të thuash, «nuk të japin bukë»?

23. — Çfarë lloj literature i pëlqen rinisë dhe si e shfrytëzon ajo atë, qoftë në shtëpi, në bibliotekën publike ose në shkollë?

Si interesohet organizata e rinisë për orientimet e diferencuara të leximeve dhe si është metoda e leximit dhe e përfitimit?

24. — Si është organizuar sporti për rininë? Çfarë lloj sporti pëlqehet dhe si orientohet ajo në zhvillimin e sporteve të ndryshme? Si bëhet nga ju politika dhe morali i sportit?

25. — Si i orientoni ju dhe organizatat e rinisë të rinjtë në diskutimet e lira në shoqëri në mes moshatarëve, në mes atyre dhe më të rriturve, në mes femrave dhe meshkujve? Apo e lini këtë problem në spontaneitet? (Kjo ka rëndësi për kalitjen e pjekurisë së saj kur hidhet në punë dhe në jetë, për të mos e harxhuar kohën me kotësira. Si për çdo gjë, ajo duhet të fitojë prirjen bazale të shëndoshë edhe në këtë drejtim.)

Gjatë këmbimit të mendimeve për problemet që u shtrova, konstatova se udhëheqësit e organizatës së rinisë të Shkodrës, me sa mundin, preokupohen për edukimin e brezit tonë të ri. Sidomos pas Letrës së Hapur të Komitetit Qendror, ata kanë nxjerrë detyra dhe po përqendrojnë tërë vëmendjen e përpjekjet në drejtim të punës politike dhe ideologjike, duke synuar që rinia çdo problem ta shikojë, në radhë të parë, ashtu siç mëson Partia, me syrin politik. Për këtë qëllim ishin duke bërë përpjekje për gjetjen e formave të reja për një punë më të mirë, duke iu larguar pu-

nës formale dhe kënaqjes shpesh me rezultatet e një veprimtarie sa për dukje e të përgjithshme.

Le të nxjerrim tani disa konkluzione për të përmirësuar më tej punën e rinisë, pas takimit aq të vlefshëm për mua, me udhëheqësit e rinisë së mrekullueshme shkodrane.

Orientimi drejt i rinisë në jetë duhet të jetë një nga preokupacionet tona më të mëdha e të vazhdueshme, mbasi ka të bëjë me fatet e atdheut, të socializmit. Në qoftë se kuptohet dhe mendohet që ky problem zgjidhet vetëm nëpërmjet organizatës së rinisë, një kuptim i tillë është shumë i ngushtë. Në rast se shkohet me mendimin se kemi kohë të kujdesemi për rininë, derisa kjo të ketë bërë stazhin në organizatën e saj, edhe ky mendim është foshnjor.

Kujdesi serioz i Partisë për rininë duhet të jetë i përhershëm. Nuk mund të mjaftohemi me mendimin që «mbasi organizata e rinisë drejtohet nga Partia», çdo gjë lidhur me të është zgjidhur dhe ecën vetë, sepse fakt është që organizatat e Partisë dhe udhëheqjet e tyre punën e rinisë në shumë raste e shikojnë përciptazi, në mënyrë sentimentale, organizatën e saj e ndihmojnë dobët, kurse hallet dhe problemet materiale, ideopolitike, edukative të rinisë nuk i shikojnë si duhet.

Të marrim problemin e përgatitjes së rinisë për jetën. Ky nuk është i vogël dhe mund të themi se është një problem që duhet të na bëjë të reflektojmë thellë në të gjitha aspektet e tij.

Rinia te ne rritet në socializëm, prandaj ajo duhet të frymëzohet në çdo gjë nga materializmi dialekt-



tik dhe historik. Ky jo vetëm duhet ta orientojë rininë tonë në të gjitha shfaqjet e jetës së saj, por e udhëhequr nga Partia, me ideologjinë marksiste-leniniste, ajo të bëhet thyesi i sigurt i ideologjisë borgjeze idealiste, i pikëpamjeve metafizike, me një fjalë i të gjitha mbeturinave mikroborgjeze, idealiste të trashëguara nga të vjetrit dhe të reflektuara në të rinjtë. Këto mbeturina janë të gjalla në shkallë të ndryshme në shtresat e klasat e ndryshme që formojnë shoqërinë tonë. Duke shkuar nga parimi që ne po ndërtojmë shoqërinë pa klasa, kuptohet se sa më mirë ta edukojmë në këtë rrugë rininë, që është e ardhmja e kësaj shoqërie pa klasa, aq më shpejt do të arrihet ky qëllim i madh. Kjo do të bëhet nëpërmjet vetë luftës së klasave, sepse rinia jonë nuk rron e mbyllur në vetvete, në kullë të fildishtë, larg dhe jashtë kësaj lufte të madhe që udhëheq Partia për ndërtimin e shoqërisë pa klasa, për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit, për formimin e njeriut të ri komunist.

Terreni i rinisë është shumë i ndjeshëm, shumë delikat, i influencueshëm për të mirë ose për të keq. Do të ishte naive dhe e dëmshme po të mendohej se, edhe te ne, rinia nuk ndeshet dhe nuk influencohet nga botëkuptimet idealiste që janë në luftë të ashpër dhe të përditshme me pikëpamjet materialiste të botëkuptimit tonë marksist-leninist.

Të dalim me konkluzionin se rininë e kemi fituar ne krejtësisht dhe s'ka asnjë rrezik për të, ky do të ishte një konkluzion i padrejtë, i papjekur, i rrezikshëm. Pavarësisht se politikisht dhe ekonomikisht lufta është fituar, ajo nuk ka përfunduar derisa nuk është

fituar plotësisht edhe në fushën e ideologjisë, prandaj lufta vazhdon dhe efektet e saj reflektohen edhe në rini, duke lënë mbresat e saj në këtë terren kaq të ndjeshëm dhe të influencueshëm.

Në goftë, pra, se edukimin e rinisë sonë do ta li-  
dhim, do ta koordinojmë dhe do ta ndërtojmë në për-  
shtatje me konditat materiale të jetës, me eksperien-  
cën e punës socialiste të gjallë në terrenin konkret  
politiko-ekonomik të fituar, të konsoliduar dhe që po  
e konsolidojmë çdo ditë, në sajë të ideologjisë sonë ma-  
terialiste, atëherë ne do ta fitojmë tërësisht dhe më  
shpejt rininë, atëherë ne do ta kemi influencuar drejt  
dhe në mënyrë të qëndrueshme atë dhe kjo influencë  
shpëtimtare do të thyejë të gjitha barrikatadat dhe fe-  
rrat, me të cilat rinia do të ndeshet rrugës.

Në rast se ne nuk do ta hedhim rininë tërësisht  
në luftën praktike revolucionare, gjatë së cilës ajo do  
të fitojë shprehi dhe mendime të reja revolucionare  
për punën, për jetën, atëherë ne do ta ngadalësojmë  
procesin e madh për kalitjen ideologjike dhe politike  
të rinisë. Ky duhet të konsiderohet plusi ose minusi  
për socializmin.

Edukimi i rinisë në shkollë, me libra, me leksione,  
ose me referate nuk mund të konsiderohet si një edu-  
kim në vetvete. Një gjë e tillë nuk mund të konside-  
rohet as i tëri as i ploti dhe «i përsosuri», ashtu si-  
kundër nuk mund të konsiderohet «e tërë dhe e për-  
sosur» edukata familjare, me anët e saj pozitive dhe  
negative, sepse pikërisht nga edukata familjare, që  
bën të përplasen mbi të riun shumë paragjykime, bo-  
tëkuptime, zakone dhe mbeturina, krijohen zakone dhe

vese të këqija, për spastrimin e të cilave shkolla, leksionet dhe konferencat bëjnë një punë të madhe. Por, natyrisht, kjo nuk është e tëra, nuk është e plotë në qoftë se shkolla, leksionet dhe konferencat nuk janë të lidhura me realitetin, nuk i lidhin të rinjtë me luftën dhe me praktikën revolucionare, me jetën që vlon, që krijon.

Duhet të formojmë të rinj luftëtarë, me botëkuptim marksist-leninist që të punojnë, të krijojnë dhe të luftojnë për të renë, kundër prapambetjes, të edukojmë të atillë të rinj dhe të reja, që të mos i tremben as punës as luftës as jetës, të atillë të rinj dhe të reja që të mendojnë me kokën e tyre dhe të mendojnë drejt, të kuptojnë që të dallojnë të mirën nga e keqja, të kenë masën e gjykimit materialist marksist-leninist për çdo gjë.

Puna me rininë ka specifikën e saj, të cilën ne duhet ta ruajmë dhe ta zhvillojmë, por në të gjitha format e saj, në të gjitha prirjet, dëshirat dhe detyrat e rinisë, duhet të kemi të qartë qëllimin kryesor të kësaj pune dhe çdo etapë që kalon rinia të jetë si një bllok i çimentuar në formimin e ndërgjegjes së saj revolucionare.

Ne asgjë nuk duhet të kursejmë, as mundin as lodhjen as mjetet materiale as ato mendore, për të ndihmuar në edukimin e brezit të ri me jetën, me punën, me mendimin marksist-leninist të Partisë. Çdo gjë për rininë të përpiqemi ta bëjmë të menduar mirë, të koordinuar me kujdes dhe sado shumë të kemi bërë për të, përsëri dhe kurdoherë të themi që s'kemi bërë sa duhet. Kush punon për rininë, punon për at-

dheun, për socializmin, për Partinë, për të ardhmen.

U drejtova shokëve të Shkodrës pyetjen nëse i kanë bërë ndonjë studim serioz vijës së organizatës së rinisë në lidhje me parimet e saj organizative dhe me orientimin e përgjithshëm që duhet të ndjekë ajo në bazë të direktivave të Partisë. Është e qartë për të gjithë se kohët tani kanë ndryshuar, rinia nuk është më ajo e para sepse ka 22 vjet që edukohet në socializëm, prandaj është më e zgjuar, më e ngritur në çdo drejtim, më e kulturuar. Të rinjtë e të rejat tani interesohen dhe i kuptojnë më mirë çështjet politike. Por mbasi konstatova se e kishin ca vështirë të më jepnin përgjigje, u thashë se mund të më përgjigjen një herë tjetër për këtë çështje, qoftë edhe me ndonjë letër, pasi ta kishin menduar dhe ta kishin thelluar më mirë problemin.

Pyetjet që u drejtova shokëve atje i bëra me qëllim që të thellohem si ne, ashtu edhe organizata e rinisë mbi një sërë problemesh (të cilat sigurisht nuk përmblihdhen të gjitha në pyetjet që kam shënuar në krye të këtij materiali) dhe të përpiqemi të ndërtojmë një punë më konkrete, lidhur me gjendjen në zhvillim, të përcaktohen, pra, më drejt disa probleme dhe të gjenden forma pune më të përshtatshme për organizatën e rinisë.

Të marrim, për shembull, disa aspekte të këtyre problemeve:

1. — Mendoj se organizata e rinisë nuk duhet të qëndrojë në atë punë të diferencuar që bën në vija të trasha me kategori të ndryshme të rinjsh dhe të rejash. Në rini problemet janë të diferencuara, ndry-

she për rininë fshatare, ndryshe për atë punëtorë dhe të qyteteve, ndryshe për të rejtat e qytetit e ndryshe për ato të fshatit. Prandaj, duke u udhëhequr nga orientimet e përgjithshme, duhet ta mësojmë bazën të mendojë dhe të krijojë forma pune të përshtatshme, mundësisht për çdo fshat ose grup fshatrash që kanë karakteristika të njëllota.

Një ndihmë të madhe në këtë drejtim mund të japin mësuesit. Mësuesi është njeri i mendimit dhe i penës, por nuk njoh shumë mësues që të shkruajnë jo vetëm për pionierët, por edhe për të gjitha problemet e rinisë në përgjithësi. Mësuesi i pasionuar për profesionin e tij është medoemos i afruar me nxënësit, i do shumë dhe ata e duan e nuk fshehin asgjë prej tij, ai njih kështu mirë botën e tyre të brendshme, dëshirat, mendimet dhe nevojat e tyre, prandaj është në gjendje të shkruajë shumë gjëra të bukura për ta dhe në mënyrë të diferencuar. Mësuesit shpesh ngarkojnë nxënësit në klasë të bëjnë hartime, po asnjë nuk i vë detyrë vetes që të bëjë edhe ai një hartim, që do të jetë shumë herë më i mirë nga ai i nxënësve. Hartimet e mira, të shkruara nga mësuesit për rininë me tema të ndryshme, mund të shtypen në broshura, me qëllim që rinia t'i ketë si një ushqim të këndshëm edukativ. Këtë problem mendoj t'ua ngremë medoemos arsimtarëve.

2. — Edukimi fizik dhe ushtarak i rinisë, që është njëkohësisht edukim patriotik i saj, ka marrë një zhvillim të mirë. Por nuk duhet të kënaqemi me këtë. Fakt është se rinia e do shumë këtë gjë, tregohet shumë entuziaste, veçanërisht për përgatitjen paraushta-

rake. Është e domosdoshme të zgjerohet puna, komanda e ushtrisë dhe organizata e rinisë ta marrin mirë në dorë këtë, të hartojnë bashkërisht plane të reja, të gjera, ushtria të mos kursejë asgjë për rininë, për përgatitjen e saj paraushtarake, t'i japë asaj disa materiale, të organizojë shëtitje, marshime, konferenca politike e patriotike të lidhura mirë me historinë dhe me mbrojtjen.

Komandat, gjithashtu, të mos mjaftohen vetëm me të rinjtë, por të ndihmojnë sa më mirë me materiale të thjeshta ushtarake qendrat edukative të pionierëve, të ndihmojnë për të krijuar sheshe, lodra etj. për fëmijët.

Pra, edhe në këtë drejtim është vendi që organizata e rinisë t'i bëjë një rishikim serioz punës së saj dhe kjo çështje të mos i lihet spontaneitetit. Unë e di se kjo dhe problemet e tjera si kjo s'janë lënë pas dore prej saj, por edhe më mirë mund dhe duhet të kryhen.

3. — Edukimi estetik i rinisë është një problem i madh dhe shumë serioz. Ky bën pjesë dhe është i pandarë me atë të të gjithë popullit. Në shumë drejtime për rininë, për edukimin dhe për orientimin special të saj, ne duhet të krijojmë gjëra të veçanta. Në këtë drejtim nuk punohet ose punohet shumë dobët, megjithëse lexuesit më të shumtë të romaneve, degjuesit dhe spektatorët e muzikës, të teatrove, të estradave, të operave etj. janë të rinjtë. Edhe shumica e punonjësve të krijimtarisë letrare e artistike dhe të skenës gjithashtu janë të rinj.

Rinia nuk duhet të lexojë vetëm çfarë i jepet,

por edhe të kërkojë çfarë i duhet dhe nëpërmjet një kritike të shumanshme dhe me shumë forma të hedhë poshtë ato që nuk vlejnë. Ne duhet të arrijmë që opinionin e rinisë të dëgjohet nga njerëzit e artit dhe të kulturës më shumë se deri tani. Dhe që kjo të bëhet mirë, lipset një rishikim i këtyre çështjeve.

Asgjë nuk duhet të vejë në kundërshtim me edukimin marksist-leninist të rinisë, me frymën e saj revolucionare, asgjë nuk duhet të lejojë që të neutralizojë edukimin patriotik materialist që po bëjmë me rininë. Në këto drejtime është e domosdoshme të spastrojmë kinematë tona nga filmat borgjezë dhe revizionistë dhe nga muzika dekadente. Kjo është urgjente, pse ne mund ta edukojmë mirë të riun dhe të vjetrin në mëngjes, po pasdreke ose në mbrëmje ata i edukon filmi borgjez, muzika dekadente ose romani borgjez.

Në këto drejtime ne duhet të pastrojmë me fshehtë të madhe, por edhe të përpiqemi t'i zëvendësojmë këto që do të pastrojmë, me gjërat tona të bukura, revolucionare. Ky është një rishikim i domosdoshëm që vihet për detyrë ta bëjnë Partia, Qeveria, organizata e rinisë etj., të cilat të marrin masa të shpejta dhe të studiuara drejt sa nuk është vonë.

4. — Edukimi i rinisë me sjellje të mira është gjithashtu një problem me rëndësi, i vazhdueshëm për të gjithë, prandaj herë pas here duhet rishikuar dhe, sipas rasteve e situatave, duhet të merren masa edukimi të përgjithshme dhe të veçanta.

S'ka dyshim se rinia jonë është e thjeshtë dhe revolucionare. Në këtë drejtim është shumë e nevojshme të mendojmë dhe të veprojmë, që këtë thjeshtë

tësi ta bëjmë shprehi në jetë, modesti revolucionare. Kjo nuk mund të arrihet vetëm me leksione morale, por me aksione konkrete.

S'ka dyshim se rinia jonë nuk ka shumë ekzgjencja, por diçka asaj i duhet për libra, për shkollë, për kinema, për një akullore, për një piknik. Këto mjete të pakta modeste duhet të sigurohen nga dikush, nga prindërit ose nga puna e tyre, prandaj të luftohen rrugët e këqija për t'i siguruar këto mjete nga ana e të rinjve me mënyra të dënueshme nga ligjet dhe nga shoqëria.

Edhe në këto drejtime kapitale kemi shumë për të bërë drejtpërdrejt me rininë, por edhe me prindërit e tyre, të cilët as nuk duhet t'i përkëdhelin jashtë masës bijtë e tyre por as edhe nuk duhet që ata të mos mendojnë fare për nevojat minimale të tyre. Masat e drejta influencojnë shumë në edukimin e kulturuar revolucionar të të rinjve dhe të të rejave.

5. — Marrëdhëniet në shoqëri dhe sidomos në mes të rinjve dhe të rejave janë probleme shumë të rëndësishme që po t'i injorosh dhe t'i lësh të zhvillohen jo në kuptimin e drejtë revolucionar, do të na sjellin perturbacione të rrezikshme.

Rininë tonë e karakterizon ndershmëria në marrëdhëniet e saj. Kjo duhet të ruhet dhe të forcohet çdo ditë. Vetëm po të edukohet rinia me moralin proletar, atëherë sigurohen të gjitha virtytet e mira për njeriun komunist.

Në të rinjtë dhe të rejtat duhet të rrënjoset ndjenja e pastër e shoqërisë revolucionare në mes tyre. Këtë, të rinjtë dhe të rejtat e duan dhe e zhvillojnë,



por shumë herë opinionin e ngarkuar me mbeturina mikroborgjeze për jetën, për kontaktet, për fejesat, për martesat, i ngatërron të rinjtë dhe të rejtat në këtë rrugë të pastër, të natyrshme, të drejtë dhe të rekomandueshme, që i çon ata në njohjen mirë të njëri-tjetrit, në lidhjen e një dashurie të vërtetë, në fejesë dhe në martesë, në krijimin e një familjeje të shëndoshë. Në këtë rrugë të drejtë ku ecën dhe duhet të ecën, s'ka asnjë degjenerim, s'ka asnjë gjë të jashtëzakonshme.

Por ka edhe nga ata që nuk e kuptojnë drejt këtë dhe që dalin nga kjo rrugë. Duhet, pra, të luftojmë shkaqet subjektive dhe objektive që i shtyjnë të rinjtë dhe të rejtat të dalin nga rruga e drejtë e moralit proletar, duhet t'i edukojmë drejt të rinjtë dhe të rejtat, si edhe opinionin, që t'i shikojnë si duhet këto probleme. Thashethemet janë shumë të dëmshme. Të mbash nëpër gojë, të denigrosh, të shpifësh, këto janë vese mikroborgjeze, vese të njerëzve që s'kanë punë tjetër. Këta njerëz, kur kanë me të vërtetë arsye për ta këshilluar një të ri ose të re, që të parandalojnë një qëndrim të padenjë, është më mirë të mendojnë për marrjen e masave të drejta, të shpejta, efikase, kur duhet dhe ku duhet.

Duhet t'i mbrojmë të rinjtë nga çdo rrezik, veçanërisht të rejtat nga qëndrimet jo-të drejta të llafazanëve dhe të llafazaneve, që, po e panë një të re me një të ri, i ngjitin një mijë e një epitete të paqena. Këta elementë duhet t'i luftojmë pa mëshirë.

Opinionin jo i mirë ushtron një influencë të fuqishme në qëndrimet e të rinjve, megjithëse të gjithë, edhe

vetë vajzat, e kanë të qartë që të drejtat i kanë një-lloj në çdo fushë si edhe djemtë. Ne akoma nuk kemi arritur t'i luftojmë e t'i likuideojmë plotësisht thasethemet. Prandaj, sa më shumë ta përpunojnë këtë opinion me një punë të dendur politike Partia dhe organizata e rinisë, aq më mirë do të arrijmë të luftojmë thasethemet dhe, si rrjedhim, vajzat do të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet, do të pakësohet kështu gradualisht diferencimi që ekziston midis tyre dhe djemve. Natyrisht, rinia jonë nuk duhet t'i nënshtrohet një opinioni të pagdhendur. Në zbatimin e vijës ne do të bëjmë disa zigzage, por pa hequr dorë nga qëllimi kryesor, nga forcimi i gjithanshëm politik dhe ideologjik i rinisë sonë, që kjo të jetë në gjendje t'u vërë shqelmin mbeturinave dhe opinionit të pagdhendur dhe t'u imponojë këtyre qëndrimet e saj të drejta.

Çdo prind e kupton rolin e organizatës së rinisë, e di se puna dhe edukata që jep ajo, sipas mësimeve të Partisë, ndihmon për ta forcuar karakterin e vajzës, e di se kjo, po të vejë në një klub ose në ekskursion me kolektivin, është në gjendje ta ruajë veten. Në përgjithësi, rinia jonë është e formuar mirë nga kjo anë. Megjithatë ndonjëherë ngjasin edhe raste të papëlqyera. Po ne nuk duhet të lejojmë që rinia të tërhiqet nga aktivitetet, të pranojmë kufizimin e veprimtarisë së vajzave për arsye se ndonjëri mban një sjellje jo të pëlqyer. Ne duhet të punojmë pa u lodhur që rinia t'i kuptojë mirë direktivat e Partisë, të kemi kujdes të bëjmë një punë të diferencuar me shtresat e ndryshme të rinisë, derisa të arrijmë të ngremë nivelin e saj në atë shkallë të lartë edukative, arsimore dhe

kulturore që çdo anëtar i organizatës të kuptojë esencën e vijës dhe të direktivave të Partisë. Natyrisht për këtë mund të përdoren forma të shumta pune, konferenca, libra, artikuj etj., të cilat duhet të mbahen kurdoherë mirë parasysh nga organizata e rinisë në radhë të parë.

Si këto probleme që preka shkurtimisht ka edhe shumë të tjera që organizata e rinisë, e ndihmuar edhe nga Partia në radhë të parë, duhet t'i rishikojë, t'u bëjë retushe dhe korrigjime, në qoftë se ka vend për të bërë, të forcojë punën atje ku ka mungesa dhe dobësi etj. Unë do të jem i gëzuar në qoftë se ndihmoj, sadopak, me këto mendime për të cilat më ndihmuan shumë shokët e rinisë në Shkodër.

6. — Puna është faktori vendimtar për edukimin socialist të rinisë. Jashtë këtij koncepti nuk mund të ketë edukim të vërtetë të rinisë dhe jo vetëm si koncept filozofik, por edukimi praktik me punën do të lindë dhe do të forcojë në rini konceptin filozofik materialist për këtë çështje, që përbën qëllimin e madh të jetës, që transformon jetën dhe njeriun. Të flasësh ditë dhe natë për punën dhe të mos punosh praktikisht, do të thotë të bësh një vërë në ujë, të mos ia arrish qëllimit. Prandaj, qoftë organizata e rinisë, qoftë shkolla, qoftë fabrika dhe kooperativa mësimin, edukimin, duhet t'i bazojnë mbi punën konkrete, t'i lidhin me praktikën. Filozofi për filozofi nuk na duhet. Filozofia dhe politika duhet të lidhen me praktikën revolucionare dhe anasjelltas.

Puna praktike në shkolla, më duket, duhet rishikuar seriozisht, jo vetëm që të fuqizohet si program

shkollor, të ndihmohet me mjete pune më të shumta e të shumanshme, të organizohet më fort, pse është koordinuar shumë dobët dhe formalisht me qendra pune, por mendoj të ndryshohet pikërisht mendimi se puna praktike që po bëhet me rininë shkollore ka karakterin e një lënde të posaçme shkollore, se ajo duhet të bëhet brenda mureve të shkollës ashtu sikurse lënda e historisë ose e gjeografisë. Po të hetojmë te nxënësit do të na dalë se ata u vënë rëndësi, preokupohen më shumë për lëndët humanitare ose për shkencat ekzakte, sesa për punën praktike dhe atë fizike. Këto i quajnë si kalim kohe ose të dorës së tretë, që s'të japin shumë bukë, që s'të lënë në provime. Pikërisht këto pikëpamje duhet t'i luftojmë dhe ta vëmë punën praktike në vendin e merituar në jetën e nxënësit, sepse po s'e vumë këtë si duhet, do të lindin dhe do të zhvillohen në rininë shkollore dhe pastaj në jetë, jashtë shkollës, pikëpamjet e intelektualizmit të sëmurë me të gjitha rrjedhimet e tij të këqija.

Mosvënien në platforma të drejta të punës praktike dhe të teorisë qysh në shkollë, ne e shohim në shfaqjet e rinisë shkollore jashtë shkollës. Nxënësi, kur del nga shkolla, ose e ka mendjen në lodra (dhe me këtë nuk dua të them që ai nuk duhet të luajë), ose të mësojë lëndët (detyrë kjo që duhet ta bëjë), ose të shëtitë rrugëve apo të vejë në kinema (dhe prapë edhe këto nuk dua të them që të mos i bëjë), por rininë e qyteteve veçanërisht, nuk e sheh thujse fare të merret me një punë praktike në shtëpi e gjetkë. Ky fenomen ngjet për arsyet që thashë më lart, arsye që duhet të

na preokupojnë dhe që Partia dhe organizata e rinisë të marrin masa t'i studiojnë me shumë kujdes.

Këtë fenomen ne nuk e gjejmë në rininë punëtore dhe në atë fshatare. Në fshat, rinia ndjek shkollën, por është e lidhur konkretisht me punën praktike në bujqësi, pavarësisht nga mungesa e një organizimi më të mirë. Rinia punëtore në ndërmarrje dhe në fabrika nuk mbetet pas, përkundrazi, ajo është e lidhur ngushtë dhe fort me punën.

Është shumë pozitive që rinia punëtore në Shkodër e do punën, profesionin, bën përpjekje për ngritjen e saj profesionale. Në çdo ndërmarrje ka kurse kualifikimi të profileve të nevojshme, pjesëmarrësit e të cilëve në shumicën dërrmuese janë të reja dhe të rinj, të cilët, duke qenë shumë të zellshëm në mësim dhe në punë, përfitojnë kategori të larta brenda një kohe më të shkurtër se punëtorët e moshave të kaluara. Në rininë punëtore ka iniciativa për t'u lavdëruar në drejtim të përmirësimit të cilësisë së prodhimeve, për t'u specializuar në profesion, për mësimin e dy-tri profesioneve etj.

Por puna e organizatës së rinisë për edukimin e rinisë shkollore me ndjenjën e dashurisë për punë, duket se është akoma e pamjaftueshme. Lidhur me këtë problem janë bërë disa përpjekje për të lidhur rininë shkollore me punën, me punëtorët. Një sërë shkollash të qytetit kanë marrëdhënie me nga një brigadë të punës socialiste në ndërmarrjet ekonomike. Pjesëtarët e brigadës u flasin nxënësve në takimet si punojnë punëtorët për të vënë në jetë zotimet që marrin dhe në fund nxënësit japin për nder të tyre ndo-

një shfaqje të vogël. Puna e nxënësve në prodhim, me gjithë të metat që ekzistojnë, i ka afruar këta me punëtorët. Nxënësit, me përjashtime të vogla, kur shkojnë për të bërë praktikën në ndërmarrjen e caktuar, i shtrohen mirë punës dhe ka raste që është vësh-tirë të dallosh cilët janë shkollarët dhe cilët janë punëtorët. Ata herë pas here bëjnë edhe punë vullnetare në ndërmarrjet ku zhvillojnë praktikën mësimore. Nuk ka dyshim se ç'ndikim pozitiv ushtron puna praktike që bën rinia shkollore në prodhim. Ajo e edukon atë në radhë të parë t'i shohë me sy të mirë nje-rëzit e punës dhe të ushqejë respekt për ta. Por, jo kudo i vënë nxënësit të punojnë drejtpërsëdrejti në prodhim, për arsye se, në disa raste, numri i tyre është më i madh nga mundësitë e ndërmarrjes.

Shkollat që i dërgojnë nxënësit për të bërë praktikë në fabrikat moderne, kur në këto nuk ka mundësi të futen të gjithë në punë, duhet të mendojnë së bashku me mjeshtrit për të gjetur mënyrën si të rrënjosin në ndërgjegjen e rinisë shkollore dashurinë për makineritë, t'i bëjnë këta të kuptojnë rëndësinë që kanë për ne veglat, detajet, makinat, fabrikat dhe t'u jepen dijenitë e nevojshme për to. E vlen që ndërmarrja të ngarkojë njerëz që t'u flasin nxënësve mbi teorinë e makinave, si punon secila, t'u bëjnë të qartë përbërjen, mekanizmin, rëndësinë e lidhjet me makinat e tjera të së njëjtës fabrikë, t'u flasin për rolin e klasës punëtore në ndërtimin e socializmit etj. Një punë e tillë ka vlerë të madhe edukative dhe mësimore. Shpjegimi i rëndësisë së makinës u ngjall nxënësve interesin dhe dashurinë për makinën dhe për ata që punojnë

në to. Njohuritë mbi funksionimin e tyre shtojnë dituritë e nxënësve. Kur këta të shikojnë funksionimin e makinës dhe punëtorin ose punëtoren që e drejton dhe prodhon me të, do të admirojnë shkathtësinë e tyre dhe do të krijohet tek ata pikëpamja se nuk janë vetëm shkollarët që dinë, se dituri zotëron edhe punëtori për gjëra që nuk i dinë nxënësit. Edhe kjo ka shumë rëndësi për edukimin e rinisë shkollore. Mbase nxënësit t'i kenë mësuar mirë të gjitha këto që thashë, atëherë mund të lejohen edhe të punojnë e të prodhojnë diçka. Kjo do të ishte një kënaqësi e madhe për ta.

Nxënësit që, për shkak të ambientit dhe të rrethanave ku janë rritur, shfaqin tendenca të intelektualizmit, për t'i edukuar dhe spastruar nga këto, është mirë të dërgohen në procese pune nga më të vështirat, atje ku punohet me krahë, ku ka vajra, në kovaçanë, në fonderi etj., me qëllim që të gjithë të rrënjosen e fortë dashuria dhe respekti për punën dhe për njerëzit e punës.

Partia dhe organizata e rinisë duhet të bëjnë një punë të menduar me nxënësit e shkollave të mesme të arsimit të përgjithshëm, ku duket tendenca që pas maturës t'i shmangen futjes në punë, në prodhim, duke synuar të ndjekin të gjithë shkollat e larta, bile edhe në këto, në degë më të lehta.

Veprimtaria kolektive e të rinjve të shkollës për një muaj rresht në punët bujqësore, pas fundit të vitit mësimor, pritet me gëzim nga të rinjtë e qytetit dhe këta tregohen shumë entuziastë. Këtë praktikë kaq të mirë, jo vetëm ta vazhdojmë, por ta zhvillojmë

dhe ta organizojmë akoma më mirë se deri tash. Të zhdukët çdo formalizëm nga organizata e rinisë dhe të shqelmohet çdo pengesë në rast se sillet nga ana e kooperativave bujqësore ose e ndërmarrjeve bujqësore shtetërore.

Kuptimi i drejtë i punës, si një armë edukimi nga më të rëndësishmet për rininë, na shtyn dhe do të na ndihmojë të gjejmë forma dhe metoda të reja që rininë punëtore dhe fshatare ta bëjmë epiqendrën dhe shembullin e madh për rininë e shkollave të qyteteve, së cilës duhet t'i futim në gjak dashurinë për punën, për punëtorin, për kooperativistin, për fabrikën, për bujqësinë. Vetëm nëpërmjet kontakteve dhe punës praktike të përbashkët ne do të rrënjosim te rinia jonë atë luftë që po zhvillojmë për zhdukjen e dallimit në mes punës fizike e punës mendore dhe në mes fshatit e qytetit.

7. — Rinia dhe shkolla. Një rol të madh i ka ngarkuar Partia organizatës së rinisë për edukimin e shëndoshë politik, ideologjik, moral e fizik edhe të rinisë shkollore. Këtë detyrë me shumë përgjegjësi ajo e ka kryer dhe po e kryen me nder. Por Partia dhe pushteti njëkohësisht i kanë ngarkuar edhe shkollës sonë të re edukimin e gjithanshëm komunist të nxënësve e të studentëve në vendin tonë. Të dyja së bashku, institucionet arsimore dhe organizatat e rinisë, luftojnë dhe punojnë për të përmbushur porositë e Partisë për edukimin e shkollarëve. Lidhur me këtë qëllim të përbashkët, i pyeta shokët e organizatës së rinisë në Shkodër, si e kanë kuptuar ata artikullin kritik që u botua para dy muajsh në «Zërin e rinisë», mbi marrëdhëniet e ri-



nisë shkollore me shkollën, nëse këto i konsiderojnë të drejta dhe a duhet të ekzistojë bashkëpunimi midis organizatës së rinisë dhe shkollës. Nga përgjigjja që më dha sekretari i komitetit të rinisë të rrethit dukej se problemin atje e kanë të qartë. Shkollën e konsiderojnë, siç është, një institucion shumë të rëndësishëm shtetëror që përgatit rininë, kuadrot e ardhshëm për ndërtimin e socializmit, por njëkohësisht edhe organizata e rinisë punon gjithashtu për edukimin e brezit të ri. Duke pasur të njëjtin objektiv të dyja palët, nuk ka përse të mos ketë bashkëpunim midis shkollës dhe organizatës së rinisë. Prandaj shokët e rinisë atje kishin vepruar drejt që nuk ishin nxituar ta punonin këtë artikull në organizatë.

Unë u shpjegova se ky moskuptim, për të cilin bëhet fjalë në artikullin e «Zërit të rinisë», ka ndodhur se në rregulloren e Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës për shkollat figuron shprehja se arsimit i besohet «edukimi unik» i rinisë. Shokët e Komitetit Qendror të Rinisë, duke u bazuar në disa ngjarje të jetës praktike, mbasi disa mësues ose drejtorë kishin ndërhyrë më shumë nga sa duhej në vendimet që merrnin organizatat e rinisë në shkolla, duke insistuar që të rinjtë të shkonin kurdoherë në ekskursione, marshime, piknikë etj., të shoqëruar nga mësuesit, këtë e quanin si ndërhyrje në punët e organizatës.

Patriotët tanë dhe mësues të shquar të periudhës pas Shpalljes së Pavarësisë së Atdheut, si Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani etj., që janë përpjekur për përhapjen e arsimit në popull, kanë bërë një luftë të madhe për drejtimin laik të shkollave, kundër klerit që

i drejtonte atëherë dhe edukonte rininë me frymën klerikale idealiste. Kur triumfoi revolucioni popullor dhe u vendos pushteti i ri, një nga fitoret më të rëndësishme ishte fakti që shkollat në Shqipëri u bënë laike, nën drejtimin e shtetit dhe u mbyllën menjëherë të gjitha shkollat fetare. Me këtë u realizuan dëshirat e zjarra dhe të drejta të patriotëve, të popullit dhe të inteligjencies përparimtare shqiptare të periudhës përpara Çlirimit. Kjo masë përparimtare, që gjeti përkrahje të zjarrtë në popull, u realizua vetëm në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë. Prandaj nuk ishte aspak gabim që, pas fitores së revolucionit, të vendosej «drejtimi unik» i shkollave nga ana e shtetit, gjë që nuk vinte aspak në kundërshtim me veprimtarinë e organizatës së rinisë, e cila ka luajtur, luan e do të luajë një rol jashtëzakonisht të madh në edukimin politik dhe ideologjik të rinisë. Shkolla jonë e pajis rininë me shkencën materialiste. Mbi këtë bazë ajo zhvillon të gjitha lëndët, edhe historinë e Shqipërisë, për të cilën tani kemi një manual të mirë, që, pavarësisht nga të metat, bazohet në marksizëm-leninizmin dhe ndryshon si nata me ditën nga disa tekste të shkruara para Çlirimit.

Shkolla jonë, pra, e edukon rininë në mënyrë të gjithanshme. Ajo gjithë punën e saj e zhvillon në bazë të vendimeve të Partisë dhe të Qeverisë, për zbatimin e të cilave është shumë e interesuar dhe lufton organizata e rinisë. Objektivi i përbashkët, pra, lind nevojën e bashkëpunimit sa më të ngushtë midis shkollës dhe kësaj organizate. Iniciativat e rinisë për të dalë me grupe në marshime apo në ekskursione

janë të mira dhe duhen përkrahur, sepse ndihmojnë për ta kalitur dhe për ta edukuar rininë tonë në të gjitha drejtimet. Djemtë dhe vajzat e shkollës, natyrisht, i duan mësuesit e tyre, i respektojnë, por gjatë këtyre aktiviteteve ata duan të jenë ca më të lirë, të këndojnë, të kërcëjnë, të merren me sport, të bëjnë edhe ndonjë shaka, prandaj kur është i pranishëm një mësues, mund të mos e ndiejnë veten plotësisht si midis shokësh. Në qoftë se mësuesi shkon, atëherë duhet ta heqë veten si njeriu i tyre i afërt, të shkrihet me ta, t'u fitojë zemrën që ta ndiejnë veten të lirë e njëkohësisht, pa e kuptuar dhe pa e ndierë nxënësit, të bëjë edhe punë edukative me ta. Në rast se marrëdhëniet do të zhvillohen kështu, s'ka dyshim që këto do të forcohen dhe do të jenë vetë nxënësit që do t'i ftojnë të shkojnë së bashku në aktivitete, ku është e rekomandueshme të marrin pjesë arsimtarët. Në rast se në marrëdhëniet midis tyre mund të ndodhë diçka jo e mirë, duhen bërë përpjekje që çdo gjë të zgjidhet në rrugë të drejtë.

Mësuesit duhet t'i dojë dhe t'i respektojë rinia, ata janë edukatorët e brezit tonë të ri. Dhe kur ndodh që ndonjë nxënës nuk sillet mirë gjatë mësimit dhe mësuesi me të drejtë detyrohet të mbajë qëndrim, udhëheqësi i organizatës së rinisë në klasë apo në shkollë, që është njëkohësisht nxënës, duhet të mbajë qëndrim, të marrë anën e mësuesit dhe ta kritikojë shokun që ka gabuar. Qëndrime të tilla do t'i nxitin mësuesit të jenë të matur dhe të marrin masa të drejta ndaj nxënësve që gabojnë. Por mund të ndodhë edhe e kundërta që një mësues, duke u nxituar, të marrë

një masë jo të drejtë ndaj një nxënësi. Edhe në këtë rast përgjegjësi i rinisë i klasës ose i shkollës, jo publikisht, por mënjanë dhe me takt, t'i thotë mësuesit pikëpamjen e vet e t'i sugjerojë që ta rishikojë masën me gjakftohtësi. Mësuesi i mirë do ta shikojë me respekt sekretarin e rinisë dhe do të bisedojë me të në platformën e marrëdhënieve shoqërore si me përfaqësuesin e rinisë.

Ministria e Arsimit dhe e Kulturës mundet të studiojë çështjen që, në disa mbledhje të këshillit pedagogjik, si dhe në takimet që bëjnë mësuesit me prindërit, të marrë pjesë edhe sekretari i rinisë i shkollës. Ky, pavarësisht se mund të jetë një djalë ose vajzë 17-vjeçare, është përfaqësuesi i gjithë rinisë së shkollës për edukimin dhe përgatitjen e së cilës preokupohen kaq shumë Partia dhe shteti, duke ngarkuar për këtë qëllim një armatë të madhe kuadrosh në shkolla dhe në organizatën e rinisë. Natyrisht, jo kur analizohet veprimtaria e arsimtarëve, por kur trajtohen probleme që u takojnë nxënësve, sjelljes dhe përparimit të tyre në mësim, jam i mendimit që sekretari i rinisë të thërritet në mbledhjet e këshillit pedagogjik. Por sekretari i rinisë në këtë rast, është e domosdoshme, që, kur të vejë atje, të mendojë mirë për përgjegjësinë e madhe që ka, të jetë i matur, të tregojë pjekuri, sepse aty nuk do të vejë më si nxënësi përpara mësuesve të vet, po si përfaqësues i rinisë. Duke shprehur respekt për mësuesin dhe drejtorin, duke u treguar i pjekur dhe korrekt në qëndrimet dhe në dhënien e mendimeve, me pjesëmarrjen e tij në mbledhjen e trupit mësimor, sekretari i ri-

nisë do të ngjallë tek edukatorët e tij ndjenjën e respektit për organizatën e rinisë.

Për kolektivin pedagogjik, pjesëmarrja e përgjegjësit të rinisë në mbledhje jo vetëm do të jetë diçka e mirë, sepse çdo të dhënë për nxënësit e vet do ta marrë drejtpërsëdrejti, do të mësojë më mirë disa karakteristika të nxënësve, të cilat do t'i shërbejnë për të ndërtuar një punë më të mirë pedagogjike me ta, por edhe organizata e rinisë do ta marrë ndihmën gjithashtu drejtpërsëdrejti nga udhëheqja e shkollës. Në mbledhjen e këshillit pedagogjik mund të trajtohet, për shembull, problemi që nxënësit të mos bëjnë muhabet gjatë orës së mësimit, që këta po marrin nota të dobëta në shkencat ekzakte, ose që nuk i kushtojnë rëndësi mësimit të edukatës fizike etj. Sekretari i rinisë i shkollës, duke ndier përgjegjësinë që ka organizata për këto çështje, qysh përpara mbledhjes duhet vetë të reflektojë dhe të nxjerrë konkluzione për masat që duhet të marrë organizata e rinisë për zgjidhjen e problemit. Gjatë mbledhjes së këshillit pedagogjik ai mban shënim vërejtjet e drejta që do të bëjnë mësuesit, e së bashku me ato që ka menduar vetë, i shtron pastaj në organizatë dhe mobilizon rininë që porosinë dhe detyrat e vëna nga këshilli pedagogjik të realizohen dhe gjendja të marrë kthesën që dëshirohet.

Kur sekretari i organizatës së rinisë së shkollës konstaton disa shfaqje jo të mira të nxënësit, mund ta marrë edhe vetë iniciativën, t'i lutet drejtorit për të biseduar me të, ose për t'i shtruar këto çështje në mbledhjet e këshillit pedagogjik, nga i cili të kër-

kojë ndihmën e rastit. Një iniciativë e tillë jam i bindur se do të përkrahet nga drejtori i shkollës.

Në drejtim të përmirësimit të marrëdhënieve midis mësuesve dhe nxënësve të shkollave të mesme, edhe Universiteti Shtetëror duhet të mendojë dhe të punojë më mirë, me qëllim që studentët që përgatiten për të dalë mësues jo vetëm të bëhen të aftë për të dhënë mësimin në nivelin e duhur shkencor, por njëkohësisht të përgatiten edhe si pedagogë të mirë, të dinë të sillen si duhet e të jenë të afruar me nxënësit, pra, t'i mësojnë që të bëjnë përpjekje të njohin sa më shpejt veçoritë, nevojat, anët pozitive dhe të metat e çdo nxënësi dhe mbi këtë bazë të ndërtojnë punën e tyre kur të bëhen mësues. Njohja e psikologjisë së nxënësve dhe trajtimi i kujdesshëm i tyre do t'i bëjë mësuesit të fitojnë dashurinë dhe respektin e nxënësve dhe autoriteti do t'u rritet. E njëjta detyrë, mendoj, duhet të kihet parasysh edhe për shkollat e mesme pedagogjike, ku mësuesi, veçanërisht ai i filllores, të përgatitet edhe si fizikulturist i mirë, të dijë edhe të këndojë, t'i bjerë një vegle muzikore, të dijë të vizatojë, të recitojë bukur etj. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës t'i kushtojë më shumë kujdes këtij problemi, prandaj do të ishte mirë që në programet e shkollave që përgatitin mësues të bëhen korrigjimet përkatëse dhe të mos bëhen lëshime për vënien e tyre në jetë, të punohet, pra, për rritjen e cilësisë së punës në këtë drejtim.

Tendenca për të qëndruar larg nxënësit dhe për të ruajtur njëfarë autoriteti, vjen nga një koncept jo i drejtë i trashëguar nga intelektualët e vjetër bor-

gjezë e mikroborgjezë, që synonin të kishin epërsinë mbi të tjerët, të shfrytëzonin diturinë për interesat e tyre, të qëndronin larg masës. Tani të tilla tendenca, natyrisht, nuk i manifestojnë ata që mbarojnë universitetin, këto pothuajse po zhduken. Por në qoftë se Partia nuk punon mirë me të rinjtë e universitarët, në qoftë se ajo nuk i mban afër arsimtarët e rinj, atëherë këto mund të ngrenë kokën, mësuesi do ta harrojë të kaluarën, do të harrojë se edhe ai dikur ka qenë nxënës dhe ka dashur që edukatorët e tij të ishin më të ngrohtë me të, kurse tani që u bë vetë mësues ka frikë se, po t'i mbajë afër nxënësit, do të humbasë autoritetin, prandaj u qëndron larg. Kjo vë detyrën që, qysh kur përgatiten në universitet dhe pastaj në jetën praktike, organizata e Partisë dhe ajo e rinisë të punojnë vazhdimisht me arsimtarët e rinj që të mos na shpëtojnë nga duart, të mos infektohen me pikëpamjet e intelektualëve të vjetër.

Ne tani jemi duke parë raportin midis shkollave të arsimit të përgjithshëm dhe teknikumeve. Në vendin tonë nuk ka dhe kurrë nuk do të ketë superprodhim njerëzish të mësuar, por është e domosdoshme që nxënësit dhe studentët t'i drejtojmë në ato profile e profesione, për të cilat kemi më shumë nevojë.

Baza e arsimit tonë të përgjithshëm është shkolla 8-vjeçare, e domosdoshme për të gjithë rininë tonë, pa përjashtim. Në këtë shkollë rinia, bashkë me kulturën e përgjithshme, duhet të marrë edhe shprehitë e para të punës që të përgatitet për jetën. Por, ata që mbarojnë shkollën 8-vjeçare, paskëtaj duhet të orientohen të ndjekin më shumë se deri tani tekniku-

met dhe politeknikumet. Politeknizimi është objektivi ku ne synojmë të shkojmë, po natyrisht menjëherë nuk arrijmë dot atje. Ky është një problem delikat dhe jo i lehtë, së pari, sepse nuk kemi kuadro. Deri tani ne kemi synuar të përgatitim më shumë kuadro mësimore të lartë për shkollat e arsimit të përgjithshëm dhe kuadro të lartë për prodhimin dhe mendoj se mirë kemi bërë, sepse kemi pasur nevojë. Për kuadro me arsim të lartë do të kemi nevojë përsëri, po lidhur me perspektivën e zhvillimit të vendit duhet të mendojmë njëkohësisht të përgatitim kuadro pedagogjike edhe për teknikumet. Kjo është një detyrë e madhe.

Sot kemi vetëm disa teknikume dhe politeknikume, po është e qartë se do të na duhen të tjera më shumë. Shkollat 12-vjeçare që kemi dhe do të vazhdojnë të zgjerohen, nuk do të jenë në gjendje të pranojnë gjithë numrin e madh në rritje të nxënësve që do të mbarojnë shkollat 8-vjeçare. Kjo arsye dhe vetë zhvillimi i mëtejshëm ekonomik e kulturor i vendit, na vë detyrën të hapim patjetër teknikume dhe politeknikume të reja. Me zhvillimin e shumanshëm të vendit do të na duhen edhe kuadro të lartë të profileve të ndryshme, prandaj edhe universitetit do t'i duhet të bëjë ndryshime, të mbyllë, për shembull, përkohësisht një fakultet dhe të hapë degë të tjera për të përgatitur specialistë të lartë për sektorët ku do të kemi më shumë nevojë. Mundet më vonë të vendosim edhe sistemin e konkursit për të hyrë në universitet, ku në të ardhmen nuk do të dërgojmë vetëm gjimnazistë, po edhe maturantë të teknikumeve, nga



të cilët tani për tani nuk dërgojmë dot shumë, mbasi prodhimi ka nevoja të mëdha për kuadro të mesëm teknikë. Sidoqoftë kjo është një çështje që duhet studiuar. Mësuesit, pedagogët, punonjësit e Partisë, kanë mendime të ndryshme për këtë problem, prandaj të gjitha t'i shohim e t'i shohitim mirë e me kujdes.

Edukata familjare është një faktor që luan një rol të madh te të rinjtë dhe te të rejat, prandaj Partia dhe organizatat e masave duhet t'i vënë shumë rëndësi kësaj çështjeje. Nuk është se s'flitet për këtë problem, por kujdesi i familjes për fëmijët, për të rriturit, në gjirin e saj konsiderohet si një «çështje e mbyllur private», që i përket familjes ta zgjidhë ashtu si mendon ajo vetë.

Në përgjithësi, ose individualisht, lavdërohen ose kritikohen në shoqëri shfaqjet e jashtme të këtij ose të atij të riu ose të reje dhe zakonisht për pionierët bëjmë fajtorë prindërit, po nuk ndalemi në atë që përbën një pjesë të rëndësishme të burimit të këtyre shfaqjeve negative në të rinjtë, tek edukata që marrin ata në gjirin e familjes së tyre. Jo vetëm nuk ndalemi në këtë gjë, por as nuk merret si duhet mundimi të studiohet familja shkencërisht, në drejtimin shoqëror, të studiohen ligjet e pashkruara që e drejtonin atë, ç'ndryshime dhe sa e ç'duhet të bëjmë më tej që t'i revolucionarizojmë këto lidhje dhe këto ligje në familjen tonë shqiptare.

A ka vend për të bërë revolucionarizim të mëtejshëm në këtë drejtim? Shumë bile.

Themi se te ne është zhdukur familja patriarka-

le dhe me këtë kënaqemi se është bërë një përparim. Zhdukja e familjes patriarkale kuptohet me procesin e ndarjes, të dezintegrimit të familjes dhe, pra, me humbjen e autoritetit të plotfuqishëm të «plakut» ose të më të madhit të shtëpisë. Këndej dilet me konkluzionin që ky autoritet despotik, retrograd, u zhduk.

Po ta marrim, si të thuash, fizikisht, ky proces i familjes, i shtyrë nga përparimet që bën vendi në lëmin ekonomik, politik, ideologjik dhe kulturor, zhvillohet edhe në fshat edhe në qytet, por ky proces dezintegrimit fizik, si të thuash, i familjes, është larg të ketë mbaruar në fshat. Por çfarë nuk ka mbaruar (dhe për këtë do të thosha se jemi akoma në fazën fillestare) është botëkuptimi i vjetër i familjes në ndërgjegjen e njerëzve. Ky botëkuptim (e kam fjalën për anët idealiste, patriarkale, retrograde), nuk zhduket aq lehtë, aq shpejt dhe ca më pak po e lamë ta zhdukë spontaneiteti.

A janë bërë përparime drejt spastrimit të këtyre «mbeturinave» që, në fakt, janë shumë herë më tepër se mbeturina? Sigurisht përparime janë bërë, nga puna e dendur dhe e gjallë e Partisë.

Thuhet se qyteti e influencon fshatin në këtë drejtim, duke çuar të renë. Kjo është e drejtë, por jo kurdoherë, sepse edhe në qytet në disa drejtime, në problemin e familjes është njëlloj si në fshat, në mos më keq. Pikëpamjet moderniste janë të huaja për kuptimin dhe zhvillimin socialist të familjes, janë më të këqija se pikëpamjet konservatore të fshatit.

Por të mendosh se osmoza<sup>1</sup> është e njëanshme, atëherë s'ka osmozë. Të mendosh gjithashtu se pikëpamjet fshatare për familjen nuk depërtojnë dhe nuk influencojnë mbi qytetin, ky do të ishte gabim. As ka pasur, as ka dhe as mund të ketë barrierë që ta ndalojë këtë. Klasat në vendin tonë nuk ndahen me mure dhe po të studiohet kjo shkencërisht (dhe duhet të bëhet kështu), do të na dalë se 40-50 vjet më parë në vendin tonë mbizotëronte jo pikëpamja e qyteteve, por pikëpamja e klasës fshatare, nga e cila, drejtpërdrejt nga zakonet dhe ligjet e popullit tonë krejtësisht fshatare, influencoheshin edhe klasa feudale, edhe inteligjencia e vogël. Prandaj, sipas mendimit tim, studimi i zhvillimit, i përbërjes, i transformimeve shpirtërore të rrjedhura nga transformimet ekonomike, shoqërore të familjes sonë fshatare, duhet të jetë bazë për ne, për të parë më qartë ku kemi qenë, ku jemi, ku do të shkojmë dhe çfarë masa të reja duhet të marrim, për ta zhvilluar më tej dhe drejt këtë proces të rëndësishëm e vendimtar.

Pavarësisht nga këto konsiderata, konkretisht, Partia me vijën e saj, me politikën e saj të drejtë, me transformimet e thella ekonomike dhe kulturore, ka bërë një revolucion të madh edhe në kuptimin e rolit të familjes në drejtimin e edukimit të rinisë. Por çështja është ta kuptojmë dhe ta thellojmë këtë revolucion, që rinia jonë të bëhet kurdoherë më e bukur, më e pastër dhe më e fortë, pse kemi të bëjmë me

---

1 Këtu fjala osmozë ka kuptimin e ndikimit reciprok.

fatet e brezit të ri, që përtëritet kurdoherë dhe që bën të përtëriten edhe vetë populli, edhe Partia.

Koha që jetojmë është një periudhë e rëndësishme dhe delikate në drejtimin e brezit të ri. Ne duhet të bëjmë të pamundurën që t'i sigurojmë atdheut dhe Partisë një brez të ri të shëndoshë nga çdo pikëpamje, i cili të marrë stafetën në duart e tij të sigurt nga brezi ynë i moshës së kaluar që bëri luftën dhe revolucionin. Brezi i ri që do të na zëvendësojë, duhet t'u përgatitë vendit dhe Partisë brezin tjetër të ri të ardhshëm, e kështu me radhë.

Kuptohet, pra, se detyrat e brezit tonë, në drejtimin e edukimit të rinisë, janë më të rënda, më të kocklavitura, sepse jemi brezi i parë që ndeshemi në një luftë të ashpër me mbeturinat e theksuara mikroborgjeze idealiste në ndërgjegjen e njerëzve, mbeturina që do të likuidohen nëpërmjet një lufte klase të vazhdueshme dhe konsekuente në lëmin ekonomik, politik, ideologjik e kulturor. Ky proces zhvillohet të ne me sukses dhe revolucionarisht. E reja lufton me të vjetrën në punë, në prodhim, në mendim.

Në gjirin e familjes sonë luftojnë gjithashtu mendimet e reja materialiste me mendimet e vjetra reaksionare, idealiste, konservatore.

Të rinjtë ndeshen në rrethin familjar me zakonet e vjetra konservatore; të vjetrit, jo plotësisht të qartë, në vend që të bëjnë përpjekje revolucionare për t'i ndihmuar dhe për t'i drejtuar të rinjtë, për t'i kuptuar ata në zhvillimin e tyre në një shoqëri socialiste, me norma të reja, me botëkuptime përparimtare, shu-

më herë e kuptojnë detyrën shoqërore të prindit, të drejtën e tyre si prind, në normat e një morali të vjetër dhe, duke u udhëhequr nga këto norma, nuk e bëjnë si duhet detyrën ndaj të riut ose së resë. Kështu, këta, me dashje ose pa dashje, jo vetëm thyejnë hovin e rinisë, por mendojnë se me qëndrimet konservatore të një kohe të kaluar, mund të edukojnë rininë në periudhën aktuale të ndërtimit të socializmit. Shumë herë këto qëndrime konservatore e neutralizojnë edukimin e rinisë ose punën e shkollës së re dhe të organizatës së rinisë.

Shumë prindër, duke u udhëhequr nga qëllime të mira, në sjelljet me fëmijët nuk përpiqen që këshillat dhe mësimet edukative t'i lidhin me moralin e ri dhe me rrethanat dhe kushtet e jetës së re, por duke gjykuar rreziqet që mund të hasin në rrugë fëmijët e tyre, ata gjejnë një zgjidhje të vjetër, anakronike.

Për shembull, prindi, në vend që t'i flasë të riut për rreziqet që mund t'i vijnë nga ndonjë veprim i pamatur në shoqëri ose në aktivitetet e ndryshme dhe të arsyetojë me të si t'i parandalojë, ai e mbyll brenda, e imponon të mos shkojë ku dëshiron i riu ose e reja, ku ia dikton vetë jeta. Në vend që vajzën ose djalin ta përgatitë me një moral të shëndoshë në jetë, në marrëdhëniet shoqërore, në çështjen e dashurisë, të fejesës, për të mirat dhe rreziqet e tyre, prindi më të shumtën e herës, ose këto çështje s'i hap fare, ose merr masa të palejueshme antipedagogjike, shtrënguese, antishoqërore.

Në këto probleme kaq delikate për të riun dhe të renë prindi nuk sillet si shok, si edukator, por si një i huaj, ose sillet si prindi i vjetër me njëfarë turpi mikroborgjez dhe mendon si «*pater familias*», ndaj të cilit i riu duhet *a priori* të dijë dhe t'u bindet zakoneve tradicionale të familjes.

Dikush duhet ta edukojë të riun dhe të renë në rrugën e luftës për afirmimin e normave socialiste. Në rast se mendojmë se këtë do ta bëjë vetëm shkollla, kjo nuk është e plotë. Në rast se prindi mendon se këtë do ta bëjë organizata e rinisë, edhe kjo gjithashtu nuk është e plotë, pavarësisht se shumë herë prindi e pengon të riun dhe të renë të marrë pjesë në shfaqjet dhe manifestimet e organizatës së rinisë, nga frika se mos ngjasë kjo ose ajo, i del nami për atë ose për këtë etj.

Atëherë, vetë jeta e gjallë në të gjitha shfaqjet e plotëson këtë edukatë. Pra prindi e ka për detyrë t'ia plotësojë këtë edukatë, jo duke e mbyllur të riun në guaskat e një morali të vjetër, por ta armatosë për jetën, për vështirësitë, ta bëjë atë të mendojë vetë, të luftojë në jetë, të ecë përpara, të kuptojë ç'është e mirë, ç'është e keqe etj.

Një qëndrim i tillë i prindërve ndaj të rinjve, i mëson këta të fundit të mos jenë hipokritë, tjetër të thonë e tjetër të bëjnë, por i bën këta të veprojnë ballëhapur ndaj prindërve, t'u thonë atyre mendimin me kohë dhe të gjejnë mirëkuptimin e zgjidhjen e drejtë dhe jo të krijohet një ndrydhje e atillë që vetëm atëherë kur ndodh diçka e papëlqyer e merr vesh

prindi dhe ky pastaj alarmohet e shan dhe e shan. Prindi duhej t'i kishte menduar me kohë, t'u kishte dalë përpara ngjarjeve.

Por kjo është një edukatë e tërë që ne duhet të krijojmë dhe të forcojmë në familje që të mundet, nëpërmjet kësaj edukate të shëndoshë, të edukohen drejt të rinjtë. Dhe që të bëhet kjo si duhet, përveç masave të shumta praktike, politike dhe ideologjike që duhet të marrin Partia dhe organizatat e masave, ne duhet të bëjmë të qartë atë që edukimi i të rinjve nga familja nuk është vetëm një çështje thjesht private, por një detyrë e dorës së parë me karakter shoqëror, e lidhur ngushtë jo vetëm me interesat e familjes, por me interesat e shoqërisë, të socializmit dhe të komunizmit. Po të kuptohet ky parim, besoj se do të gjenen rrugë më të sheshta për t'i shtuar rezultatet në këtë problem të madh të edukimit të brezit të ri me moralin proletar të Partisë.

Në familje ekzistojnë disa rrethana, të cilat bëjnë të mundur që te të rinjtë të lindë e të mbahet gjallë për një kohë ndjenja e pronës private, shumë e rrezikshme për edukimin e tyre. Sigurisht që familja ka në pronësi sendet e nevojshme që u duhen pjesëtarëve të saj për jetën. Këto nevoja nuk përmbushen njëjloj nga çdo familje. Kuptohet, kjo është e drejtë për këtë periudhë dhe rrjedh nga zbatimi i parimit «secili sipas punës», prandaj dikush i plotëson më mirë këto nevoja, dikush më pak, dikush i harxhon të gjitha ç'fiton, dikush bën kursime dhe depoziton të holla. Në të gjitha këto operacione familjare ekziston

krimbi i «pronës private» që vepron në ndërgjegjen e njerëzve, pra edhe te të rinjtë. Kjo ndjenjë, në të gjitha shfaqjet e ndryshme të saj, përpiket të neutralizojë idenë e pronës së përbashkët shoqërore, me të cilën njerëzit rrojnë dhe edukohen në luftën për ndërtimin e socializmit, jashtë mureve të shtëpisë, jashtë familjes.

Ideja e pronës së përbashkët shoqërore është i vetmi mjet i sigurt për të luftuar idenë e pronës private. Kjo ide duhet të rrënjoset te njerëzit dhe te të rinjtë në punën dhe në jetën kolektive, që të hyjë e të bëhet kështu shprehi edhe në familje. Prandaj në gjirin e familjes sonë duhet të rrënjoset fryma e re socialiste; kjo frymë të forcojë dhe të kalitë parimet tona të shëndosha, si dashurinë për njëri-tjetrin, solidaritetin, ndershmërinë, thjeshtësinë, patriotizmin etj., që janë karakteristika dalluese për familjen shqiptare, por nga ana tjetër, kjo frymë është e domosdoshme të spastrojë idenë e pronës private, idenë që çështjet e familjes «janë thjesht private», të spastrojë gjithashtu edhe çdo gjë idealiste në të gjitha shfaqjet dhe mendimet që vërtiten në gjirin e familjes.

Këto ishin problemet për të cilat unë shkëmbeva mendime me shokët e rinisë në Shkodër. Ata bënë sugjerime të vlefshme për çështjen e rinisë punëtore, fshatare e shkollë, mbi të cilat ne duhet të reflektojmë. Po puna me rininë është e një rëndësie të madhe, e gjerë, e shumanshme dhe për ta parë thellë nuk është i mjaftueshëm një bisedim 4-5 orësh. Sidoqoftë,



nga ato që më informuan, krijova përshtypjen se njerëzit që kemi ngarkuar të merren me organizatën e rinisë janë të pasionuar për këtë punë. Çdo njeri duhet të jetë i pasionuar për punën e vet, po ky pasion është shumë pozitiv veçanërisht për ata që punojnë me organizatën e rinisë.

Mendimet që më shfaqën shokët e Shkodrës në përgjithësi ishin të drejta, të pjekura dhe në rrugë partie. Jo vetëm sekretari që është në krye të organizatës së rinisë të rrethit, por edhe gjithë shokët e tjerë që morën pjesë në këtë bisedim më lanë përshtypje të mirë, si kuadro të pjekur. Kur kujtoj rininë e kohës sonë dhe e krahasoj atë me njerëz të tillë si këta, ndryshimi është si nata me ditën. Është një sukses i madh që Partia ka arritur të edukojë një rini, nga gjiri i së cilës po dalin kuadro kaq të zotë. Partia kurdoherë e ka pasur në plan të parë, e ka vlerësuar lart rolin e madh të organizatës së rinisë dhe kjo nga ana e vet është përpjekur, me luftë dhe me punë të palodhur, ta meritojë këtë rol të madh që i ka ngarkuar Partia.

Problemet për të cilat fola në ekspozenë time duhet të na ndihmojnë për të marrë masat e nevojshme që ta përmirësojmë më tej punën me rininë. Në qoftë se Partia do të kujdeset më shumë për ta ndihmuar edhe më afër se deri tani organizatën e rinisë dhe t'ia përmbushë kësaj sa të jetë e mundur më mirë nevojat që ka ajo në fabrika, në shkolla, në kooperativa e kudo, rezultatet tona në punën me rininë do të jenë edhe më të mëdha.

Sekretariati i Komitetit Qendror duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të gjetur disa forma pune dhe mundësi materiale për t'i dhënë rinisë një ndihmë akoma më të madhe, sepse për Partinë, siç e përmenda, organizata e rinisë ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Nganjëherë jo se nuk duam, po na rrëmbejnë shumë probleme që nuk na lënë të mendojmë si duhet dhe të bëjmë sakrifica të nevojshme në drejtim të edukimit të brezit të ri. Prandaj kemi ngelur ca si prapa në plotësimin e disa nevojave të rinisë, për të cilat mendoj se nuk duhet kursyer. Është e drejtë që letrën ta kursejmë, por të mos i japim rinisë libra të përshtatshëm e të nevojshëm për edukimin e saj, ose të mos botojmë disa libra të ilustruar për edukimin dhe argëtimin e pionierëve e të fëmijëve, nuk është mirë. Ç'na kushton ta nxjerrim gazetën e pionierit me një tirazh disi më të madh nga ai i tanishmi për të plotësuar më mirë kërkesat e shumta që na bëhen? Shkurtime të bëjmë, po atje ku nuk prishet shumë punë. Kjo reflekton edhe një gjë tjetër, njerëzit tanë që punojnë nëpër aparate e nënvleftësojnë ca punën me rininë. Një gjë e tillë pasqyrohet edhe gjatë punës së madhe që është bërë pas punimit të Thirrjes së Komitetit Qendror dhe të Qeverisë. Ndërsa për shtimin e prodhimit janë bërë e po bëhen propozime të panumërtat nga punonjësit tanë, dhe kjo, me të drejtë, është një shprehje e lartë e patriotizmit të tyre socialist, e dashurisë së pakufishme për Partinë dhe atdheun, asnjë nga shokët tanë të Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë nuk është preokupuar për të tërhequr interesi-

min e punonjësve në drejtimin që ata të mendojnë e të krijojnë mjete e vegla pune, lodra, libra etj., për argëtimin dhe edukimin komunist të rinisë sonë. Nuk është çështja për t'i bërë qejfin rinisë, por ky është një problem jetik, shokë, për vendin tonë. Sa më mirë ta edukojmë rininë ideologjikisht dhe politikisht, sa më fort ta kalitim atë fizikisht dhe moralisht, në mësim dhe në punë, aq më mirë do të zgjidhim të gjitha problemet që na dalin vazhdimisht përpara dhe vendi ynë do të bëhet i pathyeshëm. Pra, kështu ta kuptojnë problemin, Partia dhe njerëzit që ajo ka vendosur kudo, në punë të ndryshme. Për rininë, që do të marrë në dorë stafetën nga brezi ynë dhe do ta çojë edhe më lart flamurin e socializmit në vendin tonë, ne duhet të jemi gati edhe rripin të shtrëngojmë, po asaj t'i sigurojmë disa mundësi më të mëdha, të nevojshme për edukimin e saj, që të zhvillohet si kurdoherë në rrugën e drejtë të Partisë.

Problemet për të cilat u interesova në Shkodër, disa mendime plotësuese që paraqita dhe konkluzionet që do të nxjerrë Sekretariati për këtë problem, do të na shërbejnë për një përmirësim të mëtejshëm të punës së Partisë me bashkimet profesionale dhe me rininë. Për disa nga problemet që u interesova mbase akoma mund të mos dalim me konkluzione që të veprohet kështu ose ashtu, sepse mund të gjykojmë që mendimet duhet të rrihen e të përpunohen më tej, po këto, së bashku edhe me mendimet që do të shprehin shokët, mund të na vlejné për të na hapur hori-

zonte, që të thellohemi akoma në këto çështje kaq të rëndësishme.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha «Ra-  
porte e fjalime 1965-1966»,  
f. 368-441. Tiranë, 1971*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## DEMOKRACIA NË KOOPERATIVAT BUJQËSORE KA ECUR MBI PARIME TË SHËNDOSHA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

23 maj 1966

Jam dakord ta pranojmë projektvendimin e paraqitur, me vërejtjet që u bënë. Ky do të jetë një ndihmë për forcimin e mëtejshëm të demokracisë në kooperativat bujqësore, po të mos konsiderohet si një gjë e re dhe të krijohet përshtypja sikur tani po na hapen sytë. Këtë çështje ne e kemi ngritur edhe herë të tjera dhe kjo është pasqyruar në vendime të mëparshme që kemi marrë, por megjithatë ka pasur mungesë kontrolli dhe mobilizimi për zbatimin e detyrave që janë shtruar lidhur me forcimin e mëtejshëm të demokracisë kooperativiste. Si pasojë ka zënë vend teknokratizmi etj. Nga kjo ndodh që, kur del një vendim i ri, disa njerëz, që nuk kanë punuar mirë për t'i zbatuar ata të mëparshmit, bile ka edhe që nuk i njohin, tho-

---

1 Në një nga pikat e rendit të ditës u diskutua lidhur me masat që duhen marrë për forcimin e mëtejshëm të demokracisë në kooperativat bujqësore.

në: «Ja, tani na doli një vendim i mirë». Këto, pra, që po themi nuk janë gjëra të reja.

Lidhur me demokracinë në kooperativat bujqësore, ne kemi ecur mbi parime të shëndosha, po në njohtjen, në kuptimin dhe në zbatimin e tyre ka dobësi të mëdha, të cilat kanë ardhur nga mungesa e një pune më të madhe e më të kujdesshme nga ana jonë. Vërejmë se ka kuptime të ngushta për demokracinë në kooperativat bujqësore. Në këtë fazë të zhvillimit të tyre ne nuk mund të kemi administratë për çdo sektor, por mjafton një përgjegjës. Edhe kryetari i kooperativës një është, po ai çdo urdhër e jep në përputhje me vendimet kolegjiale që ka marrë kryesia apo asambleja dhe me detyrat që kanë nxjerrë ato. Në qoftë se ai vepron në kundërshtim me to, secili ka të drejtë dhe detyrë të bëjë vërejtje e të kërkojë llogari. Prandaj po të kemi një ose dy njerëz që të drejtojnë dy-tri fshatra të kooperativës së bashkuar, duke i quajtur këto «sektor», është vallë keq? Edhe përgjegjësit e sektorëve duhet t'u nënshtrohen vendimeve të asamblesë së kooperativës bujqësore, ashtu sikurse kryetari.

Ne kemi dhënë orientimin që të ecet drejt bashkimit të kooperativave bujqësore. Në qoftë se duam ta ushtrojmë mirë demokracinë, edhe kooperativisti më i thjeshtë duhet ta ndjekë në zhvillim, si do të na shkojë ky orientim gjatë zbatimit dhe, të gjithë së bashku, të mendojmë masa të tjera të mëtejshme më efektive. Asnjeriu nuk i lejohet të mbyllë sytë kur ndeshet me gjëra jo të pëlqyera. Për dobësitë që vërehen në drejtim të bashkimit të kooperativave bujqësore nuk e ka fajin orientimi i dhënë për bashkimin e tyre, prandaj

nuk mund të themi tani të kthehemi prapa, duke e konsideruar këtë si një gjë pa vend, po të marrim masa ta forcojmë atë. Shkakun e dobësive ta kërkojmë gjetkë, dhe pikërisht tek ajo se sa janë të aftë njerëzit që kemi vënë t'i drejtojnë këto kooperativa të bashkuara. Këtu të kemi kujdes që tani për tani të mos bashkohen aq shumë fshatra sa të mos i drejtosh dot. Në kooperativën bujqësore të Shijakut, për shembull, janë bashkuar 16 fshatra. Në realitet me këtë forcë akoma të dobët organizative dhe drejtimi që kemi pasur dhe kemi, më duket se është e parakohshme të zgjerohemi shumë në bashkimin e disa fshatrave në një kooperativë bujqësore. Duke marrë parasysh fshatin tonë, me këtë ngritje politike jo të mjaftueshme, del se ne nuk kemi marrë masa të forta e të shëndosha për t'i bërë ballë një organizimi të tillë kaq të madh e të ndërlikuar, prandaj na ndodhin atje abuzime, tarafe, qëndrime prepotente nga ana e punonjësve përgjegjës. As komisionet e revizionimit, siç na thuhet, nuk po e luajnë rolin e duhur. Ato kanë të drejtë të thonë fjalën e tyre për kompetencat që u janë dhënë, por puna është se detyrat që kanë këto komisione nuk po i zbatojnë mirë. Të gjitha këto vijnë se njerëz të aftë nuk kemi, duke filluar që nga kryetari i kooperativës e gjer te llogaritari, brigadierët dhe normistët.

Ne duhet të mobilizojmë mirë njerëzit dhe të marrim disa masa efektive nga ana organizative për forcimin e kooperativave bujqësore. T'i edukojmë kooperativistët që të kenë një kuptim të drejtë për demokracinë në kooperativë, të dijë kujt t'i drejtohet edhe për ndonjë ankesë të tij, por edhe kur sheh se diçka

nuk shkon mirë në kooperativë. Në qoftë se ndonjë njeri ka një ankesë, ai shkon te kryetari i kooperativës, ose te sekretari i organizatës-bazë dhe bisedon me ta, sepse nuk është me vend të kërkojë të mblidhet përfaqësia për një nevojë të tij. Përfaqësia nuk zgjidh çështje të një individi, por ato që i përkasin gjithë kolektivit. Në qoftë se as sekretari as kryetari nuk merren me hallet që mund të kenë njerëzit, kjo do të thotë që gjendja në kooperativë nuk është e shëndoshë dhe duhet parë me seriozitet.

Por mund të ndodhë që, kur përfaqësia është në mbledhje, një anëtar i kooperativës i drejtohet në këtë rast asaj, duke parashtruar se ndaj tij po bëhet një padrejtësi dhe kërkon që ta dëgjojnë shokët e përfaqësisë. Këta e kanë për detyrë ta dëgjojnë dhe asnjë nuk ka të drejtë ta pengojë të flasë. Në përfaqësi ai mund të ngrejë, për shembull, çështjen që qetë e punës nuk po përdoren mirë duke e bindur përfaqësinë që, për të, ky është një problem i madh.

Në qoftë se është problem çështja e normave, atëherë kjo është diçka që i takon gjithë brigadës dhe aty diskutohet më parë. Brigada ka të drejtë të diskutojë edhe për brigadierin e saj, ta ndihmojë për ta drejtuar mirë brigadën dhe ta kritikojë nëse nuk e bën mirë një punë. Kur brigadieri premtan e nuk ndreqet, atëherë edhe një anëtar i brigadës ka të drejtë të vejë në kryesi dhe t'i thotë se brigadieri është rrenacak dhe se kërkon të merren masa ndaj tij, ose të bëhet një mbledhje e hapët e përfaqësisë. Forma, pra, ka plot, po nuk shfrytëzohen mirë.

Për çështjen e kredive, nuk duhet të alarmohemi



se do të na dalin disa miliona lekë nga banka. Le të dalin këto, po ne duhet të dimë se ku venë, i shërbejnë prodhimit? Në qoftë se kooperativat bujqësore i kanë marrë për të përballuar investimet, mendoj se mirë kanë bërë. Por në qoftë se kooperativat bujqësore i bëjnë ato, siç thotë populli, rrush e kumbulla, atëherë kjo s'lejohej, prandaj duhet ndërhyrë që të parandalohet e keqja se nuk e shkelim demokracinë.

Në këtë drejtim të mos qëndrojmë vetëm në atë çfarë bëjnë e do të bëjnë vetë kooperativat bujqësore. Edhe banka, edhe komiteti ekzekutiv duhet të kenë një evidencë të fondeve, dhënë kooperativave bujqësore, të ndara në dy kategori, edhe për investime, edhe për nevoja të tjera të prodhimit. Këtë evidencë ta kenë përpara që të dihet se filan kooperative i janë dhënë kaq fonde, tjetrës kaq. Jo vetëm çdo kooperativë bujqësore duhet të mendojë ku do të investojë, po edhe seksioni i bujqësisë i rrethit duhet të vrasë mendjen ku mund të investojë më mirë secila prej tyre dhe t'i sugjerojë, duke i argumentuar drejtimet më me leverdi. Sikur të bëhet kjo punë nga komitetet ekzekutive, çështjet mund të zgjidhen më mirë. Pastaj komiteti ekzekutiv mund t'i tërheqë vëmendjen një kooperative bujqësore, përgjegjësi i së cilës ka disa dëshira jo të shëndosha.

Për sa i përket emërimit të punonjësve të administratës kam mendimin që të mbetet në kompetencën e kryesisë së kooperativës bujqësore, e jo të asamblesë. Llogaritari mund t'i vejë kooperativës edhe nga qyteti. Në një rast të tillë fshatarët nuk kanë si enjohin, prandaj ai mund të merret në punë si lloga-

ritar duke e caktuar kryesia, pastaj kontrollohet e ndihmohet edhe nga të tjerët për ta bërë punën. Por po e emëroi asambleja një teknik, do të jetë vështirë ta heqësh kur gabon ose kur nuk punon mirë, se përsëri duhet të vendosë asambleja, mirëpo kjo nuk mbli-dhet dot çdo ditë. Pastaj demokracia jonë është e tillë që një njeri që nuk e bën punën dhe nuk është i nder-shëm, ai hiqet. E rëndësishme është t'i edukojmë nje-rëzit në mënyrë të tillë që të gjithë të mendojnë e të veprojnë si të bëhet më mirë puna e si të shkojë për-para kooperativa bujqësore. Demokracia kërkon që jo vetëm kryetari, kryesia apo brigadieri të flasë e të bë-jë vërejtje, po edhe kooperativistët e thjeshtë kanë të drejtë dhe detyrë të japin mendimin e tyre për çdo problem të kooperativës.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## TE ARRIJME QE KOOPERATIVAT BUJQESORE TE KENE SPECIALISTET E VET

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

23 maj 1966

Edhe unë jam dakord me projektvendimin që na paraqitet. Kooperativat bujqësore kanë nevojë për kua-dro drejtues e për specialistë dhe ne do të marrim të gjitha masat që të plotësohen më mirë këto nevoja, por është e drejtë të mendohet dhe të vendoset edhe për shpërblimin e tyre.

Kooperativat bujqësore janë akoma të dobëta ekonomikisht, prandaj nuk mund të kërkojmë që në këto kushte ato të mbajnë tërë peshën e shpërblimit për kuadrot dhe për specialistët që u dërgohen, kështu që drejt është menduar për t'i marrë shteti përsipër një pjesë të shpenzimeve. Nuk më duket me vend propo-zimi i bërë që t'u kërkojmë këtyre kuadrove e specia-

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua edhe për shpërblimin e kua-drove drejtues dhe specialistëve që dërgohen në kooperativat bujqësore.

listëve të shkojnë për të punuar pa marrë fare shpërblim çdo muaj, në një kohë që kooperativat bujqësore, i ndajnë të ardhurat vetëm në fund të vitit. Partia jonë ka shumë eksperiencë dhe anëtarët e saj kanë bërë gjëra të mëdha, janë hedhur vetë të parët në sakrifica dhe kanë tërhequr edhe të tjerët në këtë rrugë, por që të arrihet deri në atë shkallë sa të thuhet që «të dërgojmë specialistë në fshat edhe pa para fare», kjo s'është e arsyeshme, sepse njerëzit punojnë, por kanë nevojë edhe për mjetet e jetesës. Është tjetër gjë për anëtarët e kooperativave, të cilët e kanë ekonominë të ngritur në fshat.

Po të jetë atdheu në rrezik, secili e vë veten e vet në balancë dhe dihet nga anon ajo në një rast të tillë, ku asnjëri nuk i vete mendja për interesat e tij, por ky është një tjetër moment. Tani kur agronomi që punon në kooperativën bujqësore sheh që shoku i tij në ndërmarrje bujqësore shtetërore merr një pagë më të mirë duke pasur arsim dhe eksperiencë të barabartë, mendon se kjo nuk është e drejtë dhe me të vërtetë kështu është. Këtij i kërkojmë të marrë një pagë fare të vogël në muaj dhe të bëjë sakrifica, kurse ai i ndër-marrjes bujqësore jo vetëm që merr më shumë, po ka raste që ndonjëri edhe ankohet, kërkon pagë akoma më të madhe. Një frymë të tillë sakrifice përse e kërkojmë ne vetëm për ata që do të dërgojmë në kooperativat bujqësore, kurse për të tjerët, që qahen dhe kërkojnë akoma shtesë mbi pagën, nuk e kërkojmë?

Për specialistët e lartë ne kemi caktuar një pagë bazë që duhet të përpiqemi ta mbajmë afërsisht njëlloj për të gjithë. Pagën e caktuar ta marrin, po edhe puna

politike të vazhdojë me ta, që të punojnë me të gjitha forcat për ta shtuar prodhimin dhe të jetojnë thjesht.

Duhet të përpigemi që çdo kooperativë bujqësore të ketë specialistë të lartë, po ky objektiv nuk mund të arrihet kudo në një kohë të shkurtër. Specialistë të lartë ne do të përgatitim edhe nga fshati, edhe nga qyteti, kurse për teknikët e mesëm ne duhet të ecim më shpejt në rrugën që çdo kooperativë t'i sigurojë vetë.

Në parim, teknikët e mesëm të kooperativës nuk duhet të paguhen nga shteti, për arsye se një teknik i mesëm nuk ka ndonjë ndryshim të madh nga një bujk me eksperiencë dhe se këtë barrë nuk jemi në gjendje ta përballojmë. Shteti duhet të shkarkohet nga pagesat që jep për teknikët e mesëm të bujqësisë dhe ata të shpërblehen nga kooperativat bujqësore sipas punës që bëjnë. Kur kooperativat bujqësore t'i përgatitin vetë kuadrot dhe kur ta kenë rritur prodhimin, atëherë nuk do të jetë më problem shpërblimi i tyre.

Nuk jam dakord, gjithashtu, të paguhet nga shteti një brigadier që shkon nga zona fushore në malësi, siç ka ndonjë propozim. Po të dojë brigadieri i kooperativës fushore le të vejë vetë vullnetarisht në atë të malësisë, po që t'i paguajë shteti të holla, ne këtë nuk duhet ta bëjmë.

Kryetarët e kooperativave bujqësore në mund t'i paguajmë pjesërisht. Ka rëndësi të caktohet koha sa vjet do t'i paguajë shteti kryetarët dhe pas kësaj kohe ata të shpërblehen tërësisht mbi bazën e prodhimit dhe të të ardhurave që do të realizojë kooperativa bujqësore, se çështja është të nxiten ata. Sa më pak kohë t'i paguajë shteti, aq më mirë do të jetë se, po ta ketë

kryetari pagën të siguruar, mund të mos bëjë përpjekje për shtimin e prodhimit, të mos i vërë të gjitha kapacitetet dhe mundësitë e tij në shërbim të kooperativës. Ndryshe është për agronomin, i cili është përgatitur dhe është mësuar që të rrojë e të punojë pikërisht në fshatra. Ai shkon me mendje të mbledhur se atje do të merret me punën në fusha, kurse një që është marrë edhe me nëpunësi në qytet e ka më të vështirë të lidhet si duhet me fshatin, aq më tepër në qoftë se atje shkon pa shumë dëshirë.

Ne e kemi në dorë të vendosim nëse duhet t'i paguajë shteti ose jo kryetarët për tërë kohën ose për disa vjet, por nuk duhet ta shohim këtë çështje në mënyrë sentimentale, po me perspektivë. Në këto kooperative ku do të çojmë kryetarë, perspektiva të jetë e tillë që, edhe po u shpërblye me ditë-pune nga kooperative, paga e tij të arrijë sa më shpejt, të themi në 700 lekë. Kjo do të realizohet kur kryetari do ta organizojë punën dhe do ta drejtojë kooperativën në mënyrë të tillë që ajo të rritë prodhimin dhe të krijojë stabilitet ekonomik. Këtë perspektivë, këtë orientim të përgjithshëm për kooperativat bujqësore le ta dijë cilido që vete kryetar kooperative dhe të luftojë për ta realizuar.

Po cilët duhet të dërgojmë kryetarë të kooperativave bujqësore? Ne kemi nxjerrë kuadro nga një shkollë që e kemi pasur për këtë qëllim dhe këta ua kemi rekomanduar kooperativave t'i zgjedhin kryetarë. Ka prej tyre që kanë punuar shumë mirë, që e njohin bujqësinë, mirëpo ka edhe nga ata që pas dy vjetësh i kanë hequr. Pse ndodh kështu? Mos vallë nuk janë zgje-

dhur mirë që në fillim njerëzit e përshtatshëm që do t'i dërgonim për t'i përgatitur si kryetarë për kooperativat bujqësore? Edhe puna që po bëjmë tani, duke dërguar njerëz nga qyteti në fshat, që të bëhen kryetarë, më duket si ca e shpejtuar. Nuk mund të sigurohemi se këta që po dërgojmë janë më të zgjedhurit. Ne i themi një kuadri se po e dërgojmë kryetar, i japim edhe pagën, po pas ca kohe mund të na dalë se ai nuk e bën dot atë punë. Mund që ai ka luftuar dhe për këtë ka meritat e tij, po nga punët e bujqësisë nuk ka haber fare, prandaj nuk mund ta bësh kryetar. Në këtë drejtim ne duhet të kemi shumë kujdes, e jo si tani, shko ti nga qyteti në kooperativë se je me origjinë fshatare, ndërkohë që atij i kanë rënë dhëmbët 20-30 vjet këtu në qytet dhe e ka humbur origjinën si fshatar. Pra në fshat të çojmë njerëz që me të vërtetë të punojnë. Ne duhet të arrijmë që pikërisht agronomi, veterineri, zootekniku të jenë kryetarët e ardhshëm, njerëz politikisht të formuar, të zotë nga ana organizative dhe specialistë me eksperiencë.

Çështjen e kam që të jemi të matur. Kryetarë të kooperativave bujqësore të mos dërgojmë njerëz që vetëm kanë bërë luftën, po kuadro të aftë për drejtimin e punëve atje. Kryetarin fshatari e do, e respekton, po ai duhet të punojë mirë që ta meritojë këtë respekt dhe dashuri të fshatarit.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **KUR FRONTIN E UDHËHEQ NJË PARTI E VËRTETË MARKSISTE-LENINISTE, FITORJA ËSHTË E PASHMANGSHME**

*Nga biseda me delegacionin e Komitetit Qendror  
të Partisë Popullore të Laosit*

**25 maj 1966**

*Pasi u përshëndet me pjesëtarët e delegacionit,  
fjalën e mori shoku Enver Hoxha:*

Mirë se na erdhët në vendin tonë, shokë! Populli dhe Partia jonë gjithnjë e kanë simpatizuar popullin tuaj dhe e kanë përkrahur luftën e drejtë që ju bëni kundër ndërhyrjes imperialiste dhe reaksionarëve vendas. Eksperienca jonë tregon se rruga e luftës është e vetmja rrugë për të çliruar popullin nga imperializmi dhe nga reaksionarët e brendshëm dhe se lufta kundër armiqve të jashtëm nuk mund e nuk duhet të ndahet nga lufta kundër armiqve të brendshëm.

Kjo ka qenë për ne e vetmja rrugë që na çoi në çlirimin e plotë të vendit. Dhe sot, kur e krahasojmë të kaluarën me të tashmen, nxjerrim mësim të vlefshme, të cilat na ndihmojnë për të parë më me guxim të ardhmen.



Ju luftoni larg nesh, por ne na keni gjithmonë aty, pranë jush, pranë luftës së drejtë që zhvillon populli juaj. Neve na bie për detyrë t'ju ndihmojmë edhe më shumë, prandaj në propagandën tonë në rajonin e Evropës do të japim të gjithë ndihmën tonë, do të vëmë në dukje vazhdimisht luftën heroike të popullit laosian, luftën heroike të popullit vietnamez, luftën dhe përpjekjet e mëdha të të gjithë popujve që luftojnë kundër imperializmit dhe reaksionit. Ne e kemi quajtur dhe e quajmë si detyrë të lartë internacionaliste të vëmë në dukje, të përkrahim dhe të ndihmojmë të gjitha luftërat që bëjnë popujt për liri, pavarësi e progres shoqëror.

Shokët tanë jua kanë thënë, por edhe unë dëshiroj të theksoj se ne kemi plotësisht besim në luftën e drejtë të çdo populli dhe jemi të bindur se vetëm kjo luftë e zhvilluar me konsekuencë të çon në fitore. Ju keni tani eksperiencën e luftës që e keni zhvilluar dhe po e zhvillon në bazë të kushteve të vendit tuaj. Këtu e kam fjalën kryesisht për taktikën tuaj, të cilën më mirë se kushdo tjetër mund ta caktoni vetëm ju. Natyrisht, për të përcaktuar një taktikë sa më të drejtë e të shkathët në luftë duhet përfituar edhe nga eksperiencia e vendeve të tjera. Si çdo vend, edhe ne në këtë drejtim kemi eksperiencën tonë. Të marrim, për shembull, çështjen e frontit. Ju keni krijuar në vendin tuaj Neo Lao Hak Sat-in, në të cilin bën pjesë partia juaj. Edhe ne, gjatë kohës së Luftës Antifashiste, krijuam Frontin Nacionalçlirimtar, por ne Partinë e shpallëm hapur si udhëheqëse dhe organizatore të luftës dhe ajo jo vetëm e themeloi dhe e forcoi Frontin

Nacionalçlirimtar, por qëndroi kurdoherë në udhëheqje të tij. Te ju, me sa kemi dijani, partia nuk ka dalë hapur në front. Kjo, pa dyshim, është një çështje që ju takon juve sepse ju jetoni e luftoni në Laos dhe ju e dini se cila rrugë është më e mira. Megjithëkëtë, eksperiencia jonë vërtetoi se ekzistenca legale e Partisë në Front na ndihmoi shumë, mbasi kjo gjë i dha një shtytje të madhe përpara Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.

Partia jonë, duke dalë hapur në Front me një vijë të drejtë, me një program të qartë lufte, sqaroi masat, zhdukoi iluzionet, shpejtoi diferencimin dhe demaskoi punën minuese, sidomos të atyre elementëve të borgjezisë reaksionare dhe të feudalëve, që mundën të futeshin në radhët e Frontit tonë dhe përpiqeshin të bënin këtu një punë sabotuese. Fronti Nacionalçlirimtar, i cili kishte në krye Partinë Komuniste, nuk ia fshehu popullit qëllimet e veta, programin minimal dhe maksimal, nuk i fshehu popullit ekzistencën e Partisë dhe vijën e saj të përgjithshme. Kjo vijë ishte për mobilizimin në luftën e armatosur të të gjithë popullit kundër pushtuesve të huaj dhe, krahas kësaj, synonte të përkrahte aspiratat e punëtorëve dhe të fshatarëve për liri, pavarësi e përparim shoqëror, të likuidonte mbeturinat e feudalizmit, t'i jepte fund regjimit shtypës e shfrytëzues dhe të çonte në vendosjen e demokracisë popullore.

Eksperiencia jonë këtu në Evropë, tregon se ekzistenca legale e Partisë dhe roli i saj udhëheqës në Front kanë luajtur rol vendimtar për të ardhmen. Në Evropë ekzistonte «demokracia» borgjeze, për të cilën

populli ynë nuk kishte opinion të mirë, sepse jeta e kishte bindur se ajo u shërbente interesave të fuqive të mëdha imperialiste. Në vendin tonë kanë dalë jo vetëm gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, por edhe më përpara, njerëz shumë kurajozë, grupe përparimtare, elementë progresistë borgjezë, po këta kurrë nuk mundën të kenë sukses, mbasi u mungonte një parti e shëndoshë që të bëhej udhëheqëse e vërtetë e gjithë popullit. Ata kurrë nuk mund të bënin atë që bëri Partia jonë marksiste-leniniste. Kjo është e kuptueshme: Në kuadrin e «demokracisë» borgjeze mund të mobilizohet populli dhe me gjakun e tij të çlirohet vendi nga pushtuesit e huaj, por, pas kësaj, borgjezia e çarmatos popullin, nuk e lejon ta vazhdojë më tej luftën për të arritur çlirimin e tij shoqëror.

Në vendin tonë mbreti Zog e mori fuqinë në dorë në kushtet kur ekzistonte feudalizmi. Ai doli në fillim me parullën e demokracisë, por më pas vendosi monarkinë, diktaturën shtypëse e shfrytëzuese të klasës së vet. Kështu që populli ynë e kishte kuptuar se ç'do të thotë dhe ku të shpie demokracia borgjeze. Prandaj, kur ne krijuam Partinë, menduam se ishte e domosdoshme të dilnim hapur me qëllimet tona para popullit, t'i thoshim se ne qemë për një luftë gjer në fund konsekvente, se ne synonim jo vetëm çlirimin e vendit, por edhe «për një Shqipëri Demokratike Popullore» dhe e dinim se populli kishte besim te politika e Partisë. Nga ana tjetër, duke pasur gjithmonë parasysh që të mos dëmtonim vijën e Partisë, ne menduam se duhej të punohej me elementët që nuk ishin komunistë, bile edhe me borgjezinë e fshatit e të qytetit dhe u

përpoqëm që ajo të bashkohej në një front të vetëm me popullin, duke ruajtur kurdoherë rolin udhëheqës të Partisë në Front. Jeta vërtetoi se kjo ishte vija më e drejtë. Brenda një kohe të shkurtër, duke u mbështetur në vijën tonë të drejtë, ne pamë të bëhej diferencimi i elementëve: elementët e shëndoshë qëndruan me ne, ndërsa gjithë mbeturinat e borgjezisë zgjodhën rrugën e reaksionit dhe u bashkuan me armikun. Brenda një kohe të shkurtër ne vumë re se kjo vijë që kishte përcaktuar e ndiqte Partia jonë e lidhi më shumë popullin me Partinë. Kjo taktikë që ndoqëm, na tregoi se populli e kuptonte dhe e pranonte ekzistencën dhe udhëheqjen e Partisë dhe gjatë luftës u bë një diferencim i mirë midis atyre që ishin ose jo për këtë luftë.

Në kundërshtim me këtë vijë që ndiqte Partia jonë ishin revizionistët jugosllavë. Tradhtia e tyre doli në shesh në vitin 1948, po ata kanë qenë armiq të betuar të socializmit shumë kohë më parë dhe kjo u pa te ne qysh në periudhën e luftës. Atëherë, ata paraqitën për të parën herë tendencën e tyre për të fshehur ekzistencën e Partisë prapa Frontit. Ata nuk donin që te ne Partia të vihej në krye të Frontit, prandaj bënë çmos që roli i saj të fshihej. Por përpjekjet e tyre gjatë kundërshtimit e prerë të Partisë sonë. Pas Çlirimit, trockistët jugosllavë u përpoqën ta likuidonin fare Partinë tonë dhe të ruanin në vend të saj Frontin, gjoja si një organizatë e aftë për ndërtimin e socializmit. Por edhe këtu ata dështuan. Kjo është eksperiencia jonë.

Natyrisht kjo është eksperiencia jonë, kurse te ju janë kushte të tjera, prandaj ju më mirë se kushdo

tjetër mund të gjykoni se kur është momenti më i përshatshëm që partia të dalë hapur para popullit. Ne për një gjë jemi të sigurt: kur frontin e udhëheq një parti, e cila qëndron në pozita të shëndosha marksiste-leniniste, fitorja është e pashmangshme.

Eksperienca jonë tregon gjithashtu se gjatë luftës partia komuniste nuk duhet ta humbasë për asnjë moment perspektivën dhe në kuadrin e aleancave të mundshme që do të krijohen brenda frontit s'duhet lejuar për asnjë moment një politikë shumë e avancuar me borgjezinë. Partia Komuniste e Indonezisë, për shembull, duke u mbështetur jashtë mase në disa elementë të tillë të borgjezisë si Sukarno, bëri që në një moment kjo politikë ta rrezikojë e ta dëmtojë shumë rëndë partinë. Partia mund të bëjë zigzaget e saj në luftë, bile edhe ndonjë koncesion, por duhet pasur parasysh që ky koncesion të ketë karakter dialektik dhe të mos ndodhë që të krijojë më pas situata të vështira e të ndodhesh në gjumë, përballë reaksionit e fashizmit, i cili, në kuadrin e demokracisë borgjeze, kurrë nuk fle, por përgatitet, mbledh forcat për t'i dhënë fund «demokracisë» borgjeze e, para së gjithash, për të goditur partinë komuniste. Në këto momente njeriu duhet të jetë veçanërisht shumë vigjilent, mbasi tradhtia e revizionistëve sovjetikë, propagandimi prej tyre i «rrugës paqësore», i aleancave të paprincipita me borgjezinë etj. e dëmtoi shumë lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe lëvizjen nacionalçlirimtare të popujve.

Partia jonë konsideron se revizionistët sovjetikë janë duke zhvilluar tani një punë reaksionare, ata janë në lidhje të ngushtë me imperializmin për të pen-

guar socializmin dhe luftërat çlirimtare të popujve. Këta mund t'i krahasosh me të ashtuquajturit demokratë anglezë dhe italianë, të cilët në fillim të luftës flitnin për çlirimin e popullit etj., etj., kurse nga ana tjetër përgatitnin zgjedhën për këta popuj. Pra, të tillë janë revizionistët sovjetikë. Ne ua themi haptazi këtë shokëve tanë dhe nëse ata i hapin ose jo sytë, kjo varet pastaj prej tyre.

Partia jonë konsideron se jo vetëm në kuptimin teorik, por edhe në veprimtarinë praktike, revizionistët nuk janë gjë tjetër veçse tradhtarë të shitur, që luftojnë me të gjitha forcat kundër socializmit. Ata flasin për luftën e Vietnamit, të Laosit etj., ata japin edhe ndonjë ndihmë materiale, por kjo ndihmë e tyre është njëllë sikur të japësh një bombonë helmi të lyer jashtë me sheqer, pse nga një anë ata japin «ndihmë» për të maskuar tradhtinë, dhe nga ana tjetër u futin thikën prapa shpine popujve që luftojnë për liri e pavarësi. Ja pse ne themi që ata janë tradhtarë.

Partia jonë e thotë hapur dhe është e bindur se kundër këtyre tradhtarëve duhet luftuar, pse ata bëjnë çmos për të sabotuar luftën, për të likuiduar socializmin.

Le të marrim, për shembull, qëndrimin e tyre ndaj vendit tonë. Të gjitha ato që kanë bërë kundër nesh tregojnë qartë se këtu kemi të bëjmë me një sabotim të organizuar. Por qëndrimi i tyre ndaj nesh tregon edhe dobësinë e tyre të madhe, sepse ata nuk ishin në gjendje të likuidonin një Shqipëri të vogël prej 1 milion e 800 mijë frymësh, e cila ndodhet e rrethuar nga të gjitha anët prej armiqve. Ne luftuam me të gjitha forcat kundër gjithë kësaj bande, që ka qenë e gat-

shme për të na goditur hapur. Kur shikonim veprimtarinë e tyre tradhtare ne mendonim: Pse i bëjnë të gjitha këto? Çfarë të keqe ka bërë Shqipëria që të sillen në këtë mënyrë? Pse, pra, gjithë kjo luftë? Sepse Partia jonë s'ishte dakord me shumë pikëpamje të tyre të gabuara që filluan të dukeshin. Sa më tepër thellohej veprimtaria e tyre tradhtare, aq më shumë lufta jonë ashpërsohej.

Çfarë duhej të bënim ne përpara presionit dhe shantazheve të revizionistëve? Të gjunjëzoheshim? Jo. Ne thamë: «Mirë, ju do të na goditni, jugosllavët do të na godasin, atëherë goditni, ja, këtu jemi!». Natyrisht ne nuk qëndruam duarkryq. Ata na goditnin me armët e tradhtisë, të diversionit, të sabotimit, ne i goditnim me armën e pathyeshme të marksizëm-leninizmit, me të vërtetën që qëndronte në anën tonë. Kështu ata e panë më në fund se për të likuiduar Shqipërinë duhej të merrnin parasysh të gjitha rreziqet, se për të bërë këtë duhej hyrë në luftë, por kjo nuk do të ishte një luftë e lehtë, pse vetëm nga ana e propagandës politike ata do të pësonin një humbje të madhe. Revizionistët sovjetikë, çekë e të tjerë vendosën ndaj vendit tonë një kordon të fortë e të gjithanshëm, por edhe në këtë drejtim pësuan disfatë. Prandaj ata u detyruan të ndryshojnë taktikë, të shiten tani sikur janë të gatshëm për të rregulluar çdo gjë, të merren vesh me ne.

Po për çfarë të merremi vesh me ta? Për të restauruar kapitalizmin si në vendet e tyre? Për t'i hapur rrugën shthurjes e liberalizimit, për të inkurajuar elementët armiq, siç ndodhi në Çekoslovakia ditën e 1 Ma-

jit, kur elementë të tillë kalonin me pankarta në duar, me parulla proamerikane, dhe policia nuk bëri as kundërveprimin më të vogël, me qëllim që të mos komprometoheshin tratativat e ndyra që janë duke bërë revizionistët me imperializmin?! Këtë qëndrim të krejtëve revizionistë e kanë kuptuar mirë imperialistët, të cilët po e brohorasin parullën revizioniste të hedhjes së urave. Kështu thonë ata «të hedhim urat» dhe ura të tilla, për t'u lidhur me imperializmin, vazhdimisht po hidhen.

Tani ura gjithnjë të reja po ndërtohen nga vendet revizioniste për t'u lidhur me imperializmin. I kujt është faji për këtë? Yni? Ata kërkojnë që ne të tradhetojmë, por jo, në asnjë mënyrë, këtë ne nuk e bëjmë kurrë. Pra, ne të shkojmë në rrugë të drejtë dhe ata le të bëjnë punën e tyre. Ne kështu bëjmë detyrën tonë, u qëndrojmë besnikë parimeve tona të drejta marksiste-leniniste.

Ne, shokë, kemi admirim të madh për popujt e Laosit dhe të Vietnamit që bëjnë një luftë heroike dhe jemi të bindur se, duke ndjekur një vijë të drejtë, marksiste-leniniste, fitorja do të jetë me ju. Indokina është bërë sot vatër revolucionare dhe lufta juaj, e Vietnamit dhe e vendeve të tjera ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe, sepse godet e demaskon imperializmin dhe shërbëtorët e tij revizionistë. Sytë e gjithë popujve revolucionarë të botës janë drejtuar sot në luftën tuaj. Ne shikojmë se si imperializmi amerikan është futur në një qorrsokak nga ku s'di si të dalë. Për këtë arsye revizionistët sovjetikë përpiqen ta shpëtojnë atë, por nuk mundën. Çfarëdo që të bëjnë, revizionistët sovje-



tikë nuk do të mund t'i shpëtojnë imperializmin, reaksionarët dhe veten e tyre nga llumi ku janë futur dhe nga fundi që i pret.

Edhe një herë, në emër të Komitetit Qendror të Partisë sonë, ju urojmë sukses në punën dhe në luftën tuaj dhe të jeni të sigurt se kurdoherë ju do të gjeni në Partinë tonë, në popullin tonë, në Komitetin Qendror të Partisë sonë, të gjithë përkrahjen marksiste-leniniste për fitoren tuaj të plotë.

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim që gjenden në AQP*

## TE NGREMË NIVELIN E SEKRETARËVE TE ORGANIZATAVE-BAZË

*Nga biseda me anëtarët e byrosë së Komitetit  
të Partisë të Rrethit të Elbasanit*

31 maj 1966

Në fillim, sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit, shoku Jashar Menzelxhiu, e informoi shokun Enver Hoxha se si po punojnë për zbatimin e masave revolucionare që ka marrë Partia kohët e fundit. Në zbatim të këtyre masave ai vuri në dukje se mjaft kuadro kanë kaluar nga administrata në prodhim. Shumica e tyre kanë shkuar në kooperativat bujqësore.

Pastaj midis shokut Enver Hoxha dhe shokëve të byrosë së Komitetit të Partisë u zhvillua kjo bisedë e përzemërt:

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si duken tani ata që kanë shkuar në fshat, a janë të kënaqur? Keni marrë takim me ta? Të kemi parasysh se në fillim do të kenë disa vështirësi dhe kjo është e natyrshme.

**SHOKU JASHAR MENZELXHIU:** Ata janë kua-

dro të mirë, që i kuptojnë drejt masat që po merr Partia dhe janë të mobilizuar për realizimin e tyre.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Si paraqitet bujqësia?

*SHOKU JASHAR MENZELXHIU:* Gjer tani bujqësia duket e mbarë. Kemi mbaruar mbjelljen e duhanit më shpejt se çdo herë tjetër. Atë e kemi mbjellë në kodra.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kodrat si ato të Dumresë ju mund t'i mbillni fare mirë edhe me grurë.

Sa për pambukun, tani që rendimenti i tij është rritur nga 3-4 kuintalë për hektar në 8-10 kuintalë për hektar, edhe çmimet duhet t'i shohim.

Po misrin si e keni?

*SHOKU JASHAR MENZELXHIU:* Kemi akoma 70 për qind të sipërfaqes pa mbjellë. Kurse planin e mbjelljes së patates e kemi tejkaluar. Besojmë se do të arrijmë të marrim 80-90 kuintalë për hektar, se shërbimet po i bëhen mirë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Duhet të mendoni të përgatitni edhe transhe për t'i ruajtur patatet.

*SHOKU JASHAR MENZELXHIU:* Planin vjetor të hapjes së tokave të reja ne e realizuam. Toka të reja për të hapur kemi akoma, sidomos në zonën e Dumresë dhe në malësi.

Kemi marrë masa për ta përfunduar korrjen në një kohë të shkurtër. Për këtë qëllim në ndihmë të fshatit do të shkojnë punonjës nga qyteti.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ne duhet t'i mbajmë gjallë këto iniciativa. Ja, së shpejti do të shkojnë në aksione 20 mijë të rinj, lëre pastaj sa do të shkojnë nga qyteti në ndihmë të bujqësisë. Tek ata që do të shkoj-

në në aksione, ne duhet të rritim entuziazmin, po njëkohësisht të gjejmë edhe mënyrat se si t'i presin kudo vullnetarët.

Ju keni kërkuar bukë këtë muaj?

**SHOKU KOSTAQ LAZRI<sup>1</sup>:** Po, kërkuam për kooperativat bujqësore të Gjocajt, Shezës, në përgjithësi për zonën malore të Peqinit dhe për disa fshatra të Dumresë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si ju shkojnë punët në ndërmarrjet ekonomike?

**SHOKU KOSTAQ LAZRI:** Nga të gjitha ndërmarrjet e qytetit tonë, vetëm 2-3 kemi që nuk do ta realizojnë dot planin, kurse të gjitha të tjerat do ta realizojnë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si shkojnë me punë shoferët e parkut?

**SHOKU KOSTAQ LAZRI:** Përgjithësisht mirë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** U marrin të holla udhëtarëve?

**SHOKU JASHAR MENZELXHIU:** Ka edhe nga ata shoferë që u marrin.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shoferët duhen edukuar me kujdes nga Partia, që të formohen plotësisht me tiparet e klasës.

Po ju (*duke iu drejtuar shokut Sadik Bocaj<sup>2</sup>*) pse keni ardhur në Elbasan?

**SHOKU SADIK BOCAJ:** Kam ardhur për të parë

1 Në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Elbasanit.

2 Në atë kohë shef i sektorit të Statutit në aparatit e Komitetit Qendror të PPSH.

dhe për të ndihmuar për disa probleme organizative të Partisë. Një nga këto probleme për të cilat duhet ndihmuar rrethi i Elbasanit, sidomos në zonat malore, është ai i gruas.

**SHOKU JASHAR MENZELXHIU:** Në këtë drejtim mund të ndihmojnë shumë mësueset dhe mamitë, prandaj po i aktivizojmë për të punuar me gratë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** A ka raste që i martojnë vajzat me para në këto zona?

**SHOKU JASHAR MENZELXHIU:** Po, ka prin-dër që marrin para kur fejojnë vajzën.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Partia duhet të bëjë një luftë të madhe kundër këtij zakoni, sidomos në malësi, që janë prapa, se nuk është një punë aq e lehtë për ta luftuar këtë zakon të rrënjosur me shekuj.

Qyteti a furnizohet mirë me ushqime, mish, qumësht, zarzavate?

**SHOKU JASHAR MENZELXHIU:** Qumësht kemi pasur vazhdimisht, por jo në sasinë që na duhet. Zarzavate kemi pasur edhe gjatë dimrit. Edhe mish në përgjithësi kemi pasur.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ti shoku Ngjeli Toka<sup>1</sup> me ç'sektor merresh?

**SHOKU NGJELI TOKA:** Merrem me çështje organizative, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po si mendon, çfarë duhet bërë me sekretarët e organizatave-bazë për ta rritur nivelin e tyre ideopolitik e kulturor?

---

1 Në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit.

*SHOKU NGJELI TOKA:* Një nga format për ngritjen e tyre është organizimi i seminareve.

*SHOKU JASHAR MENZELXHIU:* Ata ne i thërrsim herë pas here dhe i vëmë në dijeni për problemet aktuale. Në kooperativat bujqësore të bashkuara ne praktikojmë edhe mbledhje në bazë zone, ose në bazë lokaliteti.

*SHOKU NGJELI TOKA:* Ka mundësi që nga ana jonë të jepet një ndihmë më e mirë, më e studiuar dhe të mos kufizohemi vetëm në dhënie udhëzimesh.

*SHOKU ENVER HOXHA:* I duhet vënë kujdes i madh edukimit të sekretarëve të organizatave-bazë të Partisë, sepse ata janë në kontakt të vazhdueshëm çdo orë me komunistët dhe me masën. Anëtarët e Partisë sonë janë njerëz të mirë, të ndërgjegjshëm, të palodhur, gjykojnë me pjekuri, po jemi ne që duhet të gjejmë metodat si t'i aktivizojmë dhe t'i ngremë ata gjithnjë e më lart. Mirëpo është e zorshme që të gjithë komunistëve t'u vijmë në ndihmë me anën e instruktorëve, prandaj duhet të ngremë nivelin e sekretarëve të organizatave-bazë, që ata të mësohen si të punojnë me komunistët, si të përgjithësojnë eksperiencën dhe si t'i edukojnë edhe masat me shembullin e tyre. Udhëheqja në rreth duhet të mendojë seriozisht për këtë çështje.

Në përgjithësi sekretarët e organizatave-bazë të Partisë janë njerëz të aftë e të zgjuar, janë nga komunistët më të mirë, por ata kanë nevojë për ndihmën tonë. Ne duhet t'i edukojmë në mënyrë të tillë që ata t'i shikojnë çështjet jo në anën e jashtme, por në brendinë e tyre, të njohin gjendjen, të gjykojnë edhe vetë

për të, të gjejnë format më të përshtatshme si të mobilizojnë komunistët dhe masat. Këtu merr një rëndësi të veçantë metoda e punës që përdor sekretari i komitetit të Partisë, i deleguari apo instruktorët në lidhjet e tyre me sekretarët e organizatave-bazë. Kur jepet direktiva, ajo duhet zhvilluar me të gjitha mjetet dhe mënyrat, duhet shpjeguar dhe nuk duhet transmetuar në mënyrë të thatë. Direktiva, natyrisht, duhet t'u jepen, por duke iu shmangur zyrtarizmit. Këtij qëllimi t'i vlejnë edhe seminarët, edhe bisedat e lira. Kur ti takohesh me sekretarin e organizatës-bazë, ai të kuptojë se nuk ke shkuar vetëm për të dhënë udhëzime, por për të diskutuar së bashku problemet që atij nuk i ka vajtur mendja t'i shtrojë në atë formë. Në bisedë e sipër mund ta pyesësh edhe për gjendjen e gruas apo të rinisë dhe, pasi të njihesh me gjendjen, të diskutoni përsëri së bashku se si duhet rritur puna e organizatës-bazë të Partisë me njerëzit. Pastaj u thua se, që të bëhen këto gjëra, ne duhet të mobilizojmë punonjësit, të mobilizojmë edhe rininë, që e kemi shumë të mirë. Pra, nëpërmjet një bisedimi të ngrohtë shoqëror, u jep atyre edhe direktivën. Duhet vepruar si me një njeri që të vjen në shtëpi dhe bisedon me të shtruar. Me sekretarët të veprojmë në atë mënyrë që t'u hapim horizonte.

Në përgjithësi sekretarët e organizatave-bazë kanë një nivel më të ulët ideopolitik e kulturor në krahasim me drejtorët e me kryetarët e kooperativave bujqësore, por kjo është një vështirësi e përkohshme, të cilën do ta kapërcejmë. Një rrugë është t'i dërgojmë ata në Shkollën e Partisë, por të gjithë nuk kemi

mundësi t'i dërgojmë, prandaj, krahas kësaj rruge, komiteti i Partisë të organizojë e të bëjë një punë të veçantë me sekretarët. Edhe drejtorëve dhe kryetarëve, të cilët janë njerëz të zgjuar, janë nga njerëzit tanë më të mirë, t'u kërkohet që t'i kryejnë deri në një detyrat shtetërore dhe t'i bëhen krah sekretarit të organizatës-bazë, ta ndihmojnë dhe ta përgatitin si veten e tyre nga ana e nivelit, që edhe ai t'i kuptojë drejt detyrat shtetërore dhe ekonomike. Edhe drejtori i ndërmarrjes ose kryetari i kooperativës, si njeri partie që është, e ka për detyrë t'i edukojë njerëzit dhe, në rradhë të parë, të ndihmojë sekretarin e organizatës-bazë. Po edhe nga sekretari kërkohet që ai të bëjë të gjitha përpjekjet për t'u ngritur në nivelin e detyrës që i ka ngarkuar organizata-bazë. Faktet tregojnë se nga kjo punë e gjithanshme edhe sekretarët po bëhen kuadro nga më të mirët.

Duhet gjetur mënyrat që sekretari i organizatës-bazë t'i kryejë mirë të gjitha detyrat, edhe normën ta realizojë, edhe njerëzit t'i edukojë, të kujdeset edhe për të zgjidhur hallet e për t'iu përgjigjur pyetjeve që mund të bëjnë herë pas here anëtarët e Partisë. Atje ku sekretari i organizatës është i ngritur, qoftë edhe kur punon në torno, është në gjendje të këshillojë dhe të udhëzojë shokët e tij, si gjatë kohës së punës, ashtu edhe mbasi mbaron punën e vet. Ai mund të thërresë në fabrikë një komunist për një çështje që e preokupon dhe, pa qenë nevoja të zgjatet në bisedë me të, i thotë se i kanë raportuar diçka për të, prandaj e këshillon që më të mos e përsëritë. Tani, e porosit, shko në shtëpi, reflekto dhe nesër, atje ku do të jem në punë, eja më



thuj, ç'ke menduar. Ose kur merr vesh, për shembull, që ngjet diçka në lagjen e tyre, ai mendon: «Përse të pres unë gjersa të bëhet mbledhja e muajit? Ky do të ishte një formalizëm» dhe ndërhyr për të zgjidhur problemin. Ose në lagje sheh se njëri nuk sillt mirë me gruan apo me fëmijët, atëherë thërret një komunist që ai e di se i shkon fjala më shumë në atë familje dhe i thotë: «Shko dhe ndihmoje atë burrë të shkojë mirë me gruan e vet». Pra jo çdo gjë zgjidhet vetëm me mbledhje. Në qoftë se në këto takime personale njerëzit nuk binden nga sekretari, atëherë çështja shtrohet në mbledhje të organizatës dhe atje të përgjigjen edhe ata që nuk sillen mirë si komunistë, edhe ata që nuk kryejnë detyrat, edhe ata që nuk realizojnë normën. Sekretari i organizatës i thotë hapur secilit: «Ti je anëtar partie, kurse unë, duke qenë edhe sekretar i organizatës-bazë, jam i zënë më shumë se ti, se merrem me organizimin e mbledhjeve, takohem me komunistë, me punëtorë etj., megjithatë normën e realizoj. Ja, edhe me ty kam bërë disa takime, prandaj mblidhu dhe përpiku të realizosh normën, ndryshe organizata-bazë nuk ka për të të lënë rehat». Kjo punë shërben që të formohet më shpejt një edukatë e shumanshme, efektive në organizatën-bazë të Partisë.

Sekretari i organizatës-bazë mund të bëjë shumë punë të tilla, mirëpo në praktikë shpeshherë mendohet sikur vetëm mbledhjet e organizatës-bazë kanë rëndësi të madhe. Anëtarët e Partisë dhe sekretarët e organizatave-bazë duhet të punojnë me forma të shumanshme me komunistët dhe me masat edhe jashtë organizatës. Po t'u dalë ndonjë problem, nuk është nevoja të presin

gjersa të vijë koha e mbledhjes, po të kenë iniciativë dhe të veprojnë sipas rastit. Ky është një aktivitet revolucionar i anëtarit të Partisë, sepse kështu si bëhet, duke pritur mbledhjen, kjo në përgjithësi është një punë rutinë.

Mbledhjet duhet të bëhen medoemos dhe duhen bërë efektive. Atje, në organizatë, duhet bërë një luftë e vërtetë. Ti, për shembull, i thua shokut që merret me rininë: Pa na thuaj si e kryen këtë detyrë? Kjo duhet bërë, por nuk mjafton. Puna është që shokëve t'ua njohësh mirë mendimet, dëshirat, prirjet, të bëhesh shok me ta dhe, së bashku me më të mirët, të tërhiqni pas shembullit tuaj edhe të tjerët.

Në mbledhjen e organizatës-bazë merren vendimet përkatëse dhe çdo komunist e ka për detyrë të ndjekë zbatimin e tyre gjatë muajit. Por ndodh që sekretari i organizatës-bazë i mbledh çështjet që nuk gjejnë zbatim dhe i paraqet pas një muaji në mbledhje. Kjo nuk është e mirë, se ai duhet të punojë vazhdimisht. Këtu qëndron zotësia e tij. Sekretari duhet të pajiset me aftësi organizative. Ai i thërret vazhdimisht komunistët, i inkurajon, i përgëzon kur kanë vepruar mirë dhe u thotë se këtë do t'ia bëjë të ditur edhe organizatës-bazë. Sekretari, gjithashtu, ngarkon shokë të aftë për të folur në lagje, me rininë etj. Ai mendon dhe vepron si t'i vërë të gjithë në lëvizje. Kur sheh se një çështje nuk po zgjidhet si duhet pa marrë pjesë edhe ai në zgjidhjen e saj, atëherë e ndjek edhe vetë këtë, bashkë me shokun e ngarkuar më parë.

Sekretari kujdeset që shokët e byrosë të japin shembullin para shokëve të tjerë të organizatës, duke marrë

përsipër zgjidhjen e çështjeve më të vështira. Në qoftë se një anëtar i byrosë nuk e kryen mirë detyrën, nuk lëviz po rri, fle, sekretari e këshillon shoqërisht, e ndihmon që ta kryejë atë, por në qoftë se edhe paskëta ai përsëri nuk punon, atëherë i thotë një tjetri që ta kryejë detyrën e lënë në mes nga anëtari i byrosë. Njëkohësisht, sipas rastit, ai e shtron çështjen në organizatën-bazë, së cilës i thotë që ky shok, si anëtar i byrosë, nuk aktivizohet. Organizata e këshillon nga ana e saj dhe, në qoftë se përsëri nuk i kryen detyrat, e heq dhe në vend të tij zgjedh një tjetër që e bën mirë punën. Pra ne duhet t'i mësojmë sekretarët e organizatave-bazë që t'i vënë në zbatim këto forma pune.

Sekretari i organizatës-bazë vërtet mund të mos lëvizë nga vendi i tij i punës, po duhet të mendojë dhe të kujdeset që të vërë në lëvizje të gjithë anëtarët e Partisë. Si sekretar, atij mund t'i duhet ta sakrifikojë një gjysmë ore nga koha e punës për ndonjë problem të rëndësishëm që mund t'i dalë, po njëkohësisht kohën që humbet, duhet ta vërë në vend. Secili duhet jo vetëm ta kryejë detyrën shoqërore të ngarkuar, po të realizojë edhe normën. Në jetë çdo komunisti mund t'i dalin edhe gjëra që s'ka si i parashikon dot, prandaj e ka për detyrë që punën e ngarkuar ta kryejë në mënyrë shembullore, të jetë edhe në udhëheqje të masave për çdo aktivitet shoqëror.

T'i mësojmë gjithashtu sekretarët e organizatave-bazë të mendojnë vetë. Ata të mos presin vetëm ç't'u thotë instruktori i komitetit të Partisë ose çfarë do t'u thuhet në seminar, po të mendojnë edhe vetë sidomos për zbërthimin e direktivave të Partisë.

Është vallë nevoja t'i thuhet sekretarit të organizatës-bazë të kooperativës bujqësore që misri duhet prashitur në kohë? Këtë ai e di dhe duhet ta dijë medoemos. Ai e di dhe duhet ta dijë se sa më shpejt të korret gruri, aq më fitim ka. Për gjëra të tilla nuk është nevoja të vijë as agronomi, as instruktori i komitetit të Partisë, prandaj ai vetë të interesohet që organizatë-bazë e Partisë të jetë në krye të punës për t'i mobilizuar të gjithë njerëzit. Në këtë mënyrë edhe kryesia e ndien më shumë përgjegjësinë që ka. Për këto çështje nuk duhen fjalë të mëdha, duhet punë që gruri të korret, apo që misri të prashitet etj. Te korrja apo te prashitja duket jo vetëm prodhimi i ardhshëm, por edhe puna e secilit anëtar partie. Kur një komunist punon dobët e në mënyrë të pandërgjegjshme herën e parë sekretari do ta sinjalizojë të ketë kujdes. Metodën e punës gjeje vetë, do t'i thotë, prej teje kërkohet që aty ku punon ti, të kryhet mirë çdo detyrë. Po të vazhdojë të punojë dobët, herën e dytë do ta kritikojë organizatë-bazë, kurse herën e tretë organizata nuk do të mjaftohet me kaq.

Njerëzve nuk është nevoja t'ua shpjegosh fill e përpe çdo gjë, se ata janë vetë në dijeni të çështjeve dhe të direktivave që janë dhënë nga Partia. Nuk është nevoja të rrimë e t'i shpjegojmë komunistit pse nuk duhet të lejojmë që të prishen patatet, por t'i themi të vrasë mendjen si ta parandalojë këtë, t'i themi shko e bisedoje edhe me anëtarët e kooperativës në brigadën tënde, kërko nga ai që ka bërë shkollë ta studiojë këtë çështje, studioni edhe shtypin se mos ka ndonjë artikull për transhetë dhe merrni masat e nevojshme për të

ruajtur patatet. Në qoftë se del, për shembull, një njeri dhe thotë se në filan shtet «kam parë që patatet i futin në hangar», nuk duhet marrë vetëm kjo eksperiencë e të kërkoen fonde për ngritjen e hangarëve, po shikoni më mirë si i ruan patatet fshatari ynë i Devollit gjatë dimrit.

*Pastaj shoku Enver Hoxha pyeti se çfarë shfaqjeje teatrale jepej atë ditë në qytetin e Elbasanit. Pasi mori përgjigjen se shfaqej një pjesë me përmbajtje nga Lufta Nacionalçlirimtare dhe se qyteti kishte një kor që përbëhej nga arsimtarë, një fanfarë të vogël me 18 veta, anëtarët e së cilës shpërbleheshin me një shumë të vogël të hollash, po në përbërjen e saj shumica ishin të vjetër në moshë, tha:*

Të vjetrit i zëvendësoni me të rinj, të cilët ta bëjnë këtë punë pa shpërblim në lekë, se të rinjtë ndiejnë gëzim të madh të dalin ditët e diela dhe ditët e festave në grup për të dhënë shfaqje për popullin. Mësuesi duhet të dijë muzikë, të jetë sportist, të vizatojë, t'i bëjë të gjitha.

Ju në Elbasan si instrument popullor, më duket, keni dajren e gërnetën. Mendoj se duhet kujdesur për organizimin e prodhimit të instrumenteve popullore që fshatari i ka qejf dhe ai të ketë ku të blejë një fyell, një dajre, një gajde. Dikujt i duhet, për shembull, një dajre në shtëpi, po tani ku ta blejë? Tjetrit mund t'i duhet një fyell, po gjithashtu edhe këtë ku ta gjejë? Prandaj ne duhet të mendojmë që jo vetëm t'i prodhojmë në vend të tilla instrumente muzikore tradicionale, po të jenë edhe të mira, të lira, të mos mungojnë asnjëherë në treg. Pa këtë kujdes nuk ka si zhvillohet arti ynë popullor.

Po të tregojë interesimin e duhur Partia, shumë gjëra të tilla, që tani duken të perealizueshme, mund të realizohen. Edhe ata që shkruajnë duhet t'i përkrahni. Krijimet e tyre më të mira t'u jepen grupeve teatrale të qendrave të punës dhe t'i vënë në skenë. Pjesët e bukura, me përmbajtje të shëndoshë, kanë rëndësi të shfaqen në kolektivat punonjës, ku rolet i luajnë anëtarë të kolektivit. Në shfaqje mund të ftohen edhe pjesëtarët e familjeve të shokëve e të shoqeve të qendrave të punës, pse kështu lidhen më ngushtë me ta.

Prandaj i inkurajoni arsimtarët dhe amatorët e tjerë që marrin pjesë në këto shfaqje dhe ata që përgatitin pjesë teatrale për to, qofshin me një apo me dy akte. Këto pjesë të vogla mos i nënvleftësoni se në botë ka edhe shkrimtarë që kanë shkruar pjesë me një akt dhe me to janë bërë të dëgjuar. Natyrisht, për ne ka rëndësi që materiali, dhe, në radhë të parë, përmbajtja e pjesëve të jenë goditur shumë mirë dhe të shërbejnë për edukimin komunist të masave. Kjo do të arrihet si duhet, kur shfaqjet të kenë edhe një nivel të lartë artistik.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **PARTIA NA MËSON TË PUNOJMË USHTARAKISHT**

*Nga biseda me kuadrot drejtues të Partisë, të pushtetit  
dhe të kooperativës bujqësore të Shalësit  
në rrethin e Elbasanit*

**1 qershor 1966**

*Në fillim, shoku Enver Hoxha u informua nga kryetari i kooperativës bujqësore të Shalësit dhe nga kuadro të tjerë se si punohet dhe ç'rezultate janë arritur për të zbatuar direktivat e Partisë në lidhje me forcimin e kooperativave bujqësore. Pastaj shoku Enver Hoxha u interesua dhe i pyeti ata për fondin e pandashëm, për tokat e reja, për kreditë, për shtimin e të ardhurave të kooperativës etj. dhe, duke marrë fjalën, tha:*

*Në sajë të luftës dhe të punës që bën populli, vendi ynë përparon e, bashkë me të, lulëzon edhe kooperativa juaj. Po të mos luftonte populli, Shqipëria nuk do të ishte çliruar, po të mos punonte populli për të realizuar transformimet e thella socialiste, ai do të ishte keq edhe për bukë, siç ka qenë tërë jetën e tij në të kaluarën. Por me punë heroike, nën udhëheqjen e Partisë, populli ynë e kapërceu atë gjendje të vështirë të viteve të para të Çlirimit kur mungonte buka. Atëherë*

kishte shumë arsye të ndodheshim në atë gjendje, sepse ekonomia jonë ishte e prapambetur dhe e shkatërruar nga lufta, fshatari ende nuk ishte bashkuar në kooperativë bujqësore, toka punohej me mjete primitive dhe pjesëmarrja në punë ishte e kufizuar. Partia, krahas masave që mori për ta futur fshatin në rrugën e kolektivizimit të bujqësisë, bëri një punë me të vërtetë bindëse, edukative me njerëzit, për të formuar tek ata psikologjinë e re për punën në socializëm. U desh shumë kohë që fshatari ynë të bindej që të punonte sipas kërkesave të ekonomisë socialiste dhe të bëhej kështu një kthesë e madhe në jetën e tij. Në sajë të këtyre përpjekjeve ai tani ka fituar dituri, por dihet se dituria nuk ka fund, prandaj duhet mësuar vazhdimisht.

Partia lufton që popullit t'i plotësohen nevojat dhe ai të jetojë gjithnjë e më mirë. Për këtë kërkohet që anëtarët e Partisë, në radhë të parë, të jenë më të paldhurit, më revolucionarët dhe të udhëheqin masën me shembullin e tyre. Ata duhet të vënë interesin e përgjithshëm përpara çdo gjëje, të mos njohin kurrë rehatinë. Komunistit nuk i lejohet të bjerë në qetësi. Komunistët nuk i zë gjumi për çështjen e popullit dhe të Partisë, për punën e kooperativës, të fabrikës, të shkollës. Po ka edhe ndonjë prej tyre që është indiferent, që thotë «ku rafsha mos u vrafsha». Në fakt edhe ky i fundit do të jetë në rregull me organizatën-bazë, që ajo të mos i heqë veshin, por për këtë mendon shumë përciptas. Atij i duket se mjafton të jetë i ndershëm, të mos përvetësojë, të përpiqet ta kryejë mirë atë detyrë që i kanë ngarkuar dhe me kaq kujton se ka bërë një punë të madhe, po kjo nuk është e gjitha. Një komu-



nist si ky nuk e ka bërë si duhet detyrën. Komunisti militant nuk duhet ta kufizojë aktivitetin e tij vetëm në detyrën që i kanë ngarkuar, duke thënë se kaq jam në gjendje ta hedh hapin, por ai duhet t'i kapërcejë detyrat e zakonshme dhe ta hedhë hapin shumë të madh.

Ai komunist që mendon se mjafton të jetë vetë i ndershëm, nuk e ka drejt, nuk është i formuar plotësisht si revolucionar. Ai duhet të bëjë edhe të tjerët të ndershëm, t'u prijë aty ku vështirësitë të jenë më të mëdha e ku kërkohen më shumë sakrifica, ndryshe-përse është anëtar partie? Ai duhet të sakrifikojë vazhdimisht për punën e Partisë. Komunisti edhe kur kthehet i lodhur nga ara, po të marrë vesh se diçka nuk shkon mirë, ai duhet të sakrifikojë nga koha e tij e çlodhjes dhe të shkojë atje ku kanë nevojë për fjalën dhe për punën e tij.

Puna e Partisë nuk do t'ia dijë nëse komunisti është i lodhur ose pa gjumë. Partia, si ushtar që e ka, edhe në mes të natës e thërret po të jetë nevoja dhe e sinjalizon se puna në sektorin ku është ai nuk po ecën, prandaj, qoftë edhe pa shkuar fare për disa ditë në shtëpi, kjo punë, i thotë, duhet të kryhet dhe, pasi ta kesh kryer, atëherë do të çlodhesh. Ndonjëri mund të fillojë nga justifikimet, po me këtë ai vetëm tregon se nuk është një komunist i mirë.

Fryma revolucionare në punë luan një rol vendimtar në përparimin e bujqësisë, ashtu sikundër edhe në çdo sektor tjetër. Kjo frymë karakterizon Partinë dhe komunistët, po në këto situata revolucionare ka qindra e qindra njerëz nga masa që nuk i dallon dot nga anë-

tarët e Partisë. Ky është një sukses i madh i punës së Partisë, që tregon se masat ecin hap pas hapi pas shembullit pararojë të komunistit, por, nga ana tjetër, ky fakt e ngarkon me detyra më të mëdha komunistin, i cili duhet ta luajë kurdoherë rolin pararojë. Në qoftë se komunisti do të shohë se ka të tjerë që ia kalojnë, ai t'ia vërë mirë gishtin kokës dhe të mendojë se nuk po e luan më rolin pararojë që i është besuar. Ai të jetë i qartë se në Parti duhet të bëjnë pjesë ata që e meritojnë, prandaj të mos mendojë se ka zënë vendin dhe nuk e lëviz kush. Jo, komunistit nuk i lejohet të qëndrojë në bisht. Detyra e komunistëve të mirë është ta shkundin fort atë që është i fjetur, ta aktivizojnë sa më shumë, por edhe ky të bëjë përpjekje që të zgjohet. Në qoftë se e shohim që shoku pranë, me gjithë ndihmën që i japim, nuk po ecën përpara, sigurisht ai armik nuk është, por gjersa s'e meriton, le t'ia lërë vendin tjetrit që është më i zoti dhe më i vendosur gjer në fund për Partinë. Komunisti duhet të jetë revolucionar i vërtetë, të punojë pa u lodhur për popullin dhe çdo gjë ta shohë me syrin e interesit të popullit.

Ka edhe ndonjë sekretar organizate-bazë që thotë: «Më duhet të realizoj normën, prandaj s'kam kohë të merrem me punë të tjera». Jo, shoku sekretar, t'i thuhet, këtë mendim nuk e ke të drejtë. Ti edhe normën duhet ta realizosh, bile ta tejkalosh, edhe mendjen, edhe syrin t'i kesh te të gjithë anëtarët e Partisë të organizatës ku je zgjedhur, të dish vetë me hollësi se si shkon puna në skuadrën ku është ky ose ai anëtar partie dhe, në qoftë se atje puna nuk ecën mirë, të shkosh e t'i thuash komunistit në kohën e duhur që ti brenda dy

ditëve duhet të tejkalosh planin, ndryshe herën e dytë, do të ta ngre në organizatën-bazë që nuk po e kryen detyrën. Duke vepruar kështu çdo ditë, sekretari kryen një punë partie. Ka edhe nga ata sekretarë që, kur konstatojnë diçka, thonë se «do ta shohim kur të bëhet mbledhja e organizatës». As ky nuk vepron mirë se, po të lihet çështja gjer në atë kohë, puna dëmtohet.

Që të ketë autoritet sekretari i organizatës-bazë duhet të jetë vetë shembull në çdo drejtim, se pastaj tjetri ka të drejtë t'i thotë «mos më shit mend». Po kur punonjësit ta shohin që ai edhe natën e bën ditë, atëherë ata kanë respekt për të dhe ia dëgjojnë fjalën. Populli e do me gjithë shpirt anëtarin e Partisë kur sheh që ai punon, por kur sheh që një komunist nuk e vret mendjen për punën, kur sheh se ai nuk është i ndershëm, nuk sillet mirë me gruan, atëherë ka të drejtë t'i propozojë organizatës-bazë të Partisë që ta analizojë punën dhe sjelljen e tij si komunist, nëse e meriton ose jo të vazhdojë të jetë i tillë. Partia të gjithë i këshillon ta ngrenë zërin pa frikë për të kritikuar cilindo qoftë, kur shohin tek ai një veprim të gabuar.

Jam duke lexuar disa shkrime të vjetra të kohës të luftës. Midis tyre ka edhe direktiva me shumë interes për organizatat e Partisë. Në një letër Komiteti Qendror u tërhiqte vërejtjen komandantëve dhe komisarëve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, përse nuk punonin që të pranoheshin në Parti njerëzit më të mirë, luftëtarët më të vendosur për çështjen e Partisë dhe të popullit. Kjo letër u bë atëherë sepse kishte sektarizëm në drejtim të pranimeve në Parti. Edhe tani ne duhet të pranojmë në Parti nga ata që janë në ballë të zjarrit

të luftës për ndërtimin e socializmit, nga ata që nuk u tremben vështirësive. Kështu u bë gjatë luftës, kështu, pra, duhet të veprohet edhe sot e kurdoherë, sepse nga e njëjta busull drejtohemi. Të luftojmë që të na vijë në Parti njerëzit më të ndershëm, më të guximshëm e më luftëtarë për çështjen e popullit, elementët më punëtorë. Një njeri që i ka këto cilësi, duhet të vijë në Parti, se për të tillë njerëz ka nevojë ajo. Njerëz pa cilësi si këto që thashë nuk kanë vend në gjirin e Partisë, pse në punë e në luftë duhet të jesh vazhdimisht konsekuent.

Po ka njerëz, bile edhe anëtarë partie, që mbajnë disa dekorata në gjoks, të cilat i kanë merituar, sepse kanë qenë luftëtarë trima për çështjen e çlirimit të atdheut dhe të popullit, por që tani, megjithëse relativisht janë akoma të fortë, nuk u pëlqen të punojnë dhe, po t'u thuash përse nuk punoni, të thonë: «Le të punojnë edhe të tjerët sa kemi punuar ne». Në mënyrë të veçantë anëtarit të Partisë nuk i ka hije të përgjigjet kështu. Të punojnë të tjerët, po të punojë edhe ai, që ata të shohin se komunisti, sado që është i thyer në moshë, po punon. A mund të tërhiqet komunisti nga aktiviteti i tij duke thënë se i mbusha të gjashtëdhjetat? Jo, kjo nuk i lejohet, në asnjë mënyrë. Gjersa të ketë këmbë dhe dorë, tërë jetën ai do të punojë dhe duhet të punojë. Edhe në qoftë se nuk do t'i punojnë më këmbët, edhe atëherë ai duhet të gjejë mundësinë si të ndihmojë, të japë ndonjë këshillë, se mendjen e ka të shëndoshë. Ç'shembull i lartë, ç'frymëzim do të jetë ky për 20-vjeçarët! Pra në asnjë rast komunisti nuk duhet të vërë përpara dekoratat, asnjëherë të mos

i ushqejë vetes ndjenja jo të drejta për luftën dhe për punën që ka bërë për çlirimin e atdheut dhe për ndërtime e socializmit, por të niset kurdoherë nga pozita partie.

Jeta dhe vepra e Partisë sonë e kanë treguar më së miri se ç'njerëz të mrekullueshëm kanë hyrë e militojnë në gjirin e saj. Organizatat-bazë të Partisë kanë punuar dhe kanë kalitur revolucionarë të flaktë për çështjen e popullit e të socializmit dhe kjo është një garanci e madhe për Partinë. Por të kemi kujdes, shokë, për t'i prerë rrugën çdo të keqeje që e dëmton këtë gjendje të shëndoshë, se ka edhe anëtarë partie që kanë punuar për t'u pranuar në Parti njerëz të fafesisit të tyre, kush djalin e hallës apo vajzën e dajës, kush tezen apo kushëririn dhe janë krijuar kështu tarafe brenda disa organizatave-bazë të Partisë. Të dyja palët janë me Partinë, e duan atë, po i kanë sjellë dëm asaj, se më parë kanë shikuar familjen. Mirëpo në Parti, po pe familjen të parën, mbaroi organizata-bazë. Në Parti nuk ka dhe nuk duhet të ekzistojë fryma e fisit, këto pikëpamje janë të huaja për të. Në Parti shihen interesat e popullit, në radhë të parë. Interesat e Partisë nuk kanë të bëjnë me interesat e kushëriillëkut, po të të gjithë shoqërisë. Në organizatën-bazë dhe kudo në Parti çdo komunist duhet të shihet njëlloj, pa dallim, prandaj po bëri gabime kushëririn, këshilloje të sillet mirë, kurse po nuk të dëgjoi, si kushëri që e ke, jepi një dru më të fortë kokës që të mos e përsëritë më.

Të kemi kujdes, gjithashtu, që te komunisti të mos zërë vend mendjemadhësia. Nganjëherë ndonjërit i rritet mendja dhe thotë që i di të gjitha. Askush nuk du-

het të mendojë në asnjë mënyrë kështu, e aq më tepër ata që udhëheqin. Mëndjemadhësia bëhet e rrezikshme, saqë nënvleftëson edhe diturinë e madhe të popullit. Kur nuk e gjykon si duhet vlerën e madhe të mençurisë së popullit, kur arrin ta nënvleftësosh këtë, qofsh i ditur sa të duash, nuk uà del dot mbanë punëve, sepse dituria e një njeriu nuk vlen asnjë grosh përpara asaj të popullit. E vërteta tregon se vetëm populli është ai që ka forcë ta zotërojë situatën dhe jo një, dy apo dhjetë veta. Populli ka zotësi shumë të madhe dhe një forcë kolosale.

Përse themi ne që Partia është e fortë? Sepse vetë populli është i fortë në çdo drejtim.

Në sajë të vijës së drejtë të Partisë që bazohet në forcën dhe në diturinë e gjithë popullit, ne shohim të jenë bërë transformime të mëdha në të gjithë jetën e vendit tonë, të cilat duken kudo haptazi si në fusha e në fabrika, po sidomos te njerëzit, te populli, se janë ata që i bëjnë të gjitha këto vepra. Ritmi i realizimit të tyre varet nga forca mobilizuese e Partisë, nga vija e saj e drejtë dhe nga mbështetja e kësaj vije prej popullit. Ne na gëzon fakti që këta tregues janë në rritje. Direktivat e Partisë në çdo kohë kanë pasur forcë të madhe mobilizuese dhe në bazë të tyre, në sajë të luftës e të përpjekjeve të masave punonjëse për t'i zbatuar ato është zhvilluar e ka përparuar edhe fshati, por në këtë rrugë ka pasur edhe vështirësi, se jo çdo gjë kuptohej menjëherë. Një direktivë që jepte disa vjet më parë Partia nuk zbatohej kudo me të njëjtën shpejtësi. Fshatarëve u nevojitej një kohë relativisht e gjatë derisa ta kuptonin dhe ta zbatonin si duhet direktivën,

kurse tani zbatimi i saj kërkon më pak kohë, prandaj edhe ritmet e realizimeve janë më të larta.

Të marrim Letrën e Hapur të Komitetit Qendror të Partisë që u botua kohët e fundit, e cila ngrii popullin në këmbë. Kjo forcë nuk qëndron vetëm te Letra, sepse si kjo Partia ka shkruar më përpara edhe dokumente të tjera, por gjatë kësaj kohe populli është ngritur më lart ideologjikisht e politikisht dhe vetë Partia, sa vite që kalojnë, ngrihet dhe forcohet gjithnjë e më shumë, fiton përvojë dhe i mendon çështjet më mirë, prandaj kur lëshon një direktivë, populli tani atë e kap më shpejt dhe më mirë. Po nga i nxjerr Partia këto direktiva? Partia, si zemra e popullit që është, studion jetën, rrethanat, nevojat e mundësitë dhe gjykon për direktivat që nxjerr; të cilat forca dhe mendja e popullit janë në gjendje t'i zbatojnë.

Të marrim si shembull luftën kundër burokratizmit, e cila ka një rëndësi jetike për vendin tonë. Disa vjet më parë nuk ishte e lehtë ta transferoje një njeri. Ai të paraqiste njëqind pretendime. Mirëpo gjatë kësaj kohe, menjëherë, sa doli Letra e Hapur, mijëra veta u lëvizën nga qyteti, nga administrata shtetërore dhe shkuan në prodhim, shumica në fshat. Ky kuptim i qartë për direktivën sa vjen e rritet, në sajë të punës së madhe që është bërë nga Partia për vite me radhë kundër burokratizmit, prandaj të gjithë i gjejnë krejtësisht të natyrshme masat që po merren.

Para disa ditësh bëra një vizitë në uzinën moderne për prodhimin e pjesëve të ndërrimit për traktorë. Në këtë uzinë të madhe punojnë plot të rinj e të reja, mi-dis të cilëve edhe disa ish-oficerë. Këta, po t'i dërgoje

përpara në prodhim ose po t'i transferoje nga Tirana, do të thoshin: «Pse më hoqët mua këtej?». Mirëpo tani këtyre u bëri thirrje Partia dhe të gjithë shkuan për të punuar atje me dëshirë dhe janë lidhur ngushtë me punën në uzinë. Kur i pyeta disa prej tyre si shkojnë me punë, m'u përgjigjën se janë jashtëzakonisht të kënaqur dhe më premtuan se, po të jetë nevoja, janë gati të marrin përsëri pushkën.

Tani kemi në dorë planin e shtetit. Edhe ju morët pjesë në hartimin e tij dhe i rritët shifrat që ju dërguam nga lart, sepse e ndieni veten të sigurt që mund të bëhet më shumë, bile jeni të bindur se edhe ato që propozuat, prapë do t'i tejkaloni. Këtë plan, pasi të vij në të gjitha të dhënat nga baza, ne do ta shohim në udhëheqje të Partisë. Udhëheqjes i intereson shumë të dijë ç'mendoni ju për planin, se ju jeni ata që do ta realizoni. Ne importojmë akoma shumë vaj, sheqer, pambuk, oriz etj. me valutë, po tani i bëjmë pyetjen vetes: përse të vazhdojmë të importojmë të tillë artikuj ushqimorë, në sasi kaq të mëdha, kur kemi mundësi të prodhojmë më shumë në vend? Shoku agronom na foli për lulediellin. Më duket që ai mendon drejt për kooperativën bujqësore dhe çdo kooperativist duhet të mendojë si ai, si ta rritë prodhimin. Në qoftë se do të mendojnë të gjithë si shoku agronom që foli këtu, me siguri që do të arrijmë t'i prodhojmë në vend këta artikuj të vlefshëm ushqimorë, mirëpo as pambukun, as panxharin, as orizin, ne nuk i mbjellim dot në kodra, sepse ata duan fusha, pra duhet të zëmë ca parcela nga tokat e fushës. Po kështu shtrohet çështja edhe për lulediellin. Edhe ajo do toka të mira. Fjala është për gjith-



sej 25 mijë hektarë tokë që do të na japin mundësi ta ulim shumë sasinë e importit për këta artikuj. Po ç'janë 25 mijë hektarë si Republikë? Mendoj se nuk janë aq shumë sa të mos mund t'i zëvendësojmë dot me tokat e reja që po hapen.

Ne jemi të bindur që populli do të ketë mendime akoma më të bukura, më të mrekullueshme për bujqësinë. Atij do t'i lihet akoma kohë për të menduar e për të diskutuar përpara se të shkojmë në Kongresin e 5-të të Partisë dhe jemi të sigurt që ndryshime të reja do t'i bëhen planit nga klasa punëtore, nga ju dhe nga gjithë fshatarësia jonë kooperativiste. Planit që kemi hartuar, tani do t'i japim dorën e fundit. Në këtë plan ne do t'i vëmë rëndësi më shumë bujqësisë, do të qethim, si të thuash, nga anët e tjera për të fuqizuar fshatin, bile mund të lëmë pa bërë edhe disa ndërtime ose t'i shtyjmë për më vonë, që t'i japim disa qindra miliona të tjera bujqësisë, në formën e kredive për fshatarësinë. Domethënë në qoftë se ju keni për të hapur 140 hektarë toka të reja këtë pesëvjeçar dhe mendoni se mund të hapni edhe 100 hektarë të tjerë, atëherë për këta të fundit shteti do t'ju japë kredi, me qëllim që të ardhurat e kooperativistëve të mos ulen. Kanalet e mëdha për ujitje do t'i bëjë shteti, po edhe kooperativave do t'u japë kredi që sipërfaqet e ujitshme të shtohen. Kështu do të shkojmë me siguri atje ku thotë Partia: populli do t'i përvishet punës, prodhimet do të shtohen, do të rriten të ardhurat dhe mirëqenia e tij. Planin që kemi bërë për këtë pesëvjeçar ne, pra, do ta rishikojmë në drejtim të shtimit edhe ca të investimeve në dobi të bujqësisë.

Ju e shihni vetë ç'rëndësi të madhe i vënë Partia dhe Qeveria kësaj dege të ekonomisë sonë. Po të përparojë bujqësia, çdo sektor do të na ecë më mirë, edhe industria, edhe ndërtimet e komunikacioni, edhe arsimi e kultura, pse bujqësia na siguron lëndët e para. Sikur të heqim ne nga plani i importit tërësisht bukën dhe të ulim shumë importin e vajit, sheqerit dhe orizit, merreni me mend çfarë force materiale do të disponojnë Partia dhe Qeveria për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë, për zgjerimin e shkollave, të rrugëve etj., sepse tani detyrohemi të përdorim fonde të mëdha për t'i blerë këta artikuj jashtë.

Partia dhe populli janë shumë optimistë që objektivat e caktuar do të arrihen brenda një kohe të shkurtër. Tani po ecet më me vrull përpara, se Partia është më e mësuar, më e rrahur në jetë, më e zonja dhe populli gjithashtu është më i zoti. Përpara fshatari me zor vihej në lëvizje për të renë, kurse nga viti 1960, siç na tha kryetari i kësaj kooperative, domethënë brenda një pesëvjeçari, Shalësi u kthye në një kooperativë të madhe të bashkuar, po bëhet më i bukur e më i begatshëm se përpara. Prandaj ju them haptazi, me gjithë zemër, se jam shumë i kënaqur nga përparimet e kooperativës suaj. Kudo, në çdo kënd të fshatit që të shkosh, do të shohësh fushat të punuara bukur. Kjo është një punë jashtëzakonisht e përparuar që keni bërë në fushat tuaja; me diturinë dhe me djersën tuaj. Keni pasur ose jo agronom, kjo nuk ka shumë rëndësi, po edhe po të kishit, ai është vetëm një njeri, prandaj, sado i mirë që të jetë, nuk mund të bënte dot gjë, në qoftë se populli dhe Partia në kooperativën tuaj nuk

do të kishin bashkuar forcat e tyre. Ja, pra, çfarë bën bashkimi. Ai, siç thotë populli, bën fuqinë.

Prandaj në çdo drejtim, çdo meritë dhe zotësi u përkasin popullit dhe Partisë. Natyrisht, agronomi, veterineri dhe të gjithë specialistët kanë punuar dhe kanë ndihmuar për përparimin e kooperativës, secili ka dhënë kontributin e vet dhe askujt prej tyre nuk ia hanjeri hakun, po e gjithë puna aq e bukur që është bërë te ju i detyrohet, në radhë të parë, popullit dhe Partisë, prandaj ne kemi bindjen se kooperativa juaj do të përparojë dhe do të zbukurohet çdo vit e më mirë.

Partia thotë se çdo gjë mund të bëhet me sukses, po të frymëzohet populli, po të jetë ai me nerva të tendosur, i mobilizuar dhe kurdoherë me një frymë të lartë revolucionare. Qëllimi është që jeta e popullit tonë të bëhet gjithnjë e më e mirë, gjë që varet kryesisht nga ju si kolektiv e si individë, pjesëtarë të kësaj kooperative bujqësore. Shteti u jep ndihma kooperativave, pse ai është yni, i popullit, po ndihma e shtetit është një gjë e vogël përpara punës, mendjes dhe zotësisë suaj. Ja tani erdhi një kohë që kooperativa juaj nuk ka më nevojë për kredi nga ana e shtetit. Ju po ia ktheni shtetit tuaj ndihmat që ju ka dhënë më parë dhe kredinë që kishte shteti për ju, tani mund ta disponojë për t'ia dhënë ndonjë kooperative malore ose me ato fonde ai mund të ndërtojë një fabrikë të re për popullin.

Që të korrin vazhdimisht suksese, duhet që fryma revolucionare të mbahet vazhdimisht gjallë, si në luftë, se ne prapë në luftë jemi, në luftën për ndërtimin e socializmit, e cila është edhe kjo e lavdishme. Në goftë se ne që sot jemi në një moshë më të rritur morëm

pushkën dhe dolëm në mal e u bëmë luftëtarë partizanë në atë kohë të lavdishme, tani një tjetër ushtri e tërë e madhe është ngritur, ushtria e ndërtuesve të socializmit, në radhët e së cilës jeni edhe ju, që nga kooperativisti më i thjeshtë e deri te kryetari i kooperativës e te sekretari i organizatës-bazë të Partisë, që pavarësisht se nuk keni qenë në luftë, jeni po aq trima dhe të aftë, bile shumë më të zotë se partizanët e atëhershëm. Natyrisht, ne ish-partizanëve nuk na hahet haku, por edhe lufta e sotme nuk është më pak e vështirë, bile detyrat atëherë nuk ishin kaq të ndërlikuara sa ç'janë sot. Në kohën e luftës kishim në krah vetëm dyfekun, kurse tani kemi shumë halle mbi kokë, por në sajë të luftës dhe të përpjekjeve brezat më të rinj janë bërë luftëtarë të denjë të epokës së socializmit. Pra, meqenëse jemi në luftë, duhet të jemi kurdoherë në këmbë.

Partia na mëson të punojmë ushtarakisht, në shumë drejtime të marrim shembull nga ushtria. Kur u thotë komandanti i repartit ushtarëve që nesër në orën 5 të mëngjesit do të fillojmë nga puna, të tërë i ke gati në orën e caktuar. Kështu duhet të punojnë edhe te ju brigadat dhe skuadrat, me disiplinë, me ndjenjë përgjegjësie për interesin e kooperativës. Kur t'ju thotë kryetari se «gruri u bë për t'u korrur, shokë dhe shoqe, prandaj të mobilizohemi që brenda dy-tri ditësh ta korrim», të tërë të ngriheni në këmbë dhe fjalën të mos e bëni dysh. Ai të korret medoemos brenda pak ditëve, sepse ju e dini vetë që, po ta lini grurin të thahet në arë, do të bien kokrrat në tokë, do t'i hanë zogjtë dhe kështu për çdo hektar, do të kemi mjaft humbje. Pra, që të mos e lëmë të na vejë dëm

prodhimi, të marrim shembull nga ushtria, nga serioziteti me të cilin e zbaton ajo disiplinën proletare, si në organizimin, në shpejtësinë dhe në cilësinë e punës së saj. Ata vërtet janë ushtarë, po edhe ju jeni ushtarët e bujqësisë dhe disiplina proletare është një për të gjithë.

Përparimet që keni arritur e gëzojnë Partinë, po ju duhet të mos mjaftoheni me kaq, të jeni ambiciozë në kuptimin e mirë të fjalës dhe kurdoherë të përpiqeni të ecni gjithnjë përpara. Ambicia e mirë nuk duhet luftuar, përkundrazi duhet inkurajuar, kurse ambicies së sëmurë mikroborgjeze, që unë të kem më shumë ngatë, i duhen prerë këmbët. Të luftojmë të gjithë që t'i shtojmë të ardhurat kombëtare, që të përmirësojmë jetën e popullit, të bëjmë që Shqipëria të përparojë sa më shpejt, kjo është një ambicie shumë e bukur.

Me këtë dua të them se ne kemi akoma shumë për të bërë, prandaj të mobilizohemi me të gjitha forcat, të jemi kurdoherë të gatshëm të luftojmë vazhdimisht, se kështu arrihet fitorja. Jam i bindur se, po të kem rastin të vij edhe ndonjë herë tjetër, fshatrat e kooperativës suaj bujqësore të bashkuar do t'i gjej edhe më të përparuara se tani, se shoh që këtu keni një organizatë-bazë të fortë, një popull të çeliktë, një unitet të madh luftarak dhe të gjithë jeni të pajisur me ndjenja të pastra.

Po nuk jeni ju të vetmit në rrethin e Elbasanit dhe në vendin tonë që keni arritur rezultate të mira. Ka në Shqipëri edhe kooperativa të tjera, që janë si kjo juaja dhe që po u japin dorën vëllazërore fshatrave më të varfra. Kooperativistët e Devollit, që e kanë të lartë vlerën e ditës së punës, mund të thoshin fare lehtë:

«E po, ç'na duhet neve të ndihmojmë malësinë, për vete rrojmë mirë, kurse po të shkojmë për të ndihmuar malësinë, ne do të rrojmë më keq», po ata nuk menduan kështu. Edhe ju, kur bëtë këtë veprim fisnik, nuk morët parasysh asgjë, megjithëse e dinit se për kohësisht mund t'ju ulej vlera e ditës së punës. Kjo provon atë që thashë se ndjenjat tuaja janë shumë të larta. Megjithatë, megjithëse u dhatë dorën vëllezërve tuaj të fshatrave të tjera, dita e punës për asnjë nga ju nuk u ul, përkundrazi, bashkimi dha mundësinë e u ngritën edhe fshatrat e tjera në nivelin tuaj. Ju, pra, keni bërë kështu një gjë të madhe, i bindët vëllezërit tuaj fqinjë që bashkimi është një hap me leverdi të madhe jo vetëm në fushën ekonomike, po edhe në lëmin politik. Kooperativistët e fshatrave që u bashkuan me ju, e kuptuan konkretisht atë që mëson Partia, ç'do me thënë të mendosh në mënyrë socialiste për shokun dhe ta ndihmosh atë. Kjo ndihmon që të sundojë kudo dhe kurdoherë në vendin tonë ndjenja e interesit të përgjithshëm dhe jo e atij vetjak. Dhe këtë ju e vutë në jetë, se fare mirë mund të thoshit: «Mirë jemi, nuk na prishet puna për të tjerët», po ju nuk menduat kështu. Kjo provon edhe një herë se populli është kurdoherë zemërbardhë dhe se Partia kështu ju ka edukuar vazhdimisht.

Ndihma dhe solidariteti socialist po zhvillohen kudo në kooperativat bujqësore. Kooperativat e fushës së Korçës, për shembull, kanë marrë në patronazh kooperativat malore dhe po i ndihmojnë ato duke u dërguar qe, bagëti, skuadra të tëra formohen dhe shkojnë për të punuar në malësi, ku ka pak krahë pune dhe, si

kryejnë punë, largohen. Kjo veprimtari revolucionare ka shumë rëndësi, sepse tregon që kooperativat tona kanë hyrë në një fazë të re të zhvillimit të tyre. Nga ndihmat në kredi dhe në mjete që kooperativat bujqësore merrnin më parë nga shteti, tani janë ato që kthehen e i japin shtetit, sepse u forcuan dhe jo vetëm kaq, po ato ndihmojnë edhe vëllezërit e tyre të malësive që të ngrihen në nivelin ekonomik e kulturor të tyre. Ja, pra, ç'ndjenja të vërteta vëllazërore marksiste-leniniste, ç'ndjenja fisnike të dashurisë për popullin, për njëri-tjetrin, rriten në rrugën e përbashkët që jemi duke bërë për në socializëm. Këtë e bën te ne vetëm vija e drejtë e Partisë. Kjo i edukoi njerëzit tanë me ndjenja të thella dashurie, uniteti dhe solidariteti për njëri-tjetrin. Këtu është siguria në popull dhe në vijën e drejtë të Partisë. Një gjë të tillë nuk mund ta bëjë kurrë kapitalisti francez, italian, jugosllav e të tjerë. Ata duan si e si të të rrjepin. Partitë ish-komuniste të vendeve të tyre i kanë tradhtuar interesat e popullit, prandaj nuk i do njeri.

Përpara kishit sipërfaqe të kufizuara toke nën kulturë, tani i keni rritur këto disa herë. Po edhe kjo nuk është e mjaftueshme. Ju, gjithashtu, keni rritur rendimentet, po edhe sikur 25 kuintalë grurë për hektar të merrni, prapë mos u kënaqni se nuk janë shumë, rendimentet nuk kanë kufi. Prandaj, porsa të fillojmë të prodhojmë plehra kimike, luftoni dhe i përmirësoni më shumë shërbimet ndaj bimëve, që të merrni shumë më tepër rendimente. Me një fjalë, të jeni ambiciozë në shtimin e prodhimit dhe njëkohësisht me këtë të përmbushni më mirë edhe nevojat e kooperati-

vistëve. Përpiquni t'i përdorni si duhet të ardhurat tuaja, duke pasur kurdoherë parasysh përmirësimin e jetesës së anëtarëve, të ngritjes së nivelit material e kulturor të tyre. Tërë jetën ju keni punuar dhe tani po punoni edhe më mirë, po e fitoni jetën me djersën e ballit, pa shtypje e shfrytëzim dhe të gjitha sa fitoni janë tuajat; ju jeni gjithashtu të zotët e të ardhurave të kooperativës, prandaj mund të bëni çfarë të doni me to, Partia dhe Qeveria vetëm ju orientojnë që çdo gjë e tepërt, çdo luks në shtëpi, nuk është i nevojshëm, sepse kështu ulet shpirti revolucionar i njerëzve, dobësohet ndjenja e dashurisë për të tjerët dhe lidhjet e ngushta të të gjitha krahinave të Shqipërisë në luftën kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm dhe ngjallet ndjenja e të menduarit vetëm për vete. Njeriu nuk rron për të ngrënë, po ai ka nevojë të hajë për të jetuar.

Kështu, me të ardhurat që do t'ju mbeten, mbasi të keni plotësuar nevojat, të punoni për ta zhvilluar më tej ekonominë kooperativiste.

Punonjësit e qytetit duhet të përpiqen më shumë që ta shikojnë një çikë më me kujdes fshatin. Shokë të tillë, si Rakip Lami, që ju erdhën kohët e fundit nga qyteti, Partia i ka rritur e i ka edukuar me kujdes, prandaj ata nuk i tremben punës, përkundrazi janë të parët në çdo detyrë, po shembulli i tyre duhet të frymëzojë edhe të tjerët. Këtu nuk është fjala për të shkuar të gjithë në fshat, por për të menduar drejt për fshatin edhe ata që do të punojnë e do të jetojnë në qytet, që të zvogëlohet sa më shumë ndryshimi midis fshatit dhe qytetit. Partia punon që gërsërët fshat-qytet të



ngushtohen. Natyrisht kjo nuk bëhet dot me një ditë. Për këtë arsye u futën gërshërët në pagat e larta, se ishin më të mëdha nga sa duhet, për këtë arsye u vendos të kryhet puna prodhuese nga punonjësit e punës mendore dhe Partia shumë prej këtyre po i dërgon ta bëjnë këtë punë në fshat<sup>1</sup>. Kjo direktivë do të zbatohet me rreptësi.

Në gjithë këtë punë të madhe për transformimin socialist të fshatit ne nuk duhet të harrojmë mësimin, i cili duhet të shkojë krahas punës. Fshatari ynë ka një të metë, ai kënaqet me pak dhe këtë t'ia luftojmë, por ka edhe një anë shumë pozitive, është shumë i thjeshtë, nuk është si disa intelektualë që mendojnë se i dinë të gjitha. Fshatari ynë nuk thotë asnjëherë që di shumë. Këtë cilësi të mirë ta përdorim në punën tonë për të rritur tek ai dëshirën për të mësuar.

Ne duhet të përpiqemi që njerëzit të bëhen të ndërjegjshëm, ta ndiejnë se tërë jetën njeriut i duhet mësimi, i cili nuk ka asnjë vlerë në qoftë se nuk futet në shërbim të popullit. Njohuritë që merr secili duke mësuar mund të jenë të gjera, mesatare ose të ulëta, por kurdoherë njeriu duhet të mësojë me synim që t'i shërbejë një qëllimi të lartë, interesave të popullit dhe të atdheut. Prandaj popullit ne duhet t'ia bëjmë jetën të lumtur dhe lumturia arrihet vetëm me punë e me di-

---

<sup>1</sup> Për këtë çështje shoku Enver Hoxha diskutoi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH më 4 qershor 1966. Duke u nisur nga përvoja e punës prodhuese në rrethin e Elbasanit, ai bëri disa përgjithësime dhe dha orientime se si të zgjerohet e të thellohet më tej puna prodhuese e punonjësve të administratës.

turi dhe dituritë zhvillohen me punë e mësim. Duhet të punosh, se vetëm kështu zhvillohet mendja e njeriut. Ibrahim Biçaku<sup>1</sup> nuk punonte kurrë, prandaj ishte si kali i arabasë. Pra të mësojmë dhe vazhdimisht të mësojmë të gjithë në shkolla, në kurse dhe nga praktika.

Edhe shfaqjet e ndryshme që përgatitin djemtë dhe vajzat e reja në shtëpinë e kulturës që keni ngritur, shërbejnë për dëfrimin dhe njëkohësisht për mësimin tuaj, se në to ka pjesë që inkurajojnë për të punuar më mirë, ka kritika për ata që punojnë pak, që punojnë keq ose që gënjejnë, ka edhe pjesë që u sjellin të gjithëve një kënaqësi të madhe shpirtërore.

Ju keni tri shkolla në kooperativën tuaj të bashkuar, pra keni shumë mësues, të cilët duhet ta marrin mirë në dorë shtëpinë e kulturës dhe të organizojnë shfaqje artistike të përgatitura mirë që t'ju kënaqin e njëkohësisht t'ju mësojnë diçka të re ju kooperativistëve. Por që ta bëjnë mirë këtë punë, mësuesit duhet të kenë lidhje të ngushta jo vetëm me nxënësit, po edhe me familjet e nxënësve, me ju kooperativistët, me punën tuaj në fushë, me të gjithë njerëzit një e nga një. Mësuesi i regjimit socialist nuk duhet të jetë njëri qibar dhe të mendojë ngushtë se detyra e tij na qenka vetëm në shkollë, sa për të mësuar nxënësit në bazë të programeve dhe, pasi ta këtë bërë këtë punë, të

---

<sup>1</sup> Ish-çifligar i fushave të Shalësit, Belshit e Cërrikut, kriminel i lufte, kryetar i «komitetit ekzekutiv provizor» të krijuar nga gjermanët pas kapitullimit të Italisë fashiste. Ka qenë kryeministër i qeverisë së parë kuislinge të krijuar nga pushtuesit nazistë gjermanë.

kthehet i kënaqur se e ka kryer detyrën e të rrijë «rehat» në shtëpi.

Roli i mësuesit është shumë më i madh, ai nuk kufizohet vetëm në shkollë, po shtrihet edhe jashtë saj, ku puna e tij është po aq e rëndësishme sa edhe brenda në shkollë. Kur mësuesit janë të devotshëm për profesionin e vet, janë të lidhur me jetën e popullit, do të njohin thellë edhe zakonet, traditat dhe nevojat e fshatarëve dhe, duke u bazuar në këtë njohje, do të kenë mundësi të shkruajnë vjersha e këngë që t'i këndojë rinia. Në këtë mënyrë, me siguri, do të arrihet një përparim i shpejtë në fshat. Mësuesi i mirë duhet të shkruajë për jetën dhe për përpjekjet e fshatarëve, të cilët po luftojnë në fushë si luanë që të shtojnë prodhimin. Të tilla vjersha duhet të mësojnë kalamajtë dhe t'i recitojnë. Kjo është zbatimje, njëkohësisht edhe mësim për të gjithë, se do të nxiten të bëhen si ata. Mësuesi mund të shkruajë për të kritikuar ata kooperativistë që bëjnë gabime të mëdha, ose ata prindër që fejojnë vajzat sipas zakoneve prapanike. Në vjershat e tij mësuesi revolucionar njerëz të tillë t'i godasë si me kamxhik që të turpërohen përpara kolektivit dhe me një forcë të atillë që asnjë të mos guxojë më pas të bjerë në gabime. Kur vjen koha e korrjeve, mësuesi mund të përgatitë vjersha, këngë e valle për korrjet, për bukën e re, për punën e palodhur të kooperativistëve, për djersën që derdhin ata në luftë për prodhimin. Më vonë, kur vjen koha e vjeljes së patateve ose e vreshtave, të shkruajë edhe për këto. Për çdo aksion në fshat duhet të ketë nga një aktivitet të bukur.

Po kështu mund të veprohet edhe për çështjet

shoqërore. Sa me interes do të jetë sikur shokët që merrren me shtëpinë e kulturës të mendojnë me seriozitet se si t'i propagandojnë normat e reja dhe si t'i fshikullojnë zakonet prapanike që rëndojnë sidomos mbi jetën e grave dhe të vajzave. Të rejat do të mendojnë me optimizëm për jetën dhe do të marrin krahë për të luftuar edhe ato vetë për të drejtat e tyre, kur të shohin se opinioni i shëndoshë në fshat e dënon rëndë zakonet poshtërues të fejesave në moshë të mitur e me para, që e konsideron vajzën si një plaçkë. Ai që e bën një gjë të tillë, nuk ka kuptim të drejtë për gruan. Njeriu është krijesa më e çmuar, prandaj është e palejueshme që të shitet. Pleqët duhet ta kuptojnë këtë. Medoemos duhet të përpiqemi që ndershmëria e njerëzve tanë të jetë e përsosur, të mos ndodhin gjëra të papëlqyera, po fejesat dhe martesat të sjellin gëzime në jetën e familjes së re. Ndaj atyre që i shkelin këto norma të mos jemi dorëlëshuar, por t'i kritikojmë, të mos lejojmë të vazhdojnë më disa fenomene negative të trashëguara nga e kaluara e hidhur.

Gruaja punon shumë kudo, në arë dhe në shtëpi. Partia po bën një punë të madhe për t'u kuptuar qartë nga të gjithë se të drejtat e saj janë të barabarta me ato të burrit, përparime ka, por na duhet edhe shumë e shumë punë për të bërë. Punët e shtëpisë, drutë, ujën, gjellën, marrjen dhe përgatitjen e ushqimeve, qepjen e rrobave dhe larjen e tyre, të gjitha këto gjer tani i bën gruaja. Po përse mos të venë burrat të presin drutë, të marrin ujë në çezmë e të blejnë bukë në furrë? Duhet të mos i lihen të gjitha punët gruas, duhen nda-

rë mirë dhe drejt detyrat midis burrit e gruas në çdo familje.

Rëndësi të madhe për lehtësimin e gruas kanë edhe çerdhet e kopshtet, ngritja e të cilave i jep asaj mundësi të dalë në punë dhe të sjellë më shumë të ardhura në familje.

Ja, për këto e për shumë probleme të tjera po të organizohen aktivitete të mira, atëherë të gjithë fshatarët do të vijnë me qejf të madh në shtëpinë e kulturës. Mirëpo, kur vijnë aty, ndonjëri ose disa do të shkojnë edhe nga biblioteka për të parë çfarë librash e gazetash ka dhe do të marrin ndonjë prej tyre për ta lexuar.

Shokët e Komitetit të Partisë të Rrethit duhet të vijnë më shumë këtu te ju që t'ju ndihmojnë, t'ju mësojnë, po edhe ata vetë kanë nevojë gjithashtu të mësojnë prej jush. Në qoftë se e shikoni që ata nuk po ju vijnë, u thoni se po duket që ka filluar t'i prekë burokratizmi, prandaj të kenë mendjen, të mos sëmuren nga kjo sëmundje e rrezikshme, të mos lejohet që kjo t'u kapë trupin dhe zemrën.

Punët nuk na shkojnë keq. Në përgjithësi, sivjet do të kemi një vit të mbarë bujqësor në çdo drejtim. Grunjërat i kemi të mira. Misri po mbillet gjithashtu në kushte të favorshme. Të mos harrojmë që në të gjitha tokat nën ujë të shfrytëzohen kanalet ujitëse, të cilat duhet të jenë të gjitha në gatishmëri. Kësaj çështjeje i duhet vënë rëndësi, pse po të shfrytëzohen si duhet, nuk ka përse të mos jenë të mbara prodhimet bujqësore.

Edhe në sektorin e industrisë po punohet mirë dhe

janë të gjitha mundësitë që planet të realizohen. Gjendja e brendshme politike dhe ekonomike e vendit tonë është e fortë. Edhe më shumë do të forcohet ajo nga ky vit i mbarë bujqësor që po duket.

Gjithë populli në vendin tonë, i entuziazmuar, është hedhur si asnjëherë tjetër në punë. Kjo vjen se Partia i ka edukuar politikisht masat. Politika e Partisë është e drejtë, gjë që e ka vërtetuar e gjithë veprimtaria e saj, qysh nga krijimi. Po të mos ishte e drejtë, nuk do të mund të ishin arritur sukseset e gjertanishme. Gjendja jonë, pra, është shumë e mirë.

Kurse imperialistët amerikanë dhe tradhtarët revizionistë sovjetikë, jugosllavë, polakë, me një fjalë, të gjithë revizionistët modernë janë në hall, në krizë të madhe dhe shkojnë drejt dobësimit të vazhdueshëm, sepse politika dhe qëllimet e tyre janë antipopullore. Ata duan të zhduket socializmi, të mposhtet ideologjia jonë fitimtare, marksizëm-leninizmi, duan që populli ynë dhe të gjithë popujt e botës të mos jenë në fuqi, të mos jenë të lirë dhe të mos vetëvendosin, po të jenë nën zgjedhën e tyre, t'u shërbejnë kapitalistëve. Edhe revizionistët modernë janë si kapitalistët. Ata po punojnë që të restaurojnë kapitalizmin në vendet ku kishte fituar revolucioni socialist. Atje po bëhet gradualisht procesi i shndërrimit të socializmit në kapitalizëm, gjë që do të thotë se popujve po u rrëmbehen fitoret nga duart, djersa e popullit po kthehet gradualisht në interesin e disa njerëzve, të cilët përpara hiqeshin si komunistë, po tani mendojnë e veprojnë si kapitalistë.

Një gjë e tillë ka rrezik të ndodhë në çdo vend socialist, në qoftë se Partia nuk bën një luftë të ashpër

kundër burokratizmit, kundër atyre që mendojnë vetëm të fitojnë për veten e tyre dhe as që shqetësohen për çështjen e popullit. Në qoftë se Partia nuk bën një luftë të ashpër në të gjitha drejtimet, dalngadalë e njëri pas tjetrit drejtuesve do t'u rritet mendja, do të bëhen fodullë dhe do t'ia hipin popullit në zverk. Po të mendojë njeriu vetëm për vete, për egon e vet, atëherë vaj halli për popullin. Kjo është një mbeturinë e dëmshme që duhet luftuar me çdo mënyrë. Partia duhet t'ia hapë sytë popullit që ai të flasë pa drojtje. Në qoftë se dikujt ka filluar t'i rritet mendja dhe të bëjë padrejtësi, askush të mos mbyllë gojën, të mos ketë frikë për ta kritikuar se, po të kesh frikë, i bën dëm vetes, popullit dhe Partisë. Po ta lësh sëmundjen pa kurrar, ajo të kap gjithë organizmin dhe pastaj të fut në gropë.

Prandaj ka rëndësi të madhe që ne të punojmë për të mos lejuar të ngjasë kurrë në vendin tonë si në Bashkimin Sovjetik. Partia dhe populli duhet të bëjnë një luftë klasash të pandërprerë, të cilën të mos e shuajmë kurrë kundër armiqve të klasës dhe të gjitha mbeturinave të tyre në vendin tonë. Këta nuk i kanë më dyqanet, tokat dhe pasuritë e tjera që kishin më parë, se i ka shpronësuar pushteti popullor, por brenda në shpirtin e tyre kujtojnë me mallëngjim pasurinë dhe pozitën sunduese që u ikën nga duart, prandaj ata punojnë, ku më shumë e ku më pak, që të mund të çoroditin mendjen e njerëzve tanë dhe të sjellin në fuqi njerëzit e tyre. Në qoftë se ndokush nuk e kupton mirë rëndësinë e kësaj lufte klasore, atëherë ai nuk do të jetë në gjendje t'i mbrojë interesat e socializmit e të

revolucionit. Një njeriu të tillë, po të jetë në vende drejtuese, duhet t'i thuhet të largohet nga ajo punë që i është ngarkuar dhe në vendin e tij të vihet ai që mendon e punon mirë. Edhe kjo është një formë e luftës së klasës që duhet të bëhet e vazhdueshme.

Në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera ish-socialiste ku sundojnë revizionistët, krimbi që ka hyrë është si një gjarpër që ka zënë popullin për gryke dhe e ka vënë përkohësisht poshtë. A do të arrijë vallë ta mbytë? Jo! Populli nuk mbytet kurrë. Ai nuk mund të durojë për një kohë të gjatë në kurrizin e vet shtypjen dhe robërinë. Populli, në mos sot, nesër, do të fitojë me luftë. Këtë na e tregon historia e popujve, ky është ligj, i cili vepron aq më tepër sot që rrojmë në një kohë kur imperializmit dhe revizionizmit u bëhet një luftë më e organizuar dhe medoemos do të zhduken nga popujt. Socializmi do të triumfojë. E ardhmja është e popujve.

Kohët që po kalojmë janë të rëndësishme. Imperializmi dhe revizionizmi modern nuk janë më në ngjijtje, por po shkojnë drejt varrit, pavarësisht se hëpërhë janë më të fortë ekonomikisht dhe kanë në dorë teknikë të përparuar, armatime moderne etj. Natyrisht, edhe këto kanë vlerën e tyre, po nuk kanë dhe nuk mund të kenë vlerën dhe forcën e popujve dhe të marksizëm-leninizmit.

Le të marrim Shtetet e Bashkuara të Amerikës që janë një vend i madh e i pasur imperialist, i pajisur me armë moderne, koka e kapitalizmit botëror. Luftës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk mund t'i shpëtohet, sepse kapitalistët nuk i lëshojnë lehtë pasuritë e



tyre, nuk mund të jetojnë pa luftë, prandaj imperializmi amerikan hap ku të mundë vatra të reja zjarri, si në Laos, në Kamboxhia, në Kongo, në Vietnam e gjetkë, por në vend të fitoreve, po korrin disfata, se popujt janë të pamposhtur. Sidomos në Vietnam imperialistët amerikanë po pësojnë disfatë të plotë. Kjo do të thotë që, një vend i vogël është duke fituar kundër fuqisë më të madhe kapitaliste. Imperialistët amerikanë nuk kanë ndjenja njerëzore. Ata bombardojnë ku mundin, e megjithatë barbarizmat e tyre nuk u sjellin asnjë rezultat. Jo vetëm kaq, por në Vietnamin e Jugut miqtë e amerikanëve, ballistët vietnamezojugorë, janë të përçarë. Kështu, ndërsa imperialistët amerikanë po luftojnë kundër partizanëve vietnamezë, qeveritarët kukulla po luftojnë kundër njëri-tjetrit, saqë është bërë një çorbë derri dhe gjithë këtë konfuzion në radhët e armiqve të popullit vietnamez e ka sjellë lufta partizane. Kjo luftë në Vietnam ua ka bërë jetën amerikanëve dhe Kao Kisë, priftërinjve budistë e tërë reaksionarëve si xhehenem.

Partizanët vietnamezë kanë çliruar pjesën më të madhe të Vietnamit të Jugut. Amerikanët tani po kërkojnë medoemos paqen në Vietnam, që të shpëtojnë nga turpi. Është me të vërtetë turp i madh ajo që ngjet me ta në Vietnam, por nuk kanë si të shpëtojnë. Për këtë arsye ata kanë thirrur në ndihmë revizionistët sovjetikë, të cilët po bëjnë çmos t'i shpëtojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga katastrofa ku po rrokullisen, prandaj nxitin vietnamezët të futen në bisedime. Po populli vietnamez nuk dëshiron të shkelë mbi gjakun e partizanëve të rënë. Ai do ta vazhdojë luftën gjer

në fund, gjersa imperialistët amerikanë të kthehen të mundur në vendin e tyre. Dhe për këtë nuk ka dyshim se do të vijë dita që amerikanët do të largohen nga Vietnami të thyer me turp.

Lufta në Vietnam po e dobëson nga të gjitha drejtimet prestigjin e imperializmit amerikan në botë. Ai, për këtë arsye, dita-ditës po prishet edhe me aleatët e vet kapitalistë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë në grindje, në radhë të parë, me Francën, e cila nuk dëshiron të jetë më nën kontrollin dhe sundimin e tyre; po edhe miqtë e tjerë të imperialistëve amerikanë përpiqen të largohen, megjithëse amerikanët përpiqen t'i mbajnë sa më afër, gjë që është e pamundur dhe në dëm të madh të tyre, pse u jep zemër popujve të marrin forcë dhe t'i godasin nga të katër anët armiqtë amerikanë, revizionistët sovjetikë, jugosllavë e të tjerë.

Revizionistët hrushovianë menduan se do ta kthenin lëvizjen komuniste botërore në drejtimin që dëshironin, po nuk ua arritën dot qëllimeve. Partia jonë u qëndroi si duhet revizionistëve sovjetikë, jugosllavë, polakë, bullgarë e të tjerë dhe me luftën që bëri tregoi se cila është rruga e drejtë, rruga e fitores. Kjo ka rëndësi të madhe, sepse sot në të gjitha kontinentet janë krijuar e po krijohen parti dhe grupe të reja marksiste-leniniste.

Ne kemi besim se, edhe në Bashkimin Sovjetik e në vendet e tjera ku janë në fuqi revizionistët, forcat e vërteta marksiste-leniniste do të luftojnë kundër revizionizmit modern. Revizionistët do të marrin masa të rrepta kundër tyre, po idetë e marksizëm-leninizmit nuk

shtypen, përkundrazi, sa më shumë masa të merren, aq më shumë njerëzit ngrihen në luftë. Dhe kjo do të ndodhë kudo.

Tani revizionistët sovjetikë po përpiqen me çdo mjet të lidhen me imperialistët amerikanë dhe, së bashku me ta, të godasin Shqipërinë, se Shqipëria po ua prish atyre planet djallëzore, po nuk do t'ua arrijnë dot qëllimeve të tyre të poshtra, sepse vija e Partisë sonë është e drejtë. Marksizëm-leninizmi nuk mposhtet. Forcat tona janë vazhdimisht në ngjitje, ndërsa armiqtë e popujve dhe të socializmit, imperialistët dhe revizionistët modernë, po dobësohen çdo vit e më shumë. Ne do të asistojmë në të ardhmen në disfata të tjera të imperializmit dhe të revizionizmit modern.

Partisë sonë i bie detyrë e madhe që rrugën e nisur ta vazhdojë me guxim, se është plotësisht e drejtë, pse pikërisht kjo na ka çuar vazhdimisht në fitore. Ishte kjo rrugë që i solli lirinë popullit shqiptar dhe e çoi në ndërtimin me sukses të socializmit, është po kjo rrugë që tani na siguron dhe na mbron nga armiqtë, të cilët ne do t'i dërrmojmë sa herë që të orvaten të na dëmtojnë.

Kur u krijua Partia jonë, armiqtë pushtues ishin të armatosur gjer në dhëmbë, po ajo na mësoi t'i sulmojmë dhe t'i dëmtojmë. Përse ngriheni, na thoshin reaksionarët, nuk mund të luftohet me shtete të mëdha e të fuqishme, si Italia e Gjermania hitleriane, po ne u përgjigjeshim atyre se luftojmë, sepse ata na kanë pushtuar atdheun dhe lufta jonë, duke qenë e drejtë, na jep forca që armiqtë t'i mundim. Edhe ata në të vërtetë na e ki-

shin shumë frikën, sado që ishim shumë të paktë në fillim. Merret me mend sa shumë na e kanë frikën tani.

Ne jemi të fortë, se e gjithë vija e Partisë sonë për ndërtimin e socializmit është e drejtë. Idetë marksiste-leniniste po zbatohen drejt në praktikë, prandaj ekonomia që ndërtojmë, industria, bujqësia etj. po ecin përpara. Kjo bën që Shqipëria të jetë shembull dhe ndihmë për vendet e tjera, pse vetëm të flasësh dhe të mos japësh shembull konkret, mund të besojnë disa, po jo të gjithë. Vetëm kur të të shohin si ecën në punë, si prodhon dhe për kë, si rron dhe si mëson, të tjerët do të gjykojnë se kjo është rruga e drejtë dhe do të të ndjekin. Populli ynë ka një fjalë të urtë që thotë: Fshati që duket s'do kallauz.

Dje lexova një artikull të një gazetari amerikan, i cili bënte pyetjen: Çfarë regjimi ekziston në Jugosllavi, kapitalist apo socialist? Përse ta fshehim, përgjigjet ai vetë, atje ekziston dhe zhvillohet kapitalizmi, atje nuk mendon njeri për socializëm, sepse çdo njeri lufton të pasurohet, atje 200 mijë njerëz nuk kanë punë dhe janë të detyruar të mërgojnë jashtë vendit. Në rrugë, vazhdon ai, ka lypës, kurse nga ana tjetër mund të shikosh edhe një berber që vete në punë me veturë luksoze. Është e qartë, përfundon ai, në Jugosllavi mbretërojnë interesat private mbi ato të të gjithë shoqërisë.

Gazetari amerikan thotë se në Jugosllavi mund të shikosh shoferë privatë taksish. Pyeta një, vazhdon ai, nëse fitojnë me këtë zanat dhe ai u përgjigj se fiton gjer në 1200 dollarë në vit. Taksi ka edhe shteti atje, po taksitë e shtetit kanë falimentuar. Te ju po ndër-

tohet socializmi, i thotë gazetari amerikan shoferit jugosllav, po ky i përgjigjet, më në fund, se këto janë vetëm gjepura.

Bujqësia në Jugosllavi nuk është e kolektivizuar, ajo gjendet gjithashtu në duart e privatëve, të cilët blejnë edhe traktorë ngaqë kanë sipërfaqe të mëdha tokash dhe nxjerrin të ardhura të mëdha. Po ku i gjejnë të tilla sipërfaqe tokash këta njerëz? Ua kanë marrë fshatarëve, sidomos të varfërve; duke u marrë të gjitha mjetet e prodhimit dhe fshatarët janë detyruar kështu t'i shesin tokat. Pra ky proces që po zhvillohet në Jugosllavi, nuk është socializëm, po kapitalizëm.

Çështjen e kisha që lufta jonë për ndërtimin e socializmit, për zhvillimin dhe forcimin e bujqësisë së kolektivizuar, të industrisë, të minierave, të kulturës sonë socialiste është një detyrë e madhe kombëtare dhe ndërkombëtare që ne po e kryejmë me sukses. E vërteta është se ne jemi duke përparuar në këtë rrugë dhe jeta e popullit jo vetëm po bëhet gjithnjë më e lumtur dhe më e gëzuar, po kjo punë është inkurajuese, është shembull edhe për popujt e tjerë. Kur hapim toka të reja për shtimin e prodhimit dhe të mirëqenies sonë, mendojmë dhe punojmë njëkohësisht për vete dhe për të tjerët. Vend i vogël jemi ne, Partia dhe Qeveria jonë janë të një populli të vogël, po detyrat i kemi të mëdha, pse na duhet të ndihmojmë edhe popujt e tjerë që luftojnë. Në këtë drejtim nuk mungojmë të japim kontributin tonë, duke hequr edhe kafshatën e gojës për t'u dhënë ndihmë, për shembull, vëllezërve vietnamezë, dhe këtë as që e zëmë në gojë, se ndihma jonë është e sinqertë, është vëllazërore. Kurse revizionistët sovje-

tikë dërgojnë atje vetëm disa ndihma qesharake, disa armë të vjetruara dhe këtë e reklamojnë me bujë, sikur kanë bërë kushedi çfarë. Po nuk janë vetëm vietnamezët që ndihmojmë. Ne ndihmojmë gjithashtu në proporcion me mundësitë që kemi edhe popuj të tjerë që luftojnë për lirinë, pavarësinë dhe të drejtat e tyre. «Mik i mirë, thotë populli ynë, është ai që të ndihmon në kohë rreziku». Vietnamezët, në bazë të llogarive që bëjnë, thonë se proporcionalisht me popullsinë, ata që na ndihmojnë më shumë janë shqiptarët.

Ne, pra, shokë, punojmë për vete, mendojmë edhe për miqtë e vëllezërit tanë të vendeve të tjera, prandaj të mobilizohemi për të kryer me sukses detyrat që kemi përpara për të mirën e atdheut e të popullit tonë, si dhe për të ndihmuar edhe miqtë e shokët.

Ne po jetojmë në kohëra revolucionare, shokë. Ta mbajmë kurdoherë lart e më lart shpirtin tonë të pa-pur revolucionar. Partinë ta duam dhe ta mbrojmë nga çdo rrezik, se ajo është zemra e popullit. Por, për ta mbrojtur Partinë, kërkohet zbatimi i disa ligjeve që populli ynë i njeh mirë. Fshatari dhe punëtori ynë, të rinjtë dhe të rejat, pleqtë dhe plakat, të gjithë njerëzit tanë, të gjithë së bashku, në bazë të këtyre ligjeve të mbrojmë Partinë, vijën e saj të drejtë. Këtë detyrë të madhe ta kuptojmë në frymë revolucionare, të luftojmë pa mëshirë të gjithë ata që, qofshin brenda në Parti ose jashtë saj, kërkojnë ta shtrembërojnë këtë vijë. Ne duhet ta mbrojmë Partinë dhe vijën e saj nga këta njerëz që me dashje ose pa dashje i cenojnë ato, sepse me këtë Parti dhe me vijën e saj të drejtë po ndërtohet socializmi te ne.

Ju uroj, shokë, suksese në çdo drejtim, dalshi faqebardhë në realizimin e planeve!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## TE MENDOJMË E TË VEPROJMË KURDOHERË SI REVOLUCIONARË

*Nga biseda me kuadrot drejtues të Partisë, të pushtetit,  
të organizatave të masave dhe të ushtrisë  
në rrethin e Librazhdit*

2 qershor 1966

*Në fillim, sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Librazhdit e informoi shokun Enver Hoxha për punën e Partisë në këtë rreth dhe për rezultatet që janë arritur. Pastaj, shoku Enver Hoxha bëri disa pyetje:*

Si i kuptojnë politikisht problemet organizatat-bazë të Partisë? Ku i keni më të dobëta organizatat-bazë dhe ç'dobësi paraqiten atje? Si është uniteti i mendimit dhe i veprimit në ato organizata? Ju vjen në rregull dhe në kohë shtypi? Si shkon organizata e rinisë e rrethit? E furnizoni rregullisht fshatarësinë me drithëra buke? Sa toka të reja keni pasur në plan për të hapur, sa keni hapur dhe sa mendoni të hapni gjatë gjithë pesëvjeçarit të 4-t? Po patate sa hektarë keni mbjellë? Si po shtohet numri i qeve të punës te ju dhe çfarë keni menduar për ta zgjidhur këtë problem? Ç'punë bëni ju që të mos theren viçat në fshat?



Ç'mëndime keni për çmimin e mishit që grumbullon shteti? Po sikur ta heqim fare detyrimin e mishit dhe të leshit, e realizojmë dot me tepricat planin e shtetit? A kanë ardhur shokët e aparatit të Kryeministrisë për t'u këshilluar me ju për këto probleme?

*Pasi dëgjoji përgjigjet e këtyre pyetjeve, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Është fakt se ekonomia e Librazhdit, në krahasim me krahinat e tjera të vendit, është më pak e zhvilluar, por duket që në kushtet ekzistuese ka mjaft mundësi për një përparim më të shpejtë. Prandaj për këtë Partia në rreth duhet të mobilizohet më tepër, të ngrejë gjithë popullin në punë dhe në luftë për të zhvilluar më tej ekonominë, për të ngritur nivelin e jetesës së masave punonjëse. Të mos bëhen punët sa për të shkuar radhën, por secili të mendojë e të veprojë më shumë për perspektivën, që puna të jetë më e studiuar. Natyrisht në këtë drejtim ne kemi planin pesëvjeçar, që është hartuar dhe do ta diskutojmë tani së afërmi në mbledhjen e Byrosë Politike. Pas diskutimit të hollësishëm që do të bëhet atje, planin do ta dërgojmë për t'u parë edhe në bazë, me qëllim që ajo të japë mendime se ku ka mundësi të bëhen shtesa dhe ndryshime që do të ndihmojnë për fuqizimin e mëtejshëm të sektorëve të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve. Komiteti Qendror i Partisë do të lëshojë direktivat e tij, të cilat, do të diskutohen këtu në bazë, përpara se të vendoset plani definitivisht. Ky diskutim duhet të organizohet mirë nën drejtimin e Partisë, në mënyrë që të gjithë punonjësit e vendit, qofshin këta në kooperativa bujqësore apo në ndërma-

rrje, të mos nisen nga mendimi që «këtë plan e kanë diskutuar dhe e kanë vendosur lart, nuk kemi ç'të bëjmë më shumë», por të marrin pjesë aktive dhe të shfaqin mendimet e tyre. Pra, diskutimi i direktivave të Komitetit Qendror të Partisë lidhur me planin e katërt pesëvjeçar që do t'i paraqitet Kongresit të 5-të të Partisë, të mos bëhet në mënyrë formale, po të mbahet me të vërtetë lart fryma revolucionare dhe ai të shërbejë për të shtuar më tej perspektivat e zhvillimit të ekonomisë, sepse në këtë drejtim ka rezerva të mëdha të dukshme, pa folur për rezervat e dyta që do të krijohen pas realizimit të këtij plani, të cilat, sidomos në bujqësi, ekzistojnë me shumicë dhe që akoma nuk janë planifikuar.

Gjersa të përfundojë diskutimi i direktivave të pesëvjeçarit, ne do të kemi në dorë edhe rezultatet e prodhimeve bujqësore të këtij viti, pse gjer atëherë do të jetë korrur gruri, do të jenë vjelur perimet dhe patatet, të cilat parashikojmë t'i kemi shumë të mbara. Edhe kulturat pranverore paraqiten mirë. Një gjendje e tillë do të entuziazmojë shumë fshatarësinë dhe do të shtojë besimin në mendjen dhe në forcat e veta, do të forcojë një besim akoma më të madh në vijën e Partisë, do të rritë guximin e njerëzve. Edhe ju jeni optimistë se do t'i tejkaloni planet e prodhimeve bujqësore të këtij viti dhe kështu jeta e popullit do të bëhet edhe më e mirë. Në këto kushte fshatarësia kooperativiste do të marrë zotime të tjera shumë më të mëdha për të plotësuar direktivat e planit të ri pesëvjeçar që do të aprovojë Kongresi i 5-të i Partisë.

Çështjen e kisha që disa mungesa e dobësi të buj-

qësisë këtu në rrethin e Librazhdit të mbahen mirë parasysh. Megjithëse ju keni bërë studime dhe mbi bazën e tyre keni përcaktuar masat për përmirësimin e gjendjes, mendoj sikur këto të jenë ca më të thelluar, më të shtrënguara, të shihen me syrin revolucionar, që të mobilizojnë masat dhe të arrihet që përpara vitit 1970, në rrethin tuaj të jenë zgjidhur një sërë problemesh në mënyrë shkencore.

Të marrim çështjen e qeve të punës që është një problem shumë i rëndësishëm. Pavarësisht se do të bisedoj me shokët në qendër për të forcuar SMT-në tuaj, dua të theksoj se problemi i qeve, në mënyrë të veçantë për ju, është i rëndësishëm, sepse jeni një rreth malor dhe, megjithëse edhe këtu mund të punohen mjaft toka me traktor, prapë këto do të jenë të kufizuara në krahasim me gjendjen. Prandaj çështja e shtimit të qeve, me gjithë vendimin që keni marrë, duhet rishikuar e duhet studiuar edhe një herë. Shteti mund të vërë në dispozicionin tuaj edhe kredi të veçantë për të bërë investime në disa kooperativa, veçanërisht për shtimin e qeve. Në fushën e Domosdovës mendoj se janë kushtet dhe mund të zhvillohen më mirë lopët, të cilat jo vetëm që do të japin më tepër qumësht në vit, por do të shërbejnë edhe për përtëritjen e qeve të punës.

Çështje tjetër me rëndësi për rrethin tuaj është ajo e ujitjes. Për këtë ju keni eksperiencë. Ujitja e 70 për qind të sipërfaqes së tokave që keni arritur është një sukses i madh. Tani juve ju vihet detyrë që sipërfaqet e ujitshme t'i shtoni më tepër, sepse keni mundësi natyrore. Nuk e di nëse kanë kredi për pu-

nime të tilla kooperativat, po edhe në qoftë se duhet ndonjë ndihmë e veçantë në mjete e në teknikë, si për piketimin e kanaleve, për çimento, për dinamit etj., i parashikoni këto në diskutimin e direktivave të planit dhe shifrat për shtimin e kapacitetit ujitës i paraqitni më të mëdha. Ju planin për ujitjen e keni ndër-tuar në bazë të njohurive që keni mbi shfrytëzimin e ujit, por që ai të shfrytëzohet si duhet, në mënyrë shkencore, duhet të marrim e ta përgjithësojmë më shumë eksperiencën e fshatarësisë. Çështjen e kam se në këtë drejtim, megjithëse eksperiencia është e madhe, përsëri duhet të njohim më mirë teknikën e ujitjes, sepse ka shumë për të përmirësuar. Por nuk duhet të presim që përmirësimi të vijë vetvetiu. Ky përmirësim, që të bëhet shpejt, duhet të jetë i drejtuar me një plan dhe me një punë të organizuar. Ujitja ka një teknikë shumë të hollë. Në kuptimin shkencor kjo teknikë nuk qëndron vetëm te hapja e vijave kulluese, por edhe te kuptimi më shkencor i sasisë së ujit që i duhet dhënë bimës, sipas llojit të saj, kohës kur duhet t'i jepet etj., të cilat varen nga përbërja e tokës me infiltrimin e saj kripor ose jo, nga largësia e rrënjëve etj. Pra, teknika nuk është vetëm në punën që bëhet në sipërfaqe ose në mënyrat e rrjedhshme të ujit në formë brazde ose me përmytje, po në ato që përmenda, të cilat duan një studim të mirë. Eksperiencia e fshatarësisë për ujitjen është një gjë shumë pozitive, po ne nuk mund të kënaqemi vetëm me atë që është arritur nga ana praktike, prandaj këtë eksperiencë ta thelloni më tej, ta përpunoni, ta pasuroni e ta shikoni edhe në planin teorik. Kështu do t'u hapni

një horizont më të gjerë kooperativistëve, të cilët janë të interesuar për këtë çështje, prandaj ata duhen ndihmuar me format më të përshtatshme.

Disa herë mendohet se për këtë punë duhet të vëmë agronomin që t'i mbledhë fshatarët dhe t'u mbajë një leksion. Ky mund të jetë një leksion shumë i mirë, i studiuar, por mund të mos jetë i mjaftueshëm për ta, se nganjëherë u bëhet i rëndë, kurse vetë fshatarët duhet të kuptojnë se teknika e ujitjes, që ata kanë, është e mirë, por jo e mjaftueshme, prandaj është e nevojshme të perfeksionohet. Me fshatarët duhet folur herë pas here, që ata të arrijnë t'i ndryshojnë në këtë drejtim disa koncepte, të kuptojnë se dinë të ujitin, por nuk dinë sa duhet. Atëherë, mbasi të përgatitet terreni, mbasi të jetë rrënjosur në mendjen e tyre ideja e një pune më të mirë që duhet të bëjnë në këtë drejtim, duhet të gjesh metodat praktike që t'u shpjegosh anët shkencore, si thellësinë e nevojshme që duhet të infiltrojë uji, përbërjen e tokave etj. Vetëm në këtë mënyrë ata do ta kuptojnë me rrënjë teknikën e re të ujitjes, do të binden dhe do ta zbatojnë atë. Kështu mund të punohet edhe për plehërimin. Ju këtë dini ta përdorni, por puna është që plehu të përdoret në mënyrë më racionale. Traditën që kemi ta mbështetim edhe në shkencën, të studiohen më me hollësi kushtet dhe mundësitë me qëllim që zbatimi i metodave të reja në bujqësi të çojë në shtimin e prodhimit, në ngritjen e rendimentit, në forcimin e ekonomisë.

Në këto drejtime ne kemi për të bërë shumë, prandaj Partia, pushteti, kuadrot kryesorë të tyre e kanë për detyrë që planet t'i bëjnë sa më të studiuar dhe

t'i realizojnë. Përse populli na ka dhënë besim dhe na quan udhëheqës? Që ne të punojmë kurdoherë mirë, që planet t'i bëjmë të përparuara dhe detyrat e ngarkuara t'i kontrollojmë, t'i ndjekim mirë e t'i zbatojmë në kohë, por njëkohësisht të shohim edhe më larg, të hapim perspektiva, çfarë mund të bëjmë më tepër dhe më mirë akoma qoftë për planifikimin e bujqësisë qoftë për atë të industrisë etj., sepse shumë herë kënaqemi me punën tonë, duke thënë se kemi gjetur rrugën më të mirë. Partia vazhdimisht ka bërë një luftë të drejtë e parimore kundër të metave që kanë ekzistuar në punën politike, në mobilizimin e masave për realizimin e detyrave ekonomike, në punën kulturore etj. dhe rezultatet që kemi arritur janë të mëdha, por nuk duhet të vetëkënaqemi. Në qoftë se ju, shokë, do t'u ktheheni edhe një herë vendimeve të Komitetit Qendror të Partisë dhe raporteve të mbajtura në plenumet e tij jo përpara dy vjetëve, por edhe përpara shumë vjetëve, atje do t'i gjeni të shkruara të gjitha parimet e Letrës së Hapur, bile akoma më me hollësi. Pra nuk është se këto çështje i kishim lënë në harrësë, përkundrazi, janë pikërisht këto vendime dhe udhëzime që kanë mobilizuar masat për zbatimin e vijës së Partisë dhe për ruajtjen e pushtetit nga shtrembërimet burokratike. Në punë e në luftë i kemi korrigjuar edhe njerëzit që kanë pasur të meta e gabime.

Po të mos ishte bërë kjo punë e vazhdueshme, Letra e Hapur nuk do të mund t'i ngrinte të tërë në këmbë, siç i ngriti në luftën kundër shfaqjeve të burokratizmit. Në këtë luftë frontale ajo po arrin suksese, sepse baza ka qenë e armatosur për këto çështje dhe ndër-

gjegjja e anëtarëve të Partisë nuk u gjet e çoroditur. Këtë pjekuri ideologjike e tregoi fakti që brenda dy muajve, mijëra veta u ngritën në këmbë dhe shkuan me gatishmëri të plotë atje ku i dërgoi Partia.

Pra, të gjithë të punojmë me një metodë dhe me një stil revolucionar në punë, të ndjekim në rregull dhe të kontrollojmë zbatimin e detyrave të ngarkuara, t'i realizojmë ato që vendosim dhe të shohim më tutje, duke vënë në jetë udhëzimet e Partisë, e cila na mëson që kurdoherë të mendojmë dhe të veprojmë si revolucionarë. Por mund të mendojnë e të veprojnë kurdoherë kështu, vetëm ata që e ndiejnë veten se janë me të vërtetë revolucionarë, se janë në gjendje jo vetëm t'i realizojnë detyrat aktuale të Partisë, por të shohin edhe më tutje, se realizimet e njëpasnjëshme na hapin perspektiva. Ata që i rrëmben rutina e që nuk shohin perspektivën janë revolucionarë gjysmakë. Ai komunist që kënaqet me një shikim shumë të ngushtë të çështjeve, ai që kufizohet vetëm në punën për realizimin e detyrave që i janë caktuar e nuk bën përpjekje për të gjetur metodat e një pune më të shkathët e më revolucionare, ai nuk është njeri me perspektivë. Revolucionari i vërtetë jo vetëm e realizon atë që vendos, por njëkohësisht shkon edhe më përpara. Përkërisht këtu duhet bërë dallimi i masave nga komunistët dhe i komunistëve nga udhëheqësit.

Për të realizuar të gjitha këto detyra të rëndësishme që kemi përpara duhet, në radhë të parë, ta kemi të fortë Partinë dhe Partinë do ta kemi gjithmonë të fortë, sepse në radhët e saj ekziston një unitet i çeliktë ideologjik, politik dhe organizativ. Kjo është një

gjë shumë pozitive që i detyrohet mendimit unik të Partisë dhe që ka rëndësi të madhe.

Por në Parti ka edhe njerëz të paformuar plotësisht, ka nga ata që bëjnë gabime, ka të tjerë që disa çështje nuk i kuptojnë mirë dhe nuk punojnë drejt. Ky është, si të thuash, një proces i natyrshëm që zhvillohet brenda në Parti për edukimin marksist-leninist të komunistëve, është luftë klasash. Partia është kundra e kalitjes revolucionare dhe kjo do të thotë që këtu «hekuri» duhet rrahur, i duhet dhënë forma dhe kjo formë është edukata ideologjike dhe politike e Partisë. Një edukatë e tillë njerëzve duhet t'u rrënjoset thellë, sepse ata që vijnë në Parti me të vërtetë janë njerëz që dallohen midis të tjerëve, kanë dashurinë dhe besnikërinë për Partinë, e pranojnë vijën e saj ashtu si i gjithë populli, por jo të gjithë i kanë të formuara cilësitë e komunistit revolucionar. Ata garancinë kanë si të tillë, se «hekurin» pastaj duhet ta punojmë, në mënyrë që në ndërgjegjen e tyre të zhduken gradualisht mbeturinat mikroborgjeze e idealiste, për të mos i lënë njerëzit të kalojnë në rrugën antimarksiste. Konceptet e huaja përbëjnë një frenim, prandaj Partia i lufton e duhet t'i luftojë vazhdimisht. Në qoftë se ka komunistë të rinj të pranuar para 2-3 vjetëve, të cilët nuk aktivizohen dhe puna edukative me ta nuk bën efekt, atëherë këta duhen parë, sepse u kanë zënë vendin atyre që janë jashtë radhëve të Partisë, por që janë më të gjallë e më revolucionarë. Ky do të ishte një stimul edhe për ata që janë me stazh të vjetër në Parti por që kanë rënë në plogështi. Përsa u përket komunistëve të vjetër në Parti e në moshë nuk duhet ngulur



këmbë shumë që të vazhdojnë shkollat e të marrin arsim dhe kulturë të gjerë, siç ua kërkojmë të rinjve, por me ta të punohet në forma të ndryshme, në mënyrë që të shkunden nga plogështia, të mos u humbasë shpirti revolucionar, të mos lejojmë që të arrijnë deri atje sa organizata-bazë të detyrohet t'i përjashtojë nga Partia. Këtyre t'u jepet mundësia që, me aq sa dinë, të punojnë; të mobilizohen dhe të aktivizohen në punët e Partisë, në mënyrë që shembulli i tyre të frymëzojë dhe të nxitë për punë edhe ata anëtarë partie që janë të rinj dhe me kulturë.

Partia na mëson se e vetmja rrugë e kalitjes politike dhe ideologjike e komunistëve dhe e masave është pjesëmarrja e tyre aktive në punën dhe në luftën revolucionare. Prandaj një nga faktorët që e ka bërë Partinë tonë të çeliktë, është kalitja e saj gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe gjatë luftës së pandërprerë që po bën ajo me gjithë anëtarët e saj në gjirin e popullit, në punë për ndërtimin socialist të vendit. Duhet thënë që të gjithë ne komunistët i zgjeruam njohuritë teorike dhe politike kryesisht nëpërmjet punës dhe luftës së përditshme për të zbatuar me vendosmëri direktivat e Partisë. Domethënë pjesën më të madhe të teorisë që dimë ne, nuk e kemi mësuar nëpër shkolla, por në shkollën e madhe të luftës dhe të punës. Këtë teori nuk duhet ta nënvleftësojmë aspak, sepse nuk e dimë keq, pavarësisht se nuk e mësuan me formula e me citate, siç e mësuan më vonë profesorët, pedagogët dhe shokët e tjerë në Shkollën e Partisë. Kuadrot që mbarojnë studimet në Shkollën e Partisë kanë një avantazh më të madh, se edhe ata janë të brumosur me

ideologjinë marksiste-leniniste në luftë e në punë, edhe në shkollë marrin një dituri më të gjerë e më të thellë, kështu që edhe teorinë e dinë mirë, edhe praktikën e dinë dhe do ta mësojnë më mirë. Kur të mbarojnë shkollën, këta kuadro duhet t'i rifutim në punën revolucionare të jetës së përditshme.

Partia, ata që i dërgon në shkolla dhe i përgatit më mirë nga ana teorike, i edukon që këtë teori t'ua mësojnë edhe të tjerëve dhe së bashku ta zbatojnë drejt në praktikë. Prandaj, ne duhet t'i vëmë rëndësi të madhe si edukimit politik dhe ideologjik të komunistëve, ashtu edhe punës revolucionare. Neve na bie për detyrë ta bëjmë më mirë kombinimin e punës teorike me punën praktike, t'i lidhim këto më ngushtë me njëra-tjetrën dhe për këtë të mendojmë të gjithë, si ne në qendër, ashtu edhe ju në bazë. Mënyra e koordinimit të punës teorike me praktikën, metoda e kësaj pune, format që kemi përdorur janë të drejta, sepse ato kanë dalë nga një eksperiencë e gjatë e punës së madhe që ka bërë Partia për t'i mësuar njerëzit si ta lidhin teorinë me praktikën. Në sajë të kësaj pune është arritur që qëndrueshmëria politike, vendosmëria dhe besnikëria e popullit të Librazhdit ndaj vijës së Partisë të jetë e tillë që s'e luan topi, kjo është karakteristikë dalluese e gjithë popullit tonë, po ju duhet t'i rritni përpjekjet për të realizuar ndryshime më të mëdha në jetën tuaj. Fakti është se disa zona, si ajo e Myzeqesë, kanë ecur më përpara në shumë drejtime, si në ekonomi (po do të thuash se i ka favorizuar terreni, unë mendoj se nuk është e tëra kjo), ashtu edhe në jetën shoqërore. Ata tani vishen më lehtë, më bukur

dhe më lirë. Mbeturinat e huaja dhe zakonet e vjetra prapanike atje i kanë fshirë me fshesë të madhe, kurse ju këtu nga kjo anë jeni ca prapa.

Çështjen e kam që format dhe metodat e punës ekzistuese të Partisë janë të drejta, por ato duhen zbatuar në mënyrë revolucionare, kurdoherë të na punojë më shumë mendja. Këtu në Librazhd, për shembull, mund të mendohet si duhet t'i bëjmë më frytdhënëse mbledhjet e grave të rrethit tuaj, çfarë duhet biseduar me to etj. Mund të njiheni me eksperiencën e rretheve të tjera dhe të merrni atë që ju duket më e përshtatshme, por format e punës se si ta zbatoni i gjeni vetë, sepse për kushtet tuaja mund të ndodhë që të mos u shërbejë fare një formë ose një metodë pune që ka përdorur një rreth tjetër. Pra ju duhet të përdorni metodat tuaja, sepse ju e dini më mirë si të punoni për t'i zgjidhur problemet që ju dalin, si të organizoni mbledhje që gratë të mësojnë sa më shumë dhe, në qoftë se ato nuk vijnë, atëherë shkoni nëpër shtëpitë e tyre e i mblidhni nga dy e nga tri, bisedoni me to, i pyetni ç'probleme kanë dhe u merrni mendimin si mund të zgjidhen më mirë. Nga ana tjetër bëni analizën, pse nuk vijnë gratë në mbledhje? Ç'pengesa e vështirësi kanë? Mbledhja, ashtu siç e organizoni ju, a ngjall interes tek ato? Mund të ketë raste që prindërit të pengojnë vajzat, po komunistja ose aktivistja e rinisë të vejë në shtëpitë e tyre, të takohet me vajzat një, dy, tri herë, derisa problemi të zgjidhet. Sigurisht, për një punë të tillë kaq të gjerrë do të duhet të sakrifkohet gjumi dhe shumë gjëra të tjera nga jeta personale e aktivistit, por duke ve-

pruar kështu, te të rejat ne do të kemi futur mësimet e Partisë dhe një mëngjes, kur t'i thërresësh, do t'i sho-hësh ato të gjitha të mbledhura pa vështirësi.

Edhe për organizatën e rinisë kini kujdes, që mbledhjet të mos bëhen shumë zyrtare, se rinia kështu ndrydhet dhe i pritet iniciativa. Veç mbledhjeve, i duhet kushtuar rëndësi e veçantë punës individuale me njerëzit, sipas rasteve që paraqiten. Të marrim rastin e atyre dy të rinjve që dashuroheshin. Do të ishte mirë që në fshatin e tyre të shkonte vetë sekretarja e rinisë së rrethit, të bisedonte në shtëpi me prindërit e vajzës dhe t'i bindte ata që ta lejonin vajzën e tyre për t'u martuar me djalin që ajo dashuronte. Është më mirë të veprohet kështu, duke bërë me njerëzit punë individuale bindëse, sesa në forma të organizuara publike. Dihet që vajzën te ne, gjer në njëfarë shkalle, e sundojnë akoma prindërit. Mentalitetin e vjetër të tyre nuk mund ta mposhtim pa një punë bindëse e këmbëngulëse. Këtë gjë kanë mundësi ta bëjnë më mirë se deri tani si Partia, ashtu edhe levat e saj, sidomos organizata e rinisë. Rruga jonë është e drejtë për të shkukur nga rrënjët normat dhe zakonet e vjetra që pengojnë të drejtat dhe lirinë e vajzave. Këto dhe forma të tjera pune duhen gjendur sipas situatës. Kësaj i thonë që eksperiencën e punës të dish ta përdorësh dhe ta shpiesh përpara, gjithnjë në mënyrë revolucionare, në kushtet e terrenit.

Ai që merret me agjitacion e propagandë duhet të jetë njeri i zoti, të gjejë formën e duhur të punës për edukimin e masave dhe jo të vejë të regjistrojë se

është bërë një leksion teorik, të cilin edhe ai vetë e kupton që nuk ka efekt, sepse nuk u përshtatet nivelit dhe problemeve të masave. Në qoftë se bëhet një punë e tillë formale, atëherë njeriu ynë i propagandës duhet t'i thotë vetes se nuk e ka bërë mirë punën, nuk ka sakrifikuar gjumin dhe kohën e lirë. Propagandisti, para se të vejë në një fshat për të bërë një temë, më parë duhet të dijë çfarë pikëpamjesh ekzistojnë te fshatarët, të arrijë që ta njohë fshatin në pëllëmbë të dorës, pastaj të vejë të flasë për këtë ose për atë problem. Por, që ta bëjë mirë këtë punë, ai duhet të rrijë edhe pa gjumë, ta studiojë gjendjen, të veprojë si revolucionar dhe të mos e kuptojë detyrën e tij në mënyrë formale, sa për të shkuar radhën.

Pra, ka rëndësi që komunistët të largohen nga metodat e punës burokratike. Edhe ato forma pune, të cilat janë të drejta, ka raste që nuk mund të përdoren kudo njëjloj, prandaj komunistët duhet të mendojnë se si t'i përshtatin sipas kushteve konkrete të rrethit, të kooperativës bujqësore, të një shtate të veçantë, të nivelit të masave etj. Në qoftë se bëhet kështu, ne me punën e Partisë nuk kemi ngritur në këmbë vetëm një njeri të organizatës, po gjithë organizatën e Partisë, kemi ngritur gjithë kooperativën.

Interesi i Partisë është që të gjithë komunistët të jenë revolucionarë, po në realitet midis tyre ka diferencë. Disa janë më të zotë, më të gjallë, më të hedhur e të sakrificës, ka të tjerë që zvarritin këmbët, bile ka edhe nga ata që mbajnë ramazan e që nuk pranojnë në Parti një të ri luftëtar kundër besimeve fetare. Pra, shikoni, edhe në Parti ka njerëz me lloj-lloj

pikëpamjesh, me të cilët duhet punuar shumë për t'i bërë revolucionarë të vërtetë.

Atëherë si duhet vepruar? Në qoftë se organizata-bazë për problemin që shqyrtohet punon në mënyrë të përgjithshme, sigurisht që do të kemi disa rezultate, por jo të mjaftueshme. E rëndësishme është të ndërtohet puna në mënyrë të tillë që secili komunist të japë maksimumin e aftësive të tij. Organizata-bazë e ka për detyrë të bëjë punë me të gjithë anëtarët e saj dhe t'i aftësojë ata, por syri dhe ndihma e saj duhet të jenë veçanërisht për të aktivizuar e për t'i bërë më revolucionarë ata, që janë të dispozuar për të marrë përsipër detyra më të mëdha dhe për të bërë më shumë sakrifica. Nga ana tjetër, edhe ndihma e komitetit të Partisë duhet të jetë më efektive për ata që kanë më shumë perspektivë, me qëllim që të bëhen krahu i djathtë i komitetit të Partisë brenda organizatës-bazë, për të frymëzuar me shembullin e tyre të gjithë komunistët e tjerë. Në radhë të parë duhet të bëjmë një punë të veçantë me sekretarin e organizatës-bazë, i cili është në lidhje të vazhdueshme me komunistët dhe me masat, e që logjikisht duhet të jetë njeriu më i dalluar.

Sekretari i organizatës-bazë të Partisë mund të mos jetë njeriu më i ngritur, po si komunist ai duhet të jetë shumë i vendosur, revolucionar, mbi çdo gjë të shohë interesat e Partisë, të ketë cilësitë e bolshevikut dhe të ketë një garanci të madhe që me punën e vet ta ndihmojë organizatën-bazë për ta rritur gjithnjë e më tepër nivelin e punës së saj, në rrugën revolucionare. Prandaj sekretarin e organizatës-bazë

jo vetëm ta zgjedhim nga më të mirët, po atij t'i vëmë një kujdes të veçantë për ta edukuar e për ta mësuar, që të mbajë për çdo problem qëndrim revolucionar. Ju, shokë, anëtarë të komitetit të Partisë dhe instruktorë, të mos e përkëdhelni sekretarin e organizatës, sepse po u mburr, puna e tij mbaroi. Në qoftë se është njeri i mirë, ai do t'ju thotë vetë: «Mua mos më mburrni se nuk e kam bërë si duhet detyrën». Atij t'i kërkohet vazhdimisht që të hidhet «në zjarr», se kështu do të bëhet i zoti dhe komiteti i Partisë do të ketë ku të mbështetet.

Por punën e Partisë nuk e bën vetëm sekretari, janë të gjithë komunistët e organizatës-bazë që punojnë dhe që luftojnë. Këtë organizata-bazë e ka zgjedhur në krye të saj, ajo ta pranojë, ta dojë dhe ta respektojë në qoftë se jep shembull në punë e në sakrifica, por në qoftë se nuk jep shembullin pozitiv, atëherë do të ishte shumë keq. Sekretar i organizatës-bazë duhet të jetë ai që realizon normën më mirë nga të gjithë, në kooperativë apo në fabrikë, ai që kryen mirë detyrat ekonomike e politike të Partisë. Këtë u thashë dje edhe shokëve në Elbasan. Mund të thuhet se kur do ta bëjë ai punën si sekretar, ku do ta gjejë kohën? Këtu është çështja, se si të jesh revolucionar. Në qoftë se të tjerët flenë nga 8 orë, sekretari të flejë më pak, prandaj ai jo vetëm kur të mbarojë punën, por edhe gjatë kohës së punës duhet t'i kontrollojë e t'i ndihmojë shokët e organizatës së Partisë dhe punonjësit e tjerë. Ai duhet të bëjë më shumë sakrifica, të veprojë në punë me një kthjelltësi e shkathtësi të ti-

llë që me metodën dhe me stilin e punës së tij të mobilizojë e të drejtojë të gjithë shokët.

Në shumë raste në praktikë ndodh që vetëm në fund të muajit u kërkohet llogari komunistëve. Po mbeti puna për t'u kërkuar llogari në fund të muajit, e ka marrë ferra uratën. Në mbledhje u mbetet të bëjnë nga një kritikë për disa gjëra, të thonë nga një fjalë për ndonjë çështje të përgjithshme, për shembull, se Partia do që brenda këtij muaji të realizohet plani, të jemi të disiplinuar, të ndershëm, të shkojmë mirë me gruan, të lexojmë libra, të mësojmë mësimet, të përgatitim ndonjë referat etj. Patjetër që të gjitha këto detyra duhet të bëhen, por, që të vihen në jetë, sekretari duhet të kontrollojë vazhdimisht zbatimin e tyre, sepse disa komunistë i kryejnë plotësisht detyrat, disa të tjerë i lënë ato në mes të rrugës etj.

Mirëpo sekretari i organizatës-bazë duhet të realizojë njëkohësisht edhe planin individual, edhe detyrën e vështirë si sekretar i organizatës. Atëherë si do t'i takojë ai komunistët, të cilët presin ndihmën e tij dhe që prej tyre varet i gjithë drejtimi i uzinës? Të marrim një tornitor, i cili është njëkohësisht edhe sekretar i organizatës-bazë. Pikërisht edhe atje, pranë tornos duke punuar, ai duhet të organizojë e të marrë të dhëna si punon njëri dhe si e kryen tjetri detyrën që i ka ngarkuar organizata. Sekretari të kërkojë nga byroja që ajo të jetë aktive gjatë gjithë kohës, por, veç kësaj, ai mund të ngarkojë edhe komunistë të tjerë për të ndjekur dhe për të kontrolluar zbatimin e detyrave të organizatës në kohën e caktuar. Ai të kërkojë që informacioni për këto detyra t'i jepet kur bë-



hen 15 minuta pushim ose të kërkojë të vijë shoku që ka caktuar të ndjekë zbatimin e detyrës dhe ta informojë se kush e ka bërë këtë dhe kush jo. Në këtë rast sekretari ngrihet dhe i kërkon llogari shokut që nuk e ka kryer detyrën dhe e porosit që ta kryejë sa më parë, ndryshe, t'i thotë, kur të bëhet mbledhja e organizatës-bazë, do ta vë në dijeni. Kështu, sekretari, gjatë kohës midis dy mbledhjeve të organizatës-bazë, veç byrosë, aktivizon me radhë e sipas problemeve, të gjithë komunistët. Sekretari dhe çdo komunist e ka për detyrë që punën e Partisë ta bëjë në mënyrë të organizuar. Organizata-bazë, pra, lufton vazhdimisht për realizimin e detyrave të Partisë dhe nuk pret fundin e muajit kur të bëhet mbledhja.

Është e qartë që sekretari i organizatës së Partisë duhet të jetë kurdoherë në këmbë, duke thirrur çdo ditë herë njërin dhe herë tjetrin, po të jetë nevoja edhe në mes të natës, e t'u thotë: «Përse ju nuk po merrni masa për kryerjen e kësaj ose të asaj detyre që ka vendosur organizata-bazë? Ashtu sikurse po rri unë pa gjumë, duhet të rri edhe ju». Nën shembullin e sekretarit të veprojë edhe kryetari i kooperativës. Të tjerët, kur të shikojnë sekretarin e Partisë ose kryetarin e kooperativës që prishin gjumin dhe i bien fushës kryq e tërthor, që nuk qëndrojnë me mendje të fjetur, do të thonë se ky sekretar apo kryetar është revolucionar, i ndershëm, i mirë dhe, nëse më la pa gjumë, mirë ma bëri, ai nuk e lë punën zvarrë se vetë është shembull, po dhe di të të ndihmojë e të të shkundë.

Format se si duhet punuar nuk mund të jepen për

çdo rast. Ato i nxjerr lufta, puna, njerëzit, terreni, vështirësitë. Ne duhet të dimë të përdorim ato forma e metoda pune që janë më të përshtatshme dhe që japin rezultate. Kur një formë nuk është e mirë, hidhe tej dhe mendo për një tjetër që të jep më shumë. Asnjë njeri nuk të thotë pse nuk zbatove këtë ose atë formë, sepse kjo nuk prish asnjë punë. Puna prishet atëherë kur rezultatet janë të këqija.

Nga të gjithë komunistët kërkohet që, duke i pasur parasysh direktivat që ka kristalizuar Partia, idetë kryesore të Letrës së Hapur si dhe gjithë veprimtarinë revolucionare të Partisë, esencën e punës dhe të luftës së saj, të punojnë që këto të bëhen pikënisja e një zhvillimi akoma më të madh, ta mbajmë luftën revolucionare kurdoherë të ngritur. Ky hov i madh që ka shpërthyer, të na shërbejë për realizimin e planeve dhe sidomos për revolucionarizimin e mendimeve tona.

Mendimet nuk bien nga qielli. Ato janë produkt i trurit, e kanë burimin te realiteti objektiv, janë pasqyrim i këtij realiteti. Kur mendimi pasqyron mirë realitetin, ai është i drejtë dhe atëherë puna ecën mirë. Mendimet, kur nuk puqen në procesin e praktikës me realitetin objektiv të zhvillimit të shoqërisë, atëherë ato janë idealiste dhe, si të tilla, pengojnë ecjen përpara. Me këtë lidhet shprehja e popullit që «peshku qelbet nga koka». Kjo nuk do të thotë se vetëm udhëheqësit mund të qelben, po edhe të tjerë, pavarësisht se nuk janë në udhëheqje, kur mendimet e tyre nuk pasqyrojnë realitetin objektiv. Populli ka eksperiencë shekullore, ai shikon se njerëzit që shkëputen nga ky realitet, nga baza, nga teoria materiali-

ste, rrëshqasin në idealizëm, në antimarksizëm, kësh-tu që mendimet e tyre nuk përputhen me ato të Partisë. Një njeri i tillë është, për shembull, për pronën private, për të grumbulluar pasuri për vete, ai kërkon të komandojë vetë, nuk pranon kritika etj. Të gjitha këto qëndrime e kanë burimin te mendimet e tij të gabuara, të cilat i turbullojnë kokën dhe dalngadalë, në qoftë se Partia nuk e ndihmon, nuk e ndreq, ato gradualisht e çojnë në rrugën antimarksiste.

Kështu ndodhi në Bashkimin Sovjetik e në Jugosllavi, ku Hrushovi, Titoja dhe gjithë banda e tyre u bënë shumë të rrezikshëm, sepse shfrytëzuan për interesat e tyre gjithçka që kishte krijuar partia dhe tradhtinë e mbulojnë me një petk gjoja marksist-leninist, i cili, në fakt, është antimarksist. Këta arritën të krijojnë shtresa njerëzish që, pak nga pak, ndryshuan pikëpamjet, pranuan sa për formë socializmin dhe vijën e partisë, kurse në veprimtarinë praktike mohuan objektivat e partisë, luftën ideologjike e politike të saj. Në këtë mënyrë, arrin një moment që, njerëz të tipit Hrushov, duke pasur edhe fuqinë në dorë, bëhen një grusht kundërrevolucionarësh, siç ngjau në Bashkimin Sovjetik, ku shteti socialist u kthye në një shtet kapitalist. Prandaj, në qoftë se lindin idetë antimarksiste në udhëheqje, kjo bëhet shumë e rrezikshme. Që të mos ngjasë kjo, ligjet dhe normat e Partisë duhet të ruhen të forta e të drejta siç janë. Në Parti, kryesorja të jetë lufta për kalitjen ideopolitike revolucionare të komunistëve. Pjesëmarrja në punë e komunistëve dhe e kuadrove të bëhet një jetë e dytë, me qëllim që këta të jenë të lidhur me masat, t'i nën-

shtrohen kritikës së gjerë dhe ndikimit të tyre të madh. Në të kundërtën, në qoftë se lidhjet me masat nuk janë të shëndosha dhe në rrugë revolucionare, atëherë ngjet katastrofa që ndodhi në Bashkimin Sovjetik.

Stalini nuk bëri gabime parimore, se ai zbatonte mësimet e Leninit. Kjo është provuar me fakte. Nën udhëheqjen e Partisë Bolshevike me Stalinin në krye u arritën suksese të mëdha, që krijuan një Bashkim Sovjetik të fuqishëm, ku zhvillohej revolucioni në mënyrë të pandërprerë, ku u ngritën industria dhe bujqësia socialiste etj. Por prej kohësh Hrushovi me shokë vepronin nën rrogë, shtrembëronin vijën e drejtë të Partisë Bolshevike, gjë që kishte rrjedhime të rrezikshme dhe pas vdekjes së Stalinit do të çonte, sikundër çoi, në ardhjen e revizionistëve në fuqi. Kjo duhet të na bëjë të mendojmë thellë, të nxjerrim mësim të nevojshme nga eksperiencia e hidhur e Partisë Bolshevike dhe e gjithë partive të tjera revizioniste, që në vendin tonë të mbyllen rrugët e revizionizmit.

Për këtë, në radhë të parë, duhet të kemi kurdoherë parasysh luftën e klasave. Kjo luftë, në të gjitha aspektet e saj, do të vazhdojë deri në ndërtimin e plotë të shoqërisë komuniste. Kur kritikojmë një shok për një mbeturinë të huaj në ndërgjegjen e tij, për një qëndrim jo të drejtë ndaj pronës socialiste ose ndaj punës, për një sjellje që nuk përputhet me normat e moralit proletar etj., ne me këtë punë bëjmë një luftë klasash, përpiqemi ta pastrojmë ndërgjegjen e tij nga këto mbeturina. Edhe me fshatarësinë Partia bën një punë të thellë ideopolitike edukative, të përditshme për

ta pastruar ndërgjegjen e saj nga mbeturinat mikro-borgjeze. Pra, ne vazhdojmë të bëjmë, ideologjikisht dhe politikisht, një luftë klasore kundër mbeturinave, zakoneve prapanike e shfaqjeve të huaja. Këtë luftë ta zhvillojmë jo vetëm kundër atyre shfaqjeve që reflektohen, që nxjerrin brirët vetëm te disa njerëz, po edhe më gjerë, në planin e përgjithshëm, për të parandaluar të këqijat, për të rrënjosur te njerëzit botë-kuptimin e ri proletar.

Dihet se klasa punëtore te ne është me një stazh revolucionar relativisht të shkurtër. Në Shqipëri nuk ka pasur një klasë punëtore me tradita, ashtu siç e karakterizojnë këtë klasë Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini, sepse te ne nuk ishte e zhvilluar industria, kanë ekzistuar vetëm disa punishte artizanati. Në vendin tonë ka pasur një fshatarësi revolucionare, që ka luftuar shekuj me radhë për liri; ka pasur gjithashtu, një rini revolucionare të qytetit e të fshatit. Edhe vetë ju të gjithë keni qenë nga këta të rinj revolucionarë.

Tani gjendja shoqërore e vendit ka ndryshuar. Te ne sot ka një klasë punëtore, e cila është rritur nga Partia dhe, nën udhëheqjen e saj, po revolucionarizohet çdo ditë. Por edhe kjo, meqenëse prejardhjen e ka nga fshati, ka sjellë që andej mbeturina mikro-borgjeze e individualiste të pronës private, prandaj me të duhet bërë një luftë e madhe, e vazhdueshme ideopolitike. Çështja është që të mos nënvleftësohet lufta për forcimin e ndërgjegjes komuniste të punonjësve. Partia jonë marksiste-leniniste ka luftuar dhe lufton për të kalitur njeriun e ri.

Në vendin tonë ekzistojnë sot dy klasa mike, kla-

sa punëtoresh dhe fshatarësia punonjëse, në aleancë të ngushtë me njëra-tjetrën, aleancë jo me fjalë, po e çelikosur në Luftën e madhe Nacionalçlirimtare dhe në luftën për ndërtimin e socializmit, kundër feudalizmit, borgjezisë tregtare, uzuraxhinjve spekulatorë, të cilët i shtypëm, i likuiduam si klasë që kishte fuqinë ekonomike dhe politike në dorë, ua rrëmbyem pushtetin dhe krerët e tyre ia dhamë gjyqit të popullit, i cili i dënoi sipas krimeve që kishin bërë. Klasës feudale që ishte në degjenerim të plotë dhe borgjezisë, që sapo kishte filluar të zhvillohej e të ngrihej, u ra sëpata në kokë. Megjithatë mbeturinat e klasave armike ekzistojnë fizikisht. Prandaj Partia na mëson të jemi vigjilentë ndaj elementëve armiq, të vazhdojmë luftën e klasave kundër veprimtarisë dhe mbeturinave të ideologjisë së tyre. Me këtë nuk dua të them që tani të ngrihemi e të marrim pushkën kundër tyre, por kundër elementëve të klasës që u është marrë fuqia politike dhe ekonomike të mbajmë kurdoherë sytë hapur, lufta e klasës të mos ndërpritet për asnjë çast, po të zhvillohet pandërprerë.

Partia ka bërë një punë të madhe edukuese me të gjithë njerëzit, por kjo nuk do të thotë që të mendojmë se u edukuan edhe kulakët, prandaj «t'i bëjmë vëllezër». Edhe kur ndonjëri prej tyre ka ndonjë vajzë të bukur, nuk i lejohet një komunisti ta marrë për djalin e vet. Një gjë e tillë do të thotë të humbasësh sensin e klasës. Diferencim do të bëjmë, por sytë i kemi të hapët. Luftën e klasave mos ta shuajmë asnjëherë, po ta mbajmë të ndezur, ashtu siç na mëson marksizëm-leninizmi. Ne jemi një Parti dhe një vend

në mes të Evropës, të rrethuar krejtësisht nga imperia-  
listë dhe nga revizionistë.

Punët na shkojnë mirë në të gjitha drejtimet. Ne  
jemi optimistë për situatën, sepse revolucioni vazhdon  
gjithnjë të ngrihet. Partia, populli dhe ushtria janë në  
unitet të pathyeshëm.

Ushtria jonë po revolucionarizohet çdo ditë e më  
tepër. Djemtë, kur kthehen nga ushtria në fshat, në  
fabrika ose në institucione, flasin me mall për ush-  
trinë, ku kanë kryer një shkollë të madhe edukimi.  
Ata të jenë luftëtarë në radhët e para të fronteve më  
të vështira të prodhimit, të punojnë e të luftojnë për  
të çimentuar disiplinën, organizimin, frymën e kolek-  
tivitetit, të qëndrueshmërisë për të rezistuar kundër  
vështirësive, po edhe për t'u përgatitur vazhdimisht  
për mbrojtjen. Njohuritë që kanë marrë në ushtri, t'ua  
mësojnë edhe të tjerëve, që, në rast se do të na vijë  
ndonjë rrezik nga ana e armikut, kufirin ta kemi të  
paprekshëm. Prandaj në të gjitha këto kodra të ndër-  
tohen tunele dhe çdo shkëmb e gur të jetë një grykë  
zjarri, në mënyrë që armiku të mos jetë në gjendje  
të afrohet.

Përgatitja që bën ushtria nuk është kohë e hu-  
mbur, përkundrazi, është jashtëzakonisht e dobishme  
për nevojat e mbrojtjes e të sulmit kundër armikut.  
Çështja e ushtrisë, shokë, ka rëndësi të madhe, pra-  
ndaj ju të terrenit duhet të bashkëpunoni ngushtë, t'i  
jepni asaj eksperiencën tuaj dhe shokët e ushtrisë t'ju  
japin juve gjithashtu eksperiencën e tyre në të gjitha  
problemet.

Kuadrot e ushtrisë i kemi shumë të mirë, me par-

tishmëri të lartë, zbatues të vendosur të direktivave të Partisë. Masat që u morën për heqjen e gradave dhe uljen e pagave të larta këta i kanë pritur në mënyrë shembullore, revolucionare. Kjo do të thotë se nga puna e madhe që ka bërë Partia në ushtri, kuadrot dhe ushtarët tanë e kanë kuptuar si duhet esencën e vijës së drejtë revolucionare të Partisë. Ata e kuptojnë se ushtria jonë është një ushtri e tipit të ri, është armë e dashur e popullit, e diktaturës së proletariautit. Ajo përgatitet në mënyrë revolucionare për të mbrojtur atdheun dhe fitoret e popullit nga çdo sulm i armiqve. Është detyrë patriotike për çdo ushtar dhe për çdo oficer që të përgatitet politikisht e ushtarakisht në mënyrë revolucionare, prandaj në ushtri po rishikohen me këtë sy edhe programet e punës mësimore edukative. Në kushtet e sotme me ushtarët mund të bëhet një punë më e kualifikuar, për arsye se, në radhë të parë, oficerët tanë kanë një eksperiencë të gjatë e të madhe revolucionare lufte dhe dije shkencore, pastaj edhe për arsyen e thjeshtë, se ushtarët tanë nuk janë më analfabetë, siç ishin 20 vjet më parë. Shumica e tyre sot kanë kryer shkollën 7-vjeçare, bile shumë prej tyre kanë kryer edhe të mesmen. Kur vjen në ushtri i riu punëtor, fshatar dhe intelektual, kuadrot e ushtrisë të kujdesen që këta djem të ushqehen me ideale revolucionare, me dashurinë e zjarrtë për popullin e vet dhe për punën. Kështu do ta vlerësojnë edhe më mirë se sa e shtrenjtë është kjo tokë, për të cilën ushtria vigjilon ditë dhe natë, do ta kryejnë shërbimin ushtarak me një hov të lartë revolucionar që jo vetëm të mos shkëputen nga jeta e popullit, po edhe kur



të kthehen në punën e tyre të zakonshme, të punojnë akoma më mirë, të mbajnë gjallë edhe aty ndjenjën e kolektivitetit, të rregullit, të organizimit e të disiplinës që kanë marrë në ushtri. Kjo ka njëkohësisht edhe një kuptim të madh politik, se ushtarin e bën të mos e quajë veten të ndarë nga populli, e edukon atë që, si ushtar revolucionar, të mësojë jo vetëm artin ushtarak, se si t'i përdorë më mirë armët moderne që i kanë dhënë në duar Partia, Republika dhe populli, por, nga ana tjetër, të jetë i lidhur edhe me problemet e zhvillimit dhe të forcimit të ekonomisë.

Gjeografikisht Shqipëria është si një kështjellë e izoluar, e cila qëndron në mënyrë revolucionare dhe e patundur, por ideologjikisht dhe politikisht ajo nuk është e izoluar, përkundrazi, popujt, komunistët kudo në botë, partitë marksiste-leniniste e përkrahin qëndrimin e Partisë sonë, vijën e drejtë marksiste-leniniste të saj. Por për këtë neve nuk na rritet mendja. Prandaj, si Parti proletare, na bie një detyrë e madhe që vendi ynë të përparojë e të zhvillohet në rrugën marksiste-leniniste me hapa të mëdhenj. Kjo do të bëhet sepse Partia qëndron gjithnjë e patundur, sepse ajo kalitet çdo ditë me ideologjinë marksiste-leniniste. Për këtë arsye ne, komunistët, pararoja e popullit tonë, të mendojmë më thellë e të jemi tejpamës, t'u paraprijmë masave të popullit, të mendojmë se kemi detyra të mëdha kombëtare, po edhe internacionaliste. Edhe kur shkon të mbledhësh rininë në një qendër pune ose në një fshat, ta kesh mendjen tek e ardhmja, se, kur rinia është e pastër, e shëndoshë ideologjikisht, ajo është për Partinë burimi më i kulluar për shti-

min e radhëve të saj. Ne do të punojmë për ta kalitur rininë tonë, pse e ardhmja është kurdoherë brezi i ri. Ne, komunistët shqiptarë, të mendojmë se mund të vijmë edhe situata që rinia të detyrohet të marrë armët e të luftojë për çështjen e Partisë dhe të popullit. Si komunistë, në çdo punë të mendojmë për interesin kombëtar dhe të proletariatit ndërkombëtar, pse lufta kundër kapitalizmit, për fitoren e plotë të revolucionit socialist, është e ashpër dhe e gjatë. Kjo luftë nuk mund të konsiderohet e përfunduar, pa përmbysjen e borgjezisë në shkallë botërore.

Revizionistët sovjetikë, me veprimtarinë e tyre armiqësore, i shkaktuan një dëm të madh lëvizjes komuniste ndërkombëtare, që asaj i kushtoi shtrenjtë, po që nuk është i pakapërcyeshëm. Ne e kuptojmë se ata nuk përmbysen dot pa një luftë të përgjithshme nga vetë bolshevikët revolucionarë sovjetikë në radhë të parë. Me gjithë dëmet kolosale që i shkaktuan revizionistët modernë lëvizjes komuniste ndërkombëtare, ata nuk janë më në ngjitje, por po rrëshqasin poshtë çdo ditë e më shumë, po demaskohen vazhdimisht. Popujt, klasa punëtore revolucionare dhe fshatarësia po e shohin kudo, çdo ditë e më qartë se revizionistët nuk janë aspak marksistë, por borgjezë, kapitalistë, gjë që duket mirë në kthimin e vendeve të tyre nga socialistë në vende kapitaliste, duket në aleancat e shumta që bëjnë ata me klikat më reaksionare, feudale e kapitaliste në botë.

Popujt shohin tani se revizionistët sovjetikë dhe gjithë revizionistët e tjerë, janë në aleancë të hapët dhe të fshehtë me imperialistët dhe me reaksionarët

e vendeve të ndryshme për të shuar luftërat nacionalçlirimtare të popujve, për të goditur Republikën Popullore të Shqipërisë, për të çoroditur dhe për të vënë nën zgjedhë popuj të tjerë në Azi, për të shkatërruar Partinë Komuniste Japoneze, atë të Zelandës së Re e të tjera, për të likuiduar partitë dhe grupet e reja marksiste-leniniste që janë organizuar e po vazhdojnë të organizohen në të gjithë botën. Pra, qëllimi i imperialistëve dhe i revizionistëve modernë është të likuidojnë socializmin, të mbajnë popujt nën zgjedhë, t'i shfrytëzojnë të gjitha forcat jetike të popujve sipas parimit të shfrytëzimit total kapitalist, imperialist dhe të bëjnë ligjin në gjithë botën.

Natyrisht, kjo është dëshira e tyre perspektive, është strategjia kundërrevolucionare e tyre, që nuk do të ketë sukses, përkundrazi, ata do të pësojnë katastrofë, do të shkatërrohen. Marksistët, kur e thonë këtë, nuk nisen nga dëshira, po bazohen shkencërisht. Edhe në Shqipëri vërtetohet plotësisht teoria marksiste-leniniste, sepse populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë sonë marksiste-leniniste, në luftë të pandërprerë kundër fashizmit dhe imperializmit, mundi të fitojë dhe po ndërton me sukses socializmin. Fitorja e revizionistëve modernë është e përkohshme. Këta agjentë kapitalistë kanë për qëllim të likuidojnë marksizëm-leninizmin, por ata kurrë nuk mund ta zhdukin teorinë e lavdishme të Marksit dhe të Leninit, e cila na mëson se në çdo moment, kur imperializmi shikon se po i kërcënohet vdekja, ai shpall diktaturën dhe lufton revolucionin, në të njëjtën kohë përdor edhe elementët e borgjezuar të klasës punëtore e socialde-

mokratët, të cilët bashkohen me borgjezinë e vendit dhe hidhen kundër lëvizjes revolucionare të proletariatit. Kështu ndodhi edhe tani me revizionistët. Kur lëvizja komuniste ndërkombëtare kishte marrë një hov të madh, kur kërcënonte seriozisht nga të katër anët imperializmin dhe kapitalizmin botëror, pikërisht në këto momente të rënda për ta, agjentët e imperializmit arritën të bëjnë këtë diversion, që është një e keqe e përkohshme, pse masat e popullit nuk mund të durojnë për shumë kohë zgjedhën kapitaliste, dhe fakti është se në të gjithë botën ato po luftojnë për çlirim e tyre.

Të gjithë marksistë-leninistët e vërtetë tani e kanë të qartë se sot Bashkimi Sovjetik nuk është më si dikur qendra e revolucionit, mbasi me vdekjen e Stalinit ai vend mbaroi së qeni revolucionar. Atje duhet të kryhet medoemos një revolucion tjetër proletar që Bashkimi Sovjetik të kthehet përsëri në rrugën e socializmit.

*Pasi foli për gjendjen ndërkombëtare dhe për disa probleme të lëvizjes marksiste-leniniste ndërkombëtare, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Në këto situata ndërkombëtare të ndërlikuara Partia jonë dhe Republika Popullore e Shqipërisë qëndrojnë në radhët e para të luftës kundër planeve të imperializmit dhe të revizionizmit modern. Këtë detyrë ne duhet ta plotësojmë me nder dhe nuk jemi vetëm, sepse masat e gjera të popujve të vendeve të ndryshme janë me ne, pavarësisht se ç'qëndrim mbajnë qeveritë e tyre. Po të shohësh dhe të biesh në kontakt me to, nga fjalët, nga shprehjet dhe nga mendimet e tyre,

duket qartë se shumë e kanë kuptuar ç'është Shqipëria. Ata që flasin kështu, nuk janë vetëm njerëz të thjeshtë të vendeve ku sundojnë revizionistët, po kuadro të rëndësishëm partie dhe shtetërorë, ambasadorë, diplomatë e të tjerë. Merreni me mend pastaj ç'mendojnë masat e popullit. Imperialistët dhe revizionistët kurrë nuk do të arrijnë të na bëjnë neve rrethim, për arsye se baza, masat e gjera popullore, që përbëjnë shumicën e popullsisë të çdo vendi, nuk mund t'i kenë kurrë me vete.

Në këto rrethana kombëtare e ndërkombëtare, na bie për detyrë të përgatitemi sa më mirë për Kongresin e 5-të të Partisë, të mobilizojmë Partinë dhe popullin për realizimin e detyrave të mëdha politike dhe ekonomike që kemi përpara, me qëllim që të shkojmë në Kongres me realizime të mëdha.

Kongresi ynë do të jetë një ngjarje e rëndësishme jo vetëm për ne, por edhe për të gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Kështu e solli situata, e sollën qëndrimet e drejta të Partisë sonë. Kongresi ynë është i pari kongres i partive marksiste-leniniste që bëhet pas daljes hapur të revizionistëve hrushovianë si armiq të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, si dhe të luftës së rreptë që po bëhet kundër këtyre tradhtarëve. Në këto kushte, pra, është Partia e Punës e Shqipërisë që bën Kongresin e para. Por në këtë Kongres do të vijin edhe përfaqësuesit e të gjitha partive të vërteta marksiste-leniniste dhe të grupeve marksiste-leniniste e revolucionare të botës, të cilët do të thonë në Kongresin e Partisë sonë mendimet e tyre.

Kjo na shtron detyrën që ne të punojmë më te

për e me të gjitha forcat për të kalitur më tej Partinë, të ngremë ekonominë tonë, në mënyrë që miqtë, të cilët do të na vijnë në Kongres, jo vetëm të shohin vrullin e zjarrtë revolucionar të Partisë, po edhe atë të popullit tonë, të shohin efektin e madh të punës së Partisë gjer në skajet më të largëta të atdheut, të shohin si ka qenë gjendja në Shqipëri në pragun e Çlirimit, si është sot dhe të mësojnë perspektivat e shkëlqyera që i hap Partia jonë Shqipërisë së re socialiste.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 32-TË ..... V—IX

1966

- PARTIA DHE ORGANIZATAT E MASAVE — Fjala në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (8 prill 1966) 1—47
- IDETË E MARKSIZËM-LENINIZMIT DO TË FITOJNË NË TË GJITHË BOTËN — Nga biseda me ambasadorin e RP të Kinës (11 prill 1966) ..... 48—57
- KODI I PUNËS MBRON PARIMET E KLASËS PUNËTORE — Nga biseda me shokun Qimo Kocani në lidhje me Kodin e Punës (15 prill 1966) ..... 58—70
- TË NA PREOKUPOJË SHUMË JETA LUFTARAKE NË ORGANIZATËN-BAZË — Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë ku bën pjesë (17 prill 1966) 71—76
- KONGRESI I 23-TË I PK TË BS SANKSIONOI VIJËN E PËRGJITHSHME TË REVIZIONIZMIT HRUSHOVIAN, POLITIKËN E TRADHTISË DHE TË KAPITULLIMIT — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (22 prill 1966) ..... 77—107
- FORCA E USHTRISË SONË QËNDRON TE POPULLI DHE TEK UDHËHEQJA E PARTISË — Fjala në konferencën e parë të organizatës së Partisë të repartit nr. 8001 (27 prill 1966) ..... 108—155

TA BËJMË TË GJITHË ATDHEUN MBUROJË TË PAKAPËRCYESHME PËR ARMIQTË — Fjala në drekën e shtruar në një repart ushtarak të Shkodrës (28 prill 1966) .....	156—169
ORGANIZATA PROFESIONALE TË PËRGATITË AKTIVISTË TË ZJARRTË E ME AUTORITET — Nga biseda me drejtues dhe aktivistë të organizatës së bashkimeve profesionale të rrethit të Shkodrës (28 prill 1966) .....	170—192
TE VEPRAT QË NDËRTOHEN, POPULLI SHEH SA PËRPARA KANË ECUR BIJTË E TIJ — Nga fjala me rastin e inaugurimit të Uzinës së Telave të Bakrit në Shkodër (29 prill 1966) .....	193—202
AI VEND QË E RRRIT RININË TË SHËNDOSHË PO- LITIKISHT DHE IDEOLOGJIKISHT, AI BËN DHE DO TË BËJË MEDOEMOS PËRPARA — Nga biseda me kuadro dhe me aktivistë të organizatës së BRPSH të rrethit të Shkodrës (29 prill 1966) .....	203—232
GRUSHTI FASHIST NË INDONEZI DHE MËSIMET QË NXJERRIN PREJ TIJ KOMUNISTËT — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (11 maj 1966) .....	233—251
DY PARIME THEMELORE TË METODËS SË PUNËS TË ORGANIZATAVE TË PARTISË — Artikull i bo- tuar në gazetën «Zëri i popullit» (12 maj 1966) .....	252—265
ME KËTO TEZA TË KINEZËVE NUK MUND TË JEMI DAKORD — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (14 maj 1966) .....	266—273
MBI EKSPERIENCËN E ORGANIZATËS SË BASH- KIMEVE PROFESIONALE DHE TË ORGANIZATËS SË RINISË NË RRETHIN E SHKODRËS — Fjala në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (19 maj 1966) .....	274—352



DEMOKRACIA NË KOOPERATIVAT BUJQËSORE KA ECUR MBI PARIME TË SHËNDOSHA — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (23 maj 1966) .....	353—358
TË ARRIJMË QË KOOPERATIVAT BUJQËSORE TË KENË SPECIALISTËT E VET — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (23 maj 1966)	359—363
KUR FRONTIN E UDHËHEQ NJË PARTI E VËR- TETË MARKSISTE-LENINISTE, FITORJA ËSHTË E PASHMANGSHME — Nga biseda me delegacionin e Komitetit Qendror të Partisë Popullore të Laosit (25 maj 1966) .....	364—373
TË NGREMË NIVELIN E SEKRETARËVE TË OR- GANIZATAVE-BAZË — Nga biseda me anëtarët e byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit (31 maj 1966) .....	374—386
PARTIA NA MËSON TË PUNOJMË USHTARA- KISHT — Nga biseda me kuadrot drejtues të Partisë, të pushtetit dhe të kooperativës bujqësore të Shalësit në rrethin e Elbasanit (1 qershor 1966) .....	387—419
TË MENDOJMË E TË VEPROJMË KURDOHERË SI REVOLUCIONARË — Nga biseda me kuadrot drej- tues të Partisë, të pushtetit, të organizatave të masave dhe të ushtrisë në rrethin e Librazhdit (2 qershor 1966)	420—450